SINAN HASANI

RRUSHI KA NISË ME U PJEKË

SHKRIMTARËT E RIJ SHQIPTARË

SHTËPIJA BOTUESE „MILLADIN POPOVIQ"
PRISHTINË 1957

SINAN HASANI

RRUSHI KA NISË ME U PJEKË

PRISHTINË
1957

P A R A T H A N J E

Vetë titulli i romanit „Rrushi ka nisë me u pjekë" po-thuej simbolizon zhvillimin e letërsís sonë të re, në gjiun e së cilës má në fund po botohet edhe romani i parë si njifarë kunorzimi i të mbërrimeve tjera në këtë lamí. E romani i Sinan Hasanit ka të gjitha cilsít për me qenë i tillë: fabulën interesante të tansishme, kompozicionin e mirë me paraqitje, grindje e zbërthime logjike, me tipa të gjallë, të diferencuem, me komponenta pozitive e negative, e ajo që ásht shum e randsishme me tematikë jo vetëm bushkore. por edhe aktuale, potþuej për herë të parë të cekun jo vetëm në letërsín shqipe ndër né, por edhe në përpjestime të përgjithëshme jugosllave.

Lindë më 1922 në katundin Pozharan të rrethit të Gilanit, Sinan Hasani rrjedh prej nji familjeje të vobektë katundare. Katër klasë gjimnaz i kreu në Medresën e Isa Begut në Shkup, e në kohën e okupacionit muer pjesë aktive në Luftën nacional-çlirimtare. Si i këtillë në vjetin 1944 u internue në Vjenë. Mbas çlirimit vazhdon aktivitetin politik në ndërtimin socialist të vendit tue krye detyra të ndryshme politike n'udhëheqsí të rrethit të vet dhe të krahinës. Mbas çlirimit kreu Shkollën e naltë të Partís „Gju-

ra Gjakoviq" në Beograd, e tash âsht deputet e popullit të Gilanit në Kuvendin populluer federativ të RFPJ dhe sekretar i Komitetit të Lidhjes së komunistave të rrethit të Gilanit.

Paraqitja e tij në letërsín shqipe menjiherë me roman, megjithëse jo identike, âsht shum e ngjajshme me paraqitjen e Dobrica Qosiqit në letërsín serbe. Prej idés së thjeshtë: me shkrue diçka për jetën bashkohore, për farkimin e së rés mbi frytet e Revolucionit dhe mbeturinat e së vjetrës s'errët, Sinan Hasani kalon drejtpërsëdrejti në mbledhjet landës si për memoare dhe mban ditarin. Si puntuer politik, ai merr pjesë aktive në jetën e bujshme, plot ngjarje, plot procese, këthime, thyemje, ndërtime, krijime. I bremë gjithnji prej shtytjes me shkrue për jetën që e rrethon, atê e preokupojnë tash plot motive, karaktere, tipa. Shkas i drejtëpërsdrejtshëm me kalue prej ditarit në nji formë mâ të caktueme letrare, erdh më 1954. Nji sekretar i organizatës themelore të Partís në katund martohet me dashuni me mbesën e nji pasaniku, te i cili ka pasë punue dikur si rrogtar. Çashtja ban bujë. Pasaniku reakcionar, dikur kryeparë në katund, qet fjalën për hakmarrje. Ndërhyn pleqsija, por edhe gjyqi. Interesohen të gjithë. Edhe Partija. E reja ngadhnjen mbi të vjetrën. Dy të rijt jetojnë së bashku, të lirë, pa frigë, pa pengesa, të mbrojtun prej së rés që po piqet, po then edhe pengesat mâ të mëdha para vedit.

Me shkrue për këtë martesë, për martesën e re e të vjeter — âsht idé e mirë. Por, me u kufizue vetëm në këtê, don me thanë me bâ nji reportazhë gazetare ose nji skicë, tek e mbramja nji tregim. E materiali i grumbulluem në ditar âsht i madh, jeta që po ndërtohet âsht e gjanë. Dhe, tue kalue rrugën prej landës së ditarit drejt në formën mâ të naltë të letërsís bashkohore — në roman, auktori paraqet nji landë të gjanë të ndërlikueme të jetës në katund. Ai nuk paraqet vetëm luftën e fuqive pozitive, progresive, me ato që tërheqin mbrapa, pengojnë, mundohen me ndalë shtresat e gjana të popullit në nji stagnacion të përgjithshëm, ai nuk ndalet vetëm me potencue depërtimin e fuqive përparimtare, ngadhnjimin e tyne, pjekjen e tyne si paraqitet simbolikisht në titullin „Rrushi ka nisë me u pjekë". Ai paraqet jetën e katundit në shum nyânsa, forma të ndryshme të jetës në katund, tue kalue edhe n'analizime e zbërthime psikologjike si të luftarëve për të rén ashtu edhe të kundërshtarëve të tyne. Prandej âsht shtrëngue me paraqitë edhe mbledhjet e ndryshme të Lidhjes së komunistave, Lidhjes socialiste, kuvendit të votuesave, luftën e mbrendshme të komunistave dhe t'antarëve të Lidhjes socialiste për kuptimin e demokracís socialiste, për ngadhnjimin e saj. Në këso vendesh s'âsht çudi të ketë kapërcye edhe ndonji element deklaracioni, fraze, parulle, të ketë pasë edhe zgjanime, por edhe ato nuk duken të konstruueme, sepse edhe jeta bashkohore n'etapën e sotshme të zhvillimit të saj në katund i ka të gjitha këto elemenete. E auktori âsht mundue me i qëndrue

sa më besnik zhvillimit të jetës në katund, paraqitjes pothuej raportuese të saj, shpeshherë edhe pa përdorë at metodën: me u nisë nga individualiteti, me kalue në tipizim, e prej andej me u kthye prap n'individualitet. Përshkrimi real, pothuej gazetaresk âsht karakteristikë themelore e romanit të Sinan Hasanit. Prandej, edhe s'âsht çudi që dikush të mundet me gjetë në roman vehten e vet ose dikend të njoftun.

I primë prej këtij parimi, auktori nuk ka mujtë me iu shmangë idés për paraqitjen e jetës në katund me të gjitha komponentat e saj. S'këndejmi edhe gjithë ajo gjansi platforme me nji galeri të tanë karakteresh, tipash pozitivë e negativë. Mirëpo, auktori nuk ndalet vetëm në pikturimin konvencional bardhë e zi të tipave dhe të situatave. Edhe në tipat më pozitivë ai gjen mbeturinat e së kaluemes që i shtypin, i ngurojnë i bâjnë të luhaten, të mendojnë. Shpeshë herë auktori i jep vetë edhe shkaqet, arsyetimet, rrjedhimet. Nuk ndalet në paraqitjen e procesit psikologjik që parapërgatitë, që paralajmon nji ngjarje a veprim, por e thotë drejpërsdrejti, e përshkruen veprimin.

Asht interesant se në tanë këtë galeri tipash disa janë nga ata që mbeten shum të gjallë në kujtesën e lexuesit. Kadriu, sekretari i organizatës themelore të Partis në katund, personifikim i ngadhnjimit të së rés mbi të vjetrën, i bindun si ndonji Nagulnov në fitoren e idés së socializmit dhe të demokracís socialiste — në jetën private, intime, ka cilsi e vese, dëshira e ngashnjime, të gjitha ato ndiesi të ngrohta të katundarit të dashunuem, të birit të vetmohueshëm, shtëpijakut puntuer. Madje, edhe te ai herë mbas here flakrojnë mbeturinat e së kaluemes, të cilat i largon nji vullnet i fortë, nji bindje e patundun që mbizotnon në tanë qenjen e tij. Kjo e ban figurë shum të gjallë, të qëndrueshme, bindëse. Shum interesante âsht edhe Fatimja, e dashtuna e tij, që len shtëpín e babës, shkel të gjitha prangat e mbrapambetunís e shkon te Kardiu. Hajrija që, edhe pse i përkulet fatit të parë, kur i vjen shpirti në gropë të fytit, ik prej ndytsís e imoralitetit. Interesante âsht edhe nji seri grásh e vajzash tjera të katundit.

Në roman âsht edhe nji tubë komunistash dhe aktivistash tjerë të katundit, të përshkruem me shum karakteristika të mprehta. Asht interesant se tipat negativë, sidomos ai kryesori, Sylë Hajdini, janë figurat më të plota në roman. Tip i veçantë âsht Dauti, nipi i Sylës, i cili ka hy në Lidhjen e komunistave si vegël e reakcionit dhe, edhe pse i këtillë, luhatet kur shef të gjitha ndyesít që bâjnë mbeturinat e mbrapambetunís e të reakcionit. Si i këtillë ai âsht shum karakteristik për nji përpunim më të gjanë. Aliu, katundari i mesëm që luhatet midis paris së vjetër, fuqive mbrapanike dhe fuqive të reja përparimtare, duhet t'ishte nji sintezë e jetës në katund, përfaqsues i nji shtrese të mesme, të cilën auktori synon me e transformue. Përkundër shum rendeve të bukura, në paraqitjen e kësaj figure bijnë në sy

tendencat e dukshme t'auktorit, që e bâjnë figurën e tij pak a shum të konstrueme deklarative.

Asht krejt e natyrshme që romani ka e lhe të meta tjera, që janë kryesisht pasojë e mungesës së përvojës letrare t'auktorit. Paraqitja âsht shpeshherë e thatë, e sipërfaqshme, pa thellime mâ të mëdha, pa përjetime artistike. Por aty këtu ka edhe përshkrime të bukura, episoda interesante, mendime të thella dhe — si tha nji shok në deklaratën që i dha „Rilindjes" në lidhje me këtë roman — në tansi „Romani âsht shprehje e njohjes së thellë të jetës dhe punës në katundin tonë. Njerzit, për të cilët flet auktori në roman, janë dhanë në mënyrë reljefe, me vetí të dallueme, individualitete që janë karakteristike për njerzit. Ngjarjet janë paraqitë gjallnisht, prandej besoj se romani do të lexohet me andje dhe interesim të madh".

Prishtinë, 20 fruer 1957

Vehap Shita

RRUSHI KA NISË ME U PJEKË

KISHTE disa ditë që ndërmjet erës së jugut dhe të veriut zhvillohej një luftë e rreptë. Por, një nate pranvere së hershme, jugu e fitoi mâ në fund betejën. Tash, ngadhnjyes, frynte me rrëmbim. Ushtima e tij ndëgjohej larg e larg. Uji rridhte currel nëpër korrizat e trashë e të gjatë, që i kishte ngulë të ftoftit e dimnit nën strehë të shtëpís. Ndonji prej tyne binte poshtë së bashku me ujin e borës, që shkrîhej mbi pullazin e shtëpís. Thyhej e bâhej copë-copë. Gjamën e jugut e shtonte sidomos arra e madhe, qufarrake, me rrema të shpeshtë e të xhveshun, që ngrihej n'oborr të shtëpís s'Ali Abazit të Bllatës. Në një çast u duk se u hap Karadaku i Shkupit, se u shem Stubllovaqa: e gjithë fuqija e erës u lëshue në dritaren e dhomës s'Aliut, ja shkeu gazetën e dyfishueme dhe, së bashku me brumin e thatë të miellit të grytë, ja hodhi një copë çerçivë në kambë e tjetrën në legen të mbë-

shtetun për muri afër derës, tue bâ rrapllimë të madhe.

Aliu, i trembun, e çoi kryet prej jastekut dhe, tue i fshi syt me dorë, shiqoi se si, me agimin e mëngjezit, era fshinte me të shpejtë bërllogun e mbramjes, që kishte mbetë midis dy shtrojave. Brofi në kambë, u drejtue kah trapazani dhe, nën tê, muer dy drûj të koftorit. Mandej rroku postaqín e shtrueme afër oxhakut dhe mbylli dritaren me tê, tue e forcue nga mbrenda me drûj.

Nuk u zemrue se iu prish qetsija, pse filluen me iu përsëritë në mend të këqijat e dimnit — ditë e natë aty, truq, mshelë me gjindët e shtëpis. S'po i dilet në krye: „Unë s'e kam rendin me u qitë gjâve! „Ti e more copën e madhe!" „Pse po i merr nga dy lugë?" „Lum baba, blema nji fiston të ri!" Ani kjo: „Jemi mbetë, ore njeri, pa asnji rrem drû. „Tybe edhe miell kemi vetëm për nji kulaç". „Hani mâ shpejt e bina, se po na soset edhe qekjo pikë gaz". „Po më dhambin eshtnat..." Njani ja thotë kangës, tjetra i mshon defit... ky merr librin e flet diçka që as vetë nuk e merr vesh — Jaaa, veç m'u trenue! — dhe, tue bâ fajtuer dimnin e borën për të gjitha këto halle, bani me dorë:

— Poo... Edhe ty t'u çue bereqeti!... Boll na ke lodhë... Syt mos t'i pafshim!... — dhe shkoi kah teshat që, mbramë, i kishte lanë truq mbi shtrat.

Përmbi tlinat e gjata veshi tirqit e zez të harrnuem në gjûj, e naltë jelekun prej doku dhe mbështolli, tue dredhun, shokën lahore të vjetër rreth belit. Posa e zgjati dorën për me marrë prej shtrojës edhe gujën e zezë dhe me e qitë krahëve — hyni e shoqja. Në nji dorë mbante kacín me prush e, në tjetrën, nji kalanicë. Ndën sjetullë i zbardhonte nji gjymës buke misri e pjekun me çerep. Kalanicën e bukën i vû mbi koftor, e prushin e shtini mbrenda, tue u mundue me ndezë zjarmin.

— Ore njeri, a ta v'noj ibrigin me t'u vokë uji për abdes? — i tha grueja, mbasi u çue në kambë e u kthye kah dera me dalë jashtë.

Aliu e shiqoi mërzitshëm.

— Dishka nuk jam tue mujtë...

Dera u mshel, e ky mbet në mendime. Iu kujtuen fjalët e hoxhës, ndigjue në xhamí: „Në koftë se harron me krye farzin, nuk âsht aq gjynah. Po — në koftë se dikush ta shtin ndërmend, e ti nuk e kryen — ki m'u djegë në zjarm të xhehnemit..." Solli kryet:

„Hm, nuk kqyr punët e veta, po..." — dhe shtyni jorganin kah muri, lau fëtyrën e, mandej, u drejtue kah koftori dhe u ul në shkambin e ultë. Me lugën e drujtë nisi me përzie fasulin që kishte mbetë prej mbramjes, e me dorën tjetër me rrotullue bukën. Pjesët e bukës, që rreshkeshin, i shtinte në gojën e madhe, lëvizte fulqít e thata dy tri herë dhe i përbinte me shije.

Agimi i parë dhe drita e zjarmit që dilte prej koftorit ja vêjshin edhe mâ tepër në dukje fytyrën e mprehtë e të zbehtë, syt e larëm, hundën e drejtë dhe kryet e rruem, të mbuluem me plis të bardhë. Edhe pse në moshën pesëdhetë vjeçare, ende ishte i fortë dhe i pashëm.

Kur avulli filloi me dalë prej kalanicës, drita zbardhoi mirë. Aliu theu nji copë bukë dhe me „bismilah" nisi me hangër.

— Kuku, gjysa e ditës e jorganat hala në shtrat! — bani grueja tue hy mbrenda. La nallanet dhe shkeli zbathun në shtrojë. Dimít basme, të lidhuna me mbështjellak të kuq, fanella e barrdhë e ngjitun për trup dhe shamija ngjyrë kafje, e shtrëngueme për kreje gadi deri te vetullat — e shquejshin si grue të shpejtë e të zojën. Tue i palue të dy jorganat në dy anët e shtrojës ja lëshonte syt e kullum burrit, i cili kqyrte punën e vet. Jorganat, mandej i la mbi trapazan, shtyni kashtën që kishte dalë jashtë druve që kufizojshin tokën me shtrojë, ngrehi në vendin e vet qylymin e arrnuem e cergën e vjetër dhe rendoi rreth murit jastekët e mbushun me cukla. Muer ibrigun dhe, tue qitë ujë me nji dorë në tjetrën, stërpiku tokën ndërmjet dy shtrojave deri te dera dhe, mâ parë, fshiu shtrojat, mandej edhe tokën. Aliu hante e as që vente re pluhnin që ngrihej si mjegullë prej shtrojave.

Çoi kryet vetëm atëherë kur grueja, tue fshi tokën, iu afrue krejt ngat dhe i tha.

— Ore njeri, leju pak kaftjall edhe fëmijve.

— Ti nuk durohesh pa folë! Thot njeriu se më ka hŷ tëprija e due me e hangër krejt, — tha mrrolshëm e me vedi: „Ti po don me më mësue, shkeka e truene!"

N'ato fjalë hyni Hasani, djali mâ i madh.

Aliu e la lugën në kalanicë me: „Zoti të falt e të bâft bollëk!" dhe i fërkoi duerët:

— Eja, bre, e haj nja dy tri gojë bukë. Duhesh me shkue e me prû ndoj krah drû. Apo sheh — jemi mbetë pa to!

— Nuk jam untë, agë.

— Hec, more, ungju! — i tha e ama.

Aliu u çue, muer opangat e çarapët që ishin varë për tran mbi qyngat e koftorit, u ul në shtrat dhe filloi me u mbathë.

Djali i përngjante mâ tepër nanës se babës. Fëtyrën rrumbullake, syt e gështéjtë me vetulla të zeza mbi ta. Gjashtëmbëdhetë vjeç. I veshun me setër e pantollona të zhgunit të bardhë, me plis të ri në krye. Teshat e bardha ia vejshin edhe mâ tepër në pah fëtyrën e zeshkët. Në gojë i shtinte kafshatat e mdha të bukës, ndërsa fasul merrte me maje të lugës që la baba. Këtê e bante me qëllim që të mbetej edhe për të tjerët.

Mbasi ndreqi dhomën, grueja shkoi poshtë. Aliu, tue mbathë ende kambën e djathtë, filloi me mendue për të mbjellat e pranverës:

„Arën rreth shpís do ta mbjellim kallamoq, vetëm nja tre konop do t'i lamë për duhan; prroni po ka ujë sa të duesh për vadën e tij. Qe — hallku u banë çirak me tê. Pare prej hyqymetit — po... për vedi me pi — po... e, besa, ndoj kile po iu mbet edhe me shitë, ashtu — mbas dore... — sa me mshelë ndoj birë të shpís".

— Ooo, Ali — oj! — erdhi nji zâ prej derës s'oborrit.

— Oo — hojaa!... Dil, bre, e shih se kush â!

Djali muer kalanicën e bukën dhe duel tue bërtitë prej çardakut:

— Ooo, qe — qe!

Mbas pak hyni në dhomë, imami i atyne katundeve — mulla Rexhep Azemi. Përshëndeti qysh prej dere:

— Selamun alejkym, Ali!

— O alejkymy selam, hoxhë. Bujrum, — përgjegji Aliu tue u çue në kambë.

Hoxha u ul në ball t'oxhakut, n'anën e djathtë, ku ulen njerzit e çmueshëm, tue u përgjegjë në pyetje t'zakonshëme me dorë në zemër. Aliu muer prej dollapi paqetën e cigareve „Drava", ia qiti nji cigare e nji e ndali për vedi. Djali nxuer prej koftorit gacën, e vuni në nji bujashkë dhe me dorë në zemër, ia afroi hoxhës e, mandej, edhe t'jatit.

— Hoxhë, kafe s'na ka mbetë, por po bâjmë ka nji çaj — tha Aliu mbasi e ndezi cigaren, dhe iu kthye djalit: — Vene gjygymin!

— More, hiç mos iu hyn këtyne punëve. Pse po ngushtohesh?

— Nuk âsht ky kurrfarë ngushtimi. Të lumshin kambët që ke ardhë me na bâ zijaret. Po... hiqi kundrat e shlirou. Ndihmoj, bre, shka po kqyr!

Tue thanë se âsht i pangaeshëm, hoxha i zbathi këpucët e llastikut me ndihmën e djalit. Po — shihej se diçka nuk ishte i qetë. Prej lëvizjeve të syve dhe të krés dukej se donte me thanë diçka, po — ngurronte. Nuk ishte puna se nuk dinte me ja fillue bisedës, për të cilën kishte ardhë, por — aty ishte djali, e nuk dëshironte me folë në pranín e tij. E — kohë nuk kishte: ende pa zbardhë drita e kishte thirrë njeni prej Bllatnjanëve që t'i frynte dhe t'i shkruente për djalin e sëmundë.

— Shko, bre sokol, e blema nji paqetë cigare. Jam mbetë pa to...

Aliu ja preu fjalën tue ja qitë flutrim cigaren tjetër:

— Mos na korit, hoxhë, pash zotin! Qe kemi cigare.

— Allahile, mos fol kështu. Po unë në shtëpín tande, Alio, sikur me kanë në temen — tha hoxha, megjithëse kjo ishte hera e dytë që vinte te ai në këto dy vjet. — Po dishka me koll nuk jam mirë.

S'po muj me pi çfarëdo duhani — dhe filloi me u kollitë me zor, tue e shti dorën në xhep të xhybes. Rastësisht, bashkë me njiqind-dinarshen, nxori edhe hajmalín që ja kishte bâ gadi atij katundarit për djalë.

— Mirëde, mirë — tha Aliu. — Shko, bre bir, veç — ktheu shpejt!

— S'ka nevojë m'u gutë... Le të shkojë kadalë — tha hoxha, e me vehte: „Unë sa ja mbusha mendjen me u largue e ai: „ktheu shpejt! Qe de!" — Hajmalín e shtini në xhep, e djalit i dha paret:

— Ma merr nji paqetë cigare „Morava" e me paret tjera blej dishka për vedi. Blej sheqera të kuq, epju edhe fëmijve tjerë.

Djali muer paret dhe shkoi.

Tash mbetën vetëm, por — „si me ja fillue?.. jo menjirendi... diçka tjetër..." — zihej hoxha ndër vedi.

— Jemi konë rahat, Alio, sa e kishim dyqanin e agës Hajdin në mahallë. Hem â konë ngat, hem mall ka pasë.

Aliut i ra ndërmend se si qe pasunue Hajdini me veresí, fajde e shtrejtësí. Luejti kryet dhe çoi vetullat.

— Shka me bâ, more hoxhë, kërkuj nuk ja kanë dhanë përgjithmonë.

— Jo, jo s'kemi shka me bâ, le të shkon deri ku të shkon.

Aliu muer nji gotë të çajit në dollap, ja fryni pluhnin, i hodhi pak ujë prej ibrigut, dhe — mbasi e solli dy tri herë, e derdhi ujin. Hodhi në gastare nji kokër e gjysëm sheqer, lëshoi në të lugën e vogël, mandej qiti çajin dhe ja dha hoxhës.

— Byjrum! Unë qe sa piva — tha, megjithëse vetë as nuk e kishte kërkue. Donte me u paraqitë si „terjaqí" që pin çaj çdo mëngjez.

Hoxha nxor prej xhepit dy cigare tue u ruejtë që mos ta hetonte Aliu se e kishte paqetën plot.

— Më paskanë qëllue... hâ, kalle edhe ti njâ temen — e me vehte: — „Erdh koha, s'kam shka pres — fjalët janë gadi".

— A s'po më pvet për shka kam ardhë, a?

Aliu çoi kryet dhe e shiqoi si në habí.

— S'âsht adet, hoxhë, me e pvetë mysafirin pse ka ardhë!

— Unë, allah emrile pejgamber kaullile, kam ardhë — msit: Taf Sadiku i Moravës po ta lyp çikën për djalë — bani hoxha tue e shique drejt në sy.

Me t'u përmendë: allah... pejgamber", Aliu luejti vendit, e kur e ndieu fjalën „çikë", e uli kryet dhe mbet si i shtanguem.

— Hajrli koftë — tha mbas pak me njifarë buzëqeshjeje — Veç, çika âsht e vogël, trembëdhetë vjet i ka. E... mandej... âsht edhe nji punë tjetër...

— A din si âsht: unë e kam pa mynasip e kam ardhë, se këto farë punësh nuk i kam në huj — ndërhyni hoxha tue limue mjekrrën, megjithse nuk kishte lesh në të. — Pasha këtë çallëm — dhe e hoqi me të dyja duerët prej kres — mos me konë Tafa nipi jem, menjirendi kisha me ja dhanë çikën teme. E — mbasi unë kisha me ja dhanë çikën teme, haki âsht që edhe ti me ja dhanë dorën.

Heshti pak dhe vazhdoi:

— Djalin e ka si asllan. I shëndoshë, i ri, i hjeshëm, puntor i mirë. Nuk âsht hajlaz — me hupë vakt poshtë e përpjetë, sikur që po bâjnë sod disa të rij. Poo — u prishën more, rinija e sotshme! Secili minik don me dijtë mâ tepër se plaku gjashtëdhetë vjeç. Ky, Alio, nuk âsht i asaj dore. I ban ihtát babes e nanës, plakit ja ban ikramin dhe — dreq me gojë nuk di me i thanë kuj...

Prap e lëmoi mjekrrën dhe shtoi:

— Për idare mos pvet: tokë boll — tash i ka marrë nji pendë kije të ri, sa toka prej tyne po shembet. E ka nji magar, të mbushet mendja se pesqind kile i çon. Kerrin, përnjimend nuk e ka të hekrit, por âsht me dy parë llojtra. Shpín — njiherë në tokë, po si po ja shof mendjen, po don me e çue në dy kat. Uji i hec rekës poshtër, pemë sa të duesh. Të gjitha ja ka dhanë zoti — zahare njeri i drejtë... Mos më zafsh mue besë, pvet edhe për

okolla. Po s'ki çka pvet, pse, të gjithë me të rrêjtë, unë nuk muj. Zoti e Pejgamberi e kanë lanë rrenën haram. Me të thanë të drejtën, msitnín hiqe s'e kam në huj. Po, zahare m'u bâ sebebxhi... N'e pastë bâ zoti kismet... sa ta kenë ymrin kanë me u kënaqë... A, si po thue, Alio?

Aliu e ndigjonte tue shique para vedit. Kësaj here nuk ishte aq i prekun, si atëherë, kur e pat dhanë çikën e madhe. Atëherë i dhimbej fort çika — nuk ishte mësue me qitë kend prej shpís. I dhimbej edhe jeta e tij, pse — përcjellja e çikës ishte edhe shêji që vërtetonte pleqnín e tij. „Edhe pak e po bâhem babgjysh" — mendoi atëherë. „S'e di kur dhe si më kapërcei ymri??"... Tue mendue për këtê, tash, as që e ndigjoi pyetjen e fundit të hoxhës.

— Asht mbetë adet, Alio, me marrë e me dhanë — tha hoxha, thue se e kuptoi çka mendonte, por mâ tepër me qëllim që t'i përgjigjej në pyetje.

— Miku koka i mirë, mall paska boll. Pale... duhet me u marrë vesh edhe me fëmí. Ndoshta duhet me pvetë edhe për okolla. Në koftë kismet — po more, qysh jo.

— Mirë e kí. Nuk po ban pa u marrë vesh me fëmí për këso punësh. Ka ardhë zemani i ri... Me nji vakt, ndryshe â konë. Mirëpo, atëherë ka pasë burra. Kur shkojke msiti — kallxojnë — e pritte baba ose ndoj i veti edhe pa e pvetë gruen ja dhâke dorën e çikës. E grueja? — Grueja as ciu nuk guxonte me bâ! E tash? — Tash pa e dhanë fjalën nana e çikës, dora nuk ipet. Qysh janë tue shkue punët, kadalë dalë do të bahemi mexhburë edhe çikën me e pvetë! Njani më tha se nji i pari i Beguncës kish thanë: „Kurr i Kabashësi nuk ka me e marrë çikën teme!" Mirëpo çika kish pasë thanë: „Veç aty due me shkue". Grueja e tij i kish bâ razi tjetër në shkí dhe i kish çue fjalë msitit. Porsa vjen ky, mâ vonë vetë ja jep dorën. E-ee kuku për të Beguncin!... Burrit të shtatë gjaqeve, bishti i grues me ja kthye fjalën! Në këtë punë, jo qi janë bâ grát të barabarta, por na e kanë teprue. Qetij rregjimit të sotshëm le t'ja dijnë hedije, se beli vallahin ka çue kryet!

Nxuer tespihët me kokrra të vogla druni ngjyrë kafje e me tufë të kuqe dhe filloi me i njehë pa i luejtë buzët. Mundohej me ia paraqitë punën sa mâ bindshëm.

— Po ty, mashallah, t'u kish rritë edhe djali bajagi shum. Ish bâ burrë, për martesë, belivalla.

Aliu luejti kryet në pajtim dhe bâni ngadalë si kur flet i sëmundi:

— Qekjo gadi po më pengon: qysh me dhanë dorën e çikës para se me i zanë nuse djalit? Ai âsht mâ i vjetër se çika.

Ck, ck, ck!... — filloi hoxha me njehë tespihët me shpejtësí. „Tash të shkela n'urëz!" mendo.

— Po, a din ku qëndron puna? — tha tue u çue në gjûj.

Aliu ja zbardhoi syt.

— ?!

— Unë kam ardhë me dy amanete...

— Qysh me dy amanete?! — bâni në dyshim Aliu.

— I Moravsi ka qejf me trashë miqasín me ty: Ti me ja dhanë çikën për djalë atij, a ai ty çikën e vet për djalin tand.

Aliu ktheu kryet me nji anë dhe ngriti vetullat. Buzëqeshi pak, por u mrrol shpejt. Buzëqeshi pse i shkoi përshtat kjo që tha hoxha — me martue djalin pa e ndie shpija. U mrrol — pse iu kujtuen disa gjana të randa që kishin ndodhë aty pari në lidhje me këso fejesash e martesash.

— Mirë, bre hoxhë, po mos âsht gjynah me bâ këso farë fejesash e martesash? Shum hallk nuk kanë mujtë me u bâ rahat.

— Gjynah? Unë ju thash at ditë në vajzë: me qitap mundesh me marrë çikën e hallës dhe — pesë pare mos jep! Mandej, në koftë se vdes vllau merre serbez gruen e tij — sherijati e jep. Po kjo nuk ju nget këtyne aspak. Asht shum mâ e largët. S'ka këtu gjynah. Jo... s'ka gjynah!...

— Po, po, por unë e pata për tjetër — u përzie Aliu. — Kątër vetë po duhet me i bâ razí. Ndoshta ndonjani prej tyne nuk bje n'udhë. Mbasandaj du-

het me hy llugave... Fëmijt nuk po ndëgjojnë si përpara... âsht prishë dynjaja... Qe, meselá: ai i Trsteniksi ja dha motrën të Komogllavsit për grue, e i Komogllavsi ja dha çikën të Trsteniksit për grue. Çika e të Komogllavsit i ik nji ditë të Trsteniksit. I Komnogllavsi nuk ja ktheu motrën. U bâ ngatrresë. U rrehën, veç që s'mbetën në vend... Në fund, i Komogllavsi, si po thonë hallku, u desht me ja dhanë të Trsteniksit njizeteshtatëmijë banka... Unë s'jam asi njerí. S'muj me iu hy këtyne punëve!

Meqenëse hoxha e dinte hollsisht këtë punë, pse kishte marrë pjesë edhe vetë në të, ndërhyni:

— Ndryshe â konë me ta. Ata të dy janë konë të martuem. I kanë marrë ndër ortake. Për atô edhe nuk kanë mujtë me u bâ razí. E kjo...

Aliut iu kujtue tash ai rasti i Novo-Brdës me atê të Makreshit, për të cilin i pat dëftue miku i tij. Filloi me i përsëritë fjalët e tij me vedi: „Dy në vend, e nji i plaguem. I Makreshsi ia pat marrë motrën këtyne të Novo-Brdës, me kusht që njanit prej tyne me ja dhanë motrën e vet. Para se me ja dhanë motrën, jau kish lëshue motrën e tyne u kish çue fjalë: Mbasi t'juejën jua lëshova, mos mbani ymyt për temen. Nuk muj me jua dhanë. Ato ditë, ani, erdh prej askerit djali, për të cilin ish konë dhanë motra e këtij. Bâhen nji natë pesë a gjashtë, me pushkë e alltija, e i binte të Makreshsit në shpí. Ja lëshojnë ka nji patare dhe i bâjnë hygjym në derë. Mirëpo — dera mshelë! Kcejnë për dallapi. Kcen mbrenda me pushkë i pari. Makreshsi i bje sakicë krye. Derisa hyn i dyti, ky i bje edhe disa herë të parit. Edhe të dytin e gjen po kjo e zezë. Të tretit, tue kqyrë për dallapi pse nuk p'i dalin vllaznit, ja lëshon edhe këtij sakicën në krah dhe e le pa dorë. Të nesërit shka me pa te shpija e të Makreshcit?! Trupi me t'u tërqethë, flokët me t'u çue përpjetë — dy xhenaze si stërvinë. Njanës trutë të shkapërderdhun nëpër tokë, e tjetra pa kambë e pa sy. Mbrenda në shpí — plot gjak, sikur me pasë pre nji pendë kije."

Aliu u tërqeth dhe e pyeti hoxhën:

— A e ndjeve shka ish bâ në Makresh?

— Zoti na ruejtë prej taksiratit! — tha hoxha. Kjo, bre vlla, âsht bâ në nji vend... e juve s'mundet me ju gjetë. Ju po i ndërroni çikat për djem. Çikat e reja për djemt e rí. Mbasandej — a e dini si âsht: nuk jeni ju të gjakut të nxêtë. Keni m'u bâ rahat. E... të drejtën me ta thanë — âsht edhe tjetra. Në hesap nuk ki me u nda bash keq! Ti p'e sheh vetë: nji martesë që po bâhet me pare, p'e qet shpín dhetë vjet përmbas. Këtu s'ki shka harxhitesh... Për të mirën tande po të thom.

— — — — — — — — — — — — — — — — —

Aliu u kollit randë, tue mbajtë gjoksin me dorë. Hajrijen e kishte çue e ama me pastrue dhomën, ku flêjshin Hasani, Hajrija dhe vllau i vogël. Dhoma ishte ballë për ballë me atê ku po bisedonte Aliu me hoxhën.

Mbasi çoi shtratin dhe fshini tokën, muer krahnin e shpeshtë dhe filloi me krehë flokët e turrshëm para pasqyrës së varun në mur. Herë i ndante me nji anë, herë në tjetrën. Shiqonte me sy të njomë fëtyrën e vet rrumbullake që prej punës iu kishte skuqë edhe mâ tepër. Me gishtat e hollë i ngjeshi dhe i ngrehi vetullat përpjetë. Tue sjellë qafën e gjatë, e çoi shamín për herë të parë dy gishta mbi ballë. E hoq prej gozhdës pasqyrën dhe e vuni mâ poshtë. U largue pak, ktheu kryet shiqoi në pasqyrë pjesën e poshtme dhe të mbrame të trupit.

Kur baba u kollit, ajo u trand. Kishte frigë se po e shifte prej dikah. Mbathi shpejt nallanet pa çarapa dhe, mbasi qëndroi pak, duel në çardak tue çelë dhe mshelë derën me kujdes. Jehona e zanit mesatar të hoxhës, „për të mirën tande po të thom", ja ndali hapin. U ndal te dera që të ndigjonte se për çfarë të mirash po bisedohej.

— Epja çikën e merre dorën... Po deshte bane mend edhe ndoj ditë.

— Të shofim, hoxhë... në koftë kismet... Edhe ti thae se po duhet me pvetë gruen për këso punësh. Hajde — në ket t'êjte.

„Për mue flitkanë!" — pëshpëriti Hajrija dhe mbeti si e shtangët. Filluen me iu dridhë kambët dhe

me e lëshue laku. U mbështet me nji dorë në drunin e shkallëve, e me tjetrën ngrehi shamín e kuqe deri te vetullat, si të kishte ajo faj që bisedohej për të. Fëtyra e kuqe muer ngjyrën e verdhë. Përbini pshtymën tue i mshelë syt, e dy lot iu rrokullisën në të dy anët e hundës.

Qante, jo pse ja kishte vû synin ndonji djaloshi, por mosha e saj ende nuk kishte dhanë kurrfarë shêji se ishte bâ për fejesë e për burrë. I çoi mendët te shoqet e saj. Milica dhe Rabija, që këtë vjet mbarojshin klasën e tetë. Këtê e nxori Aliu prej klasës së dytë të fillorës. Ja rriti, atëherë, vjetët në rregjistrin e gjendjes civile: prej nandëve ia bani pesëmbëdhetë. Thonte: „Asht vjetrue për shkollë." — „Ato tash janë tue ndëgjue mësuesin ulë në banka. E unë? Qe se çfarë fjalësh ndjeva..."

Zbriti poshtë, u mbështet për shkallësh dhe filloi me mendue. Lotët i rrshqitshin faqeve, qante pa zâ.

„Kujt me ju ankue? T'i thom nanës!... Të shkoj te sekretari i rinís!" Tash lotët iu ndalën. Shiqonte në nji drejtim të caktuem.

„Me i dalë razís babës e nanës, shka kanë me thanë hallki? — Rospi?... Jo!... Si krejt dunjaja edhe unë" — dhe duel n'oborr e shkoi kah pusi.

— — — — — — — — — — — — — — — — — —

Djali erdh dhe ja pru hoxhës cigaret. Ishte mbushë frymë tue shpejtue, se kishte me shkue për drû.

— Eh, bafsh hajr, bre bir! — tha hoxha, tue ia kthye sheqerat e mbështjellun në letër. Mendoi:

„Mund të pajtohet, e — mâ mirë âsht me jau shti ndërmend me kohë, se këtë punë nuk jam tue e bâ për shpirt të babës. N'desht lirë të kuqe, n'desht vleftën e saj — gjashtëqind banka. Edhe prej të Moravsit — po aq. „— dhe lëmoi mjekrën. „Me këto pare e me hak të ramazanit, ja qes rrethin edhe nji hekteri. Ku e di shka mundet me më gjetë... Bare ta kam tokën teme".

— More ishalla, Alio, do të jenë mynasip, e do të bâhet puna. Kam qejf se jo për tjetër. Nuk âsht puna tu nji bakshish. Asht mbetë i shkreti adet.

Asht mbetë, âsht mbetë! — dhe ja qiti nji cigare Aliut.

— Po mbathna, Alio, se jam pa ngaé.

— Rrina, bre hoxhë, në sillë!

— Shëndosh, kur të kryejmë punë. Atëhere e zgjatim.

Aliu ia pruni këpucët. Tue u ngritë në kambë hoxha tha:

— Izën.

— Izën prej zotit.

KADRIU, porsa u kthye prej seminarit që ish mbajtë pranë komitetit të rrethit, caktoi mbledhjen e organizatës themelore të Lidhjes së komunistave të Bllatës, për nesër mbrama, në paralelen e vogël të shkollës.

Në seminar e kishte përcjellë me kujdes referatin e paraqitun dhe diskutimin që ishte bâ rreth demokracís socialiste. Shum gjana të referatit dhe të diskutimit mundohej me i lidhë aty për aty me gjendjen dhe organizatën e katundit të vet. Kjo gjâ i sillej nëpër mend edhe rrugës tue ardhë në shtëpí, në mbramje kur ra me fjetë, edhe të nesërmen tue çelë hendekun rreth arës së vet.

... Në mbledhje erdh nji orë përpara, me qëllim që të përgaditej. Ndejti në nji bankë t'ultë dhe të shkurtë, që ishte e para në rradhë të tjerave. U mbështet në to tue drejtue rruzën, pse ishte lodhë, gjithë ditën kishte punue.

Shiqonte kah dera dhe mendonte: a thue do të mundet me i theksue gjanat kryesore?... A do të diskutojnë shokët?... Çka do të thotë dhe çfarë përshtypjeje do të ketë shoku i komitetit për organizatën e tyne dhe për atê si sekretar?...

„Duhet të flas edhe për do suksese që ka mbërrijtë organizata jonë, e jo vetëm për të metat. Sigurisht analizimi i problemeve do të bâhet në këtë mënyrë mâ real e komunistat do të mobilizohen edhe mâ lehtë në luftë kundër dobësinave dhe për detyrat e ardhshme.

Nxuer fletoren e shënimeve me nji laps të vogël dhe filloi me lexue ato që kishte shënue në seminar. Disa, mâ kryesore, i nënvizoi. Aty këtu shënonte midis tyne ndonji fjalë për me i plotësue me gjana mâ konkrete. Çoi kryet kah dera. Rrudhat mbi vetullat e zeza e të trasha e bâjshin mâ të mrroltë fytyrën e tij të zeshkët. Mandej i lëshoi prap syt e zez e të thellë në fletore dhe vazhdoi me shkrue. Flokët e mëdhêj e të zez i bijshin mbi ballë. Nji çast u ndal... Tue shique fletoren pëshpëriti:

— Shum i përziva! Nuk do të muj m'i lexue!

E ktheu nji fletë të pastër me qëllim që të bante nji koncept të shkurtë e të qartë. Po...

Sa ja filloi punës, dikush trokiti dy herë dhe, pa pritë lejen, hyni. Ishte antari i komitet të rrethit.

— Mirë mbrama, Kadri!

— Ooo, mirë se na erdhe, shok Fazli! — bani Kadrija dhe brofi në kambë.

— Si je?

— Paj, mirë. A mujte?

Fazliu nuk kishte mundë me u nisë heret prej Vitine. E kishte zanë nata afër Bllatës. Qëlloi mu n'atë kohë, kur bora ishte shkrî. Nëpër rrugët e Bllatës ish bâ lloç i madh. Edhe ditën njeriu e kishte vështirë me kalue. Në disa vende i humbshin kambët në lloçin e trashë, tue sharrue deri në gjûj. Atëherë vetëm që nuk i shante katundarët: „Dembelat... Këta duen forcë!..." e tue i lidhë këto mendime me atê që kishte me folë në mbledhjen e sontshme: „Ndoshta udhëheqësat në katund...

ndoshta na vetë e kemi fajin... Nuk âsht lehtë me udhëheq..."

Tue shique tash pantollonat e këpucët, që iu kishin randue prej lloçit, iu përgjegj si n'idhnim:

— Erdha ngadalë... Shum lloçin e kishit... Memzi kam dalë. Duhet me marrë masa që t'i ndreqni këto rrugë.

Kadriu e ktheu kryet n'anën tjetër.

„Qe, neve goja na u shkye tue folë nëpër konferenca, e ky — duhet me marrë masa! Nuk e din se katundarit në këtë vesh po i hyjnë e në tjetrin po i dalin... Demokraci..." — mendoi, e për me la vedin tha me zâ:

— Këtij populli s'mund i bje njeriu në fije. Kur ka lloç të gjithë e apin fjalën: si të përmirësohet koha do të punojmë në rrugë. E kur bâhet moti i mirë dhe thahet toka — po harrojnë, ose po thonë: „Tash âsht vakti i punsë!"

— Nuk âsht puna se populli nuk don me punue, por don me e udhëheqë dikush. Më duket se fajin e ka këshilli i komunes dhe këshilli i rrethit. Po, kemi faj edhe na vetë që nuk e ashpërsojmë këtë çashtje në mbledhjet e ndryshme, tue kërkue që të mirren vendime. Atëherë dembelave dhe sabotuesave nuk kish me u mbetë vend — heshti pak dhe shiqoi Kadriun. — Kur duhet me fillue mbledhja?

— Mbasi të hanë darkë shokët. Po ti... shlodhu pak.

Fazliu e hoq palltën e gjatë dhe e la mbi nji bankë larg tavolinës. Nxuer prej xhepit cigaret dhe shkrepsën. U ul në vend të Kadriut dhe ia zgjati kutín e cigareve.

— Urdhno!

— Faleminderës, nuk e pij — dhe, si me mëshefë diçka, muer shpejt prej tavolinës fletoren e lapsin dhe i shtini në xhepin e gujës së shkurtë. Mandej, i kënaqun për diçka i futi duert në xhepa të pantollonave të zeza shajaku, harrnue në nji gjû me harrën të kullum e pê të bardhë. „Mbasi faji qenka te këshilli i komunes dhe te ju në rreth, atëherë — hahet kjo bisedë" — mendoi.

— Unë erdha pak mâ heret. Tash të kqyri...

— Hê, hê, a je përgaditë për mbledhje?

— Nuk dij shka me të thanë. Prej djehit kam mendue, bile edhe tash i kayra pak shënimet.

Fazliu e ndezi cigaren dhe ngrehi tymin.

— Kur kam qenë i ri, në kohën tande, mbajsha mend mâ tepër. Sa viet i ke?

— Njizet e dy, shok Fazli. Po ti, sa i ke mbushë? — e pyeti Kadriu tue e shique.

— Eee, sa i kam mbushë... sa të duesh! I bana katërdhetë. Vjet ndoshta nuk kam shum, por, me të thanë të drejtën, nuk jam kah e ndiej vehten mirë. Po ftofem shpejt... Po lodhem. Ndoshta gjurmat e luftës... Kam pasë mendue se kur të kryhet lufta nuk do të kemi mâ aq punë... Por qe. edhe tash po duhet me punue pa ja dá — nuk duel ashtu.

Nxuer krahnin prej xhepit dhe krehi flokët e thimë — ngrehi jakën e këmishës së bardhë, mrroli fëtyrën e gjatë, nxuer gazetën prej xhepit dhe filloi me lexue.

Kur Fazliu përmendi luftën, Kadriut iu kujtue nji moment i saj. Nuk u durue pa e pyetë:

— A ke qenë edhe ti, katërdhetë e dytën, në Karadak të Shkupit me çetën e „Zejnel Hajdinit" dhe arradhën e Crnotravës, kur u bâ akcioni në Llojan?

— Kam qenë n'akcionin e Llojanit.... të Crnolevës... në luftën e Livoçit... — përgjegji tue shique gazetën.

Kadriu deshti me i thanë: të pyeta se m'u kujtue nji bisedë që u bâ atëherë në shtëpín tonë ndër mjet babës e mixhës. Atëherë kisha njimbëdhetë vjet, por i mbaj mend ato fjalë sikur me u pasë folë sod.

Dhe u zhyt i tanë në të kaluemen...

*

Ishim tue ndejtë mbas darke n'odë. Ende nuk e kemi pasë shtie koftorin edhe pse ishte vjeshtë e vonë Vransinat bâheshin gadi me lëshue borën. Baba e mixha zunë dy anët e oxhakut. Unë isha ulë në shkamb, kur baba i tha mixhës:

— Na i pamë katër-pesëdhetë... po kish pasë edhe tjerë, se këndojshin dhe bisedojshin nëpër mal.

Të gjithë djem të rí ka njizet vjet. Ramë në rojë me Nezirin. Kjo na çoi te komandanti i tyne, i cilí ishte tue kqyrë nji haritë të madhe.

— Vdekje fashizmit, shok komandant— i tha roja.

Ai çoi kryet e u përgjegj:

— Lìri popullit!

— Këta dy katundarë të panjoftun, hasën në mue.

Komandanti na i lëshoi syt prej majes së krés e deri në fund të kambëve. I tha rojes:

— Shko ti në vendin tand!

Bash na hyni friga. Mirëpo, ai nxeur. kutín dhe shtoi:

— A e kallim ka nji?

Kush janë këta gjindë, ishte gjâja kryesore që na mundonte n'at sahat. Secili që shihej aty pari ishte i shtrenguem mirë dhe i armatosun. Yj e flamuj të kuq në kapuça. Disa kishin çelë librat dhe këndojshin. Disa kishin ra me fjetë. Flejshin — dhe nuk flêjshin. Pushkët i mbajshin në dorë, shtrëngueshëm për vedi. Dy gra të veshuna si të gjithë tjerët, ziejshin darkën në nji kazan. Nji kali me samar, lidhë për ahu hingllonte kanjiherë. Ndoshta kërkonte m'i qitë me hangër. Më shkuen syt kah Lajthija e madhe. E pashë tokën pak të çapuritun. Kqyra mâ mirë, kur, shka me pa — nji vorr i ri... Filluen me m'u dridhë kambët. E preka Nezirin, mirëpo, ai ish bâ si guri... I hutuem, ja kish drejtue syt nji mitralozi me grykë të kthyeme kah na.

— Po mirë, bre burra, ku jeni drejtue ju kështu? — na tha komandanti.

— Na duelëm me i lypë nja dy lopë... na i kanë humbë çobanët në mal.

— Mos keni dalë për tjetër punë?... Tregoni drejt se për ndryshe s'keni me kalue mirë.

Jo, pasha zotin e lum, zotni shok komandanti, kemi dalë m'i lypë lopët, — iu përgjegj Neziri me zâ të dridhshëm.

Ai e paloi haritën dhe e shtini në strajcën prej rrypi.

— A e dini kush jemi na dhe pse kemi dalë në mal?

Neziri më shiqoi dhe ma bani me krye që t'i përgjigjesha. Shka me i thanë, as vetë nuk dijsha. U mendova pak.

— Jo bre zotni, shok... nuk e di. Kemi takue kanjherë nëpër male njerëz t'armatosun, por ata janë konë mâ pak... Nuk janë konë kështu si ju. Ata... a e di... jau merrshin gjanë shkijve dhe i shitshin...

— Mos u sjell rreth e përqark, po thuej truq: ata ishin hajdutë — ma preu fjalën.

— Mirë e ke, pasha allahin që na ka falë, ashtu âsht — bani Neziri.

Komandanti na kqyri edhe njiherë.

— Na jemi partizanë. Djemt e popullit të Kosovës e Metohis. Me vullnet kemi dalë në mal me luftue kundra okupatorit: italjan, gjerman, bullgar... si dhe kundra atyne që bashkëpunojnë me ta... kushdo qofshin. Partizanët e Jugosllavís nuk lejojnë kurrsesi me u kthye e vjetra. Ata duen me ngritë nji Jugosllaví të re, ku nuk do të ketë mâ plaçkë e hajní... Ku do të ketë të drejta të barabrta secili popull.

— Zoti ju ndihmoftë, bre zotni shok komandant — i tha Neziri, e ai u vrâ pak e mbasandej na kqyri tue buzëqeshë. Unë i thash:

— Tash po mujshna me dijtë se kush, jeni. Zanin jua kam ndie e deri sod nuk ju kam pa.

— A për të mirë, a për të keq na e ke ndie zanin?

— S'e di si me të thanë...

— Fol lirisht, mos kij frigë aspak. Atê që mendon, kemi qejf me na e thanë në sy.

Shka me i thanë tash? — mendova. Veç drejtë do t'i flas.

— Hem për të mirë hem për të keq, mbasi po thue drejt.

— E hê. Shka për të mirë e shka për të keq, pra? — më pveti ai.

— Për të mirë — i thash — se jeni gjindë të drejtë, nuk e prekni hakun e huej. E keni komandën e fortë dhe ishi azgona. Me hyqymet me luftue, kjo kurr s'â konë. Jau pretë drunat e telit në Gilan, jau vratë karabinierët në Livoç, jau thyetë

udhën në Crnolevë, jau shkatrruet madenin në Llojan...

— E për të keq?

Neziri më preku që të mos flas, por, mbasi hyna në horë, duhej me luejtë.

— Unë po flas shka kam ndie: — Po shkojshi bashkë me Shkije, p'e hangshi mishin e thiut, ishi pa fé se p'e shajshi zotin. A edhe po luftojshi me pru Miskovin këtu.

— Unë, shok komandant, nuk kam ndie kurrgjâ për të keq — i tha Neziri.

Ai keshi me zâ, tue e kqyrë Nezirin se ishte rrudhë.

— A e dini si âsht puna — na tha komandanti, tue na kqyrë rreptë. — Këto fjalët e mira siguristh i ke ndigjue prej popullit të ndershëm. E, nëqoftëse ndalesh e mendohesh — prej kujt kanë dalë këto fjalët e këqija, atëherë ke me ardhë te ndonji kryetar, kryeplak, gjandar, hajdut e ku ta dij unë. Shka ju hyn atyne n'udhë a jemi na kundra fés e zotit? Në fund, mbasi po thonë se zoti âsht i „madh", ai le të marrë hak, e jo me u mshefë mbas tij trathtarët dhe plaçkaxhijt e popullit. Nëqoftëse na kemi pasë vështirsina prej hyqymtarëve të Jugosllavís së vjetër, çfarë faji na ka populli sërb? Na duhet me krijue dhe forcue bashkimin e popullit kundra okupatorit dhe kundra trathtarëve e regjimlive të vjetër, qofshin shqiptarë ose serbë...

— Mirë e kije, zotni shok komandant, pasha zotin, — tha Neziri — se këtë fjalë i kanë qitë në katund tonë Syl Hajdini, që âsht tash kryeplak dhe njifarë Stanko Markoviqi, që â konë kryetar në kohën e Sërpit.

Komandanti e shiqoi Nezirin dhe prap qeshi. Siguristh pse, Neziri tha pak mâ parë se nuk kish ndigjue gjâ për të keq.

— Tash nuk kemi kohë... Tjetër herë, kur të kalojmë këtu pari, do të mundohemi me i ndërrue disa fjalë me ta, — dhe e ngrehi alltín me kllef rrypi, kqyri sahatin në dorë dhe i lëshoi syt kah kazani, që qitte avull. Nuk m'u durue pa pvetë:

— Shka po bani për myhmát?

— Po marrim prej okupatorit me fuqí, e, besa, edhe populli po na ndihmon.

Kqyra anësh. Përsëri më ranë në sy zjarmi dhe kazani që avullonte. Bukë nuk pash kurrkund. I thash:

— Ju po mbarojshi jemek, veç, me hesap, bukë nuk paski?

Komandanti shiqoi në drejtim të kalit.

— Ditëve tjera, kemi pasë edhe bukë, po sod kemi mbetë pa te.

E kqyra Nezirin, mirëpo ai nuk më muer vesh: Iu ktheva komandantit:

— Të shkoj deri te shpija... në koftë se na ka qëllue ndoj trohë.

— Ku e ke shpín? •

— Nji sahat larg.

— Edhe unë po shkoj — tha Neziri.

Kur jau çuem bukën, komandanti na tha:

— Tue na dhanë bukë, ju po ndihmoni luftën e madhe nacionalçlirimtare... Po jau lamë amanet — që të kujdesoheni për at vorr — aty.

Na e mbuluem vorrin me dushk, që të mos ta shifte kush, dhe zbritëm poshtë. S'di shka me thanë. A iu del puna si thojshin?... Nuk âsht me iu besue. Hyqymetin mundet me e rrëzue veç hyqymeti. E këta janë pak... pa top... pa ballon... pa marifete... Po më dhimben, ishin djem të rí. Po nejse — fituen mirë, s'fituen s'kemi shka me iu bâ.

*

Tue i kujtue të gjitha këto, tash, si ishte në kambë, u ndal dhe shiqoi Fazliun. Pyette me vedi:

„A kam mujtë me mendue se do bashkëpunoj ndonjiherë me dikend prej atyne luftarëve?... A kisha mbërri në këtë shkallë, sikur mos të kish luftue ky e shokët e tij?..."

Fazliu, mbas demobilizimit, punoi pak në rreth, e mandej u transferue në komitetin krahinuer. Kur e kreu shkollën e naltë të partís në Beligrad, u kthye përsëri me punue në rreth. Në Bllatë, moti nuk kishte qenë. Nuk e njifte mirë gjendjen e atyshme. Tue palue gazetën, pyeti Kadrinë:

— Si po të shkon puna e organizatës?

— Organizata jonë ka gjashtë komunista. Kemi pasë shum, por tre i kemi përjashtue. Prej këtyne që kemi n'organizatë, njifarë Marku dhe Vehbija janë pasivizue bukur shum. E kemi edhe njifarë Dautin, gadi edhe ky ka çue duert, veç që s'po thotë liromëni. Asht edhe Dragutini, sekretar i këshillit komunal. Edhe ai âsht pak oportunist e byrokrat. Kemi, edhe nji të rí. E quejnë Ramë. Ky âsht mâ aktivi, e besa, edhe komunist i ngulun. I gjashti jam unë. Derisa ke qenë ti në shkollën e partís, unë isha nëpunës në këshillin e rrethit, pranë seksionit të punës. Mirëpo, kur u bâ decentralizimi, si i pa shkollë, u ktheva përsëri në katund. Tash po punojmë së bashku me vllaun dhe babën në shtëpí. Sa po muj, po kujdesohem edhe për punën e organizatës...

„Do të jetë demoralizue prej vështirsinave të tashme — mendoi Fazliu — po flet vetëm për dobsinat. Nuk çel udhë". Dhe e pyeti:

— A keni mbërri farë suksesi në punë me organizatën tuej?

— Megjithëse kemi të meta, shok Fazli, kemi mbërri do rezultate. Mbas çlirimit, secili prej nesh ka qenë dy tri herë n'akcionet e rinís e të frontit. Kur bâheshin grumbullimet e ndryshme, komunistat kanë qenë të parët në blemjen e drithit që kërkonte shteti ynë socialist. Kemi ndërtue shkollën e re në katund. Aty punojnë dy mësuesa shqiptarë e nji sërb. Kemi hapë nji bibliotekë, ku kemi mâ se treqind libra të ndryshme. Gadi çdo vjet kemi çelë kurset kundra analfabetizmit për burra e gra. Kemi prû ujin që ka qenë dy kilometra larg katundit. E... mbas çlirimit, kur silleshin ballistat këtu pari, nji e kemi pasë vra e dy zanë të gjallë. Nji informbyroist, që pat ikë në Bullgarí e që Bullgarët mandej e qitën ilegalisht me punue kundër shtetit tonë, e kemi zanë pa mujtë m'e hapë gojën.

Kadriu flitte tue ecë. Kur u kthye kah tavolina, Fazliu i tha:

— Ulu, mos rri në kambë se sigurisht je lodhë. Tue u ulë, vazhdoi bisedën si me folë me vedi:

— Me vend e pate kur tha „na jemi fajtorë, e jo populli". Na e kemi popullin që s'e ka kush. Na

s'kishim mujtë me mbërri kurrgjâ pa aktivitetin e gjanë të katundarëve tanë. Prandej — për mungesat e sotshme, na jemi fajtorë. Na, komunistat. Keq âsht kuptue demokracija socialiste.

Fazliu i rrudhi vetullat.

— Nuk e dij se sa keni mujtë me jua spjegue komunistave dhe masave demokracín socialiste. A keni marrë ndonji masë kundra atyne që e komentojnë ndryshe çashtjen ose që punojnë ndryshe?

Kadriu prap u ngrit në kambë.

— Kemi folë edhe nëpër mbledhje të ndryshme, besa kemi mbajtë edhe ligjërata. Populli âsht i kënaqun. Sidomos për hjekjen e këtyne masave administrative në katund. Ka edhe asi njerëzish që, tinzisht, e komentojnë ndryshe çashtjen. Nji prej tyne e kemi përjashtue prej Lidhjes socialiste. Kishte folë në nji odë: „Po kthehemi mbrapa — kah e vjetra „Ai ka qenë reakcionar edhe përpara. Gjithashtu kemi përjashtue edhe dy antarë të Lidhjes së komunistave. Njani qe pushue prej punës kur u ba decentralizimi dhe tha: „Unë nuk punoj mâ badihava." Ndërsa tjetri nuk dinte as me shkrue as me këndue. Kurrkund nuk e çilte gojën me folë për realitetin tonë. Bile pat çue duert edhe prej punës së përditëshme. Njeri i mbrapambetun. Nji e kemi pasë përjashtue qysh në të pesëdhetën në lidhje me IB-en. Ky kish pasë thanë: „Fuqija nuk të pvet a je tue bâ luftë të drejtë apo jo. Mâ mirë të mos flasim keq për Stalinin dhe politikën e tij ndaj nesh... Me bâ me ardhë nesër Rusët, na e shkurtojnë kryet... Kush mund ta dijë se kush ka të drejtë në këtë përziemje."

— Kush ka qenë ai?

— Para lufte shkonte në shkollë. E mbaj mend, në kohën e okupacionit ka qenë nëpunës në nënprefekturë. Vinte nga njiherë në katund dhe flitte mirë për komunistat e partizanët. Nji ditë e mshelën dhe i dhanë disa shpulla. Mandej nuk i ndëgjohej mâ zani...

— Po, po, asi malli ka shkue n'Ib-e — tha Fazliu, tue qeshë me zâ. — Ku âsht tash?

— Ishte nji vjet a dy në mermer. Kur u kthye, bisedova nji herë me të. Më tha se e ka kuptue

gabimin dhe âsht ra... re... habitue. Tash âsht tue punue në këshillin e komunes si nëpunës.

— Po për këto dobsinat e komunistave që më folë pak mâ parë?

— Na kanë premtue se do ti largojmë të metat dhe kështu âsht kan bâhet. Vetëm po shkon kadalë.

— Sigurisht, askush nuk ka le komunist, por kadalëdalë âsht ngritë...

... Prej s'jashtmi u ndie zhurma e komunistave që vijshin në mbledhje. Qeshnin me Ramën që „në zgabim", gadi e kishte kafshue qeni i Sulës.

Sa hyn e u pershendetën — Kadriu u tha me i ngrehë tri-katër banka rreth tavolinës. Tue bisedue që mos t'i arsyetohej mungesa Dautit, erdhi edhe ai.

— Pse nuk vjen me kohë? — e pyeti Kadriu.

— Zakon e ka këtê — tha Rama.

— Kam qenë në mullî — përgjegji Dauti, tue i shique. Iu afrue Fazliut dhe u përshëndet me tê.

Dragutini e hoq kastketën dhe e la në bankën mbrapa.

— Gjithnji po gjen do arsyetime — i tha me të vogël Dautit.

Mësuesi trokiti dy herë në derë dhe hyni mbrenda.

—A âsht e lejueshme me marrë pjesë në mbledhje? Jam me sekretarin e Lidhjes socialiste dhe kryetarin e kooperativës.

— Kush të dojë le të vijë. Ju e dini se mbledhjet tona janë të hapta.

— Nuk kemi kend me pritë mâ — tha njani.

— Propozoi këtë rend dite: mbi zhvillimin e demokracis socialiste në katundin tonë — e çeli mbledhjen Kadriu e, mbasi heshti pak, shtoi: — Pajtoheni, apo ka kush me shtue e me ndërrue gjâ?

Në heshtjën që mbretnoi u ndie pëshpëritja e Ramës:

— Bash mirë që do ta diskutojmë këtë pikë. Me thanë të drejtën — hala nuk më ka hŷ në krye kjo demokracija socialiste...

Disa qeshën, e Dragutini propozoi:

— Mirë kishte me qenë sikur të diskutojshim dhe të vendosshmin edhe për qëndrimin tonë në

lidhje me kandidimin e këshilltarëve të këshillit komunal, që do të mbahet mbasnesër në mbledhjen e zgjedhësave.

Fazliu nxuer fletoren e shënimeve dhe e la në tavolinën e shplueme para vedit.

— Edhe kjo çashtje përfshihet në rendin e ditës që propozoi Kadriu — tha.

Kadriu i fshini buzët dhe filloi:

— Dje, në komitetin e rrethit âsht folë gjanë e gjatë për këtë çashtje. Unë po mundohem me jua paraqitë me disa fjalë përfundimet që u muerën në seminar.

U ndal pak.

— Me luftue për demokracín socialiste domethanë me luftue edhe kundra reakcionit të përmbysun, që po mundohet me kthye të vjetrën, edhe kundra byrokratizmit tonë, që gjindet ndër né dhe pengon iniciativën dhe vetëqeverisjen e gjanë të popullit punues.

Shiqoi prap shënimet, çoi kryet dhe heshti nji çast tue thanë me vehte: „këtë e thash si duhet...

— Tash duhet me shique se a kemi njerëz, që ngrehin kah e vjetra, ku ka byrokratizëm te na komunistat e udhëheqësat tjerë dhe sa jemi tue e zhvillue iniciativën e masave dhe vetëqeverisjen e popullit punues.

Kqyri edhe njiherë në fletore, ktheu nji fletë dhe i fshini djersët në ballë e në mjekërr.

— Unë, qe, shka kisha me thanë: na komunistat ende nuk e kemi kuptue si duhet demokracín socialiste. Ndoshta ka edhe asish që e kanë kuptue — por nuk punojnë si duhet. Përshembull: Vehbiu âsht antar' i këshillit komunal, e Dragutini sekretar. Po më duket se ju dy keni ra n'aportunizëm — tha tue shique herë njanin herë tjetrin. — Këtê jeni tue e bâ, si duket, nga friga se po humbni karrikën. Po lejoni që të shkilet ligji ynë nga elementat e ndryshëm negativë. Para se me ardhë këtu, bisedova me mësuesin: Asnji vajzë shqiptare, posë çikës së Beratit, nuk kemi në klasat e nalta të shkollës. Mandej — përpak na ka mbetë shkolla pa e krye e vetëm katundi ynë ka mbetë për vjetin e kaluem pa dhanë njiqindmijë dinarë kon-

tribut. E treta — âsht ndâ tash tatimi në bazë t'ardhunave. Ju dy keni qenë antarë të komisionit. Nuk âsht dashtë me lejue që të bâhen gabime të mëdha. Përshembull, pashë në shpallje se Syl Hajdini dhe Ali Abazi gadi ishin barazue me t'ardhuna! Na të gjithë e dijmë se Aliu âsht ekonomikisht shum mâ i dobët se Syla...

„Me këtê zor do të kalohet jeta e përbashkët... Na u ka lëshue në shpinë" — mendoi Dauti dhe iu përzie në fjalë:

— Këta s'kanë faj. Komisioni e ka pa t'arsyeshme.

Vehbiu dhe Dragutini përgaditeshin me u përgjegjë. Kadriu e shiqoi mrrolët Dautin.

— Mos ma pre fjalën! Të mbaroj unë e atëherë fol sa të duesh.

Fazliu i përcillte fjalët e Kadriut, tue shique para vedit. Tash shenoi në fletore diçka shkurt.

— E katërta — vazhdoi Kadriu — janë disa pare të kontributit, afër nji gjysëm miljoni, që i ka këshilli në dispozicion. Paret nuk po harxhohen, e n'urë të Moravës nuk po mundet njeriu me kalue. Asht shkatërrue krejt. E, mandej ka edhe problema tjera. Qe, disa janë çue peshë: dalin, jau venë potkat utrinave, mbjellin në to drith e pemë — thot njeriu se jau ka lanë baba...

„Pse nuk po flet për Ramën? Këtê po e ruen, e shpís seme — grusht..." — mendoi Dauti, e tha me zâ:

— Këtê po e bâjnë njerëzit tanë. Kur Rama, si komunist, e zen utrinën, si do t'i ndalish tjerët?

Rama e ktheu kryet me nji anë. „Shife pisin" — bani mê të vogël dhe u ngrit në kambë.

— Kur më ka thanë partija me çue dorë prej saj, unë nuk kam shkue mâ n'at copë tokë, Daut. Po ju them të gjithëve e mâ së shumti ty: kështu nuk âsht e drejtë! Unë me dy pllambë tokë me e lëshue, e tjerët, përshembull kushërini yt, me shtatë-tetë hekterë, me e mbajtë hala nji gjysëm hekteri...

— Me rend, shokë! Lene Kadriun le ta mbarojë fjalën — i qortoi Fazliu, tue shënue diçka në fletoren e vet.

Edhe Kadriu shkroi diçka dhe vazhdoi:

— Këshilli i komunes nuk âsht tue iu përmbajtë ligjit edhe në lidhje me të drejtat e femnës, kur âsht puna e kunorzimit. Ka shum njerëz që po i napin dhe po i marrin çikat ka dymbëdhetë, trembëdhetë vjeçe, besa edhe n'ortake, e kundër tyne nuk po mirren kurrfarë masash ligjore...

I shkoi mendja te Syla:

„Pse me marrë burri plak vajzën prej shkollës fillore?" Sidomos e prekte fati i Fatimes, për të cilën ushqente ndjenja dashunije, megjithëse nuk kishte shpresë se do të mundej me e marrë. Syla e kishte ndërrue këtê për të shoqen, prandej edhe ja filloi prej Sylës.

— Përshembull, Syl Hajdini dhe baba i Dautit kanë qenë vllazën — vazhdoi ai. — Qëlloi që së shpejti vdiqën baba i Dautit dhe grueja e Sylës. Atëherë, Syla e ktheu nanën e Dautit për grue. Kjo e shkreta, ani, iu ka smue pak, sigurisht prej pleqnís, e ky, burri plak, pesëdhetë e pesë vjeç, muer tash nji vajzë trembëdhetë vjeçare. Nuk e bani ndërrimin me çikën e vet, që e pat me gruen e parë, por u godit me ia dhanë motrën e Dautit vllaut të nuses, kur ky të kthehet prej ushtrís — dhe fshani thellë, tue e sjellë kryet. — Në darsëm i shkuen kryetari e disa udhëheqësa tjerë, si mos të kishte bâ Syla punë të panjerëzishme. Hangrën, pinë dhe u dëfryen. Edhe vllau i Vehbís âsht martue me vajzë të ré dhe jeton me të pa kunorë.

— Mos u përziej ti, jaran, në punë të hueja! — i tërhoqi vërejtjen Dauti, tue i mshue tavolinës me grusht.

— Shokë, propozoj — tha Rama— që, po foli edhe nji herë pa marrë leje, ta qesim përjashta.

— Pajtohemi! — tha rreptë Fazliu.

Dauti e uli kryet. Fëtyra e bardhë filloi me marrë ngjyrën e kuqe. Shiqonte para vedit. Nuk ishte në gjendje as me mendue. Kadriu vazhdoi:

— Për demokracín socialiste, më duket, se duhet të luftojmë të gjithë kudo, edhe në mbledhjen e zgjedhësave, që të largohen dobësinat, që përmenda mâ parë... Vehbiu dhe Dragutini duhet të luftojnë në rradhët e këshillit komunal, që të zbatohet ligji sa mâ mirë. Demokracija jonë nuk âsht

asisoji që të punojnë sejcili në krye të vet — bashibozukqe.

Shiqoi përsëri fletoren, tue e avitë syve.

— Kisha me folë edhe për Markun. E kemi ngarkue me detyrë që, si kryetar, t'a gjallnojë organizatën e bashkimit të luftarëve. Ka tre katër muej që nuk ka mbajtë asnji mbledhje me antarët e vet!

Marku e hoqi shajkaçën dhe e shpërthekoi setrën e zhgujt e të shkurtë, ngjyrës së kullum.

— Demokracija nuk âsht me shpërnda organizatën dhe mos me qenë i disiplinuem, mos m'i krye detyrat e partís — tha Kadriu tue e ngritë dorën. — Rama ka bâ gabim në lidhje me utrinën, por mbasi e ka lirue, s'kemi shka diskutojmë mâ për të. Më duket se ky âsht mâ aktivi ndër né. Po punon, vlla, rinija, në mbledhje po vijnë, në fushë të sportit, po i shef, çfaqje po apin, n'akcionin për kanalizimin e ujit kanë marrë pjesë bukur mirë. Në bibliotekë i shef do prej tyne... Njimend, e kanë lanë pa organizue nji pjesë të rinís dhe nuk janë tue e mbledhë rregullisht antarsín... Por, sidoqoftë, po ta vazhdojnë punën kështu, edhe këtë detyrë kanë me e krye.

Rama u drejtue dhe i shiqoi shokët me buzëqeshje: „Unë mâ i miri komunist", thonte me vedi i prekun.

Kadriu u kthye kah Dauti.

— Sa i përket Dautit, ky nuk âsht tue u përmirësue. Tri-katër herë nuk ka ardhë në mbledhje. Si këshilltar' i Lidhjes socialiste nuk âsht tue punue gjâ. Për Lidhjen socialiste përgjigjemi na të gjithë, por ky, si këshilltar, pak mâ tepër. Ky ka edhe do dobsina tjera. E kanë pa dy herë tue shkue në xhamí, bile edhe ramazanin po e inon. Nji katundar më tha nji ditë: „Edhe ju komunistat e katundit tonë po rrêjshi". Kur e pyeta në zemrim — pse?, ai m'u përgjegj: „Po thueni se nuk jeni fetarë, e në xhami po shkoni dhe ramazanin p'e mbani" — Kush bre? Më tha: „Po qe, Dauti." Unë u përgjegja — nëqoftëse nji Daut i kryen detyrat e fés, nuk ke të drejtë me thanë komunistat! — Ai shuejti.

„Nuk mbeti derë kurrkund" — mendoi Dauti.

— Sa i përket Lidhjes socialiste, edhe unë jam fajtuer. Prej se e përjashtuem at reakcionarin, Miftarin, që demokracín socialiste e komentonte si anmik dhe që deshti me e përçá Lidhjen socialiste, tue u mbështetë në politikën e mahallave — populli e ka pa se nuk qenka shaka me u kapë me Lidhjen socialiste, m'u leçitë. Mirëpo, na po punojmë hove hove në Lidhjen socialiste, e çdo gjâ duhet me diskutue aty. Komunistat duhet me u aktivizue bash në Lidhjen socialiste tue dhanë propozime të mira dhe tue kritikue çfaqjet e pashëndosha. Duhet me e njoftue popullin për çdo ditë për ngjarjet e reja të politikës së jashtme dhe të mbrendshëme, me i aftësue antarët e Lidhjes socialiste që të marrin pjesë në punën e organeve të ndryshme dhe, veçanisht, të kontrollojnë punën e këshillit komunal dhe të kooperativës... Kur ra fjala e kooperativës, kisha me thanë...

Kryetari i kooperativës, që merrte pjesë në mbledhje, çoi kryet dhe filloi me krue musteqet.

— ... se këshilli drejtues nuk âsht tue punue sa duhet. Ja ka lëshue punën në dorë magazionerit dhe llogaritarit. Qe, magazionerit i kishin dalë mangu njiqindmijë dinarë. Ata nuk janë tue u mundue që kooperativa t'u ndihmojë antarëve të vet në zhvillimin e bujqsís: me u prû plehna artifiçialë, farë të mirë, vegla bujqsore e tjera. More, nga njiherë njeriu nuk mundet me gjetë as gjanat mâ të nevojshme në kooperativë: krypë, gaz... Drejtimin e kooperativës duhet me e marrë në duer të veta këshilli drejtues dhe antarët e saj. Komunistat duhet me e ndihmue dhe me e interesue popullin që të kujdesohet për zhvillmin e kooperativës.

Shiqoi edhe njiherë kah fundi i rendit të shkruem në fletore, fshini djersët dhe tha:

— Më duket se na, tue luftue për largimin e këtyne të metave, për të cilat fola deri tash, dhe, tue u aktivizue në kryemjen e këtyne detyrave — luftojmë për demokracín socialiste e kundra byrokratizmit.

Fazliu shiqoi njiherë Kadriun, e mandej edhe tjerët. Kadriu vazhdoi:

— Edhe nji gjâ, sa u përket reakcionarëve të vjetër. Këta, bre shokë, janë mjeshtra të mëdhêj, po kqyrin me përfitue me dhelpní diçka prej demokracís socialiste për interesat e tyne të flliqta. A e patë at ditë në konferencën e Lidhjes socialiste si ishin ulë afër njeni tjetrit Sylë Hajdini dhe Marko Stankoviqi? Sa ulej njani, çohej tjetri. S' e dij ku dreqin i kishin gjetë ata njerëz me i prû në konferencë. Për të parën herë i kam pa disa prej tyne aty. Siguristh i kanë organizue që t'i propozojnë për këshilltarë. Stanku thonte: „Populli, bre vlla, po më don, se unë nuk e kam pasë as mendjen me u kandidue." Kurse Syla shtonte: „Boll janë konë të vjetrit, populli po don me i provue edhe do të rí". Njerëz që kanë pasë pushtetin në Jugosllavín e vjetër, ata që e kanë ndihmue okupatorin me mish e me shpirt, ata që kanë pengue çdo akcion tonin, çdo masë të pushtetit — tash po duen me iu paraqitë popullit si njerëz të ri, që i don populli! Demokrací për ta nuk ka dhe nuk duhet me pasë! Brijt me lloz me jau thye, nuk âsht shum! — tha me nxehtësi.

Fazliu e shiqoi Kadriun me buzëqeshje, e ai vazhdoi:

— Ndoshta fola gabim, por kanjiherë njeriut i vlon gjaku... dhe përfundoi.

— Tash, shokë, diskutoni. Kush të dojë me folë, le të paraqitet... me rend...

Ia afroi kryet Fazliut dhe foli diçka ngadalë me tê. Të dy qeshën me zâ të vogël.

Qetsí.

Prej sikletit Dauti kruente birat e hundës. „Nëqoftëse shuej, edhe mâ keq." — bani me vedi tue largue dorën. Çoi përpjetë dy gishta.

— Unë po due me diskutue. Ashtu si dij, se shkollë nuk kam...

U ngrit. Me dorën e majtë përthekoi setrën e zezë doku. Ende pa folë e kapluen djersët dhe i fshini me marhamë. Shiqoi në drejtim të tavolinës.

— Unë po due me pvetë dishka: Pse Kadriu po i ban reakcionarë mixhën tem, Sylën, dhe gazdën Stanko? — tha Dauti dhe heshti.

— Mirë, edhe unë po të pyes ty: a janë të mirë dhe pse? — e pyeti Kadriu.

Dauti e lëshoi dorën në tavolinë dhe ngrehi vetullat e bardha përpjetë.

— Mue më duket se janë të mirë. Gazda Stank ka qenë kryetar i komunës në kohën e Jugosllavís së vjetër. E ka ruejtë katundin prej xhandarëve, kontrollëve e shumarëve. Në kohën e okupacionit ka ndejtë urtë. Mbas shlirimit ka punue pak kohë në komandën e vendit në Gilan. Shka i ka kërkue hyqymeti, i ka dhanë...

— Po kadalë, se unë po të përzihem në fjalë. A mundem, shok Kadri? — pyeti Dragutini.

— Fol!

— Qe shka më ka thanë baba: Stanko Markoviqi, ose si po i thotë Dauti, gazda Stank, së bashku me neve kish qenë shpërngulë prej Vranjës dhe kishte ardhë në Bllatë, më njimijë e nandëqind e njizet e tre. Ja kish pasë dhanë agrari nji copë tokë utrinë që s' e kish pasë kush. Ky nuk e kish pasë marrë utrinën, por kish kërkue tokë të punës. Baba i Sylës, Hajdini, kish qenë atëherë kryeplak. Mirret vesh me Stankun — e ky me inxhinjerin e agrarit tue i dhanë ryshfet. Syla, tokën e vet e pshton e ja merr fukaras për me ja dhanë Stankut. Mbasandaj, kish pasë marrë edhe disa hekterë utrinë. Baba i Sylës, e mandej edhe Syla, i ndihmojnë Stankut dhe ky bâhet kryetar. Kështu këta bajnë njifarë miqësije ndërmjet vedi. Këtë kohën e mbramë e mbaj mend edhe vetë. Asht e vërtetë se Stanku e ka ruejtë shtëpín e Sylës prej xhandarmve, rojes së financave e atyne të pyjeve, por jo Bllatën! Unë nuk e dij se kush prej katundarëve tanë, përveç shtëpís së Sylës, ka pshtue pa ra në duert e tyne.

U kollit dhe fëtyrën e thatë e të zezë ja mbuluen do rrudha.

— Në kohën e okupacionit, Syla ja kthei uhanë. Si kryeplak u ndihmoi Bullgarëve që t'internojnë dhetë djem të rij e disa pleq. Kur erdhi rendi te Stanku, thonte: „Kush prek aty, nuk dashet shëndosh me mue". Stanku i ka dashtë qetnikët. Edhe sot e ka mjekrrën deri në shokë... Mbas çli-

rimit, kur s'pat kah me ia mbajtë, u bâ kishe i mirë dhe hyni në komandën e vendit në Gilan. Si duket, për me e pshtue Sylën, e jo për tjetër. U kish pasë thanë shokëve në Gilan: „Unë e gjej dhe garantoj për Sylën." E merr prej shtëpís vet, ku e kish ruejtë, dhe e dorëzon.

Dhe përfundoi:

— Me pasë qenë na këtu, ndoshta nuk kishin pshtue lehtë. Por na ishim partizanë, e shokët nuk e kzanë njoftë situatën. Mâ vonë — çashtja u vjetrue.

— A ke mâ Dragutin?

— Jo njiherë. Mjaft — dhe u mbështet.

— Fol, Daut!

— Unë nuk i kam dijtë këto ogjana që po i thot Dragutini.

Disa qeshën me zâ dhe shiquen njani tjetrin, tue i dhanë shêj me krye se e zunë në rrenë. Dauti vazhdoi:

— Axha Sylë e ka ruejtë popullin tonë në katund prej Bullgarëve dhe hyqymetit të Shqipnís së madhe. Mbas çlirimit e ka dhanë drithin, mishin, porezin — shka i ka lypë hyqymeti. Ndoshta ka bâ ojna kanjiherë, por, si thot edhe fjala e popullit: „malli âsht mâ i dhimbshëm se shpirti."

Komunistat shiquen Kadriun, ndërsa ai vidhte me sy Dautin.

— Qe si e ka ndihmue popullin axha Sylë i yt në kohën e okupacionit — tha Kadriu. — Si kryeplak urdhnoi njiherë me ia çue secila shtëpí ka nji pulë, dhetë voe, nji kilogram tëlyen e pesë kile miell të grytë. Thonte: „Ju nuk po kini ku me i shti askerin e Bullgarëve, i kini shtëpijat e këqija, e këndej po duhet harxhllëk për ta." Erdhën e s'erdhën askeri i okupatorit, ai, me gjithë të vetët, rraste në shtëpi pa ndá pula të pjekuna, voe të përzhituna, petlla e pite— he barku i plastë!

Gadi të gjithë qeshën me zâ. Dauti u skuq edhe mâ tepër. Kadriu vazhdoi:

— Nuk âsht puna me qeshë, shokë. Në kohën e Bullgarit pat hapë dugâjë. Atëherë, kishe, çojshin do ushqime për popull. Ky i shpërndante. Gjy-

sën ia epte popullit e gjysën e shitte kontrabandë. U bâ pasanik i madh — veç thitë i kishte mangu. A ju bjen në mend? Pat bâ nji tërplotë me bisht të gjatë. Me tê i merrte pret dhe me tê e epte mallin. I vinte mërzi me u çue prej vendit, ose frigohej mos i flliqte duert me fukuran. Na çonte n'ara të veta me punue. Kur vinte dreka na binte nji kalanicë llallë e nji bukë të kallamojt. Hala pa u ngî, na thonte: „Hajdeni, djem, se shkoi dita!" Na shtinte m'e nda arën shokë-shokë, me pa kush punonte mâ shpejt. Njiherë, sa e mbarova pjesën teme, më kthei përsëri — „s' e ke pre mirë pirovinën." Kam qenë edhe mbas shlirimit nja dy-tri herë me prashitë e me korrë te ai, por i thojsha: „Mos të pëlqeftë, po shkoj në shtëpín teme, ka punë në Jugosllavín e Titos."

Rama luejti prej vendit.

— Isha krejt i vogël katërdhetë e katrën. Erdh ajo „Shqipnija e madhe". I thonte katundit, kur duelën nji xhumaje prej xhamije: „Kijet e zgjedhës duhet me i shitë e me ble pushkë. A p' e shihni, qafiri në fyt na u ka afrue?" U bâ komandant përmbi këto tri copë katunde. Do me hatër do me zor i çoi në luftë kundra partizanëve. Shtatë javë ndejti në Hotël — Vishticë — Matiq. Nji ditë bashibozukët i ikën, e ky memzi e kish pru kryet.

Fazliu u shtrygj tue hapë gojën dhe u mrrol. Tha:

— Ju, shokë, keni shkue shum larg në diskutim. Nuk po thom se nuk duhet me i pasë parasysh këto momente, por do t'ishte mirë me diskutue për reakcionin... në lidhje me qëndrimin e tij ndaj zhvillimit të demokracís socialiste.

Heshtën. Kadriu shiqoi Fazliun.

— Unë thash se ata janë tue e kuptue demokracín socialiste si lëshim tonin për ta. Konkretisht: në konferencën e Lidhjes socialiste kishin mobilizue do katundarë të mbrapambetun, që njeriu i sheh shum rrallë nëpër konferenca. Jau bâjshin me krye, i prekshin me brryl, e ata çoheshin dhe i propozojshin për këshilltarë të këshillit komunal.

— Po ju, komunistat, ç'bajshit në këso rastesh?

— Me ta thanë të drejtën, na nuk kemi qenë të përgaditun, e Dauti me Markun... më duket dhe Vehbiu, nuk patën marrë pjesë n'at mbledhje.

Fazliu luejti kryet, çoi vetullat përpjetë, e në ballë iu dukën disa rrudha. — „Nuk flasin për gjanat aktuale, po..." — mendoi dhe tha:

— Këtu âsht gabimi, ose mâ mirë me thanë, faji juej.

— Po shifet.

Heshtën përsëri. Disa prej tyne mbështollën cigaret dhe i ndezën.

— Unë kisha me thanë dishka — tha Vehbiu.

— Fol!

— Syla âsht fajtori kryesuer që nuk po mundet me fillue punën kursi i shëndetsís për femnat e reja. Na, bre vlla, hala nuk ja kemi thye brijt këtij. Shum hallk nuk po e kuptojnë randësín e kursit, e ky bash n'at vegëz po lidhet me ta. Po kallxojnë se u paska thanë nji mbramje n'oděn e vet disave: „Nëqoftëse e çon në kurs gruen ose çikën, mbete pa tê. Kanë me ta bâ paçavër. Mësuesët janë bâ si hamshorë."

Mësuesi u skuq.

— Ju, që jeni këtu, a i keni çue motrat e gratë tueja?

Vehbiu u suell në vend dhe shiqoi shokët.

— Na deshtëm të tanë truq... Kursi s'mundet me punue me tri a katra.

— Tri a katra tuejat, pesë të miqve tuej, kursi kish mujtë me fillue. Mandej, kishi bâ sulm s'pari në Sylën e me rradhë edhe në tjerët. Me pasë pritë në kohën e luftës deri t'ishin çue të gjithë së bashku me luftue kundra okupatorit — kurr nuk kishim mujtë me fitue lirín...

— Mirë e ka shoku Fazli. Edhe komunistat po bâjnë ojna. Kur âsht puna e përparimit të grues, po dallohen pak prej tjerëve — tha Kadriu.

Rama e ngrehi plisin e bardhë përpjetë. Mbi fëtyrën e njomë dhe ballin e ngushtë iu duk nji tubëz flokësh të zezë.

— Ky Syla, shok Fazli, âsht kah mundohet me e mbajtë autoritetin në popull me anën e do ade-

teve të vjetra e të kqija. Kur dikush rrehet ose ngatërrohet për tokë, megje, grue e ku ta dij unë për shka — ky shkon si njerí i parís, si uligje. Unë e dij se na kemi nji ligj e jo dy, nji gjykatës e jo dy!

— Ai po mundohet mos me bâ keq — tha Dauti.

Fazliu e preu me nji shiqim t'ashpër Dautin, e Marku, që deri tash kishte heshtë, tha:

— Na e kemi pranue Dautin në partí katërdhetë e tetën. Na ka pasë premtue se do të punontë çka të kërkojë partija prej tij. Sa ishin grumbullimet e ndryshme, nuk mund të thom se nuk ka punue. Mirëpo, atëherë merrte pjesë gjithnji në komisionin e grumbullimit të drithit. Edhe atëherë i kam pasë thanë se âsht tue e ruejtë vedin. Tash, sigurisht, nuk po mundet me i mbrojtë interesat e veta, prandej edhe ka çue duerët prej organizatës dhe asaj që kërkon organizata prej tij. Mue më duket se Dauti nuk âsht i sinqertë, kur thotë: „Unë nuk kam dijtë për marrëdhanjet e Sylës me Stankun." Ky i din këto mâ mirë se na, por po i msheh se Sylën e ka mixhë, gjak të vetin, e Stanku Sylën mik. Me nji fjalë — i familjarizuem. E dyta, në mbledhje nuk ka ardhë dy-tri herë, domethanë âsht i padisciplinuem. E treta, me shkue në xhami dhe me mbajtë ramazanin, domethanë — fetar. Mbasi deri tash nuk ka qenë i dënuem asnjiherë. nuk jam i mendimit se duhet me e përjashtue... por nji qortim meriton me ja dhanë... Ato gjana që i foli Kadriu për mue dhe Vehbiun, në shumicë janë me vend. Vetëm se na i kemi premtue edhe në nji mbledhje të mâparshme, se do t'i largojmë këto të meta. Qe, unë për të dielën e ardhshme kam shpallë mbledhjen e këshillit të bashkimit të luftarëve dhe kam ngarkue nji të ri që ta hapi bibliotekën.

— Edhe na në këshillin e komunes jemi kah përgaditemi me i shqyrtue ato që parashtroi Kadriu — tha Vehbiu.

Kur filloi me diskutue, Marku nuk e tërhoqi aq vërejtjen e të pranishmve. Ndërsa kur nisi me e sqarue propozimin për dënimin e Dautit, të gjithë ia lëshuen syt.

— Edhe unë pajtohem me propozimin e Markut — tha Rama.

Kadriu bisedoi ngadalë diçka me Fazliun. Ai ia luejti kryet.

— Kush don me diskutue në lidhje me propozimin e Markut?

U ndëgjuen dy-tre zana të pakthjelltë:

— Paj... to... he... mi.

Kush pajtohet le të çojë dorën!

Të gjithë komunistat i çuen duerët, posë Dautit, që uli kryet.

— Unë do të mendohem edhe pak se a jam fajtuer a jo — tha Dauti. — Ndoshta do t'i drejtohem komitetit të rrethit me nji ankesë.

— Ke të drejtë — i tha Kadriu.

— Qe ku e ke komitetin e rrethit — shtoi Rama, tue bâ me dorë kah Fazliu. Fazliu ia preu fjalën mrrolshëm:

— Mos fol ashtu! Unë jam antar i komitetit, e jo komitet. Megjithëse pajtohem me dënimin e dhanun, këtij statuti i jep të drejtë m'u ankue.

Përsëri mbretnoi heshtje. Sikur Fazliu mos të kishte vazhdue fjalën, kushedin se deri kur kishin me heshtë. Ai shiqoi në fletore dhe ngriti kryet:

— Shoku Kadri, kur foli në fillim, përmendi edhe byrokratizmin. Më duket se ju diskutuet mjaft mirë lidhje me çashtjen e reakcionit, por âsht mirë të diskutojshit mâ gjanë edhe rreth byrokratizmit dhe vetëqeverisjes shoqnore...

— Diskutoni shokë! Ndoshta unë fola mâ tepër për gjanat negative, por këto i bana me qëllim që t'i shofim dobësinat tona në përgjithësi dhe të luftojmë kundra tyne.

— Çka me diskutue? — u çue Dragutini. — Të gjitha ato që tha Kadriu ashtu janë. Nuk po thom për me mbrojtë vehten, por besoni se jam në zor. Nuk jam unë fajtuer pse s'âsht tue shkue mirë puna në këshillin e komunës. Fajin e kanë këshilltarët, e mâ së shumti kryetari. Ata, bre vlla, nuk po duen me u prishë me disa njerëz të mbrapambetun. Ndoshta po kanë frigë se tash, në këto votime, nuk po i kandidojnë dhe nuk po i zgjedhin.

— Mirëpo, kur po i shef se ata po e shkelin ligjin, çka po ban ti? — e pyeti Fazliu.

— S'po dij shka me bâ...

— Ti duhet me shkue në mbledhje të zgjedhësave dhe me i njoftue zgjedhësat se kryetari, ose ndonji antar, po e shkelin ligjin në këtë pikë dhe në këtë pikë. Po e shkelin ligjin për të cilin janë betue se do ta respektojnë besnikisht. Njerëzve që shkelin ligjin dhe nuk e zbatojnë, populli ynë në përgjithësi nuk u jep mbështetie. Sigurisht kishte me i shkarkue prej detyre. Mandej, ti e ke për detyrë me lajmrue për këtë edhe organet e nalta, këshillin e rrethit.

Dragutini luejti kryet në shêj pajtimi. Kryetari i kooperativës e hoqi plisin dhe kroi flokët e shkurtë e të thimë. „T' i qes edhe unë dertet e mija" — mendoi.

— A kam të drejtë me folë edhe unë?

— Fol, shokë, fol — i tha Kadriu.

— Unë s' dij shka me bâ! Qe dy herë që e thirri mbledhjen e këshillit drejtues e prej nandëve që jemi, njiherë nuk erdhën pesë, njiherë katër — u ndal dhe, tue e sjellë plisin në dorë, shiqoi Fazliun, i cili tash qeshi pa zâ.

— Çka mendon me bâ ti?

— Me pasë mendue, bre shok, unë s'të kisha pvetë ty. Qe, mu tash duhet me i krye mbjelljet e pranverës n'ekonomi; duhet me mbajtë mbledhjen vjetore e, n'anën tjetër, kooperativa ka mbetë pa máll. Unë jam në zor... me pasë bile ndoj qár — hajde de. Por, pa asnji dinarë duhet me bajtë gajlen e nji katundi.

— Edhe unë jam ngusht në Lidhjen socialiste sa i përket mbledhjes s'antarsís — u ankue sekretari i Lidhjes socialiste.

Disa qeshën, e Fazliu e pyeti:

— A nuk po e japin, a?

— Ata p' e japin, po na nuk po ua kërkojmë rregullisht.

Posa Fazliu desht me thanë diçka, mësuesi i u drejtue:

— Sa u përket disa zakoneve të vjetra, shok Fazli, edhe unë deshta me folë diçka. Nëqoftëse ko-

munistat e këtij katundi, rinija, na arsimtarët dhe këshilli komunal e udhëheqësat tjerë, luftojmë se bashku, ma merr mendja se këto kishin me u paksue. Merrni me mend, nji ditë nuk na ka ardhë në shkollë nji vajzë njimbëdhetë vjeçare. Kur i pyetëm nxanësat, thanë: „E kanë dhanë dje..."

— A e din shka kisha me thanë unë? — bani Vehbiu. — Mâ së mbrami faji për të gjitha të metat âsht te na. Kur kemi mujtë me i krye do detyra, ndoshta edhe mâ të mëdha, besoj se edhe këto punë të vogla kishim mujtë me i krye! Nuk kemi qenë aktivë sa duhet dhe mbaroi puna!

Diskusioni mbaroi. Marku dhe kryetari i kooperativës hapën gojën, kurse Rama e mbështeti kryet në dorë, vetëm që nuk i mbylli syt. Të tjerët heshtshin. Fazliu i shiqoi edhe nji herë shënimet që mbajti gjatë diskutimit, shkroi katër a pesë rende në fletën e pastër dhe e shtini pendën në xhep.

— Në fund, po i flas edhe unë disa fjalë, shokë. Qe çka mendoj në lidhje me detyrat konkrete, që duhet t'i zbatoni në katundin tuej për zhvillimin e demokracís socialiste. E para — në mbledhjen e zgjedhsave, që do të mbani këto ditë, duhet me marrë pjesë të gjithë komunistat dhe me luftue që për këshillin komunal të kandidohen katundarët mâ të ndershëm, që duen të sodshmen, që janë për socializëm. Katundarët tanë edhe vetë janë për asi njerzish; vetëm komunistat duhet me i ndihmue. Kur na dhe njerzit tanë dalim në mbledhje me material konkret, reaksionarët, oportunistat e byrokratët, që nuk i kryejnë vendimet e zgjedhsave, që nuk e zbatojnë ligjin, që kqyrin me spekulue me pushtetin tonë revolucionar — kanë heshtë sikur bretkocat kur bâjnë poterë e me nji të gjuejtun guri në to nuk ndihen mâ.

— E dyta — në lidhje me reakcioiarët kisha me thanë se nuk duhet vetëm me theksue se kush âsht reakcionar dhe pse, por me marrë masa konkrete kundra tyne. Mirë tha Kadriu — për ta s'ka demokraci! Nëqoftëse vazhdojnë me çue krye, duhet me i përjashtue prej Lidhjes socialiste, me i demaskue e, së bashku me ta, edhe ata që i përkrahin.

Ngriti flokët përpjetë dhe vazhdoi:

— E treta, duhet të merrni masa me e përmirësue gjendjen në koperativë. Duhet me i thirrë ata antarë të këshillit që kanë qëndrim pasiv ndaj punës së kooperativës dhe me u thanë: nëqoftëse nuk punoni, tregoni, që të zgjedhim tjerë, e nëqoftëse doni me mbetë antarë të këshillit, atëherë aktivizohuni... Shiqoni — të gjithë së bashku organizonje mirë punën n'ekonomin e kooperativës. Disa prej jush edhe munden me gjetë punë aty e me sigurue bukën. Sigurisht, shumica prej jush dhe prej katundarëve tjerë të vorfun, keni nevojë për punë. Për mos me ju mbetë kooperativa dugâjë, ju duhet me thirrë prej rrethit nji agronom për me analizue përbamjen e tokës dhe nevojat e saj. Simbas asaj analize do të mundeni me dijtë se sa dhe çfarë plehu artificial ju duhet, çfarë veglash, çfarë fare. E mandej, këtë çashtje e shtroni në Lidhjen socialiste dhe diskutoni në lidhje me këtë problem. Në mbledhjen e kooperativës, në mbledhjen vjetore ose të këshillit drejtues të saj, shtroni detyrat konkrete që kooperativa të furnizojë popullin me gjanat e nevojshme për përparimin e bujqsís.

Disa prej komunistave shiquen njani tjetrin, ndërsa kryetari i kooperativës luejti kryet.

— Problemi juej i katërt, e që duhet ta zgjidhni, âsht mospërgjegjësija e udhëheqësave t'organizatave të ndryshme. Ky në këshill të komunes nuk e zbaton ligjin, tjetri nuk vjen në mbledhjen me vendosë për problemat e kooperativës, i treti nuk kryen detyrat që i ngarkohen në mbledhjen e partís. Nëqoftëse e kanë prej mosdijes, duhet me iu ndihmue. Ndihmonju ju, e nëqoftëse ka nevojë, na lajmroni edhe neve. Ndërhyni që të hapet ndonji seminar, kurs ose këshillim. Por, nëqoftëse nuk âsht çashtja te mosdija, atëherë ju, komunistat, duhet me mobilizue popullin për me i largue prej udhëheqësís.

— Ashtu âsht! — banë gadi të gjithë.

— E pesta gjâ që deshta me u thanë âsht kjo: megjithëse na në katund kemi korrë suksese të mëdhá, ende kemi mbrapambetuní të madhe. Zhvillimi i demokracís socialiste kërkon pjesëmarrjen e

gjanë të popullit në vetëqeverisjen e tij. Derisa te na dhe në katundin tuej femnat shqiptare dhe serbe vendase nuk marrin pjesë në jetën politike dhe shoqnore, demokratizmi nuk mundet me qenë i plotë. Le atê, por shembujt e ndryshëm, që u përmendën, na apin me kuptue se pozita e grues te na nuk i përngjan aspak pozitës që duhet me pasë grueja në socializëm. Luftoni me të gjitha fuqít që çdo vajzë të vazhdojë shkollën, hapni kursin e shëndetësís! Çoni ndonji vajzë në shkollën e zejtarís, hapni ndonji kurs për shtëpijake, demaskoni ato që marrin e apin pare për femna, që bâjnë ndërrime, që i apin vajzat fëmij dhe luftoni për martesat që vijnë si rezultat i dashunís!... Unë kaq.

E shtini fletoren në xhep dhe shiqoi Kadriun e ky i kqyri shokët.

— Nëqoftëse s'ka kush gjâ tjetër, mbledhja mbaroi.

Fazliu, tue shkue me marrë palltën në bankë, e pyeti Ramën tue qeshë:

— A t' hyni tash në krye demokracija socialiste?

— Shka mujta me marrë vesh, kjo qenka në secilin vend — si byberi në jemek! — u përgjegj Rama.

Shumica qeshën me zâ.

Kah duel, Fazliu shtoi:

— Si të hasni në vështirsina, thirrmëni.

— Po mundohemi njiherë vetë — tha Kadriu.

Mësuesi i vuni bankat në vend, muer llambën dhe duel mbas tyne.

ALIU rrinte në dhomë, ulë pranë oxhakut. Kësi hòvi nuk e ndezi koftorin — mâ mirë me e pritë mikun me zjarm n'oxhak. Tue mbështjellë cigare me duhanin e grimë me thikë, kujdesohej për zjarmin që të vlonte sa mâ shpejt uji në gjygym.

Grueja hyni me nji qylym të ri dhe e shtroi n'anën e djathtë.

— Po, a ke te Murtezët? Shka të tha ajo grueja e Moravës? — e pyeti me kurreshtje gruen, kur ajo u afrue te oxhaku dhe zgjati duerët kah zjarmi për me i nxê.

— Kesh. Më tha: „Kam pasë shkue ka nji herë te Sadikët sa ishna pa ardhë këhâ, e mâ tybe s'jam konë. Të vogjëlit po rriten shpejt si shelgu. Pasha zotin, as djalin as çikën nuk e njof. Idaren e kanë orta... Ndoshta nuk âsht konë keq me pvetë edhe tjetër kend."

Aliu nuk mujti me e kuptue mirë. Thonte me vehte: „Kurgjâ nuk të paska thanë. Mirë thotë ajo ilahija: ‚Zoti vetë na ka thanë, që grues besë mos m'i zanë.' E dij unë se ku e ka ajo. S'don me prishë punë. Nuk don me i dalë zani i keq në katundin tonë dhe në Moravë. Mendon se — ja na ja ata i thomë nesër: 'Ti u bane sebep e na prishe punën.' Nuk bâhet mos me e dijtë". E me zâ tha:

— Pse nuk pvete tjetër kund?

— E ku me pvetè, ore njeri?

— Po tash, shka të bâjmë? Edhe pak vjen hoxha —e mbasi heshti pak, shtoi: — Se dij... e zateta nji ditë nji të Moravës, tue u kthye me nji kerr drû prej malit. E luta me bujtë. Më tha— nuk kam vakt. Kah e përcolla teposhtë, e pveta.

— Shka të tha? A âsht njeri që i zîhet besë? — pyeti grueja me padurim.

— Jam konë asker me tê në kohën e Sërbit. Burr' i mirë duket me konë. Më tha: „Tafa âsht njeri erzeli. Kah idarja nam janë. Çikën e kam pa kur â konë e vogël, dhetë vjeç. Gjâ behane nuk ka pasë. E djali — zahare prej mësyshit — i belbzon kapak. Por — âsht puntuer i mirë." Kaq.

— Nëkoftëse belbzon shum, përzo... — bani grueja në shêj mospajtimi.

— Ai tha: „Pak — edhe atê prej mësyshit se âsht puntuer i mirë dhe djal i hijshëm" — pëshpëriti Aliu si për vedi tue shtue fjalët e Moravësit, thue se donte m' e bindë edhe vedin se kështu duhet me qenë.

„Pa çikë kemi me mbetë se kemi me mbetë. Sa harxhitemi e bâhemi tingall për martesën e djalit, mâ mirë ta ndërrojmë" — thue se mendojshi të dy.

— Kjo ka me marrë nji burrë. Le që sod s'ka beglerë, por edhe me pasë, begi nuk i bje hise kësaj. Jam i mendimit me krye punë — tha me zâ Aliu.

E grueja shtoi:

— Këtê... ja paska bâ zoti kismet. Na s'kemi shka me bâ.

N'at çast u ndëgjue nji zâ prej derës s'oborrit:

— Ooo, Ali!

Aliu mbathi shpejt e shpejt këpucët e vjetra, që i përdorte nëpër shtëpi, dhe duel tue bërtitë:

— O, hajde, hajde!

Në derë t'oborrit u duk çallma e imamit të katundit. Hoxha, gjoja për mos me pa ndonji grue nëpër oborr e mos me hŷ në gjynah, e mâ tepër mos me ra në sy t'Aliut si hajlaz, i shpejtoi hapat nëpër oborr dhe, ai para e Aliu mbrapa, hynë mbrenda.

Oxhaku i ndezun me gjygym në të dhe disa cigare, që ishin rreshtue mbi postaqi, ishin shêj i mirë për hoxhën.

„Mbasi ky më pret kështu, mutllak paska mendim të mirë. Po dashka me krye punë" — mendoi hoxha dhe i fërkoi duerët. Që mos ta kuptonte Aliu, tue u ulë në ballë t'oxhakut, tha:

— Hala s'po ipet dimni, jo...

— Përzo, i ka ardhë koha!... — ia ktheu Aliu tue ia qitë cigaren e me dorën tjetër muer gjygymin dhe nisi me i qitë çaj. Tue ia shtrî, ia bani:

— Pije, hoxhë, shpejt, se... — dhe muer legenin e duel jashtë me derdhë ujin që ndodhej në të.

Hoxha filloi me dyshue:

„Pse më tha — pije shpejt! A thue mos do të jetë ky çaj sikter mangja? Zahare s'e paskan menden me e dhanë dorën!" — dhe e lëshoi gastaren në shtrat, hoq me nji dorë çallmën dhe u krue në tepe. Aliu hyni tue buzëqeshë.

— Hoxhë, pije shpejt se po kam qejf me ta qitë edhe njâ!

N'at çast u ndigjue jehona e lehtë e kangës së përcjellun me def me çampare, që e këndojshin poshtë dy vajza të kojshive. Hajrija nuk mundëte me këndue, mbasi po vendosej edhe çashtja e saj, prandej kishte shkue ndër kojshi.

Po na vjen nji myzhde, po na vjen nji dorë,
na ka ardhë kollaj, si m' e këputë nji mollë...

Aliu filloi me u kollitë vetëm për me bâ njifarë zhurme. Kishte frigë se mos zemrohej hoxha kur të ndigjonte kangët e vajzave me përmbajtje kundra tij. Por u hutue diqysh, nuk dinte çka me

bâ. U ngrit prej vendit, e rregulloi nji jastek që nuk ishte në vendin e vet, ngrehi qylymin dhe mbuloi kashtën që shifej afër oxhakut. Ia qiti hoxhës fluturim edhe cigaren tjetër e ia bani edhe nji çaj. Mandej filloi me e therë zjarmin me mashë, ndërsa me sy vidhte hoxhën.

Hoxha nuk kishte pse të mos jetë i kënaqun. Nxuer tespihët dhe me nji dorë filloi me i njehë e me tjetrën me lëmue mjekrrën. Fëtyra iu kthjell. Kanga e vajzave, çaji i dytë dhe sjellja e Aliut ishin shënja se çashtja kishte marrë fund ashtu si dëshironte ai.

— Boll mâ, Ali-o! Mos u harxhit! — dhe, tue e afrue çajin, bani nji „hërrp" të madhe me buzë.

Aliut i ra në mend dita kur pat ardhë hoxha si msit, ai mëngjezi i hershëm kur fryni jugu i madh. Mendonte si me e çelë bisedën.

— Shka thue ti, hoxhë, për mot? E kam bâ mend nji ditë: a thue qysh, secilin vjet, po ndryshohet vera me dimën, e dimni me verë? Këto ditë fryni jugu, i fortë, dhe ja çoi bereqetin borës. Pse â jugu i nxehtë e veri i ftoftë?

— Ku mujmë na, robët e zotit, m'i dijtë këto sende! Asht gjynah m'i shti mendët kaq fellë. Këto i din veç Ai — i kofshim falë!

— Tybeistikfa! A thue mos hyna në gjynah? — bani Aliu tue luejtë prej vendit.

— Ishalla zoti, me madhnín e vet, nuk ta shkruen për gjynah.

— Amin!

Hoxha e piu çajin dhe ia shtrini gotën. Mendoi: „Erdhi koha!" I shtini tespihët në xhep dhe iu drejtue Aliut:

— Ali-o, paja këhâ, e ungju ngat meje!

Aliu kceu si lepri prej therrës dhe iu ngjit.

— Myzhde! Taf Sadiku i Moravës, me anën teme ta ka dhanë dorën e çikës për djalë. Tash — shka po thue ti?

Aliu, pa u mendue shum, u përgjegj:

— Çou, hoxhë, në kambë! — dhe u çuen të dy, sikur të kish dhanë komandë rreshteri. — Zgate dorën!... E udhubil-lahi minesh-shejtani rraxhim bismil-lahi rrahmani rrahim — Allahi ja paska

dhanë edhe unë po ja japi. Ia paftë hajrin! — dhe u muerën n'grykë.

— Hajrli koftë, e paç faqen e bardhë. E kam dijtë se je burrë!...

— Hajr paç edhe ti — sa hapa që ke qitë, zoti sevapë t'i shkroftë! — tha Aliu tue u ulë. E muer prej takamit xhezven, i qiti ujë të vluem dhe e zhyti në zjarm. Mandej hodhi në të dy lugë kafe e dy kokrra sheqer. Xhezvja vloi shpejt dhe kafja u bâ gadi. Me kafen ia qiti hoxhës edhe nji cigare. e vetë duel jashtë. Kur hyni — Aliu mbante me nji dorë sahanin me petlla e me tjetrën nji palë çarapë të bardha dhe nji marhamë bogosije.

— E paske pasë kambën e lehtë e të mbarë. Merre ket myzhde të parë.

— Mos u harxhit, allahile! — përshpëriti hoxha dhe, tue i marrë shpejt e shpejt, i shtini në xhep të xhybes.

I lanë majet e gishtave sa për adet dhe së bashku filluen me hangër petlla.

Tue hangër, hoxha mendonte:

„Nëqoftëse edhe myzhdja kryesore më vjen kështu — simbas adetit — mirë do të bâhet. Ta ha nji sillë të rrastë... ka zanë me m' u tha fyti... Asht edhe tjetra: n'at muhabet ka me më dalë zani edhe mâ tepër..." E rralloi përtypjen dhe filloi me dyshue. „Ndoshta ky hajvan i zotit, don me mbarue me kaq? Ku e dij unë! Kanë zanë me u ndërrue devret" — dhe nuk iu durue pa e pyetë:

— Mirë, Ali, këtë dorë që ta pruna, a don me ta lanë sod, apo e ki mendjen me bâ ndoj gjymbysh?... Ti e din si âsht adeti! Për mue njisoj.. — tha sikur të mos kish mendue kurrgjâ për këtë.

— Unë sefte këtë dorë të nuses p'e qes... Kam qejf, si tanë dunjaja, edhe unë... me bâ njifarë gëzimi.

— Ashtu, ashtu, ki plot të drejtë, — dhe u çue. Mbas tij u çue edhe Aliu. I qiti ujë duerëve dhe ia ndezi cigaren. Duhani tash u shkonte mâ me lezet.

Tue dalë, e pyeti edhe njiherë Aliun:

— Po kur e ki mendjen me bâ at farë gjymbyshi?

— Sod nji javë, hoxhë. Në të kthyem...
Përpak kohë paralelja e madhe e shkollës u mbush me zgjedhësa. Hyjshin grupe grupe — ashtu si ishin nisë prej shtëpís, tue thirrë njani tjetrin, tue u takue në rrugë ose para shkollës. Pjesa mâ e madhe dallohej se çfarë kombsije ishte: Shqiptarët — me plise në krye e nji pakicë, që ishte mâ në kohë, kishin mbështjellë dhe marhama të bardha kres deri në gjysëm të veshëve, kurse disa të tjerë shervete ose shalla bojë gjaku e bojë kafe. Shumica të veshun me guja të shkurta, ndonji edhe me gujë të gjatë, doku ose zhguni të zi. Disa të rij bajshin rrobe zhguni të bardhë. Nën guja gadi të gjithëve u bijshin në sy xhemperat ngjyrash të ndryshme, e te disa jelekët e dokut të hollë. Rreth qafës u dukeshin këmishat e bardha me burushuk, por kish edhe të veshun me këmisha tregu. Te disa, në pjesën e poshtme të trupit — tirqit e zez me ka pesë fije gajtana. Shumica e tjerëve mbajshin pantallona shtofi të thjeshtë ose zhguni. Disa kishin mbathë këpucë rrypi ose llastiku e disa opanga lëkure bagtishë të trasha. Mbasi ende ishte ftoftë, shumica i kishin shti kambëzat e pantollonave dhe të tirqve në çarapë dhe i kishin lidhë me sixhim ose tojë leshi.

Serbët vendas — bajshin shajkaça tradicionale. kurse shumica e t'ardhunave kasketa. Rrobet, në pjesën e sipërme të trupit, gadi nuk kishin dallim prej atyne të Shqiptarëve, posë se këta nuk kishin jelek doku dhe bajshin mâ tepër këmisha të lîjta e në pjesën e poshtme të trupit, përgjithsisht, pantallona të zhgunit.

Në mbledhje merrshin pjesë edhe gjashtë gra. Dy — pak mâ plaka, me fustana e guja të leshta e me marhama të bardha, të lidhuna nën fyt. Katra të veshuna gjysëm qytetarçe; dy prej tyne me buzë të lyeme me karmin.

Nji pakicë njeriu nuk mundet me e dallue se çfarë kombsije ishte. Këta ishin katundarë të rij, shqiptarë e serbë që e kishin ndërrue veshmbathjen tradicionale me veshje qytetare ose gjysëm qytetare. Në këtë grup ishin mësuesat e nëpunsat.

Si hyjshin, ashtu edhe zejshin vendin në bankat e shkollës. Nji pjesë mbeti në kambë, mbrapa, rreth dritareve dhe afër tavolinës së kryesís. Mashkujt — uleshin bashkë; gratë, të veçueme, u rreshtuen në dy banka në mes të paraleles. Tue hŷ ose t'ulun, kur u përpiqeshin shiqimet, përshëdetshin njani tjetrin me zâ ose me krye.

Kryetari i këshillit komunal, me duer në xhepa, sillej rreth tavolinës së gjatë, para bankave, që ishte përgaditë për kryesín e punës. I zhytun në mendime, ai vetëm ndonjiherë u drejtohej njerëzve që t'u bâjshin vend edhe tjerëve. Mâ në fund hoq plisin dhe u mbështet në tavolinë. Ajo, që e mundonte mâ tepër, ishte pyetja: A do ta kandidojnë?

„A thue do të me zgjedhin prap për kryetar të këshillit komunal? Këta t'organizatës po më kritikojnë... këta tjerët, ani, janë çue dhampir... Si ndërmjetës — s'kanë ku më çojnë. Eee, kujtojnë këta se unë jam budallë... T'hi unë në komisjonin kandidues, mbasandej — bâ pallë! Nëkoftëse zgjedhësat më kandidojnë për këshilltar, jap dorëheqje prej komisionit. Nëkoftëse nuk më kandidojnë, atëherë, ndoshta, ja mbushi mendjen komisionit që ata të më propozojnë."

Ngriti kryet dhe shiqoi zgjedhësat.

„Aty qenka!" — tha me vehte. Mendonte për, atê, me të cilin ishte marrë vesh që ta propozonte për antar të komisionit kandidues, dhe vazhdoi:" Shka? Zor e ka kush me çue politikë si unë! Tatimet i kam mbledhë... Fëmijt po shkojnë në shkollë. Vajzat njimend s'po shkojnë sa duhet po — kjo nuk âsht vetëm në komunen tonë... Shkollën e mbaruem... Ujin e prumë... Mirëpo — qysh? Kur ardhke kush prej s'nalti ose kur më thirrëshin atje, bâjsha: sa jam tue dijtë — po punoj... Shkollë nuk kam që me e dijtë ligjin pikë-për-pikë... Njeriu që punon edhe gabon... Do të kujdesohem me i krye këto detyra... E këhâ, sekretarit e tjerëve: ju krveni zakonin, a për popull — lemani mue!... Ti, si komunist, duhesh me qenë i parë! Ti si udhëheqës i Lidhjes socialiste i ke krejt dizginat në dorë! — Njanit bacë e tjetrit axhë, mixhë, kojshí... Kë-

shtu kam krye punë. Jo dy, po tri nana i thithsha... S'âsht kollaj me konë njeri i popullit! Me ardhë kush prej komunistave kryetar — kanë m'e ngrehë largë... Nëkoftëse vijnë këta tjerët — e pengojnë punën krejt".

Dhe filloi edhe mâ tepër me e çmue pozitën e vet.

„Në këto dy vjet s'kam kapërcye keq... Njani: ‚Kam qejf me m'ardhë në gëzim'. Tjetri: ‚Për qejf po të thirri në sillë, se jo që po të tutna'. ‚Që kryetari' — thojshin grat e fëmijt kah kalojsha rrugës. Njimend kam kursye, por qe — e mbarova shpín... Bleva nji hekter tokë..."

Ngriti kryet. Dhoma ishte plot e për plot. Kishte ardhë koha. Lëvizjet e syve dhe hapja e gojës, tue i çue vetullat përpjetë, ishin shêji se donte me ja fillue punës.

Kadriu rrinte në bankën e parë, afër derës. N'at bankë ishin ulë edhe Marku me Ramën. Bâjshin plan se si do të shpërndaheshin nëpër zgjedhësa. Kadriu shiqoi për rreth. Pa Vehbiun që ishte në bankën e katërt dhe sekretarin e Lidhjes socialiste me kryetarin e kooperativës. Dauti rrinte në kambë mbrapa me disa të mahallës së vet, ndërsa Syla dhe Stanku në bankën e parë afër dritares. Kadriu u ul dhe Ramës e Markut jau bani me krye kah Syla e Stanku, të cilët i vidhshin me shiqim pa këputë, ndërsa këta bisedojshin. Mandej u çue dhe shkoi dy tri banka mbas. Bisedoi me disa zgjedhësa. Tue u kthye, u ulë, si rastësisht, në bankën që ndodhej mbas bankës së Sylës dhe Stakut. Marku shkoi në mes të paraleles dhe zu vend në nji bankë, ku ishin ulë dy zgjedhësa. Rama mbeti në vendin e vet.

Syla u kthye mbrapa për me bisedue diçka me njanin prej zgjedhësave, e kur e pa Kadriun, u mrrol, ktheu kryet dhe e preku Stankun me dorë. Stanku e shiqoi me sy të picrruem tue e mrrolë fëtyrën e kuqe rrumbullake. Mustaqet e thita e të mëdha iu mblodhën rreth gojës. Syla i dha shêj me vetulla të thime, të trasha e të shkurta, e për së shpejti edhe në nji anë të buzëve, tue i zgjatë

mustaqet e rrumcakta. Në ball e në fëtyrën e gjanë u dalluen edhe mâ tepër rrudhat e thellë.

— Qe, ai! — bani fare ngadalë.

Stanku e shiqoi Kadriun me bisht të synit, e mandej u ndal në Dragutinin, që ishte ulë në nji skaj të tavolinës, tue lexue fletoren zyrtare dhe tue u përgaditë për mbledhjen e zgjedhësave. Nxuer kutín, mbështolli nji cigare, e ndezi dhe ia dha kutín Sylës tue fshâ. Mu n'at ças — Ali Abazi hyni mbrendë, e kryetari i këshillit komunal e hapi mbledhjen.

— Këtë mbledhje të zgjedhësave, shokë e shoqe, e kemi thirrë për me kandidue këshilltarët e rij të këshillit komunal. Prej këtij katundi duhet të zgjedhen tre këshilltarë. Ju duhet me i kandidue mâ sê pakti gjashtë — kështuqë, kur të bâhen votimet, tre mâ të mirët të fitojnë.

Rama ia lëshoi nji sy dhe qeshi me ironí. „T'ia këpus shpresën menjirendi" — mendoi dhe tha me zâ:

— Hiç mos mba ymyt se ty, beli, as s'po të kandidojmë as s'po të zgjedhim! S'ke punue si duhet.

— Mos m'u përziej në fjalë. Unë jam ngarkue me ligj për m'e hapë mbledhjen, e nëkoftëse s'don populli, le të mos më kandidojë.

— Boll je kanë!... Ta kamë marifetin tand! — u ndigjuen disa zane.

Kryetari u skuq, u hutue. Iu shtrengue fyti dhe prej tij krrokati njifarë zani, sikur ta kishte rrokë ndonji sëmundje:

— Posë kësaj pike, do të mbahet edhe proçesi në lidhje me ngarkimin e tatimit, sa e kush ka me dhanë...

— A, e keni, këndaqë! — tha Aliu, i cili rrinte në kambë te dera.

Kryetari bani sikurse nuk ndigjoi.

Në bazë të ligjit duhet me zgjedhë kryesín e mbledhjes prej tre vetëve, nji për të mbajtë proçeset dhe dy vërtetuesa. Kush ka ndoj propozim?

Rama shiqoi anësh, çoi dorën, dhe mbasi muer leje, u ngrit në kambë.

— Propozoj Ali Abazin.

Aliu i hutuem shiqoi Ramën. Kryetari pyeti:

— A pajtoheni?

Ende pa u ndigjue zani i zgjedhësave, Aliu u drejtue kah ata. Iu përzien mendimet: „Kryesija... kryetari... Zahare po duen me më zgjedhë kryetar të komunes?! A thue muej me iu përgjegjë punës? Jo, nuk muj! Nëkoftëse nuk e marrin parasysh këtê, le të bâhet. E shtyj diqysh..."

— Unë s'kam vakt, bre vllazën. Unë edhe nuk e dij zakonin si duhet. Muj me bâ ndonji gabim...

Rama u ndigjue prap — si me e pasë kuptue çka mendonte Aliu:

— Ti po kujton se po të zgjedhim për kryetar të komunes, a? — dhe nëpër të qeshunat e zgjedhësave, vazhdoi:

— Ti ke me qenë vetëm për sod, derisa të mbarojmë këtë mbledhje! — dhe heshti.

— Ani, veç — jam pa ngé. Nesër më vjen nji dorë nusje... Po, nejse, nuk po ua prishi hatrin shokëve — bani Aliu si me u arsyetue.

— Unë po propozoj Markun, qe ku qenka afër meje — tha njani prej zgjedhësave, që ishte ulë në bankë para Markut.

Dragutini e shenoi shpejt emnin e zgjedhësit dhe propozimin e tij dhe ashtu me laps në dorë, u çue:

— Unë propozoj Kadri Hysenin.

— Tash — tha kryetari — kemi dy propozime. A të votojmë përnjiherë?

— Të votojmë!

Në pyetjen e kryetarit, gadi të gjithë i ngritën duerët. Syla posa e ngriti deri te goja, si me pasë dashtë me e ndezë cigaren, ndërsa Stanku shiqoi rrotull dhe, kur e pa se të gjithë i kanë çue duerët, ngriti dy gishta përpjetë.

U zgjodhën edhe vërtetuesat. Dragutini u zgjodh për me mbajtë proçes-verbalin.

Kur antarët e kryesís erdhën te tavolina, Aliu e rroku Kadriun për krahu dhe e vuni te shkambi i mesit. Marku u ul n'anë të majtë e Aliu n'anën tjetër. Dragutini i dha Kadriut nji copë letër të bardhë me disa rreshta të shkruem me maqinë. Ai shiqoi letrën dhe u muer vesht me Markun e Aliun

për rendin e ditës. Dragutini u ul n'anën e djathtë të tavolinës, muer lapsin dhe ia filloi me shkrue. Kadriu u çue në kambë dhe, herë tue shique në letrën që ja dha Dragutini, herë në zgjedhësat, tha:

— Shokë e shoqe, konstatoj se numri i zgjedhësave, që marrin pjesë në këtë mbledhje, âsht i mjaftueshëm. Pra, kjo mbledhje, simbas ligjit, mundet me marrë vendime të plotfuqishme. Propozoi këtë rend dite:

Nji — zgjedhja e komisionit kandidues;

dy — propozimi i kandidatëve për këshillin komunal;

tre — diskutimi dhe propozimi i komisionit për kandidim dhe pranimi i kandidatëve;

katër — shqyrtimi nga ana e zgjedhësave i punës së komisionit të tatimeve.

Propozimi u pranue njizanit.

— Para se me fillue punën, deshta me ju thanë disa fjalë — shtoi Kadriu, tue i mbledhë vetullat. — Deri tash kandidimin për këshilltarët e këshillit komunal e ka bâ Lidhja socialiste, Fronti populluer. Tash, mbasi po shkojmë tue e zgjanue demokracín socialiste, kjo e drejtë iu ka dhanë mbledhjeve të zgjedhësave. Në mbledhjet e zgjedhësave marrin pjesë mâ shum se në Lidhjen socialiste.

— U ndal dhe i endi syt mbi zgjedhësat.

— Qe, Myftari, përshembull, nuk ka të drejtë me marrë pjesë e me vendosë në Lidhjen socaliste. Këtu po...

Myftari, që ishte ulë në nji qoshe, deri tash e shiqonte drejt në sŷ, e mbas këtyne fjalëve e uli kryet, tue shique me bisht të synit ata që ishin afër tij: mos po e shiqojshin.

Kadriu vazhdoi:

— Mandej, kjo mënyrë e kandidimit u siguron zgjedhësave që edhe të kandidohen edhe të zgjedhin përfaqsuesat e vet në pushtetin tonë pupulluer — pushtetin revolucionar, për të cilin populli punues ka derdhë shum gjak e djersë.

U skuq në fëtyrë dhe e çoi gishtin përpjetë.

— Populli ynë i ndershëm nuk duhet me lejue kursesi që në këtë pushtet të kandidohen dhe të zgje-

dhen ata që kanë luftue me çfardo mënyre kundra partizanëve, që kanë sabotue masat e ndryshme të ndërtimit socializmit — që nuk e kanë dhanë drithin, mishin, leshin, tatimin e ku ta dij unë; ata që kanë mujtë me marrë pjesë në brigadat e frontit, ose djemt e tyne në brigadat e rinís, e nuk kanë shkue; ata që e pengojnë punën e shkollës dhe kurseve, tue mos i çue femnat në to; ata që nuk e kanë në zemër vllaznimin e bashkimin e popullit tonë, ata që nuk e zbatojnë ligjin tonë për mbrojtjen e rrugëve, pyjeve, utrinave, të drejtës së grues e tjera si këto...

Në këto fjalë, kryetari i komunes ia shkroi ngadalë dy tre rreshta dhe ia hodhi letrën truq. Kryetari shkruente:

„Nuk âsht vendi këtu për agjitacion. Këto âsht dashtë me i folë në Lidhjen socialiste."

Kadriu e lexoi letrën dhe bani me vehte: „Kush e ka mizën në kapuç..." — dhe vazhdoi:

— Unë, shokë, fola si zgjedhës. Sa e dij — kam të drejtë me folë atê që mendoj. Fola për këto gjana se disa njerëz, si këta që i përmenda, po mundohen me ia humbë bojën demokracís socialiste. Ata duhet ta dijnë se demokrací për ta nuk ka! Na po e zhvillojmë demokracín socialiste për popullin e ndershëm, që ai të ketë sa mâ tepër të drejta e jo për ata që deri tash na kanë pengue në çdo hap. Do kanë veshë lëkurën e kingjit, mirëpo turini i ujkut u ka mbetë se u ka mbetë. Nëqoftëse fillojnë me u përzie, ta dijnë se kanë me mbetë pa tê! Dikush, ani, po mendon se demokracija âsht me punue krye më vedi. Edhe atyne duhet me ua shti në mend se bashibozukë nuk ka mâ!

Përshtypja që bâjshin fjalët e Kadriut ishte e ndryshme: Syla e Stanku pijshin cigare mbas cigare tue e ngrehë tymin thellë në mushkní e tue shique, nganjiherë, tinzisht Kadriun. Nuk âsht se këta dëshproheshin që nuk do të mundeshin me u kandidue. Prej kësaj kishin çue duerët qysh prej atij çasti kur i kishte njoftue Dauti dhe kur filloi me u diskute nëpër katund se çka ishte bisedue për ta në mbledhjen e organizatës themelore të Lidhjes së komunistavе. Tash kishin frigë se mos po disku-

tohej për të gjitha ato gjana këtu, para zgjedhësave. Syla i tha Stankut kadalë:

— Nuk âsht aspak e hijshëme nëkoftëse ia shtijnë ndërmend miletit të gjitha ato gjana që kanë folë për neve.

Stanku ishte kah mendonte ato ditë mâ tepër se përpara që të shpërngulej prej katundit për me shkue për në Krushevc. „Si të flasin para masës, duhet me e shpejtësue shpërnguljen!" — mendoi.

Megjithëse Dauti i kishte bindë atëherë — kur u tregoi diskutimet që ishin bâ n'organizatën e Lidhjes së komunistave — se këto gjana janë të vjetra dhe se organet e pushtetit nuk kanë me i marrë në përgjegjësi për to, ata s'mund ta hiqshin frigën. Nuk kishin me ardhë në mbledhje të zgjedhësave, por këtê e banë mbasi vendosën mos me u kandidue. Stanku, tue u përgaditë me ardhë në mbledhje, i pat thanë Sylës: „Mos të bâhemi shkaktarë për të keqen tonë. Nëkoftëse kandidohemi, atëherë këta do të jenë gadi me na i qitë punët në ledinë.„ Pushteti, ani, Sylës nuk i dilke prej mendjes. „Sidokoftë m'e pasë aty nji njeri tonin, nuk âsht keq." Dhe erdhën në përfundim me kandidue Dautin. „Ky â hem njeri ynë, hem i tyne"... Prandej edhe kishin vendosë me ardhë në mbledhje me përkrahë Dautin dhe me u pa se janë aty. „Ndoshta kur të jemi na aty, tuten me folë keq për né e me na i qitë sendet që nuk u hyjnë n'udhë. Shumica janë rritë në bukën tonë" — tha Syla.

Para se me ardhë në mbledhje i njoftuen për këtë vendim edhe ata që në konferencën e Lidhjes socialiste i patën propozue për këshilltarë.

Kur Kadriu u ul, Marku dhe Aliu e shiquen me buzëqeshje tue ia bâ me krye se foli mirë. Ai shiqoi përsëri letrën që ia dha Dragutini dhe u çue.

— Para se të kalojmë në rendin e ditës, Dragutini, sekretari i këshillit komunal, ka me lexue proçesverbalin e mbledhjes së kalueme dhe disa nene të ligjit të zgjedhjeve dhe shkarkimit të këshilltarëve.

Të gjithë e ndëgjuen me kujdes Dragutinin. Mbasi mbaroi, Kadriu tha:

— Atëherë po fillojmë pikën e parë: zgjedhja e komisionit kandidues. Kush ka ndonji propozim?

Propozimet bâheshin shpejt dhe, me shumicë, pranoheshin, me përjashtim të dy vetëve: njani nuk ishte aty e tjetri ishte kryetari i deritashëm, të cilit i humbi shpresa, mbasi Rama e kundërshtoi edhe tash tue ia qitë të metat sheshit. Fëtyra iu nxi. Kryet e uli dhe rrinte në bankë si cung. „Me pasë me ja ngjitë për arrëze të fytit deri t'i dalin syt grugulluq" — thonte me vedi kryetari i deritashëm, tue ia lëshue nga nji shiqim të rreptë Ramës. U zgjodhën nandë antarë të komisionit dhe pesë zavendësa të tyne. Ndër ta u zgjodh edhe Rama. Për kryetar të komisionit u zgjodh Maliq Ramadani, kryetari i kooperativës.

— Tash po kalojmë në pikën e dytë — tha Kadriu. — Propozoni gjashtë kandidatë për antarë të këshillit komunal.

— Unë propozoj Trajkun, sekretarin e Lidhjes socialiste — tha Vehbiu. — Asht aktiv në punë... ka jazi dhe — ka punue mirë deri tash.

— Kush âsht për këtë propozim le të çojë dorën!

Të gjithë i ngritën duerët.

Kadriu tash ia dha fjalën mësuesit.

— Unë propozoj Kadri Hysenin. Shoku Kadri âsht mâ aktivi prej të gjithëve.

Në heshtjen që mbretnoi, u ndigjue nji zâ:

— Mos na lodh, shok mësues, allahile, se e njofim mâ mirë se ti!

Disa qeshën. U ndigjuen disa duertrokitje. Kadriu u skuq dhe dhe me zâ t'ultë:

— Kush âsht për këtë propozim le të çojë dorën!

Në sallë u ngritën shum duer, e, mandej, prap duertrokitje.

— Unë po propozoj Daut Hajdinin... Edhe mahalla jonë duhet me e pasë diken. Ky âsht komunist, deri tash ka punue mirë — tha njeni prej bankave të fundit.

Kadriu shiqoi rrotull.

— Kush âsht për këtë propozim?

Shumica ngritën duerët.

— A âsht kush kundra?

Rama u bâ gadi me kundërshtue propozimin por Kadriu ja bani me krye dhe — nuk foli gjâ.

Nji shoqe, prej atyne të rejave, tha:

— Më duket se edhe na grat kemi të drjetë me u zgjedhë për këshilltare! E... unë propozoj shoqen Darinka.

Darinka, që ishte afër saj, e ngrehi për fustani që t'ulej, e mandej u çue vetë:

— Unë nuk muj me pranue. Jam plakë. Kam punët e shpís, po duhet me kqyrë fëmijt, punën në fushë...

Shoqja që propozoi foli përsëri:

— Ka njiherë në muej mundesh me shkue në mbledhje të këshillit. Këta mos të kërkojnë punë prej teje si prej mashkujve! — dhe tue iu drejtue kryesís: — Kërkoj që të votohet për propozimin tem.

Kadriu e vuni në votim propozimin dhe e çoi dorën i pari. Të gjithë votuen për tê.

Kandiduen edhe dy të tjerë.

Komisioni kandidues u tërhoq përjashta. Tue dalë, Rama iu afrue Kadriut:

— Unë do të ndërhyj në komision që Dauti të hiqet— tha ngadalë. — Le të vijë nji tjetër në vend të tij. M'u ka bâ tullusum!

— Lene këtë hov. Shko se janë tue të pritë shokët — përgjegji shpejt Kadriu dhe mendoi: „Edhe unë nuk jam i nxehtë në tê, por sa do kudo âsht i organizuem e, ndoshta, përmirësohet. Nëqoftëse e lakon samarin, mundem me e hjekë".

Rama duel i pabindun.

Të vetmin ndryshim që kishte bâ komisioni, mbledhja e zgjedhësave e pranoi me shumicë. Dautin e kishin shti në numrin katër e Darinkën në numrin tre. Pesëmbëdhetë zgjedhësa, së bashku me Sylën dhe Stankun, votuen kundra këtij korrigjimi.

— Para se me dalë në pikën e katërt, po pushojmë pak. Këta të komisionit për caktimin e tatim-fitimit le të bâhen gadi.

Disa duelën jashtë, e disa mbetën aty.

Komunistat dhe disa aktivista u mblodhën me nji anë dhe bisedojshin në kambë:

— Reakcioni nuk pat guxim me u kandidue — tha Kadriu.

— Ja kanë ndie erën frigës, prandej u shukatën. A e din si flitshin para disa ditësh? — shtoi Dragutini.

Qeshje e tallje.

Afër dritares ishte mbledhë nji grup i vogël, ku merrshin pjesë edhe Syla me Stankun. Syla, në të cilin ishin ngulitë syt, e përthekoi gujën e shkurtë dhe e trusi plisin e mbështjellun me shall ngjyrë kafje.

„Nuk u bâ mirë që ja ndërruen vendin po, nejse, në listë hyni!" — ia bani ai ngadhnjyeshëm dhe qeshi. Ishin të kënaqun për kandidimin e Dautit. por edhe mâ tepër pse nuk u fol gjâ për të cilën iu kishte hŷ lepri në bark. Nuk ishte puna se nuk ua dijshin këto gjana negative. Si komunistat, ashtu edhe katundarët tjerë, i njifshin mirë Sylën dhe Stankun, por ende nuk ua kishte thanë kush ashtu truq para masës qëndrimin e tyne anmiqsuer. Ende shum njerëz të mbrapambetun ishin të nji mendimi me Dautin — se ata i kanë bâ shërbim popullit dhe kanë punue atê që ka kërkue pushteti, të cilin duhet me e ndigjue edhe nëqoftë „dreq i zi".

Zilja lajmroi vijimin e mbledhjes.

Ata që kishin vendet n ulën përsëri, të tjerët u shmangën anash.

Kadriu ia dha fjalën kryetarit të komisionit për caktimin e tatimeve. Ky i vuni syzat e lidhuna me nji anë me nji tojë e në tjetrën me tel, nji dorë e mbështeti n'elaboratin e komisionit që e kishte në tavolinë e, në tietrën, mbante nji copë letër të shkrueme.

— Kemi punue, shokë, qe nji muej ditë — tha — dhe kemi hasë në vështirsina të mëdha. Shum prej zgjedhësave nuk na kanë dhanë shënime të sakta, prandej jemi detyrue me pyetë edhe rreth e përqark. Nganjiherë, edhe antarët e komisionit nuk pajtoheshin ndërmjet vedi. Ka pasë prej tyne edhe asi që ruejshin vedin ose ndonji t'afërt. Na, sa kemi mujtë, i kemi luftue. Mâ së mbrami, qe ku jeni ju dhe epne fjalën tuej. Qe nji javë që komisioni e ka

shpallë propozimin e vet në vende të dukshme. Por, sidoqoftë, jam i mendimit me ja lexue edhe njiherë para sysh secilit të parë shtëpije t'ardhunat dhe tatimin. Pse, dikush, ndoshta, nuk ka mujtë me lexue ose nuk e ka dijtë tatimin.

— Ashtu âsht! — u ndigjuen disa zane.

— Unë, shokë nuk jam tue pa bash mirë, prandej propozoi që Dragutini t'i lexojë t'ardhunat për secilin dhe të thotë se âsht ngarkue me tatim, mbasi ai âsht edhe sektretar'i këshillit komunal dhe antar'i këtij komisioni.

— A pajtoheni? — pyeti Kadriu.

— Pooo.

Plaku u ul i fshini djersët me faculetë të ndrydhun, lëmoi mustaqet e mëdha të thime, përthekoi gujën dhe ia nguli syt Dragutinit, që ishte çue prej vendit dhe lexonte me rradhë ashtu si kishte punue komisioni. Lexonte emnin e mbiemnin e të tatuemit, t'ardhunat në përgjithësi, i zbritte shpenzimet që kishte bâ për ato t'ardhuna dhe e njoftonte me sasín e tatimit.

Disa mbajshin shënime. Edhe Kadriu shënoi diçka në fletoren e vet.

Kur mbaroi leximin, Dragutini shtoi se kujt i intereson mundet me i kërkue hollsisht shënimet në mbështetje të të cilave komisioni kishte punue.

Diskutuen gjashtë zgjedhësa. Pesë vërejtje nuk ishin me vend, kurse njanën e pranoi mbledhja. Tjetër kush nuk u paraqit.

Kadriu mendonte: „Sa të mbajmë mbledhje të veçantë e ta njoftojmë popullin me qarkore të re, mâ mirë po u flas tash dhe... po i paraqes edhe vërejtjet e mija".

— Në këtë vjet, tatimi do të paguhet me kadastër. Në këtë mënyrë do të shihen mâ mirë puntorët dhe dembelat. Nëqoftëse dy vetë kanë tokë të njâjtë edhe tatimin do ta paguejnë të njajtë. Mirëpo, dembelit nuk do t'i mbetet gjâ ose do t'i mbetet fare pak, kurse puntori e paguen dhe s'ka me e ndie. I pari s'e ka punue tokën si duhet, kurse i dyti ka derdhë djersë dhe âsht shkrî në të...

— E dyta gjâ që deshta me diskutue âsht gabimi i komisionit në lidhje me llogaritjen e t'ardhu-

nave të Sylë Hajdinit dhe Ali Abazit. Sylës duhet me ja shtue t'ardhunat edhe dy herë mâ tepër se Aliut, e Aliut me ja paksue njizetepesë mijë dinarë.

— Pse, bre? — kceu Syla. — Kujt të doni paksonja, por mue pse me m'i shtue?

— Sepse ti ke mall dy-tri herë mâ tepër se Aliu — i tha Kadriu tue ia drejtue gishtin.

— Qe po jua lexojmë shënimet njanit edhe tjetrit, se për shka janë ngarkue për vjetin e kaluem — ndërhyni sekretari, tue kërkue shënimet e tyne. Mbasi nxuer të dy shënimet prej eleboratit të komisionit, lexoi:

— Syla: shtatë vetë; pesë jo t'aftë për punë. Aliu: pesë, por katër t'aftë për punë. Syla: shtatë hektarë tokë; Aliu: dy. Mirëpo, — Syla: tri krenë gjâ të trasha e Aliu: nji pendë ké, nji lopë dhe dy mështjerra. Njani djalë i Aliut ka punue gjashtë muej me kerr tue qitë metra prej Popilaçeje. Afër njimijë dinarë i ka marrë në ditë.

— Qe ku âsht gabimi! — ia preu fjalën Kadriu. — Ju po i bani vjetat e Aliut mështjerra. Syla ka vetëm tri krénë gjâ të trasha, po i ka edhe nji pendë ké që i ka çue te miku i rí në qesim e te i vjetri ka çue njizet krén dhen, nji lopë e nji bullicë. Këto i din edhe katundi. Ku âsht toka e Aliut rreth kodrave, e ku âsht ajo e Sylës buzë Moravës. Syla jo vetëm që ka dy mashkuj t'aftë për punë, po atij i punon edhe grueja e ré. Njimend ka pak vjet, por, kur mundet me u bâ grue, mundet edhe me punue. Ashtu edhe Dauti, motra e Dautit. Pra — katër vetë, e jo dy!

Syla kërcllinte dhambët. Deshti me e shá, por u përmbajt.

— Pse, bre, po m'i ngjet do të pabame?

— A lidhemi me kusht? Nëqoftëse nuk âsht si po thom, po të bâj rrogtarllëk badihava sikur të kam bâ do kohna. Nëqoftëse âsht sikur po thom, atëherë...

Disa qeshën me zâ, e disa luejtën kryet.

Syla, i prekun që u zû në rrênë dhe që „bishti i tij" po ia humbë „iftibarin", tue u ulë, tha:

— Nuk të kam marrë në punë pa pare, jo!

— I lamë ato, por unë kërkoj prej komunes me të qitë në gjygj se po e saboton edhe tash socializmin.

Syla kafshoi gjuhën. Deshti me u ngritë e me folë çka t'i binte ndërmend, po — bani me vehte: „Na mâ mirë le të kalojë me kaq".

— Çka thueni ju, shokë, a duhet me e paditë në gjygj dhe me ia shtue tatimin? — pyeti Kadriu.

— Me ja shtue tatimin ani, e me e qitë në hyqymet nuk bâjmë mirë — tha njani, që ishte afër Dautit. Ata që ishin të mahallës së Sylës, dhe ata te të cilët sundonte botëkuptimi se çdo gjâ që njani flet për tjetrin, kur ai vetë e mshef, âsht „myzevirllak", u mrrolën dhe e kqyrën rreptë Kadriun.

U pranue propozimi që Aliut t'i zbriten njizetepesëmijë dinarë prej t'ardhunave, e Sylës t'i shtohen edhe pesëdhetëmijë. Kur u vû në diskutim propozimi për me e paraqitë në gjygj zgjedhësat muerën pjesë me nji shumicë të madhe dhe ky propozim nuk u pranue. Aliu e preki Kadriun.

— Bafsh hajr! Për mue e ngushtove vehten.

— Detyrë e kam me luftue për të drejtën.

U disktue edhe për disa tjerë. U banë ndryshime edhe te tre vetë.

Kadriu e mbylli mbledhjen.

I pari ndër të gjithë të tjerët e lëshoi sallën kryetari i komunes. Ai u përvodh pa u vû re, tue ecë ngadalë e krye ulun.

NË SHTËPÍN e Aliut po ndodhte sod diçka e re, e hareshme.

Dhoma, ku po pritshin msitët në krye me hoxhën, dashamirët dhe kojshit — ishte e ndërrueme mâ tepër se tjera herë. Në dy anët e shtrojave ishin dy qylyma të rujtun, kurse n'anën e djathtë, mbî qylym, edhe nji jane me cukla. Njanin qylym dhe janen i kishin marrë prej kojshive vetëm për at ditë. Tjetri ishte i tyne. Ndërmjet dy shtrojave, afër oxhakut kishin shtrue në tokë nji postaqí, kurse me qylymin e vjetër kishin mbulue trapazanin. Për rreth kishin rendue edhe disa jastekë të rij, të ruejtun. N'oxhak digjej zjarmi. Në trapazan mangalli plot prush me dy gjygyma në tê. Rreth tij takami me disa filxhana dhe nji tepsí me gota çaji, dy qese të mëdha me sheqer e kafe. Në mur nji letër varë, që sigurisht ua kishte çue dikush prej ushrís.

Pranë disa rreshtave të palexueshëm — shuplaka e dorës së shkruesit, e vizatueme pa shije. Afër letrës nji palë tespihë të gjatë dhe nji cigarallëk qehlibari, që i kishte mbetë Aliut trashigim prej babës dhe e vente në mur atëherë kur donte me e hijeshue dhomën.

Disa mâ t'afërm — miku i Aliut, dhe gjyshja, çika e martueme e dhandrri, erdhën qysh në mbramje. Sod, heret, erdhën edhe dy baxhanakët me gratë e tyne. Filluen me ardhë edhe gra e çika të kojshive si edhe kojshít e katundarët që kishte thirrë Aliu. Kur vijshin ja bâjshin „për hajr" dhe, simbas afërsís e aftësís, merrshin me bâ punë të caktueme. Njani rrinte gadi me pa se kur po shifen mësitët në katund, që të lajmronte ardhjen e tyne. Nji tjetër ishte caktue me bâ kafe e çaj. I treti — me shpërnda kafet dhe çajat, me mbledhë filxhanat e shprazët, me dhanë ujë ose gaca me ndezë cigaret, me u kujdesë për me shtrue dhe me çue sofrën.

Përveç tjerëve, Aliu thirri në gëzim edhe Sylën e Kadriun. Sylën — si njerí plak, që e njifshin bota jo vetëm në Bllatë, por edhe mâ larg, që dinte me bâ muhabet me miq, mandej edhe për me i bâ „iqrám" si njanit prej krenëve të katundit. Kadriun — si njeri që po përzihej në punët e katundit dhe të pushtetit dhe që po punonte me drejtësí, si njeri të dijshëm dhe guximtar. Mos t'ishte ai — kush kishte me e pague gjithë at tatim, që ia patën caktue!

Po vijnë! — thirri tue hŷ me nxitim në dhomë ai që e kishte për detyrë me lajmrue.

Posë dy miqve që mbetën afër oxhakut, të tjerët, në krye me Sylën, duelën te dera e oborrit dhe u renduen në pritje.

Hoxha, i shoqnuem prej dy shokëve tjerë dhe i përcjellun prej mikëpritësave, hyni n'oborr dhe iu drejtue dhomës së naltë.

Te gratë dhe vajzat krisi kanga dhe defi me çampare.

Hajde, mësito, hajde me nafakë,
bohçja e jote palë përmbi arkë,
palë përmbi arkë, mbështjellë në letër,
more i biri i qenit, shka don tjetër?...

Shpejtojshin kah dhoma tue u shti se nuk po ndigjojnë kangën. Dy prej tyne u ulën në nji anë t'oxhakut, kurse hoxha në tjetrën. Syla u ul afër hoxhës. Aliu ua qiti nga nji cigare dhe, sa i ndezën, ja mbërrinë kafet. Hoxha bisedonte pak. Mendonte. „Rrëmujë e madhe... po gaboj tue dhanë dorën." Tue i kujtue këto fjalë, tha me vehte: „Edhe nji si unë s'kanë me e gjetë për këso punësh! Ta hjeki gajlen e të rrij rahat. Edhe vakti âsht..." U çue në kambë dhe iu drejtue Aliut:

— Alio, paja këhâ!

Aliu, tue u pengue në nji skaj të janes, gadi u rrëxue. Kur erdh afër hoxhës, të gjithë brofën në kambë. Hoxha i lëshoi duerët si në lutje dhe ia filloi si me qenë në xhamí:

— Eudhubilahi mineshejtani rraxhim bismillahi rrahmani rrahim! A ja ke lypë Taf Sadikut të Moravës çikën për djalë?

Aliut iu suell nëpër mend si vetima se ky nuk e kish lypë, po hoxha e kish ndreqë vetë këtë punë. Megjithatë iu përgjegj:

— Po, hoxhë, si po thue ashtu âsht.

Sylës nuk i tingllòi në vesh si duhet kjo përgjegje e Aliut.

— Thuej: „Po, ja kam lypë!" — i tërhoqi vërejtjen kadalë.

— Po, ja kam lypë! — përsëriti Aliu dhe u skuq.

— Allahu emrîle pejgamber kaullile: Taf Sadiku i Moravës ta ka dhanë çikën për djalë — ia bani hoxha në qetsín mâ të madhe dhe ia zgjati dorën. — Hajrin ja pafsh!

Ia shtrenguen njani tjetrit dorën dhe u muerën n'grykë.

— Ejvallah, hoxhë! Paç faqen e bardhë!

Gadi të gjithë ata që ishin në kambë thanë njizanit me buzëqeshje:

— Ooo, për hajr të koftë Ali, për hajr!

— Hajr paçi, bre shokë e dashamirë, e ju miq të dashtun!

Tue u kthye i shiqonte shokët me buzëqeshje. Erdhi te trapazani. E ndjeu të nevojshme me i nderue të gjithë të pranishmit. I hypi njifarë fuqije e briti me zâ të naltë:

— Ho, bre, ti, qi po rrin rreth tangarit, livrit pak!

Tash hareja u shtue edhe mâ tepër. Tymojshin duhan, pijshin kafe dhe bisedojshin ndërmjet vedi, ulë kambëkryq. Prej së poshti vinte kanga pa u kputë:

... Ani more hoxhë, msit i ri,
Ani kush t'ka thanë msit me hi?
— Mue m'u ka kâjtë kjo msitni
Se m'ka metë grueja pa dimi...

Këndojshin dy grupe vajzash e bijash. Nuset e reja rrijshin paluet, kurse ato që ishin vjetrue pak rrijshin ulë në shkàm. Vajzat të veshuna thjeshtë: me shamija të lidhuna deri te vetullat, fanella të bardha, ose xhaketa basme me dimi dhe pshtjellakë të kuq e në kambë-nallane. Veshmbathja e bijave dhe e nuseve të reja kishte dallim prej asaj të vajzave. Nuset bajshin shamija me oja në maje të kres e zylyfe të lëshueme në dy anët e faqeve. Disa kishin edhe bistekë deri në shokë. Xhaketat dhe dimít lahore ose kumashi; këmishat e mëndafshta me mangë të gjana. Në duer bylyzykë të ndryshëm e në qafë, ndonjana prej tyne nga nji dukat, por mâ tepër peneza. Në kambë këpucë të ruejtuna dhe çarapë pambuku.

Plakat herë rrijshin afër nuseve të veta, herë bisedojshin ndërmjet vedi. Dy bija luejshin valle „veta-vetë". Si te këto ashtu edhe te tjerat nuse të reja bijshin në sy kollanat rreth belit.

Ky ishte grupi i grave dhe i vajzave mâ t'afërta të shtëpís, që kishin ardhë me shtue gëzimin e me u dëfrye edhe vetë.

Edhe Fatimja, motra e Dautit e mbesa e Sylës, merrte pjesë në këtë dëfrim të grave. Ajo rrinte gjihnji pak si në mendime. Flitte rrallë. Kanga e

loja e vajzave, nuseve dhe e bijave të reja, nuk i bâjshin kurrfarë përshtypjeje. Shiqonte pa kurfarë lëvizjeje në fëtyrë. Nganjiherë qeshte pa zemër. Nji shoqe, që ishte tue kërcye në valle, kur kaloi pranë saj, i tha:

— Pse s'po këndon? Kërkend nuk e ke shti në në dhé!

— Tybe, zani dishka nuk po më shkon... Po, edhe def, mori, nuk kam.

— Gjêje, çikë, njâ! Shko te Shabanët e merre!

Fatimja kishte natyrë mjaft të gjallë. Edhe ajo kishte qejf me këndue e me këcye, por nuk mundej me i mbledhë fuqít. E brente diçka përmbrenda. Ajo e lidhte këtë gëzim me Hasanin e Hajrijen, e krahasonte rastin e Hajrijes me të vetin... Ndërrimet që kishte bâ Syla me te, e Aliu me Hajrijen. E shifte vehten dhe t'ardhmen e vet të pasigurtë. Prandej e habitte kanga dhe këcimi i vajzave dhe grave, që në shumicë i kishte gjetë ose i pritte fati i tillë. Fshani thellë:

— Qysh po mujnë, qysh!?...

Nana e Hajrijes me dy gra tjera ishin tue përgaditë siellën për msit. Tue kalue brî Fatimes, e pyeti:

— Ku âsht Hajrija?

— Më duket te Shabanët... Shka po të duhet?

— Jo, veç pveta!

— Asaj bijo, iu ka dhanë dora. Sikur ti që nuk ke kcye e nuk ke këndue kur ta kanë dhanë dorën, edhe ajo... Asht marre. Por lene ti atê! Përziju me shoqe e kënaqnani pak — dhe me nji saç, që e kishte në dorë, duel shpejt përjashta.

Fatimja, si ishte ulë në shkam, u çue dhe duel prej dhomës pa i rá kujt në sy. Shkoi te Shabanët, që të rrinte pak me Hajrijen dhe të bisedonte për gjanat që e mundojshin. Atje, në shtëpi, afër oxhakut e gjeti nanën loke tue tjerrë lesh.

— A âsht Hajrija te ju?

A hë, âsht në sobë nalt — i tha plaka dhe e drejtoi pak gungën. Mandej, tue pshty gishtat dhe tue dredhë penin, shtoi:

— Asaj i ka ardhë sahati i hajrit, bijo. Eee, shka me bâ. Ulu, ulu se ajo tash vjen poshtë! — e

lëshoi furkën ngadalë në prehën, dhe vazhdoi, si me këndue:

— Sikur sod e mbaj mend kur ma patën dhanë dorën. Jam konë, si thonë, bajrak ndër çika. E sod? Hê, hê... prej vedit po trishtohna!

— Qe, oj nanë loke, na jemi të reja, po shka po të vyen të rít! Mâ mirë mos me konë...

— Shuej bíjë! Qysh — shka të vyen të rít?! Sod ju ipet dora... nesër ju bien pare... mbaroni çejz... jau bijnë petkat... shkoni nuse... bâheni me fëmij... A ka gjâ mâ mirë?

Filloi me iu kujtue e kaluemja, nata e parë.

„Kur më fejuen i kishna tetëmbëdhetë vjet, e kur erdha njizetekatër... Të gjitha mahít e lojnat u shlyen. Nata e parë... e vetmja gjâ që nuk muj me e harrue kurr: ma ngjiti për cica... unë aq e shtrngova ndër kambë, sa ke tue i ra të pakët" — dhe fshani me përmallim. Mandej shtoi me zâ:

— Ah, me pasë me hŷ edhe njiherë nën duvak!...

Fatimja buzëqeshi. E uli kryet, gjoja se u turpnue.

— Ta kqyri shka po ban Hajrija se më duket që s'e ka mendjen me zbritë poshtë.

— Ani, ani, shko pak.

Hajrija, ulë në shtrat afër dritares, mbaronte oja me miqik. Kur hyni Fatimja, ajo e çoi kryet me pa se kush erdhi. Kur diktoi shoqen e vet, brofi në kambë me gëzim.

— A ban me ta bâ për hajr? — i tha Fatimja me njifarë pikëllimi.

— Çfarë hajri, çikë!?

Fatimja u ul afër saj, muer nji skaj t'ojave, tue shique yrrnekun.

— Kishe s'po di! Sikurse âsht tue u bâ te ju sod gëzim, ashtu edhe i Moravësi ka me e qitë dorën tande sot nji javë.

I erdh si me e tallë.

— Sikur ty! Ti e ndërrueme unë e ndërrueme... — iu përgjegjë Hajrija tue vazhdue punën rreth ojave.

Fatimes iu duk se iu ahmuer pa i pasë borxh.

— A po idhnohesh?

Heshtën të dyja. Hajrija i lëshoi në prehën ojat e miqikun dhe u mrrol.

— Me pasë konë në shkollë, nuk kishin mujtë me ma bâ kështu. Qe, Rabijen, pse s'po e jep baci Berat? Tash shka me bâ — si krejt dunjaja edhe na. Razís babës e nanës nuk i dilet! Po dojnë me më lanë mendët edhe për nji gjâ tjetër: vllau me m'u fejue e unë mos me mujtë me u gëzue! E kam pasë deshtë Hasanin si mundet motra me e deshtë vllaun. Kam pasë mendue se kur t'i zamë nuse, kam me plasë tue këndue dhe defin me e shkye copa copa. Hec e këndo tash! Me këndue — thonë: „Qe kqyrni të pamarren, po i vjen mirë që e kanë dhanë!"

Heshti dhe syt iu mbushën me lot.

Kur pat vendosë me ardhë te Hajrija, Fatimja mendonte se do të mundej tash, në gjendjen e saj, me ia thanë të gjitha ato që askujt nuk ja kishte zbulue deri sod e që i silleshin shum herë nëpër mend. Botkuptimi i Hajrijes, si edhe i shum vajzave tjera, që ajo e shprehi tash me „si krejt dunjaja edhe na" — e ndali. Tash edhe iu ngjallën mâ tepër ndjenjat që ushqente ndaj Kadriut. Iu kujtuen mâ gjallë se kurr ato tri-katër herë, kur, së bashku, prashitën e korrën para nji vjeti. Ende pa e drejtue mirë shpinën me u çlodhë pak, ata e vidhshin shpejt e shpejt me sy njani tjetrin, e kur drejtohej edhe Dauti, këta e kthejshin kryet në tjetrën anë ose vazhdojshin punën. Por... para katër muejve Syla e fejoi, tue e ndërrue me gruen e vet të ré. Kjo nuk e pengonte me mendue prap për Kadriun megjithëse mbrapambetunija dhe doket e vendit nuk i epshin shpresë se do të plotësoheshin dëshirat e saj. Nuk ishte aq e sigurtë se edhe Kadriu mendonte për tê dhe, tue mbledhë vetullat e holla, foli me vedi: „As s'kam shka me i thanë, as s'kam kujt me i thanë."

U kthye kah Hajrija. E prekun prej lotëve të saj, u trondit edhe mâ tepër.

— Unë u çova — tha dhe u ngrit.

— Rri, pash zotin, se bash m'u ka hjekë nji

trohë mërzí — ia bani Hajrija dhe fshini syt. Por, Fatimja, tue e ndie vehten të pafuqishme për me i ndihmue, duel dhe shkoi.

*

Hasani, vinte nganjiherë në dhomën e burrave, binte ujë drû. Turpnohej me ndejtë me ta, prandej sillej mâ tepër nëpër oborr. Trembte pulat, që shkapërderdhshin kashtën në pleme, ose i bërtitte qenit, që endej rreth shtëpís mbas erës së mishit. Ishte i gëzueshëm që kish pasë fatin e mirë me zanë nuse me kohë e mos me mbetë si Dup Tërpeza, për të cilin flitej se nuk kishte mujtë me u martue derisa kishte vdekë. Kanga dhe defi te gratë e nxitshin edhe mâ tepër. I dukej se nuk po shkilte në tokë. Për tash, ai as që mendonte se çfarë grueje ka me marrë.

Syla e përcolli me kujdes hoxhën kur ky dha dorën. I tha nji shoqit të vet me zâ të vogël.

— Hallall i koftë, se beli i paska hije msitnija. A e pae? Kur dha dorën, aspak nuk u habit. Foli sikur me ia ngrehë kambzën shtatëshes.

Me nji çast sikur t'u ishin sosë fjalët. Shumica heshtshin vetëm disa bisedojshin me zâ të vogël. Syla mendonte si me çelë muhabetin, por edhe vetë s'dinte ku me ja nisë. E pengonte edhe pranija e Kadriut, i cili rrinte ulë në trapazan.

— A ndigjuet shka kish mbarue ai Gjelekarsi? — u ndigjue pa pritë zani i Kadriut.

Të gjithë e shiquen. Kadriu e çoi gishtin përpjetë.

— Pse i kish ikë grueja për Nasalsin, iu kish përvjedhë në shtëpi dhe e kish vra në magje. Tash pushteti po e akuzon për dy vrasje, sepse grueja kish qenë shtatëzanë — në të tetin muej.

— Zotin havale, jarabi — bani hoxha.

— Jo more?!... — tha njani midis pëshpritjeve dhe habís.

— Po, valla. Pramë ia kish sosë bukën — ia priti tjetri.

Syla e ndiente vehten të fortë në këthough gëzim. Me hoxhën, dost i moçëm, i njifte edhe shokët e hoxhës. Shumica që merrte pjesë aty ishin shpijakë-

që pajtoheshin me Sylën për disa botëkuptime të vjetra. U çue në gjûj, ndezi nji cigare, e vuni në cigarallëk të qehlibarit, dhe, tue thanë me vedi: „Bash mirë që më gjete fjalë... Ty, more lahper, s'të duket kurrgjâ ai që mundohet për dy gishta fëtyrë!" — e me zâ:

— Ai, bre djalë, ka qitë pushkë për erz e namuz. Kush âsht Turk, duhet me i këndue rahmet për së gjalli!

— Ashtu âsht, aga Sylë! — u pajtue hoxha tue i thye gishtat e gjatë.

„Qe, ky qet tash bedate të vjetra. T'ia thej brinat menjiherë" — mendoi Kadriu.

— More s'i këndoi rahmet, po, për insafin që e kam, në konop e kisha qitë. Nuk âsht kollaj me vra njeriun!

— Për këtë punë na nuk po mujmë me u marrë vesh njani me tjetrin. Ato që na i kanë lanë të parët, burrat e vaktit, shokët e tu po i përbuzin.

— Mirë e ki, aga Sylë — beli valla! Jemi bâ lajk. Zoti na ruejtë, jam tue u tutë se toka ka me na lëshue! — tha hoxha.

Kadriu deshti me thanë diçka, por n'at çast u ndigjue zani tallës i Ramës, i cili, si duket, kishte ardhë pa thirrë dhe ishte ulë diku afër derës.

— Mirë hoxhë, çka âsht ky lajki?

Nji plak, tue medue se lajki âsht mu kjo që i riu i kundërshton të vjetrit, iu kthye:

— Pa kadalë, bre djalë. Lene agën Sylë dhe hoxhën le të na bajnë pak muhabet. Nuk jemi këtu në hyqymet po në muhabet! — dhe vazhdoi me zemrim tue pëshpëritë: „Nuk truset me ndejtë, po keshe po dij dishka! Kur jam konë në kohë të tij, gojën s'e çilshna. Këta të sodit — si mazi para pelës!..."

Syla u kollit, u ul kambëkryq dhe, tue mbështjellë cigaren, vendosi me hapë bisedën rreth detyrimeve që kishin marrë Aliu dhe i Moravësi ndaj njani tjetrit.

— Ty, bre hoxhë, si edhe shokëve të tu, ju lumshin kambët! Ju e kryet si duhet punën tuej. Tash këtu kanë punë Aliu dhe i Moravësi.

— S'ka tjetër, aga Sylë! — u ndigjue Aliu që rrinte ulë në shkam të vogël, afër trapazanit, dhe ua vente veshin fjalëve të Sylës mâ tepër se të tjerëve.

— Ju, pasha axhën, i keni ndërrue çikat për djem. Mirë keni punue. Kështu po bâjnë shumica prej anës sonë. Unë, besa, s'e kam pasë menden po — ish konë kismet, e kështu u bâ edhe me mue e me at mesën teme.

— Jazís së zotit, aga Sylë, nuk i dilet përpara — tha hoxha, e ky vërtetim i erdh Sylës si mehlem në plagë. Vazhdoi:

— S'ka shybe, bre hoxhë, ajo ishte mâ e fortë se çdo gjâ! Shka më ka vyet mue grueja e re në pleqní? Njimend, jam konë në halle të këqija, e s'kish kush me m'i la petkat ose me ma vû nji kusí ujë. Ja lëshoi zoti, i kofshim falë, asaj plakës sime nji dergjë që prej vendit s'mund të luente. Thash — hajt me e bâ keshe rahat edhe mbesën. Më mbet në dorë. Vllau e ka lanë krejt të re, e unë jam shpenzue boll deri e rrita. Thash ta qes në bukë të vet. Ajo n'deshtë ne t'ma dijë për nderë, n'deshtë mos t'ma dijë. Allahi, i kofshim falë, ai e din.

Kadriu u prek thellë. Me nji anë pse Syla e paraqitte veprën e vet të panjerzishme si dëshirë të zotit, të cilës i shtrohej shumica e të pranishmëve, e në tjetrën anë pse ushqente urrejtje të madhe kundra mbrapambetunís, e cila shprehej sidomos në lidhje me gratë dhe vajzat në përgjithësi. Sidomos e prekte rasti i Fatimes, për të cilën ushqente ndjenja të veçanta. Si ishte mbështetë në duer, u drejtue. Nuk iu ndejt pa folë:

— Po mirë, aga Sylë!... Hajde që po i raka burrit plak me marrë çikën trembëdhetë vjeç dhe që po bajka me i ndërrue, po — pse ti nuk e ndërrove çikën tande për grue, po të huejën?... Ti, ndoshta, do të thuesh ashtu si pak mâ parë: „Zoti e kish bâ kismet, apo jo?" Nëqoftëse edhe zoti punon ashtu, na, komunistat, kemi të drejtë që i kemi çue duerët prej tij.

Syla u skuq. Hoxha dhe disa pleq luejtën prej vendit me — „tybe istikfar." Dy tre, afër trapazanit, qeshën, kurse Aliu e shiqoi shtrembët.

— Ngo khâ, shka po të thotë axha ty! Ti edhe në nji vend më ke marrë nëpër gojë. Mos u përzie pasha axhën, në punë të hueja se nuk të bje mirë! — bani Syla tue iu kërcnue me gisht dhe ndezi cigaren me atê të hoxhës. Prej habís, as nuk i tha „ejvalla".

E hoxha shtoi:

— As në punë të zotit, bre djal'i mirë, mos u përziej, pse ai âsht edhe „gafurr" edhe „rrahim": i mirë për të mirin e shudetxhi për të keqin.

— Demek: Syla i mirë dhe zoti i mirë, mbesa e keqe dhe zoti i keq! — u ndigjue prap Rama.

— Aiii ha!... — klithi plaku që mâ parë i kish thanë me shuejtë e tash u mrrol. Dy, që ishin në dy anët e Ramës, e prekën me brryla, e ai heshti. Heshtën gadi të gjithë... Hoxha bluente ndër vedi: „E pat dinjeti", e Syla: „U prish mileti!" Aliut i hyni friga se po prishej muhabeti. „Kah erdh ky këtu? Kush e thirri?" Shumica tymojshin duhan, të zhytun në mendime.

— Bana pak muhabet, aga Sylë. Fole ndonji fjalë se s'kemi ardhë me bâ qelime — i tha plaku, që qortoi Ramën.

— S'po dij, m'u përzien fjalët... — dhe heshti pak derisa i ra ndërmend se ku mbeti:

— Shka me bâ, bre vllazën, idare hesapi. Me ndërrim nuk po harxhitet njeriu. Nuk âsht keq, po — na nuk po mujmë sikur do të rrafshit, e besa edhe të kodrave. Ata, zahere qëlluen burra të fortë, për pare s'po kanë gajle, p'e peshojnë robin me pare. I Mogillsi ia dha motrën të Verbansit, qysh po thonë hallki, për njizetetrimijë banka. Ky i Kovaçevësi e kish marrë prej të Verbansit mâ lirë se tridhetepesëmijë banka — po, mbasi e muer n'ortake, nuk janë shum... More, edhe këta komunistat s'po dahen prej këtyne punëve. Qe — ai i Debeldejsi i kish dhanë pare të madhe atij të Lubishtësit, e të dy komunista, si ai që ka marrë ashtu edhe ai që ka dhanë! Kush ka me dhanë rob, pare po merr. Kush ka nevojë me marrë rob, pare po ep. Ata, ani, që s'po mujnë me dhanë, po i ndërrojnë. Kështu ka ecë dynjaja deri tash, kështu na e kanë lanë të parët...

— Mos thuej: po ep dhe po merr— kceu Kadriu — po thuej: po shet e po blen, mâ zi se gjanë, bile. Gjanë, të paktën, e shef, e këtu ashtu qorras po ipen paret. E ndërrimi? Ndërrimi bâhet vetëm me tesha, e kurrsesi me njerëz! Askush në botë nuk e banë këtê përveç neve... Për komunistat nuk ke aspak të drejtë, që i përgjithësove.

„Po kadalë se tash ta ndreqi!" — tha Syla me vedi.

— Ty, bre djal' i mirë, nuk t'ka kurrkush faj që do me mbetë si Dup Tërpeza. I bane njizet e sa vjet, e nuse hala nuk ke zanë. Në shtëpi ke qëllue i fiktë, me ndërrue nuk ke, e këndej pleqnija ia ka nisë me ta ngjitë për fyti!

Shumica qeshën, e disa e shiquen Kadriun me keqardhje.

Syla u kthye kah hoxha, tue ia bâ me sŷ.

— U mahitëm pak... Mahín e ka dhanë zoti. Hoxha buzëqeshi.

— Fol, aga Sylë, fol!

— Lek Dukagjini ish konë shum njerí i hollë. Na i ka lanë do adete shum me vend. Qe, mesela: nëkoftëse çika nuk shkon aty ku âsht fejue, âsht shum punë e randë. Shum mâ mirë âsht me t'ikë grueja, gjaku i huej, se çika — gjaku yt. N'dash le të jenë burr plak, n'dash sakat, n'dash i martuem, n'dash vejan — atij që t'i ipet dora, medoemos duhet me i shkue robi!...

Hoxhës, sikur me iu pasë hjekë barra e randë prej shpinës. Me këto fjalë të Sylës, ai mundej me arsyetue punën që kishte bâ: „Nëkoftëse djali i Tafës i ka disa mungesa, kjo spo deshka me thanë gjâ."

Syla vazhdoi:

— ... Për ndryshe kanuni i Lekës e ep që shtëpija e çikës t'i hîj në hak mikut — nji rob borxh. Pra, ose me ja dhanë ndonji femën tjetër ose — mashqit le ta shtrengojnë rruzën! Pse — jarani ka të drejtë me lypë gjak prej asaj shtëpije. E, nëkoftëse çika ikë prej dorës së tij, e jo prej shtëpís së babës, atëherë ai s'ka shka lypë në shtëpi të çikës, por le ta lypë atê ose gruen. Le t'i qiron vetë hesapet si, mesela, i Gjelekarsi, për të cilin folëm pak mâ parë...

Aliut i hyni njifarë frige. Filloi me luejtë prej vendit.

— Unë, aga Sylë, nuk jam marrë fort me këso punësh, po kam qejf me dijtë nji gjâ.

— Fol, Ali, fol.

— Kur ka pasë mâ shum këso ngatërresash: përpara apo tash?

— Në Jugosllavín e vjetër nji i Krajnidellit e pat dhanë çikën e madhe në Livoç. Mbasandaj e dha edhe të voglën n'at shtëpi për vllaun e vogël. Mirëpo, çika kish pasë luejtë bisht me nji të Krajnidellit. Nji ditë prej ditëve çika ikë për tê. Sod, nesër — i Livoçsi ia mshoi alltí babës së çikës në midis të pazarit të Gilanit. E plagoi randë. Hyqymeti edhe atëherë i kqyrte të vetat. E msheli të Livoçsin dhe i dha hapsane sa të duesh. Kurse parija jonë e qiti të Krajnidellsin hakli. I ndreqën. Ai ia fali gjakin, e ky nuk lypi mâ rob.

— Po kjo âsht gjâ e vjetër. Në këtë hyqymet janë tue u bâ mâ pak këso vakinash — tha njani prej shokëve të hoxhës.

— Nuk âsht ashtu! Para katër pesë vjetëve e pat marrë i Begunsi prej të Stançiqsit? Ajo, kur shkoi në të pamë, u ndal te të vetët dhe tha: „Nuk shkoj mâ!" Shkuen katër burra të Beguncës dhe i thanë të Stançiqsit: „Veç rob dona." I Stançiqsi, për mos me u bâ keq, ua dha me vedi motrën e vogël të grues së parë. Bile, thonë, prej vjetave, si ish kanë tue i ruejtë, jau kish dorëzue.

— Mirë, aga Sylë, por as kjo e dyta nuk i ndejti të Begunsit — ndërhyni njani.

— I ndejti s'i ndejti, këta adetin e çuen në vend! — bani si me idhnim, dhe iu drejtue Aliut:

— Edhe unë e ti Alio, që kemi mâ ndërrime, duhet mirë me u kujtue se, a ndjeve shka kishte bâ vaki në Makresh?

— Po, — tha Aliu, — po, — dhe u rrudh prej frige se mos po i ndodhte edhe atij ndonji gjâ e padëshirushme.

— Ruena zot se çka po bâjnë disa! Atyne duhet me jua hupë gjakun si qenit në rrush. Fajtuer m i madh âsht mashkulli, pse ai i çel i pari këto he-

sape, e grueja e ligë i shtrohet. Nji i Sllatinës së Lepencit e kish pasë zanë gruen me nji kojshi në tavan. Të dytë i vrau. Parija ua hupën gjakun. Kall-xojke: „Ishem tue mbledhë molla. Unë pata hypë në mollë dhe e shkundësha, e grueja i grumbullonte. Po shkoj, ore njeri — tha — me marrë thesin'. Prita pak kohë, s'po vjen. U bana shybeli. Zhdrypa prej mollës, e mora pushkën e shkova kah shpija. Kur erdha ngat shpís e pash gruen tue zhdrypë prej tavanit me pshtjellak në dorë. Shpejt hyna në shpí. Hypa ngadalë në tavan. Po kqyri — nuk po shoh gjâ. Kur — mbas nji dengi të fshisave ia pash plisin. Kujtoi se fshisat po ia presin plumbin. Krisi pushka dhe ai u rrotullue në kokër të shpinës. Tue zhdrypë poshtë, mendojshna shka të bâj me gruen. Â konë shum mirë... E kqyra njiherë. M'u dhimtë se ish konë zverdhë tue ndejtë pshtetë për dyreku të shpís. Shpija zdritke prej saj. Deshta me dalë, kur ajo: ‚Kuku, njeri shka bane?' — Ashtu, a? dhe krisi pushka. Ra në gjûj, mbasandaj në duer dhe — u shtrî." Kur duel kjo punë para pleqnís — parija ia hupën gjakun, e të Sllatinsin nuk e lanë fajtuer.

Ndërsa Syla po flitte, të tjerët e përcillshin me kujdes.

Hoxha mendoi: „T'u thom edhe unë shka thotë qitapi për „zinâ".

— Tybe istikfar, zoti dhe sheriati zinânë e dënon shum randë. Atê që banë zinâ duhet me e shtî në dhé deri në qafë e me e mbytë me gurë të vogjël.

Kadriu zîhej ndër vedi. „Po shesin moral të pamoralshmit." Ishte gadi me bërtitë prej idhnimit, por i ra në mend se âsht në fejesë, në gëzim, prandej foli me zâ t'ultë:

— Nuk po flasim me idhnim, se jemi në gëzim. Por më duket se keni folë boll. S'e dij kend po ma bani të mirë ju të dy? Ajo grueja e Shamit, që erdh në të pamë para disa ditësh, a e dini se shka tha?

— Shka tha, bre? — pyeti Syla.

— Mbreti i Qabes i kish përmbi pesëdhetë djem. A thue sa gra i ka, e — a janë krejt të tij?

— Deri në shtatë âsht huduti me qitap — tha hoxha. — E nëkoftëse mundet me i bâ idare, mundet me marrë sa të don.

— Ndoshta me qitap po mujkanë me u bâ edhe këso gjanash, si kanë bâ ata dy hoxhallarët e Smirës. Njani me katër fëmij, e ndër ta çika mâ e madhja. Tue pasë gruen gjallë, e kish ndërrue çikën me nji të Tanishevcit. Nana e ka rritë evladin e vet për me i pru vehtes ortake! Besoj se me e pasë dijtë nana se ka me e gjetë kjohja, nuk kish pritë me e rritë çikën, por... Mandej tjetri — thue se memëzi kish pritë me i vdekë vllau. Sa e shtini në dhé, e ktheu gruen e tij për vedi. A thue, i jep qitapi këto?

— I jep, i jep — tha hoxha.

— Me folë drejtë, më duket se as ty, bre hoxhë, nuk të ka hije me u bâ msit. Me sheriat, po thoni, çika dhe djali duhet me e zgjedhë njani tjetrin. A janë zgjedhë djali e çika e Alís dhe djali e çika e atij të Moravësit — që i msitnove ti?

— Eee, hoxha thotë mos kqyrë shka bâj unë, por ban shka thom unë! — ia priti Rama me dreqní dhe heshti.

Shumica qeshën, e hoxhës i ranë tespihët prej dorës, tue u mbështetë në jastek.

Kadriut iu duk se duel fitues. Plaku, të cilit iu kishte bâ Rama ferrë në sy, u bâ gadi edhe këtë herë me ia tërheqë vërejtjen, por — e ndërpreu Kadriu, që iu drejtue Sylës:

— Me sa fëtyrë ju, parija, ngulshit kambë për me e kthye at gruen e Bukovikut për të Rainqsin?

— Unë s'paskna ndie gjâ — tha njani, mâ i riu prej atyne që shoqnojshin hoxhën.

— Po flas ashtu qysh kish folë ajo në gjygj. Ajo s'kish deshtë m'i ndejtë te Rainqsit, se herë baba herë djali kishin bâ punë me tê.

— Rezilhanę, oj! — tha nji plak tjetër.

— E parija kishin dashtë me e kthye prap n'at vend. A e jep kanuni kështu? — tha Kadriu.

— Unë s'jam konë n'at pleqní — bani Syla tue i vrâ vetullat.

— Ti jo, por shokët e tu, kanuni yt — tha Rama.

Edhe Syla u mbështetë në jastekë. Mbretnoi nji heshtje e randë, në të cilën tingëlloi bindshëm zani i Kadriut:

— More, edhe këtyne adeteve të vjetra dhe fjalëve të qitapit, ka fillue me u hy uji. Shumkushi po martohet vetë me msit e pa pare e, dikush, besa, edhe pa msit edhe pa pare. U dhanë dy në Pozheran pa pvetë askend. Ashtu edhe i Remnikësi u martue në Gilan. Dy vajza të Stançiqit shkuen me jaranat e vet. Kjo e Kabashit nuk i shkoi të Sllatinsit. Nji e Pozheranit kish thanë: „Vramëni se në Lubizhdë nuk ipna!" Populli thotë nji fjalë: „Sheh rrushi rrushin e piqet." Edhe te na rrushi ka nisë me u pjekë!

Disa luejtën kryet në shêj pajtimi, e Syla tha me ironi:

— Ndoshta edhe ti je tue mendue se do të martohesh kështu? Po, kush të merr ty, more i shkretë. Ngom mue e shko në Bosnje. Puno atje, se ndoshta e gjen ndonji hallajkë.

— Të drejtën me jua thanë — ndërhyni Aliu — m'ka humbë udha në miedis t'oborrit. Nuk jam tue dijtë ku me u mbështetë, n'adete e në qitap të vjetër, apo në zakone të sotshme?

— Pse ti, baci Ali, ke dijtë keshe ndojherë, a? Ku të bjen mâ mirë, aty mbaja, — tha Rama.

Plaku, që i epte gjithnji të drejtë hoxhës dhe Sylës, shiqoi rrotull, i erdhi randë që Rama e preku Aliun dhe, tue pa se ishte e kotë me ia tërheqë vërejtjen, tha:

— A i lamë mâ këto fjalë, bre shokë?

Nji tjetër shtoi:

— I ka fajet myzhdja në të kthyeshëm. Me pasë konë në të bujshëm, kishim gjetë tjetër muhabet, kishim këndue e kishim luejtë.

— Shëndosh, në darsëm — tha Syla.

Aliu duel jashtë dhe u kthye shpejt.

— T'i hamë nja dy kafshore bukë. Qitju, bre, m'i la duerët — i tha atij, që ishte i caktuem për këtë punë.

Me legen në dorë të majtë, e ibrig në të djathtën, ky iu afrue hoxhës, mandej me radhë dymbëdhetë të tjerëve. Dikush i lante deri në bylyzyk, e

dikush vetëm gishtat, sa për adet. Dikush i fshinte duerët me marhamë e shervetë, që i kishte qëllue, e dikush për tesha të trupit. Sofrën e vunë në mes të shtrojes, që t'uleshin sa mâ gjanë. U ul hoxha, e mbas tij edhe tjerët. Aliu e shtini Kadriun me u ulë me zor — „mbasi e kam thirrë, t'i bâjë sajdí." U renduen: çorba, mish e orizi, pitja dhe — hallva. Ndigjoheshin vetëm hërpimi e shllakitja. Rama ishte ulë në trapazan dhe, kohë mbas kohe, kruhej mbas veshit tue i lëpí buzët — thue se ishte zemrue n'Aliun që s'i dha shêj me u ulë edhe ai në sofër. Lugët e drûjta nuk tingllojshin aq fort.

Ndërsa këta po hajshin, u ndie prap zani i kangës, i përcjellun me def:

... Ani more msit, he dervish,
ani a don pite, ani a don mish?
— Nuk due mish e pite me hangër,
po e due lirën me ma dhanën.

Ishin kah fundi, kur hoxha ndigjoi emnin e lirës, që u përmend në kangë. I hangër me zor edhe dy kafshore dhe e la. Edhe të tjerët njani mbas tjetrit filluen me e lanë. Hoxha i çoi duerët për dua e mbas tij edhe të gjithë tjerët — përveç Kadriut, që ishte çue pŕej sofrës. Hoxha i luejti buzët disa herë, tue pëshpëritë fjalët e lutjes dhe e përfundoj me „elfatiha" të madhe.

Sa u çue sofra, u fshinë trohat dhe u lanë duerët, vetëm ndezën ka nji cigare e, mbasi e pinë nga nji kafe, hoxha tha:

— Qitnani opongat!

— Po rrimë!

— Aaa, izen Alio, se u çuem.

U mbathën dhe duelën të gjithë. I përcollën te dera, të rreshtuem ashtu si i pritën. Aliu ishte i mbrami. Tue i përcjellë, dy shokëve të hoxës jau dha nga nji marhamë, e hoxhës bohçen e mbështjellun, dhe iu uroi udhën e mbarë.

*

Sa u largue, hoxha e shpàloi bohçen me pa se çka kishte mbrenda. Edhe dy shokët iu afruen. Në vend

të lirës së kuqe ose vleftës së saj ishte mbështjellë në letër vetëm njimijë dinarshja.

— I kam zanë besë, se pa u marrë vesh nuk ia kisha dhanë dorën!

— Për njiqind banka nuk e kisha bâ kabull me më këndue çikat: „Ore i biri i qenit", — i tha njeni prej shokëve, si me qëllim.

— Mos jau vno veshin kangëve! Ato kanë mbetë adet si msitnija . . .

KADRIU dhe Marku, tue u kthye prej prashës me shetën në krahë, erdhën te kroni, që gjindej nën blinin e madh, në mes të katundit, aty te udha kryq, në nji ledinë të vogël. Bllatnjanët e kishin zakon, si ata që punojshin gjatë ditës, ashtu edhe ata që nuk punojshin gjâ, me u mbledhë para mbramjes në këtë vend. Mb'at'anë kronit, në shpatin e Kodrës së madhe, ishin ngritë tuba tuba shtëpijat e katundit në dy ose nji kat, të lyeme me gëlqere, të rrethueme disa me mure guri të gjatë e të naltë me dyer të mëdha, të mbarueme prej dërrasave, e disa me gardh e dyerë prej trinash. Në shpinë të shtëpijave dykatëshe nxijshin vendet e mbetuna shêj nga prishja e nevojtoreve.

Në shpatin e largët, kundruell shtëpijave shifej Zabeli i vakfit, e nën tê, dy palë vorreza — të muslimanëve e t'ortodoksëve. Te vorret e musli-

manëve, sidomos te ato të rejat, bijshin në sy disa lejka të vume në kuja që i kishin ngulë te kryet e të vdekunve, e te ata të ortodoksëve — kryqet e drujtë ose të mermerit, e aty këtu përmendore me yje.

Prej gypit të hekurtë rridhte në koritën e çimentos uji i ftoftë dhe i kulluet, e prej saj, me nji brazdë, kalonte buzë rrugës kah prroni. Pak mâ larg, ledinën e vogël e të mbulueme me bár e rrethojshin disa dushkaja të shpeshta, që, së bashku me blinin e gjatë e të gjanë dhe erën e tij, hijeshojshin dhe e bâjshin të kandshëm tanë këtë vend.

Kadriu e Marku, lanë duerët dhe fytyrën e, mbasi i fshin me peshqira, shtruen gujat e vjetra në ledinë e u ulën, tue i lanë shetnit afër vedit.

— Kam frigë se tash do të na dobsohet organizata. Rama dhe Vehbiu shkuen me punue në Shkup... Dauti, po don me na dalë mâ i zi se kemi mendue... Po mbesim pak. S'po di se çka me bâ! Punën që kemi te shtëpija, për nji ose dy muej — e mbrojmë. Mbasandaj — veç duhet me i ra fyellit. Me ndêjtë s'bâhet gjâ! Njeriu e shtëpija po kanë nevoja të mëdhá — tha Marku.

Kadriu e ndigjoi me kujdes dhe u mendue.

— Duhet me gjetë ndonji rrugë.

Tue u kthye prej këshillit komunal, erdhi Dragutini me çantë në dorë. I përshëndeti dhe u ul afër tyne.

— Decentralizimi ma hoq çantën prej dore. Si po duket as ti nuk shkon mâ larg, si ka nisë me u folë edhe për këtê komune — i tha Kadriu Dragutinit gjysëm tallje e gjysëm përnjimend.

Qeshën të tre. Po Dragutini u mrrol shpejt.

— Nuk âsht tue m'ardhë keq për tjetër, por për reakcionin! Barku do t'u kënaqet. Qe — kam ndëgjue për ty në dy tre vende kah thonë: „Kur po e shohim tue prashitë, zemra po na kënaqet! I ra parja poshtë, budalla, prej kalit e në magar. Po, prap nuk po ipet! Po punon badihava." Këto fjalë më kanë shti që tash, në pleqní, të mësoj për me dhanë provimin e gjimnazit.

Nji grup prej pesë gjashtë vetësh, edhe ata me shetën në krah, mbasi i lanë duerët e fytyrën, u

ulën te dushkajat dhe ia filluen me bisedue. Kadriu, megjithëse nuk e pinte duhanin, ia lypi Markut kutín dhe filloi me mbështjellë cigaren.

— Se çka thonë hallku, nuk jam tue pasë gajle, por — nuk po di çka me bâ me babën e me vllán! Merrni me mend: nji ditë erdh puna gadi me ikë prej shtëpís! Vetëm ndërhyni nana se... më rrokën të dy përpara. Thojshin: „Shka domethanë kjo — sekretar i organizatës? Shkon poshtë e naltë e — asnji dinarë nuk bje në shtëpí! Po punon badihava. Hallku po keshin me ty. Je kanë kishe në shkollë të partís motmot, punove sa mujte prej shlirimit e mâ së mbrami ta dhanë shkelmin... Shka të ka vyetë puna e shkollës kur e ke dijtë se nuk t'a hjek shatin prej dore? Ti vetë nuk po don se kishe mujtë me hŷ diku, bile kurir, në shkollë ose në komune. Mos kqyr me ruejtë iftibarin, po ku të del dinari aty rrasu!..."

— E, shka the ti? — e pyeti Marku me keqardhje.

— U thash shka dijta e shka më ra ndërmend. Mâ së mbrami s'mujtëm me e bindë njeni tjetrin.

Marku e çoi cigaren dhe ia afroi për me e ndezë edhe ai. Ky ia bani me dorë se nuk mendon me e ndezë. Marku e ngrehu tymin e parë dhe tha:

— Jemi komunista e duhet me folë të vërtetën. Qe — dikush po jeton mâ mirë se na që jemi n'organizatë. Do kanë zanë vende dhe për çdo muej po marrin pare. A nuk kam punue unë si ti prej katërdhetë e katrës për ditën e soçme? A s'kam qenë në kursin tremujor të partís në Gilan? — S'e di pse partija nuk i siguron njerëzit e vet me iu gjetë secilit ka nji vend e mandej shka të mbesi me jua dhanë tjerve?

Dragutini qeshi me zâ e Kadriu u mrrol.

— Ti po qesh? Kollaj për ty — i tha Marku.

— Po, kollaj! Nuk i ke marrë ti si unë ka tri fletore zyrtare për çdo muej me plot ligje — të Federacionit, të Republikës e të Krahinës. Nji krah fletore prej sekcionit ushtarak. Me shkue çdo javë në rreth. Çdo ditë me marrë e me përcjellë postën. Me pritë nga nji grumbull, njerëzish dhe me jau krye punën. Me u kujdesue për mbledhjen e tati-

mit e, posë këtyne, edhe me mësue për me dhanë provimet në gjimnaz. More, kapuçi në krye kish me t'u sjellë. A po e shef? Jam bâ si krane.

— Pse, me prashitë âsht kollaj, a?

— Nuk tha kush se âsht kollaj, po...

Dielli ishte në të perenduem. Rrezet e mbrama puthshin shpatin dhe kronin. Kadriu e mbante cigaren në dorë pa ndezë. Ia ktheu shpinën diellit mos t'i mirreshin syt dhe iu drejtue Markut:

— Bane mirë që fole atê që mendon. Edhe unë po të përgjigjem sinqerisht. Nëqoftëse nuk bindesh më thuej — mundem me e shtue këtë çashtje edhe në mbledhjen e organizatës.

— Organizata qe ku âsht. Na mungon vetëm Dauti.

— Prej fjalëve që thae shifet se ti nuk i ke kuptue ende vendimet e Kongresit të gjashtë, se pak gjâ ke përfitue prej kursit të partís.

— Pse?

— Prit se po të thom. Vetëm dëshiroj që unë e ti të bindemi e mos ta lamë punën hapët sikur me babën e vllaun tem.

— Ta merrmendja.

— Atëherë, pra, po të pyes disa gjana: a kanë luftue partizanët katër vjet pa asnji dinarë?... Madje, jo vetëm që kanë luftue, por edhe janë vra me qinda e mija, apo jo?

— Po.

— Nëqoftëse na të gjithë hyjmë në punë të qeverís, kush na jep bukë me hangër?

— Këta tjerët... janë mjaft.

— Kush janë: këta tjerët?

— Populli.

— Bash këtê deshta me dijtë. Simbas mendimit tand, na komunistat jemi diçka tjetër e populli tjetër. Qe — ky âsht byrokratizëm, nëqoftëse nuk e ke dijtë deri tash! Nëqoftëse na bajmë si thue ti — na hangër dreqi, e trathtuem popullin! E kush e ka trathtue popullin, nuk âsht ndá mirë. Na nuk kemi luftue e nuk luftojmë që ta zhdukim klasën eksploatuese për me krijue nji klasë tjetër t'atillë prej nesh: Atëhere kishte me qenë, si thotë ajo fjala popullore: „Zhdryp Ibish aga, hyp Halil aga."

Na kemi luftue dhe i kemi premtue popullit që t'ja hjekim barrën prej shpine, e, të gjithë së bashku, të luftojmë për nji jetë mâ të mirë.

Marku i rrudhi krahët dhe ngriti vetullat. Pytte me vetvedi: „Mos gabova gjâ, po më rrok përpara... A thue e ka prej disipline apo âsht aq i drejtë?" Mandej tha:

— Jo, jo, për ashtu s'kemi luftue...

Dragutini nxuer gazetën prej xhepit. Iu duk se Kadriu vuni në pyetje edhe pozitën e tij si sekretar i komunes — „Ta plotësoj, mos të keq kuptohet."

— Ashtu âsht si tha Kadriu. As nuk ban që të gjithë komunistat të hyjnë n'organet e pushtetit e t'ekonomís. As nuk ban pa qenë ata aty. Këtu, vlla, âsht punë zotsije. Për çka je i aftë, atê duhet edhe me punue.

— S'ka fjalë — tha Kadriu. — Por, siduket, këtij nuk i ka hŷ në krye ende thelbi i praktikës dhe i teorís sonë.

— Cili thelb, përshembull?

— Ai se qëllimi ynë i mbramë âsht që pushteti shtetnuer të zhduket shkallë-shkallë e të zavendësohet me vetqeverisjen e popullit.

Marku e suell kryet dhe qeshi.

— Kam besim në partín, por kjo gjâ nuk mundet me më hŷ në krye. Po flet si të mos ishe i katundit! Po ky popull mos me pasë pushtet të qet fare, hej!

— Nesër kam me ta prû librin e Leninit „Shteti e revolucioni" dhe ka me të hy në krye.

— Po, por a mund ta kuptoj?

— E lexojmë bashkë, si të dijmë. Për nji javë kemi me e krye. Mandej, marrim ekspozén e shokut Tito në lidhje me ligjin e vetqeverisjes së kolektivave të punës. Çka âsht mâ me randësi analizojmë edhe njiherë praktikën tonë konkrete dhe e shofim se ka lidhje me këto, përshembull, këshilli i komunes e sa këshillat tjera rreth tij, mbledhja e zgjedhësave, këshilli drejtues i kooperativës dhe mbledhjet e antarëve të saj, këshilli i shkollës dhe mbledhjet e prindëve, këshilli i organizatës së Lidhjes socialiste, i organizatave tjera dhe konferencat e antarë-

ve, organizata jonë e komunistave e ku ta dij unë. Ke me pa se në këto forma âsht tue u aftësue populli punues për me marrë fatin e vet në duert e veta, njiherë e përgjithmonë.

— Mirë, po ...

— Mos me qenë në këshillin e komunes dhe tue u përgaditë për gjimnaz edhe unë kisha me marrë pjesë në përpunimin e këtij materiali — tha Dragutini.

Dielli praroi. Mbrapa i la gjurmat e kuqe mbi shllungat e rêve të bardha e të shtrime, që s'dij prej kah u diktuen në perendim; ato tash i përngjajshin ndonji zjarmi të madh që fikej kadalë-dalë. Baktít e trasha dhe barijt ktheheshin pa ia ndá prej fushës. Pijshin ujë në koritë dhe shkojshin. Lopët plleja u prijshin gjedheve. Dikund larg kronit, në fushë, jehojshin fyjet e barijve.

— Të gjitha këto — tha Kadriu — duhet me i dijtë, por gjâja mâ e ngutshme që shtrohet para nesh âsht ajo që e thae ti, Mark, pak mâ parë: qysh me krijue mundësín për punë në katund ku do të mujshim unë, ti dhe katundarët tjerë të vobegtë me punue? Nëqoftëse nuk e zgjidhim këtë, atëherë duhet me lëshue katundin. Me e lëshue katundin për krejt ose me u bâ gjymës puntori e gjymës katundari...

Marku e kqyrte ngultaz pa dijtë si me iu përgjegjë. Dragutini gjithashtu. E ai, mbasi u mbështet në njanin krah, u përgjegj vetë:

— Unë kam mendue për këtë çashtje bukur shum dhe kam ardhë në këtë përfundim: Na nuk jemi në gjendje me gjetë punë për secilin katundar që ka nevojë për tê në katundin tonë. Po — për disa mundemi.

— Si?

— Qe se si: a ndigjuet si tha shoku Fazli atëherë në mbledhjen tonë: „Organizoni dhe forconi ekonomín, hyni në tê se keni nevojë për punë." Neve, mbas likuidimit të kooperativës puntore-katundare, na mbetën njizet hektarë tokë të këtyne kojshive të Kodrës. Të kërkojmë që këshilli i rrethit të na api edhe tridhet hektarë tokë t'utrinës së katundit e cila âsht bâ pasuni shoqnore. Kë-

shtu — po i bâjmë pesëdhetë hektarë. Mandej edhe ligji i maksimumit u ka marrë pasûnikëve afër pesëdhetë hektarë. Kështu kishim me i bâ gjashtëdhetepesë. Kjo nuk âsht pak! Vetëm kjo lypë punë dhe kujdes të madh. Na, së bashku me disa katundarë tjerë të vobegtë, duhet ta bâjmë vetë kërkesën dhe ta shtrojmë edhe para kooperativës, që kjo të na api ekonomín për vetqeverisjen. Detyrimet ndaj bashkësís shoqnore dhe kooperativës i kryejmë, kurse as neve nuk ka me na ra keq.

Marku suell kryet me nji anë. „Mirë e ka. Katundi do t'i mbetet mjaft merá sa me qitë gjânë. Nuk po ia marrim krejt. Fundi i fundit çka po më hyn në punë mue kjo: secili e kqyr punën e vet. Punë të përditshme, me rrogë"! „Filloi me i qeshë fytyra. E çoi dorën hovshëm.

— Mirë e ke... Veç me e kërkue!... Na po lypim punë e toka pret puntorë.

— Edhe ligji jau ep — tha Dragutini.

Në grupin tjetër u ndëgjue, për s'dı çka, gazi me zâ.

Erdh edhe nji grup prej shtatë a tetë argatëve dhe u ul në ledinë.

Tash mbërrinë edhe Syla e Stanku me guja krahëve. U ndalën në rrugë, shiquen kah ledina e kroni, ndërruen disa fjalë dhe — u drejtuen atje. Kaluen pranë njenit e tjetrit grup t'argatëve tue i përshëndetë. Argatët luejshin prej vendit e ndonjani çohej në kambë. Vazhduen përpjetë. Prej grupit të Kadriut as që luejti kush. Syla e suell shtagën krryle dy-tri herë, e Stanku e ktheu kryet në tjetrën anë.

Mbasi kaluen, Syla ndezi cigaren dhe u mendue pak: „As nuk luejtën prej vendit. Pa kadalë t'i theri pak."

— Mos po doni m'u shitë argat ju dy që paski dalë këtu?

Këta shiquen njani tjetrin dhe u skuqën.

— Ki me ja ndie krizmën kësaj mbledhjeje këtu — tha Marku tue mendue n'atâ që biseduen pak mâ parë.

— A ban me e dijtë pse?

Marku pa se deshti me i folë për ekonomín e Dragutini ia preu fjalën:

— Ishim tue mendue si me mbarue nji shtëpí të kulturës në katund.

— Aiii! Ju paski hŷ fellë në punë të hyqymetit. Shpín e kulturës mundet me e mbarue vetëm hyqymeti. Ai ka pare.

— Na kem tue bâ mend m'e ngritë me t'ardhunat e kontributit. Simbas llogarís sonë me tre përqind të t'ardhunave, ty po të rrokë pesqind e gazdën Stank pesqind e pesëdhetë banka.

Stanku, si ishte tue ecë, u ndal, shiqoi mrrolët dhe ia bani Sylës me krye:

— Hajde pashë zotin, hiqu tyne! — dhe u ulën pranë nji guri.

— E po thonë, gjoja, demokraci socialiste, drejtësi për secilin! More, çfarëdo ndryshimi me u bâ na nuk kemi pshtim prej tyne, jo! Kushdreqi i çoi tash me ndërtue edhe shpín e kulturës? — tha prap Stanku.

— Këta gjithë natën mendojnë qysh me na e rjepë lëkurën ditën — u pajtue Syla.

Dragutini qeshi me zâ e Kadriu i tha ngadalë.

— Ku të ra ndërmend shtëpija e kulturës?

— Lene mâ shtëpín e kulturës, po edhe kontributin ua llogarite. Jau ke qitë nji grusht miza! Nji javë nuk kanë me fjetë — tha Marku, dhe të tre qeshën me zâ.

— M'u duk se Marku deshti me folë për ekonomín. Nuk âsht mirë me e qitë këtë fjalë derisa s'e kemi bindë shumicën e katundarëve. Mujnë me na pengue — tha Dragutini.

Sa bâheshin gadi me u avitë te grupi i parë, mbërrinë Rama dhe Vehbiu. 'Mbas tyne u afruen edhe tjerët, të grupit të dytë. Mâ në fund erdh edhe Aliu me gjyshin e tij, mixhën Rrahman, që i kishte ardhë mysafir. U ulën të gjithë truq. Vetëm Syla e Stanku mbetën te guri.

— A keni ardhë me ndërrue teshat, apo s'ka mâ punë? — i pyeti Kadriu.

— Sod ditë e shtunë, prandej erdhëm. Puna që ish çelë në Shkup, të mbushet mendja se kurr nuk ka me u sosë. Na jemi tue punue në nji ndërtesë,

që âsht tue iu vû temeli tash. Po zen vend mâ tepër se katundi ynë. Aty do të ngrihet një fabrikë për me shkrî hekur — tha Rama dhe ngrihi pantollonat e reja që mos t'i ndrydheshin.

— Të rrijmë shtrembët e të flasim drejtë. Hallall i koftë, se sikur Tita për punë nuk kish pasë! — tha Aliu, tue shique gjyshin që pohoi me krye. Tjerët filluen me ndëgjue. Aliu vazhdoi:

— Shehret njeriu nuk po mundet m'i njohtë mâ. Por edhe në katund qiti halet të mâdh. Se mbaron fabrika pleh, kurr s'i kishna çue mendët! Katundet gadi mâ u mbushën me maqina: për me mbjellë, me korrë, me qërue kallamoq, me shkurtue talla... E besa edhe traktorët kanë mbërrî. Po mendoj kanjiherë vetë me vedi: krejt për pak kohë — shum ndryshime u banë në ditët e sodit! Përpara vetëm aga Sylë dhe gazda Stanku kanë pasë kundra në krejt katundin tonë. Edhe ata i bajshin vetëm kur dilshin ndokund. Sod, m'erdh rendi edhe mue me mbathë kundra, — dhe i dathi këpucët e gjata ushtarake, i la afër vedit dhe u ul kambëkryq. — Posë xhamís, nuk kemi pasë gadi asnji shpí të lyeme me qereç. Ato që ishin të lyeme, i thirrshin kulla. Sod, të gjithë kemi bâ kulla! — tha tue zgjatë dorën kah shtëpijat e katundit që ishin tubue në lug dhe shpatit. — Rrallë kush që ka koftor në shtëpí. Tash, në çdo dy ose tri shtëpí, gjen edhe shporeta, se lene mâ koftorin. Na kënaqën dimnit, hem po rrijmë qaty truq, pak drû po harxhojmë e shum punë po kryejmë në to. — U mendue pak. — Qe, edhe me duhan janë tue u ndá njerzija shum mirë. Pë më kallxon babgjyshi: „Prej tre shinikëve vend, kemi marrë duhan sa prej pesëmdhetë shinikëve kallamoq ose grunë." Eee, kur hajsha mish e oriz në ditët e mëdhá, mendojshna se orizi vjen prej Meqje ose Medinje. — Shumica qeshën. — Shka po keshni, a s'âsht kështu, a? Kush ka mujtë m'i shti mendët se fusha e Moravës mundet me bâ oriz? Qe, kjo ekonomija e Kllokotit, prej nji hekteri oriz kishte marrë katër-pesëmijë killa, dyherë má shum se grunë! E kilja e orizit ka ferk prej grunit ceri në tri-katër herë. Po ju pves — tha tue kqyrë të gjithë — kush ka dijtë para dhetë vjetëve në këto

tri copë katunde me shkrue dhe me këndue? Kurrkush! — përgjegji vetë. — Sod kemi shkollën në midis të katundit. Në gjuhë të nanës e të babës. More, mësuem edhe na, pleqt e gratë, se lene mâ fëmijt! Në vend se me mbushë kroshnjen me voe e me shkue te sekretari i komunes si përpara, me ia shkrue djalit asker nji letër, tash voet p'i ha vetë. Këtyne here rrasshim veç kallamoq. Tash, bajagi shum, i kemi mëshue edhe grunit.

Ndërsa Aliu flitte, shum vetë luejshin kryet tue ia vërtetue fjalët me. „Ashtu âsht!" Komunistat nuk ia ndajshin syt. Kadriu i tha ngadalë Markut:

— A s'flet mirë për partín, a? — dhe iu kthye Aliut se iu duk që edhe nji gjâ nuk e përmendi:

— Qe — i tha — edhe pushteti ka dallim të madh prej atij të vjetrit: ti vetë po i zgjedh këshilltarët, nji fjalë të keqe kush s'ta flet, shkon serbez. Jemi bâ të gjithë të barabartë, jemi nji vllazní.

— Qysh jo, bre aman! — bani Aliu. — Nji gjandar, nji kontroll, nji roje e pyjeve me kapërcye katundit, u deshke me ikë mbrenda, në birë të mi. nit. Ja të shajke, ja të lypte dishka. Këtyne të mëdhajve mâ, nuk guxojke njeri për skaj me u ra e m'i këqyrë në sy. Sod, le mâ këto në kohë, por edhe të rijt, kambë për kambë po rrijnë me deputetin e rrethit, se me këta tjerët mâ... S'e kishin këta kryet e naltë. Rahatllaki i sodit kurr nuk â kanë se âsht kurdisë dunjâja. N'dash flêj në rrugë, n'dash flêj në mal, pesë pare mos i jep!

Syla e Stanku mbetën vetëm. Shiqojshin shpeshherë në grupin e madh dhe ndigjojshin shum fjalë t'Aliut. E ndiejshin të nevojshme me u bashkue me tjerët, por u dukej se do të nënçmoheshin me ardhë pa i thirrë. U çuen dhe u drejtuen kah shtëpija. Po — mbasi në grup, ku zhvillohej biseda, ishte edhe nji jabanxhi, gjyshi i Aliut, gjetën arsye me u kthye gjoja me u përshëndetë me tê. Edhe këtherë disa luejtën prej vendit, e disa u çuen në kambë. Gjymësa nuk bani kurrfarë lëvizjeje.

— N'dashi, rrini pak me neve, — tha Aliu, mbasi ata u përshëndetën me gjyshin e tij.

— Aksham, bre, — tha Syla dhe shiqoi Stankon, i cili i dha shêj më lëvizje të syve e të buzëve se munden me ndejtë. — Nejse, po rrijmë pak! — dhe u ulën. — Ju mos e ndalni muhabetin. Ku e patët?

— Bâjshim llaf dishka për ndryshimet në katundin tonë — tha Aliu.

Syla suell kryet.

— Hm, i ndigjuem edhe na disa fjalë. P'e livdon plehin e fabrikës. Kush t'më ngon mue le t'ikë prej tij. Përpak jam kanë tue mbetë pa sy. Shkova dhe e qita nji thes n'arën e naltë. S'kanë kapërcye pesë dakika e, thash, — u qorrova! Erdha shpejt në shpí, po vend s'mund të zejsha prej dhimbjes. M'u kuqën syt dhe më duelën përjashta sa grushti.

Disa luejtën kryet, e disa qeshën. Edhe Kadriu qeshi, tue thanë me vedi: „Kur s'të kanë plasë!"

— Nuk i ka fajet plehu, po mosdija jote. Ti e ke qitë sikur farën e kallamoqit, nuk je gërmuqë. Sigurisht, era ka frŷ e plehu i lehtë. Lene që të ka ra syve, po edhe mund ta ketë kalue megjen tande.

Syla e suell kryet, u bind se ashtu paska qenë, pse me të vërtetë ashtu e pat hjedhë plehun — kur po frynte era.

— Me vend e kije, Kadri. Ashtu â kanë, bre djál.

As Stanku nuk ishte i bindun në fjalët e Sylës. Ai ishte mësue me e përdorë plehun artificial. Madje, edhe vetë kishte pa dobín e tij. Ndërsa ata flitshin, ky vetëm lëmonte mustaqet.

— Nuk âsht se njeriu nuk ka fitim prej përdorimit të plehut tê fabrikës. Vetëm, duhet me dijtë se çfarë plehu don toka. Sikur ka shum lloj tokash, ashtu ka edhe shum lloj plehnash. Duhet me dijtë me i përdorë... Po shka me i bâ tjetrës? Krejt mëzetët na i tredhën! Po duhet me i ndërzye lopët me mëzetët e hyqymetit. Hala nuk kam mujtë me dijtë. a thue më cofi lopa tue pjellë, pse lopa e vogël dhe viçi i madh, apo prej gjylpanës që ia pat dhanë veterinari para disa ditësh.

Aliu e ruente lopën si syt e ballit, prandej fjala e Stankut e tërhoqi:

— Me vend e ki, bre axha Stanko. As unë nuk due doktor në shpí, as nuk e çoi lopën në fidanishtë me e mbajtë. Lopa âsht e emja, s'ka kush më përzihet në të! — dhe ia mëshoi tokës me grusht — Pa mëzet të hyqymetit jena kanë deri tash e kena kapërcye si â mâ mirë.

Stanku e çmoi se pat sukses biseda e tij.

— Sod âsht krejt mirë, si foli edhe Alija pak mâ parë. Vetëm, të kishin me na dhanë me djegë e me shitë drû sa të domë. Dhe e dyta — me çfarimin e dhive i kanë mbytë fukarán...

Shumica ishte gadi me ia vërtetue fjalën, por Dragutini ndërhyni:

— Ti kurrsesi nuk mundesh me ia dashtë të mirën këtij populli dhe fukarás mâ tepër se ata që kanë marrë masa me ruejtë mallin! Sikur të kishim me lejue, që secili të djegi dhe të shesi sa të dojë e mandej edhe të mbajë dhí, nuk kishin me kalue as dhetë vjetë e do të mbeteshim pa asnji drû! Atëherë t'i bijmë llahutës! Kjo që fole ti nuk âsht bisedë e shëndoshë.

Stankut i hyni friga. „Njeri i hyqymetit!" — tha me vedi.

— Unë nuk mendova ashtu.

Syla e ndezi cigaren. Kur çoi kryt dhe, mbasi u mendue. tha:

— Qe, këta dy djemt e s'di sa tjerë të katundit, janë bâ mexhbur, të shkretët, m'e lëshue katundin e me hjekë si â mâ zi në Shkup për nji kafshore bukë. Pse këta udhëheqësat tanë, që po thonë se po luftojnë për të drejtën e popullit, për jetesë mâ të mirë — nuk e çelën këtu në katund, ose në rrethin tonë, ndonji maden, fabrikë ose me mbarue udhën e frengit për m'i gjetë këtij mileti punën gat shpís? Mirë kanë thanë të parët e vaktit: „Ne të vjen kush të vjen, ky vend qytyk â kanë e qytyk ka me mbetë!" Nuk kemi të parë, ja!... Dhe — nuk po dijmë me u kajtë! E pa kajtë, besa, as nana nuk i ep fëmís gjî.

Ramës iu duk se kjo âsht prrallë reakcionare, dhe s'ju ndejtë pa folë:

— Aâa, sa jeni kanë ju të parë e keni pasë zdritë krejt! As sa maja e gjylpanës nuk i keni dha-

në gjâ popullit, veç shka i keni marrë. E tash po t'u dhimka populli?! Cili shtet deri sod ka mbarue fabrika, ka çelë madene dhe ka vû udhën e frengut në çdo katund? ... E di unë ku e ke ti! Po don m'e ftofë popullin prej politikës sonë. Ky vend, ndoshta, â kanë qytyk përpara,por në ditët tona edhe këtu kemi përparue — sikur tha pak mâ para edhe Alija. Por, si duket, fjalët e tij ty nuk po të pëlqejnë, apo jo?

— Fola për ju, bre djál i mirë, e jo për vedi!

— Po, po, po mirret vesh — i tha Kadriu me ironí.

Tufat e dhenëve, mbasi pijshin ujë, së bashku me barijt, drejtoheshin kah shtëpijat e tyne. Ogiçi plak shkonte tue ngurue e tue tundë kumbonën para tufës së vet. Poshtë, kah prroni, ndigjohej rrakatja e bretkocave. Terri i mbramjes filloi me ra.

Për me këputë heshtjen, Kadriu iu tkhye gjyshit t'Aliut, i cili ishte ulë kambëkryq dhe mbante shtagën krryle në prehën.

— Folni edhe ju dishka, mixhok, boll ndigjuet.

Gjyshi e nxuer kamishin e shkurtë prej goje, lëmoi mjekrrën dhe mustaqet e bardha — të verdha kah goja prej duhanit. Sa folën të tjerët, ky vetëm ndëgjonte e shum gjana i krahasonte me të kaluemen.

— Shka me folë, bre mixhë. Neve na shkoi ymri me nji kohë që njeriu s'ka shka flet...

I mblodhi rrudhat në fytyrën e gjatë dhe e shtrëngoi shallin ngjyrë kafje rreth plisit.

— Në ditët e mbretit ka pasë jashamak të madh, por, marifeti i sodit nuk â kanë. Kish boll fushë, male e gjâ. Por rahatllëki i sodit nuk â kanë.

— Mirëpo, edhe populli ka pasë mâ pak — tha dikush.

— Bllatën e juej e mbaj mend njizetepesë shpí. Sod i ka njiqind e njizet. Gjithkah âsht shtue mileti.

— E kujna â kanë toka atëherë?

— Pashallarët,beglerët e agallarët e kanë pasë mbajtë në duert e veta këto të katundeve të Shkive rreth Moravës. Na Turqit, këndej kodrave, jemi konë mâ tepër në veti. Vetëm paguejshim sergí.

Heshti pak dhe filloi me shtagë me therë tokën para vedit. U kollit, pshtyni në birën e bame me shtagë dhe e mbuloi pshtymën me dhé.

— Shum, shum ndryshime janë bá! Në vend të dritës, n'at kohë, djegshim pishë. Sod mbërrina me i' pa edhe elektrikat! Më kujtohet, kur e pat prû baba nji fitlaç të vogël të mbushun me gaz, aq jem konë habitë. Njiheri u tutshim se mos âsht ndoj koftlarg mbrenda. Mirëpo, kur baba e kalli, deri në gjysë të natës nuk mujtëm me fjetë prej gëzimit. Secili e kallke me rend dhe e shtymte tue thanë. „Qy, qy si po kallet!" Shpijat i kemi pasë të mëdha me pak oda. Atëherë nuk dijshim për oxhak — ky vonë duel. Kallshim zjarm midis shpís në nji gropë. Duel oxhaku, duel koftori, e tash edhe qe ky shporeti — si po i thonë. Nji hoxhë në këto dhetë copë katunde ditke jazi turçe. Për kalemat tjerë atëherë nuk âsht dijtë, derisa erdhi Durgut Pasha. Mileti nuk â konë rahat. Nuk mbetke ditë pa u rrehë e pa u vra ndërmjet vedit. Shyqyr veç që nuk â konë haleti i sotshëm atëherë — i kishim vetëm ato kapsollaçe — se ishim farue krejt! ... Hyqymeti â konë i ligshtë. Hysen Pasha rrinte në Gilan, e nëpër katunde sundojshin parija. Por edhe ata punojshin me hatër. Veç nji gjâ: Padishahi ka pasë iftibar të madh! — Kur u përmendke emni i tij, u deshke me luejtë prej vendit e me thanë: „Çok jasha" Thojshin: zoti na ruejtë, me bâ me luejtë Padishahi sandakin, toka e deti bâhen bashkë. Sa herë e kam pasë lutë zotin: „Ja Padishah, mos e luej sandakun!"

Qëshen të gjithë.

— U bâ aksham! — tha njani.

— Çohmi, — thanë disa, dhe filluen të shpërndahen nji nga nji në drejtime të ndryshme.

DITËVE me shi e diell të vjeshtës, Aliu e korri dhe e bajti misrin. Duejt i bani tubë rreth koshit n'oborr. Vendosën ta qërojnë sa mâ shpejt dhe ta shtijnë në kosh për me ia „hjekë gajlen."

At ditë që po qërojshin, nxente dielli. Megjithëse rrezet e tij ishin dobsue, nxehtësija ndiehej bukur mirë. Aliu, dy djemt, çika dhe grueja, mbasi i kryen nga dy tre duej, i vunë në kambë për me u bâ hije. Secili e kishte shtrue dujin afër vedit dhe qëronte. Tramakët i qitshin në grumbullin në mes, e duejt i lêjshin së bashku me nji vend për me i bâ mâ vonë kamare.

Kur e qëroi duejin e pestë, i ra qejfi për duhan. E ndezi cigaren me brincë e eshkë. Tue tymue, filloi me mendue bereqetin që i kishte sjellë pranvera, vera e vjeshta. I luente buzët dhe numronte me gishta:

„Duhani... gruni... kallamoqi... elbi... tërshana... gjâja... Në tjetrën anë: haja... pija... veshja... mbathja... tatimi... Po, edhe pa e martue djalin — nuk ban. Ja tash ja kurr! Si të jenë kismet, në kët pazar do të dal në Gilan e të mirrna vesh me mikun."

Djali i madh, Hasani, dhe ai i vogli, bisedojshin për mbledhjen e aktivit të rinís. Ajo mbledhje ishte mbajtë nji ditë përpara dhe aty ishte diskutue për kurset kundër analfabetizmit, që rinija po përgaditej me i hapë në katund mbas mbarimit të vjeshtës dhe gjatë kohës së dimnit.

— Nuk âsht me të thanëme po me të dhanëme! — tha Hasani tue zgjidhë duejin m'e qërue. — Qe, ai Bakija as nuk ka shkollë e as nuk âsht njeri që ka luftue me partizanët. Mirëpo, qe s'di sa vjet kryetar i komunes! I shtinte në xhep ka pesë-gjashtëqind banka në muej. Mbasi po i japin kaq shum randësi dijes, kishna shkue edhe unë në kurs, me dijtë se mbasandej e zâ edhe unë ndonji vend.

— Sa njeri këndon nëpër kurse, po nuk munden me hŷ të gjithë në pushtet. A ndieve shka tha ai antari i komitetit të Rinís për punë të de... decentralizimit të pushtetit dhe t'ekonomis. Edhe prej atyne që kanë qenë nëpër zyre po shkojnë n'ekonomí. Unë nuk ndahem prej shkollës... Zarar nuk kam pasë prej saj — e në vedi mendoi:

„Bahna mësues, me setër e pantolle të reja, me këpucë të lyeme që kërsasin. Flokët jo fort të mëdhaj e jakën e kuqe. Kah të shkoj rrugës, çikat nëpër bira të gardhit. ‚Sa i hijeshëm dreqi!' As kryet nuk e kthej. Rrnofshin mësuesat: unë me rrogë ajo me rrogë! Çka? — Me bâ pak sefa!"

Tue qërue, nana u ndal dhe iu kthye Hajrijes që ishte afër saj, tue lidhë duejin e tallës:

— Lene mâ! Shko e kryej qato çarapë që i ke nisë!

— Nuk po di me ju mbajtë yrrnekut. M'u ka dallashitë krrabsa me pê të kuq.

— Je bâ tre-katërmbëdhetë vjeçe e hala nuk din me marue çarapa!

Hasani me vllaun ende bisedojshin diçka. Hajrija shkoi në shtëpi e Aliu e thirri gruen.

— S'kemi shka e zgjasim mâ! Në këtë pazar dhe me dalë në Gilan, të takohna njiherë me mikun dhe të mirremi vesh. Mâ gadi se jemi tash, kurr s'kemi me konë. Shyqyr prej zotit kemi gjetë duhan, kallamoq, grunë, tërshanë, elb. Qe, edhe çika â rritë bajagi. Djali mâ â bâ burrë. Sa na del ndoj fjalë e ligë — jo çika bani kështu, jo djali bani ashtu, mâ mirë me vakt.

— Mirë e ki, ore njeri, po... Pak çejz i kemi bâ. S'e dij si do ta përcjellim.

— Pse, ajo që vjen në shpín tande po kujton se bjen gjâ, a? E paça në qafë!

Grueja i rrudhi krahët. Aliut tash iu kujtue nji bisedë që pat me nji mik prej Moravës:... „për që belbzon nuk âsht gjâ, po nji kambë e ka pak si sakat."

— More, ne ta ha dreqi çejzin, po... Më tha njani se dhandërri lene që po belbzojke kapak, po mos kish edhe behanë tjera...

Grueja u hutue.

— Çfarë behanesh?!

Tue u frigue se mos po ndërhyn grueja me e prishë punën, e cila do të shkaktonte njiqind të zeza, bani:

— Nuk më tha gjâ jo, veç e lëshoi nji fjalë.

— Jo, ishalla!

*

Pazarit tjetër, Aliu duel në Gilan. U takue me mikun te ura e Maskatarit. U pajtuen se kishte kalue mjaft „kohë nër unazë" dhe vendosën me ua nxjerrë të rejave nga nji palë petka të mira — kumash, nji palë basme, këpucë të çeluna dhe çarapë pambuku, vathë të penezit dhe disa cikrime të tjera.

Meqenëse ishin dorëhollë, e për mos me shkatërrue vehten, shpejt e shpejt ranë n'ujdí si me e pasë harrue adetin që duhet me i nxjerrë nga dy katë të mira — lahore e kumash, dy katë basëm, dy katë këpucë e çarapa, dukat të madh ose lirë me e varë në qafë, e dhurata tjera. U muerën vesht, mandej, që mos të bâjnë si shumica e hallkut, me i **kthye teshat, se** — „nuk po iu duken robëve të shpís..."

Aliu nuk pat te shtëpija kurrfarë kundërshtimi prej grues për atê që kishte vendosë me mikun. Prandej, edhe ia filloi punës. Grunin dhe elbin, që deri tash nuk e kishin prekë, dhe nji pjesë të misrit, që e shkokluen, i shtini në pesë thas dhe i ngarkoi në kerr.

Të nesërmen — i ngjiti qét, e djali i vogël e muer për kopreshi Bardhushen. Të dy u nisën për Gilan.

Hajrija, tue mos dijtë se po at ditë po pritëshin petkat edhe për tê, e ndigjoi nanën dhe thirri Fatimen me nji shoqe për me u argtue. Mbas pak krisën defat dhe ia filloi kanga:

... Hypi aga baba kalit të bardhë,
ani me dy pupa ra në pazar.
— Ani, shka po blén, or katundar?
— Ani, unë pe blej nji basëm të bardhë...

Ushtima e kangës dhe e defit që këtë herë iu kishte drejtue Aliut, bani që t'i dridhet zemra prej gëzimit. Sa duel prej katundit, u shtî sikur iu kanë lodhë kijet.

— Ha a a, bír! Shshsh... kqyr, bre, epi ujë lopës qaty në prrue!

Nji vesh e ktheu në drejtimin e shtëpís kah vinte kanga. Kur mbaroi pjesa e parë e kangës dhe filloi tjetra, Aliu fshani: „Ah! qysh nuk pata fat me ngue dhe at kâjkën:

... O, ky aga baba po ç'çon pare,
ani po çon pare hem dinarë,
për me ble pambuk e qenar...

Dhe u bërtiti qeve:

— Hajt bír, hajt!

E shiti drithin dhe Bardhoshen, u gjet me mikun dhe — i prenë petkat. I Moravësi çfaqi mendimin që në vend të dimive të basmës të prejnë fustana. Aliu u pajtue. U muerën vesh kur me ia çue njani tjetrit petkat dhe u ndanë.

*

Mbas nji jave u krye edhe kjo detyrë. E ngarkuen nga nji sandak me petka e tjetrin zbrazët, që të ke-

të nusja ku me e shti çejzin dhe me ngarkue seksonën. N'at rast u da edhe vadja: dita e darsmës, të dielen nji javë.

*

Kjo ishte e para herë që Aliu martonte mashkull. Prandej vendosi me e bâ nji darsëm mezatare — le të ndigjojnë hallku rreth e përqark se Aliu âsht tue bâ darsëm, se p'e marton djalin dhe ka thirrë miq e dosllarë, mbesa e bija, kojshi e katundarë.

Nji ditë bisedonte me gruen:

— Unë nuk jam magacioner si ai i Dunavësi. Njimend, ai i thirri tetqind miq, por në kooperativë i duelën pesëmbëdhetëmijë banka mangu! Shkoi hapës, dhe ka me u kalbë për së gjalli.

U muer vesh me gruen dhe u çoi fjalë disa miqve e dashamirëve të ngushtë, thirri kojshit e disa katundarë. Djemt i çoi për me marrë bijat, mbesat e mikeshat. Baba i Kadriut — lëshoi shtëpín në tokë me dy dhoma për gjymbysh, e mixha Shaban shtëpín në dy katë për miq e krushq. Shtëpin e vet Aliu e la për gratë dhe nusen. Goditi nji tupanxhí e nji zurlaxhí. Nji dhí e dy copë dhen i bani gadi për mish. Bleu gaz, sheqer, dyqind copë cigare dhe muer kafe të përzieme, e prej kojshive, çaj blini. Grini edhe tri kile duhan që i kish lanë me kohë për darsëm.

Bashkë me gruen e vet, Aliu leu me gëlqere dhomën ku do të hynte djali me nuse. Ky i binte murit me furçë, e grueja përziente gëlqeren në kazan. Tue shique pjesën që e leu, Aliu tha:

— T'jau bâjmë të rijve edhe sobën e re.

— Përzo', ore njeri, dishka hiç s'jam tue ia nije lezetin kësaj darsme! — tha grueja dhe ia afroi kazanin me gëlqere.

— E, pse demek? — pyeti ky tue ia kthye fytyrën e stërpikun.

— Lene, pashë zotin! Thotë njeri se nuk p'e di. Nuk âsht krejt njâ sikur e jep çikën dhe sikur e marton djalin. Kur e jep çikën e ndien njifarë shpraztije në shpí, e kur e marton djalin, njeri âsht në kulm të qejfit. Merre me mend, ore njeri, veç trembëdhetë vjet me tê! Sa u bâ kishe dishka me më

ndihmue në shpí, me më thanë: „Nanë, loke, ungju ti se unë po tundi, rri ti se unë po fshi, unë vetë muj me i la e shpërla teshat, tash po bij drû, Bardhoshja â mësue me e mjelë unë" — qe mbeta pa tê! Jaaa, përzo, veç s'po kam çka me bâ!... — dhe i pshtuen disa pika lot. Vazhdoi: — E qysh me ndije gëzim? Shka dreqi të çoj për nji ditë me marrë e me dhanë. Ia ke lanë seri! A nuk mujte me bâ që ja na, ja ata ta marrin nji javë përpara? Me nji anë duhet me ia nisë çika me u bâ gati tue kajtë, me ia ngjitë bojën, kanën, me e ndërrue dhe me e përcjellë, në tjetrën anë, ani, kishe gëzim: m'u bâ gadi për darsëm... Gëzimi e idhnimi nuk hyjnë në nji thes!

E muer fshisën dhe e zemrueme, shkoi në qoshe të dhomës e fshiu marimangat që ishin varë.

Aliu fshani.

— Unë a nuk të thashë, kur i çova teshat se qysh jemi marrë veshë? Atëherë nuk më kundërshtove. A nuk më tha: „Mirë, ore njeri, si të thuesh ti"?

— Të kam thanë, po atëherë nuk e bana mend këtë punë.

— Ngo këhâ, shka po të thom. Me vend âsht ajo fjala se „grueja i ka flokët e gjata e mendët e shkurta." Ty të ka ra në mend tash e unë, prej asaj dite që jam marrë vesh me mikun, ia kam bajtë dertin kësaj pune. Po, por — as atëherë e as tash nuk jam pishman. Me pikë të kastit e kam bâ.

— E pse, kishe, me pikë të kastit?

Aliu i fshini syt prej gëlqeres.

— Mori, budallaqe e zotit, po pse nuk mendon pak mâ fellë? Hajde e zini besë atij osc ai ty. Me ia dhanë ti përpara, ndoshta, ta shënderon çikën dhe të thotë: „Jo, valla, nuk po më duket. Qe çika jote, e ti mos u mundo me ardhë me marrë temen. Nuk âsht robi yt." Mbasandaj shka kishe me bâ?!

Grueja i rrudhi krahët e Aliu rroki prap furçen.

— Për atê po të thom se ti nuk din gjâ. S'ka mâ mirë se ashtu si e kam sosë punën. Na e marrim çikën tonë, ata të veten. Mbas Kodrës së Madhe zateten dy palë kryshqi. E ndërrojmë ka nji cigare, luejmë disa lojë, ndërrojmë robët dhe — kthehemi.

Shka po mërzitesh ti? Këto punë që t'i ka bâ çika t'i banë edhe nusja. Nuk jam unë fajtuer — tha me zâ të rrafshtë — që baba nuk më ka lanë mall, e me e martue djalin si të tjerët. Me çue mësitin e me ia dhanë jo nja, po dy lira, me i hypë kalit të bardhë, e, tue luejtë arave, me çue pare. Mos me shkue mbas Kodrës së Madhe, po me shkue te shtëpija e me ia marrë robin.

— Nejse, kështu e paska shkrue zoti — tha grueja me ngushllim dhe duel përjashta.

*

Katër ditë para se me shkue Hajrija, erdhën dy balldëzkat e Aliut, motra e madhe e Hajrijes që ishte dhanë para tri vjetëve dhe disa gra e çika të kojshive të katundit. Motra e madhe dinte se si duhet të përgaditet vajza kur t'ipet. Prandej, ajo u bâ „telake", veshtore e parë. E dyta duhej me qenë njena prej vajzave, të cilën e pritte e shkuemja e saj. Grueja e Aliut zgjodhi Fatimen. Për këto katër ditë, ato kishin me bâ gadi Hajrijen tue plotësue adetet e ndryshme.

At mbramje, para muzgut, kur muerën me ia ngjitë bojën, Hajrija filloi me „qâ" me zâ. Mandej e muerën përkrahu dhe e prunë në dhomën e grave, ku i muer ngrykë të gjitha me radhë. Kur erdh te e ama nisi me dënesë dhe prej syve iu rrokullisën disa lot të nxêhtë.

— Mos kaj, bijë! Kështu e kanë lanë të parët...

Të nesërmen ia lanë bojën dhe ia ngjitën kanën. Dy ditë mâ vonë, e veshën me tesha të reja, që ia kishte pru i Moravësi. Dy gra e muerën përkrahësh e ajo filloi prap me „qá". E prunë në dhomë ku e pritshin grát e vajzat. I muer të gjitha ngrykë dhe u shmang. E këputi vajin. Shoqet e saj ia filluen kangës:

... Ani, kaj Hajrije, kaj e mej!
ani, kaj me lot e mos na rrêj!
ani lotin tand na ta njofim —
qite, mindilin e ta shofim...

Të gjitha, e ndër to edhe Rabija e Milica, shiqojshin kah Hajrija — tue u mundue me ia pa syt

ndën shamín e shpeshtë që ia kish mbulue fytyrën. Hajrija, kësaj here, filloi me qa me të vërtetë. Grupi i çikave që këndojshin, pa pritë që ajo ta qesë mindilin që e mbante nën shamí vazhduen kangën:

... Ani, kaj Hajrí, në hajat t'shpís,
Ani, elvida loja e çiknís...

Tashmâ askush nuk dyshonte se s'po qante me të vërtetë. Qante me loçkë të zemrës. Thonte njeriu se iu shterrë zani. As i binte në mend kujt me ia qitë mindilin. Fjalët „elvida loja e çiknís", të cilën ajo ende nuk e kishte shijue si duht, e prekën thellë.

Fatimja u ngrit, muer mindilin me të cilin Hajrija fshinte syt dhe e mbante shtrengueshëm me të dy duert. Kur e shpaloi — mindili ishte bâ sikur me pasë shti në pus. Kur e panë mindilin, të gjitha grát e vajzat u mallëngjyen.

— E mjera!...

Fatimja, zbê në fytyrë, mbeti si e shtangueme me mindil në dorë. Tue shique mindilin tha rreptë:

— T'i lamë, çika, këto kangë! Boll mâ!... — dhe e muer përkrahi Hajrijen, iu afrue qoshit të trapazanit dhe u ulën. Së shpejti bashkuen edhe Milica dhe Rabija. Milica ia çoi shamín Hajrijes, iu dukën sŷt, skuq prej lotëve dhe fytyra e âjun. Në dy anët e faqeve i shkojshin lotët curril. Zâ mâ nuk qitte, vetëm herë mbas here fshante thellë ose dneste.

— Pse po qanë tash? — i tha Milica me zâ t'ultë. — Pse nuk bane edhe ti si Rabija? E qorruen, besa edhe e rrehën nji kohë, mirë po — kjo nuk e lëshoi shkollën!...

— Ku... me ... dijtë... unë... që po nië vjen puna kështu. Të më kishin dhanë kur të kishna hy në bylyk, të kisha dijtë barem se për kând po m'apin... Po edhe vetë po e shihni se qysh po shkoj. Me kajt e me plasë!

I fshini lotët me duer. Syt filluen me iu terë.

— Hiç mos u tut se edhe shoqet tjera nuk kanë me kalue mâ mirë — tha Fatimja. — Qe, kursi i shëndetsís kishe u nis për të mirën tonë e, si du-

ket, do me na qitë fare! Ka dalë në katund se „hyqymeti po kërkon me i çue medoemos vajzat në kursin e shëndetsís". S'e di se kanë mbetë edhe dy tri vajza pa u fejue. P'i japin me mësit e pa mësit. Edhe vetë po jau çojnë dorën. I kam njehë nji ditë. Veç në këtë muej janë fejue nja dhet çika prej dymbëdhetë deri në tetëmbëdhetë vjeçe. Pesëve prej këtyne dhe gjashtëve që janë konë fejue përpara, ua kanë da vaden. Katra po shkojnë këtë të diele, e shtatë t'ejten nji javë.

Rabija i shtyni me nji anë flokët e rrumbulluem dhe e ngrehi fanelën mbi fustan për me mbulue mâ mirë krahnorin.

— Edhe mue po më thotë baba: „Kije me më mbetë në derë. S'ka me të marrë kurrkush. Të kisha qitë njiherë në shpí tande, e mandej ban shka të duesh."

— E mue axha Sylë: „Ke dalë prej gjakut tonë. Rueju e mos na flliq."

Milica i shiqoi me keqardhje.

— Si ndër ju nuk ka kund! A nuk do t'ishte mâ mirë m'e marrë ndonji djalosh në katundin tuej, ose në t'afërmin, pa pare dhe pa bâ ndërrime! Me dijtë bare se me kê m'e kalue jetën.

— Mirë do t'ishte, po hec e mbushjau mendjen — tha Hajrija.

— Me bâ ashtu, atëherë secila kishte me marrë shoqin e vet, e jo si po ban vaki ndër né — mashkulli i keq po e merr femnën mâ të mirë. Nuk e di se deri ku ka me na çue kjo — tha Fatimja, e shtoi me vehte: „Ndoshta unë do të jem ajo që do ta shkeli këtë udhë të marrë!"

— Janë budalle shoqet tona, — tha Rabija — që nuk gjejnë fatin e vet e me ikë për tê. S'e di deri kur duhet me pritë...

Erdhën edhe disa gra. Hajrija e lëshoi shamín mbi fytyrë e Fatimja e kapi përkrahu.

*

Darsma për martesën e Hasanit filloi. Gadi të gjithë kujdesin ia kushtuen kësaj ane. Hajrijen sikur ta kishin harrue fare! Lajmi për fillimin e darsmës

ishte tupani dhe zurla, të cilat, si hynë në katund, bumbulluen dhe jehuen në të katër anët. Të përcjellun prej fëmijve, zurlaxhija dhe tupanxhija u rrasen n'borr t'Aliut. Zhurmës së tupanit dhe të zurles iu bashkue edhe ajo e defit dhe e kangës që dilte prej shtëpís:

... Shka kanë ata tupana që kërsasin?
— Ani, aga baba po ban darsëm.
— Na po bâjmë darsëm me trumpeta,
Thirri, babo, gjinden me gazeta.

Dielli hyni mbas rêve dhe nuk u pa mâ. Mbramja filloi me u afrue. Rêt u ndênë në qiell dhe e mbuluen hanën pesëmbdhetëshe.

Zhurma që bâhej te Aliu — krisja e tupanit dhe e defit, jehona e zurles dhe e kangës së vajzave, valavama e njerëzve që kishte thirrë Aliu e që tash po vijshin, i tërhiqte vërejtjen secilit që kalonte aty pari.

Mbesat, bijat e mikeshat, prunë nga nji hae bakshish dhe nga dy metra basëm për nusen, marhamë ose çarapa për djalin. Miqt e dostllarët, nga nji kile sheqer e dy-tri paqeta cigare. Haet i mirrte e zoja e shtëpís, kurse peshqeshet e burrave i zoti i shtëpís.

Për darkë u qitën burrave hae taze dhe pula me oriz, e grave po ato që i kishin prû vetë.

Mbas darke filluen me ardhë edhe katundarët tjerë, kojshí e gra. Kur hyjshin n'oborr, grat drejtoheshin te grat në shtëpín e Aliut, e mashkujt në shtëpín e mixhës Shaban te burrat. Të rijt shkojshin te shtëpija e Kadriut, e cila ishte caktue për ta.

Në të tri shtëpijat bâhej pa ia da zhurmë e madhe. Te të rijt — gjimonte tupani, binte zurla, jehonte kanga; te grât — kriste defi e çohej kanga e vallja, kurse te mysafirët këndojshin kangtarët mâ në zâ.

Te këta të mbramët u bashkuen dy grupe kangëtarësh. Nji i përbamë prej katër kangëtarëve të dalluem e tjetri prej mësuesave dhe Ramës. Mësuesat ishin thirrë si miq, kurse Rama i shoqnonte, si i

ri. Kangëtarët ishin ulë njani afër tjetrit, kambëkryq, dhe bisedojshin diçka ndërmjet vedit.

— Po, hëni, bre djem, rrokna ndoj kangë të vaktit — bërtiti Syla që ishte ulë afër hoxhës.

Derisa kangëtarët mendoheshin se cilën kangë me marrë, mësuesat me Ramën ia filluen:

Nji lule që na ka çelë tash,
aman, aman,
përmbi shoqe bajke dritë...

Kur e mbaruen kangën, nji mësuesi i ra në sy se Syla e hoxha rrijshin me krye ulë e me fytyrë të mrrolta dhe iu drejtue:

— Juve, si duket, nuk po ju pëlqen kjo kangë?

Jo pse nuk po u pëlqente kanga, por vetëm për m'u shitë para tjerëve, Syla e çoi kryet.

— Nuk âsht se nuk po na pëlqen, por... a e dini si âsht puna ... jemi shum pleq.

— Eee... nuk na shkon për shtat — shtoi hoxha.

— Kjo âsht darsëm, bre shokë — tha mixha Shaban. — Shka të dijnë dhe shka të dojnë ne të këndojnë.

— Ashtu, ashtu âsht, — u pajtuen të tjerët.

Kangëtarët i shtinë nga dy kokrra sheqer në gojë tue i përcjellë me ujë. Rama e preku mësuesin me brryl dhe ia filluen kangës tjetër:

Në shtrat po dergjet shok Emin Duraku...

Kur e kënduen: „mbi krye i rrinte nana vet'e plaka..." Sylës iu shtrydhë zemra: „Qe, ndoshta, edhe ndonji vjet do të des edhe unë. Kush do të më rrin mue mbi krye? Ajo shtriga plakë, a? Edhe e reja ka me thanë: ‚Shyqyr që shkoi!'... Ah, nanë! Atê ka pasë kush m'e kajtë" — dhe iu kujtue rasti i vrasjes s'Emin Durakut. I pat tregue nji komandant i ballistave t'asaj ane se kishin vra nji rusofil të madh. Tash tha me vedi: „S'ka pasë, e shkreta, për kend me kajtë. Qata na prunë gjithë këtë gazep."

— Shka po thue, mixhë? A po të pëlqen kjo kangë?

—Mirë, mirë, bre mixhë. Po ç'e ban që... — donte me thanë se „s'ka vdekë për vatan" dhe e ktheu — nuk e njofim at Durakun."

— Edhe fjalët nuk p'i marrim vesh — tha hoxha.

Mësuesat i ngrehën kambët që kishin fillue me u dhimbtë prej të ndejtunit kambëkryq, e Rama n'idhnim tha:

— Po, Hasan Kërcyllin a e njifni?

Të gjithë qeshën. Syla uli kryet dhe prâjti. Nji plak, të cilit i erdh randë që Rama u tall me Sylën, i bërtiti:

— S'po të vjen marre, bre!

Këta të tre i ndërruen përsëri disa fjalë. Rama jau bani diçka me dorë kah ushtima e tupanit dhe e zurlës. U çuen. Tue dalë, nji prej mësuesave tha:

— Na po shkojmë te të ríjt...

Kur duelën, Syla e çoi kryet:

— Le ato që janë jabanxhi, po ky shka po përzihet, bre syt i plaçin! — dhe tue iu kthye disa miqve që ishin n'anën tjetër të shtratit:

— Shka keni, bre miq, andej kah ju? A ju kanë rrokë edhe juve si neve këndej për këto kurset e çikave dhe të nuseve të reja?

— Po valla, edhe nuk po ban pa i çue! — tha njani.

— Po, po, s'kemi shka me bâ, — dhe luejti kryet. — Jo me i çue grat me shkrue e me këndue, jo me hjekë ferexhën, me i hapë shkollat në vend të mjeteve, tash edhe kjo... S'e dij se ku do të ndalet!

Nixha Shaban e luejti kryet, u kollit dy herë dhe pshtyni mbas derës.

— Deri tash, aga Sylë, ky hyqymet nuk ka punue keq për milet. Edhe kjo nuk domethanë gjâ, kapërcen.

Syla luejti në vend dhe shiqoi rrotull.

— Ani, de, mbassi po thue ti, mirë. Mue më duket nuk kanë punue keq Xhelekari dhe Shurllani që e kanë hapë kursin dhe, bashkë me të rejat, p'e çojnë edhe nji hallë plakë. Le ta paguejnë! Nuk don me thanë gjâ. A i ndiet, qysh këndojshin: „Nji lule e mirë." Nuk iu lëshohet në dorë grueja e çika këtyne hamadreqënve, jo! — dhe e suell kryet. — Ma së

mbrami duhet me u thanë çikave e grave-mbassi s'po kanë çare pa shkue-asnji harf mos ta mësojnë? Kur ta shohin se nuk ka hajr prej tyne, çojnë dorë edhe këta.

Mixha Shaban qeshi. E me vedi: „E dij ku e ke. Pa kadalë të mahitna pak."

— Nuk ki faj. Ti edhe duhet me pasë frigë. Pesëdhetepesë vjeç e grueja trembëdhetë vjeçe! Atê, ndoshta, s'e kish rrokë tefteri me shkue në kurs, por ti, kur u martove, ia rrite vjetët dhe tash — duhet me shkue medoemos. Tue i pa djemt e ri udhës dhe mësuesat në shkollë, nuk âsht çudí me i luejtë mendja...

Gadi të gjithë qeshën e Syla fshani. Nuk dinte çka me thanë. Prej sikletit iu drejtue kangëtarëve:

— Hëni, bre djem, a e keni menden me na këndue? Pa kapnje at kajkën e mbretit.

Kangëtarët ia filluen:

Ani more mbret, more baba mbret,
Ani këtë Shqipnijën qysh na e le vetë?..."

Ndërsa kangëtarët këndojshin, Syla në mendjen e vet e lidhte mbretin me dinin, dinin me pejgamberin e pejgamberin me zotin. Kur u mbarue kanga bani: „Llailahe ilallah" dhe tha ngadalë:

— Mbreti i shkretë nuk âsht fajtuer. Mileti janë pafytyrë, ia zunë grykën e Kaçanikut dhe ia thyen postën. Ku dij unë se sa asker të mbretit janë mbetë në këtë Cërnogllavën tonë! Hëni, bre djem, ju lumtë goja! Merrni tash atê të Brahim Pashës!

Kanga jehoi përsëri:

... Brahim Pasha, mjekër zi,
E kqyr detin me durbi:
Vjen junani me xhemi...

Sylës iu kujtue marrëveshtja Jugosllavo-Greke, për të cilën flitej në gazeta e konferenca. Ngrehi tymin e cigares dhe çoi dorën:

— Thi âsht Junani! Gjithmonë mbreti ia ka pa sherrin — e me vedi: „Edhe këta kanë me ia pa!..."

Mandej: — Po hâni edhe at kajkën e Osmon Pashës!

... Osman Pasha nji burr i vogël,
I qet dy topa në Pleve të vogël,
I qet Miskovi gjashtëqind topa...

Dhe i përcolli fjalët e kangës:

„Le ta hanë dreqi!... Të kishin ndejtë rahat, bilem... Edhe me te u prishën. Kujtojnë se kanë me i dalë në skaj..." — e me zâ tha:

— Prej Moskovit na ruejtë zoti! Kurr s'e ka lanë mbretin rahat. Kallaballëk janë po edhe mihmatë kanë bâ. S'mund t'i rrijë kush karshí!

Kangëtarët pushuen pak dhe e ndezën nga nji cigare. Kur i muerën veglat prap, nji plak u lutë:

— Pa hani at kâjkën e Ahmet agës!

... Shkijet e Shtimes janë tubue,
Prej Ahmet agës veç me u çue...

— A bre! Po burr që â kanë rahmetlija. Po shka të bâjsh — e vrajti Sërpi! Aaa, bre, kaurri nuk bâhet vlla kurr! — tha Syla.

Disa u shiquen ndërmjet vedit. Sikur t'i thojshin njani tjetrit: „Ky po hyn fellë."

— Pa rrokne edhe Spir kapetanin e Vul Cetinën.

Kangëtarët u muerën vesh. Spjegimet që u bante Syla këtyne kangëve i lidhshin me ato që ishte folë në nji konferencë të gjanë në rreth. Vendosën me këndue kangë që „s'kanë lidhje me politikë." Njani i tha:

— I kemi harrue, aga Sylë. Po, p'e kapim nji tjetër për ty, — dhe filluen kangën e Sejd Zajqevcit:

Krisën pushkët dang e dang prej malit,
Këtë Mihanen fluturim prej kalit...

Syla u mendue: „Burra ka pasë n'at kohë. U kanë dhanë mend grave se shka i gjenë kur nuk i rrinë burrit — ne të shkon tash në paterica tue shkepue! More, kryet ia pres me më lëvritë." — tha tue e çue mendjen te grueja e vet e re.

— Hajtni, djem, hini pak edhe nëpër bungaja. Boll mâ me këso kâjkash! — tha mixha Shaban Kangëtarët kënduen pa u ndalë edhe nji varg kangësh të vjetra epike, por mâ tepër kangë të reja.

Erdhi edhe kryetari i ri së bashku me Dragutinin. Gadi të gjithë u çuen në kambë. Rrethi ia kishte dhanë komunes në dispozicion. Ai ishte mu i atij terreni. fqi i Bllatës. Katundi e zgjodhën për këshilltar, e kshilltarët për kryetar të këshillit. Ishte edhe antar i komitetit komunal. Mbasi u ulën e u përshëndetën me të gjithë, Syla e pyeti:

— Shka kemi të re, shok kryetar?

Ky iu përgjegjë shkurt:

— Këto ditë do të fillojmë me ndërtue rrugët e Bllatës. Gurinën do ta mbjellim me bagrema... Në fillim të muejit ka me nisë punën edhe kursi shëndetsuer...

„Me këtê s'ka mahi!" — tha Syla me vedi — „Hyqymtar!" U mendue dhe qeshi pa zâ.

— Derisa ta hapni kursin, vajzat shkuen!

— Ka nuse të reja! — përgjegji Dragutini.

*

Nji tubë vajzash, ndër to edhe Fatimja përvidheshin rreth gardhit të shtëpís së Kadriut, tue u ruejtë mos po i shef kush. Dëshironin me u afrue ngat të rijve me i pa tue kcye dhe me i ndëgjue tue këndue.

Kadriu rrinte afër derës e kujdesohej për të gjithë ata që ishin aty. Në nji çast i hetoi vajzat, e ndjeu zanin e Fatimes kur u tha shoqeve: „Kadalë, mos u ngutni!" Tupanxhiu e zurlaxhiu ishin tue hangër bukë. Të rijt, të cilëve iu bashkuen edhe mësuesat e Rama, rrokën kangën:

Shëngjergjet po sillen, bre djál,
Vjeshtat po përcillen, medet o!...

Fëmijt, që po luejshin kapuçash në nji qoshe, e lanë lojën për me ndigjue kangën.

Kadriu u ul, vuni dorën në báll dhe u mendue. Kjo kangë iu kujtonte të kaluemen. Para syve i

vetuen ditët e fëminís e të djalrís — ditët e zeza e të bardha. Mendonte: të zeza — pse duhéj me shkue me ruejtë dhent e hueja, t'agës Sylë. Kur i zdiergjet dhent në mbramje, në vend që të pushonte, aga e çonte bashkë me Dautin dhe nji rrogtar tjetër me vjedhë drû në mal. Shum herë edhe qortonte, e rrinte: „Rrogtar je, bre! Të kam pague me pare!" Gjatë vjetit ia bonte vetëm nji këmishë, nji palë tëlina dhe nji palë opanga. Flinte së bashku me dhent në torishtë... e në mëngjez, kur nisej me dhen, ia shtijshin në strajcë vetëm nji copë bukë të ftoftë...

Por, ato ditë kanë qenë edhe të bardha: kur vinte zhegu i madh, i shtinte dhent në mrizë. I milte tri a katër tinzisht, e mbushte mataren me tambël, hynte nën hije t'ahut afër kronit dhe e shtynte bukën e thatë me qumshtin e paziem. Me fyell në shokë hypte nalt në lis dhe këndonte mu këtë kangë me zemër të hareshme...

Tash âsht njizetedy vjeç...

„Qe, Hasani âsht shum mbas meje edhe po martohet. Ndoshta s'e pat keq ai Sylë qeni që tha: „Shko në Bosnje' — bani me vedi, e kur kangëtarët erdhën te vargjet:

... Pse s'po çon me më lypë, o bre djál?
— S'po t'ep baba i yt, o medet o!...

shiqoi kah dera dhe filloi me iu sjellë nëpër mend Fatimja. Tash ju kujtuen edhe disa ngjarje në lidhje me 'të: Kur ishte rrogtar i Sylës, Fatimja e shoqnonte shpeshherë tue ardhë edhe vetë mbas dhenëve. Vidhte prej shtëpís dhe i sillte me hangër voe të pjekuna dhe djath të ri e, nganjiherë, edhe ndonji copë pite që kishte mbetë prej mbramjes. Iu kujtuen edhe ato herët tjera kur, mbas çlirimit, shkonte me korrë e prashitë me pare. Pa nda e shiqojshin msheftas njani tjetrin. Dita e gjatë e verës i dukej se kalonte shpejt — sa kcen zogu në rremb.

„E fejoi Sylë qeni!" — pëshpriti tue fshâ.

Njanit prej mësuesave i ra në sy mallëngjimi i Kadriut.

— Ndoshta edhe ty, si Sylës, nuk po të duken kangët! — pyeti.

Kadriu e shiqoi hutueshëm, por shpejt erdh në vedi, qeshi dhe brofi në kambë.

— Hajde, bre shok usta, pa mshoi viranit pak mâ fort! — dhe e drodhi marhamën u vû në krye të valles. — E due „Hasan agën", „Deli Agushin", „Kukunjeshën"!...

Kcimi i kishte hije. I bukur dhe i zhdërvjelltë, kcente valle të randa e bante lëvizje të lehta. Gadi të gjithë e shiqojshin. Fatimja e zu nji plasë të derës, shiqonte. Të gjithë luejshin mirë, por ajo nuk ia dante syt Kadriut.

„Për ku ta lypsh — aty âsht, dreqi!" — tha me vedi.

Mundohej me e shique edhe atëherë kur Kadriu largohej prej plasës së derës. I shkëlqyen dhambët si dy renda inxhí:

„Gjysën e faqes në tokë kisha me ia qitë!"

Kur i mbaruen vallet duertrokitën të gjithë. Mbasi e zbrazën edhe ka nji raki, Kadriu u bâ qejfli bukur shum. Iu drejtue zurlaxhiut, e çoi dorën përpjetë e, tue i nxjerrë fjalët prej fundit të zemrës, thuese po i flitte Fatimes m'at'anë derës, i tha me ia shkrepë kangës:

Në drrasë të vekit kush po kanë?
— Kanë syza për jaran:
Gur e mal me vaj po i ban,
Dushkin malit po m'ja thanë,
S'p'e le verën sivjet me dalë!...

Të gjithë e shiqojshin me buzëqeshje në harén e tij të papritun. Pse Kadriu megjithëse djalosh i ri, mbahej mjaft zyrtar. E tash ishte dalldisë.

Rama bërtiti:

— Eu, po sharkí koke konë e s'e paskna dijtë, bre!

Tash të gjithë ia filluen kangës. Zurlaxhiu dhe tupanxhiu s'prâjshin.

— Sa fort jam nxê! Due me dalë e m'u flladitë pak — i tha Kadriu Ramës, ndërsa ishin tue këndue.

— Hajt, hajt.

Kur e pa se u nda prej grupit dhe iu drejtue derës — vajzat filluen me u largue. Fatimja s'kishte fuqí m'u nda prej derës. Dëshironte me u takue me tê me çdo mënyrë. Vetëm mos t'u bijë në sy shoqeve! — i Vetoi menjiherë nëpër mend dhe bërtiti:

— Kuku, qyqja unë! M'u këput rrypi i nallones — dhe u gërmuq, gjoja me e kërkue.

Kadriu duel. Drita e llambës i ra Fatimes në fytyrë. U hutuen që të dy. Ky deshti me i folë — por nuk kishte fuqí, s'dinte si me ia fillue. E mbylli derën, e drita e llambës, që shpërthente nëpër plasat e saj, i ra në krah. Fatimja nuk mujti me u durue — ia ngjiti për dore, ia shtrëngoi me gjithë fuqín që kishte. Ky deshti me iu afrue, por ajo iku me hapa të shpejtë. Kadriu mbet në terr si i gozhduem. U mbështet në derë dhe diçka e ambël dhe e pandieme deri atëherë iu përshkue nëpër trup dhe e nxeu. Shpërthekoi pullën e jakës dhe gjoksi i djersitun iu freskue n'ajrin e natës. Në vesh i tinglljoshin hapat e shpejtë të Fatimes e të qeshunit e largët të vashave. Iu duk se zemra i fluturoi mbas saj.

U kthye në dhomë. Fytyra iu kishte skuqë. Mbërtheu setrën që të mos i dukeshin të rrahunat e zemrës.

Të gjithë e përcillshin me kujdes njanin prej mësuesave që kishte fillue me folë për detyrat e rinis n'organizimin e kursit të shëndetsís për të reja.

Kadriu e kuptoi se jo vetëm që nuk kishin diktue gjâ, por as nuk e vunë ré kur hyni. Prandej tha në mënyrën mâ të natyrshme që mujti:

— Lene, bre shok mësues! S'âsht mbetë bota vetëm në konferenca...

— Pse? Çka të gjet ty sonte me qenë kundër konferencave?

— Nuk jam kundër konferencave, por sonte të bâjmë qejf! Duhet me shkue edhe n'odën e mysafirëve, me i ngjallë edhe ata pak,

Duelën së bashku me tupanxhiun e zurlaxhiun.

Te oda e mysafirëve i ranë në sy — kryetari i këshillit komunal e Dragutini. Kadriut iu kujtue se çka i pat thanë Fazliu në mbledhje: „Kryetari dhe udhëheqësat tjerë po marrin pjesë nëpër darsma që po bâhen jashta ligjit!" — dhe kafshoi buzën. Edhe ai ishte gjetë sonte, padashtë, në të njajtën pozitë! Çka me bâ? A me e njoftue pushtetin — Aliu po ep çikën e re, hala pa u rritë mirë, apo jo? Dhe, ndërsa të tjerët këndojshin e kcejshin, ky pështpëritte me vedi:

„Qe ku janë njerëzit e pushtetit dhe të partís. Le ta njoftojnë ata po deshtën. Nuk mundem unë me drejtue çdo thupër të gardhit!"

Edhe grât bâjshin qejf në mënyrë të vet. Tri vajza i bijshin defit me çampare dhe këndojshin pa i nda. Në horë rendoheshin vajza e gra. Kcejshin nën ritmin e defit e të kangës së rrafshtë, tue i lëvizë kambët rrallë.

Ka veshë lulja teshat e s'po don me kajt,
Po kujton, e mjera, se po shkon te dajt!
Nuk po shkon te dajt me kërkue,
Po, po vjen, te burri me punue!

Sa mbaruen kangën në horë, e rrokën tjetrën. Njana duel prej horës, hyni në rreth dhe filloi me u përdredhë, me luejtë njifarë çoçeku të përziem. Lëvizjet e pjesës së poshtme të trupit, nuk i përngjajshin çoçekut, e lëvizjet e pjesës s'epërme, sidomos trokitja e gishtave, ia teprojshin. Dy gra të reja urtojshin fëmijt e vegjël, që qajshin për gjum. Trokitja e gishtave të kcimtares jau këputi vajin fëmijve. Dhoma ishte e shtrueme me qylyma në tokë të pa kashtë. Koha ishte e ftoftë, por grumbulli i grave e nxente dhomën edhe pa zjarm.

Ajo, që kceu në mes të horës, u lodh dhe u ul. Mbas saj u ulën edhe tjerat. Ndërkaq, vajzat nuk e lejshin kangën, tash tue këndue me zâ t'ulët.

Grueja plakë e Sylës dhe nana e Kadriut ishin tue bisedue, ulun afër murit. Këtyne dyjave iu avit edhe grueja e Aliut.

— Për hajr të kofshin dy gëzimet! — i tha grueja e Aliut.

— Për hajr, për hajr! — përsëriti nana e Kadriut.

— Hajr paçi! Ishalla edhe juve ju gëzon zoti sa mâ shpejt.

— Tybe — tha grueja e Sylës — bash më ka hŷ nji gajle e madhe. Ajo e jona i ka mbushë tetëmbëdhetë, â vjetrue bukur shum... Shoqet e saj po shkojnë me fëmij në krah. Mos me konë këto adetet e reja, ndoshta nuk janë shum. Qe — unë jam dhanë njizetedy vjeçe. Mirëpo, tash — jo shkolla, jo kursi, jo çarçafi u hjek... Paç me ja dhanë, po hala s'âsht tue ardhë ai dhandërri pi askerit. Ta kisha dhanë bile si âsht rendi. Po qyqja, e rrita, e çova në kambë të veta, për me i prû vehtes ortake! — dhe fshani thellë.

— Qysh po kapërcen tash n'ortake? — e pyeti nana e Kadriut.

Ajo shtini nën shamí nji blê flokësh të thimë dhe i mblodhi rrudhat rreth gojës.

— Tybe, qysh kam kujtue, mirë. Njimend, atê p'e këqyrë mâ fort, po edhe mue, shpeshherë. po më thirrë nëpër shtëpí: „Ku je, moj plakë?". Kur p'e çon në të pamë të renë, po kthen ka nji herë edhe në sobë teme... Po, unë nuk jam mbetë mâ për burr! Sa ta api çikën jam tue u mendue me i thanë Dautit që të dahemi, të dalmi në shpí tonë... — e me vedi: „S'po muj me e durue at shtrigë të vogël nëpër shtëpí! Kur p'e shof po më rrok sëmundja edhe mâ tepër!"

I mblodhi rrudhat në fytyrë dhe, mandej, iu kthye nanës së Kadriut:

— Po ju, a doni m'i zanë mâ frik nuse Kadriut?

— Pa dijen e tij kemi shti në dy tre vende mësit, po s'p'i apin. Me marrë vesht na qet fare. Shpeshherë po thotë: „S'kam shtek m'u fikë për nji grue... ka vakt." I ka bâ njizet e mâ tepër. Kesh parzit përjashta kur ish konë tue marrë drû. I thash: Kadrio, shko dikah, nxirre ndo' i dinarë. Duhesh, biro, edhe ti m'u martue. A s'po të vjen inati: Hasani sa llulla e po martohet, e ti...

„Tash. nanë — më tha — i kam qitë punët në dyzen. Kam hy sot — s'po di si tha — me punue për ditë. Për çdo muej kam m'i marrë ka pesqind

banka. Gajlen e martesës lenma mue. Nëkoftëse unë nuk gjêj udhë, atëhere ju thom."

— Shyqyr — tha grueja e Sylës — që paska gjetë punë. Tybe, bash djál i zoti âsht. A p'e sheh qysh nuk e ka ngushtue shtëpín! Ishalla zoti ia bje e martohet me kollajllëk.

— Të jemi shëndosh, se krejt mirë ka me u bâ — shtoi grueja e Aliut.

N'at çast në dhomë hyni nji vejushkë në moshë, e cila ishte e veshun me tesha burrash, si ndoj plak. Grát qeshën me zâ. Disa vajza e nuse të reja hinglluen si mazujka. Plakat i këputën fjalët dhe shiquen me buzëqeshje kah „plaku".

Nji nuse e re, e veshun si tjerat me dimí e jelek kumashi, me këmishë mëndafshi dhe shami në maje të krés, u çue dhe filloi me ikë kah dera.

— Paja këho, paja, ti po don me ikë! — i tha „plaku".

Ajo u kthye, e „plaku" ia ngjiti për dore dhe u ul me tê në mes të dhomës.

— Bijo, unë nuse po due, se ymri nuk po më shkon kështu!

— S'ka çikë për ty, s'ka! Të gjitha këto që janë këtu, janë fejue ose janë martue. Janë mbetë vetëm do të vogla — i tha nusja.

— Të voglat e të njomat, ato i kam marak, bre bijë. Vallahi nuk i kishna ngucë për të keq, po kishna luejtë dhe ishna mahitë me to.

— Çka nuk të vjen me lujtë e m'u mahitë — i tha nji nuse tjetër që rrinte afër. Vajzat e ulën kryet tue shique njana tjetrën me bisht të synit, e „plaku" kceu dhe ia ngjiti nuses afër. Filloi gazi, e vajzat të turpnueme ikën jashtë.

*

Nuk i banë as dy-tri orë gjum. Qysh në mëngjez duhej me krye detyrën kryesore: me çue çikën dhe me marrë nusen.

Në kerr me kanata ngulën disa shtaga gjysëm rrethi, e mbi to disa të drejta. Kur e qitën qylymin e kuq mbi tê, kerri u bâ si tunel i vogël. Në hymje dhe në dalje të këtij „tuneli" i kapën për qy-

lym dy çarçafë me bogosi e mbi qylym vunë dy marhama të qindisuna.

E hangrën sillën e hershme. Krushqit filluen me u tubue te kroni. Ndër dasma, ky âsht çasti mâ i kandshëm. Po, kësaj here, nuk ishte ashtu.

Mbasi u muer ngrykë edhe njiherë me gjithë ata që e përcillshin, e mâ së mbrami me vllaznit, babën e nanën — Hajrín që qante me zâ, e hypën në kerr. Tash — krushqit para, e kerri me qé mbrapa, iu drejtuen Stubllovaçës. Dy gra që kishin hypë në kerr bashk me Hajrijen, nuk mujshin me i ndalë vajin asaj, e djali i vogël rrinte si guri.

Kur mbërrinë te Kodra e Madhe, krushqit u ndalën me pushue.

— Jemi nisë, bre shokë, shum heret — tha Syla dhe iu kujtue e kaluemja: — Me nji vakt më kallxonte baba, ishin konë gjindja të çuditshëm. U zatetshin kështu dy palë krushqi dhe asnjani tjetrit nuk ia lëshojshin rrugën. Ai — lëshoma udhën mue, tjetri — jo, lëshoma mue. Ia nisshin bajraktarët e e kryejshin nuset. Asnji i gjallë nuk mbetke! Për ato edhe ktyne vorreve u thonë — vorret e krushqve. E sod?... Krushqit po presin krushqit për me i ndërrue cigaret dhe me dhanë e marrë robin!

S'vonoi shum e ia mbërrini edhe pala tjetër e krushqve. I pritën në kambë, të renduem. U falën dhe u shtruen në bár, që posa kishte nisë me u tha. Mbasi i ndërruen cigaret, lojtarët e dy palëve, së bashku, u kapën në valle. Kerret, që ishin larg njani tjetrit, u afruen. Babat i ndërruen tash çikat tue u shtrengue dorën:

— Gjaku jem, robi yt. Ja pafshi hajrin! — banë të dy dhe, tue u nda, nxuerën ka pesqind dinarë e ia dhanë njeni tjetrit, për telake.

Kerret u nisën për rrugë të vet. Krushqit mbas tyne.

Porsa e shtinë nusen në kerr, grát e kerrit ia çuen duvakun për me ia pa fytyrën sa mâ parë.

— Alio! — thirri nji grue prej kerrit.

— Shka âsht! — përgjegji Aliu tue u grahë qeve. Filloi me iu dridhë zemra. Tue mendue — a thue çka ka shti në kerr, shka do t'i thonë grát e

kerrit — u afrue ngadalë n'anën e mbramë të kerrit dhe e çoi çarçafin e bogosís. Nji grue i tha:

— A p'e sheh? Mashalla, si mollë. Ishalla për hajr e me nafakë!

Kerri ecte ngadalë. Aliu i bante hapat e rrallë e të vegjël, e nën çarçafin e çuem, shiqonte pa këputë nusen, që i mbante syt mshelë. Teli nuk kishte mujtë me ia mbulue fytyrën e gjatë. Të bardhë e të kuqtë vetëm që ia kishin shëmtue faqen e njomë. Aliu u pengue në nji gur, e lëshoi çarçafin dhe mbet në vend. Mandej, tue e mbërrijtë kerrin u bërtiti qeve:

— Ojs, bir ojs!

Fytyra i qeshte, zemra i rrihte me shpejtësi:

— Hajt ti... Alija s'mashtrohet kollaj! — tha me gjysëm zani.

Kur mbërrinë në nji ledinë, diku në gjysëm të rrugës, krushqit u ndalën. Aliu e muer prej grave marhamën e nuses për ndeshje e tre krushq vrapuen në marhamë. Fitoi ai që dukej mâ i dobët me shëndet.

Tue hy krushqit në katund, ashtu të renduem në kolonë, flamuri, që e mbante bajraktari në báll të krushqve, valonte prej erës së vjeshtës. Katundi ushtonte prej bubullimës së tupanit e bërtimës së zurlës. Disa fëmij u turrën mbas kerrit.

Krushqit u drejtuen në shtëpín e mixhës Shaban, e kerri me nuse u ndal te dera e Aliut. Vllau i vogël i dhandërrit hapi derën e oborrit. Tue hý kerri, kunata e Aliut hudhi nën të nji zgjedhë. ndërsa nji grue tjetër u qiti rrotave të kerrit nji kovë ujë. Defi e kanga buçiten edhe mâ tepër. Kerri u ndal. Kanga e vajzave mbërrini kulmin. Thonte njeriu se kishin vendosë me e shkye defin.

... Hajde e zdrypim lulen prej kerrit,
Menzi që e nxorën prej gabelit...

Grát e kerrit e afruen nusen me duvak n'anën e parë të kerrit. Tue e marrë ngryk, kau ia mshoi Aliut shkelm. Nuk bani zâ, sikur të mos kishte ndie dhimbje. E afroi nusen deri te shkallët, ku i erdhën në ndihmë çika e madhe dhe nji grue tjetër. Ato ia

ngjitën njana për nji, tjetra për krahun tjetër dhe, me hapa të vegjël, e hypën nusen shkallëve. E shtinë në dhomë dhe e paluen në qoshe n'anën e djathtë t'oxhakut.

Për nji çast dhoma u mbush me gra, vajza e fëmij. Të gjithë, si nji, e shiqojshin nusen që rrinte symshelë. Petkat kumashi i kishte mbushë, ishte e zhvillueme mirë.

— E mirë koka, veç me konë mos m'e pasë gojën aq të madhe! — bani njana.

— M'e pasë edhe hundën pak mâ të drejtë, me konë vetëm nji grimë mâ e madhe, se kështu koka boll e shëndoshë dhe e gjanë!... — tha tjetra.

Grueja e Aliut i rrinte afër. I erdh inat që i gjejshin „behane" dhe ua ktheu me të shpejt:

— Sikur e ka falë zoti!... Përzo, si syret koka! — dhe u drejtue vajzave që ia kishin ngulë syt nuses: — Mori çika, kënoni pak!

Menjiherë krisi kanga:

More baba derri, babë magjupi,
Na i thave kosh e torishtë, t'u thaftë trupi!

— Për nji lopë e katër thasë drith nuk âsht hak me ia këndue këtë kâjkë — tha nana e Kadriut, që ishte aty afër.

Koha kalonte. Nusja rrinte gjithnji mâ me vështirësi në kambë. Jo vetëm që ishte lodhë, por edhe këpucët e shtrëngojshin aqësa i kishte gufue mishi dhe âjë kambët. I çeli syt nën shamí dhe e uli kryet për me i pa kambët.

Ta ka nxjerrë aga baba mafesin e hollë,
Mshili syt, oj lule, se u bane horë...

Vajzat kënduen e ajo ngriti kryet tue i mshelë çepallat dhe i bani dy rrudha në báll.

Kah mbramja u paksuen grát, vajzat e fëmijt. E lejuen që t'ulet, të çlodhet dhe — të dali jashtë.

*

Edhe Hasani po bâhej gadi. Qysh në mesditë shkoi në dhomë, u la dhe u pastrue. Veshi nji gujë leshi

të zezë dhe nji palë pantollona të thjeshta stofi. Këmishë e tëlina të reja prej pëlhure. Në krye vuni pliş të rí. Mbathi këpucët e reja llastiku. Ende pa dalë prej dhome, vajzat filluen me këndue:

Dishi, dishi teshat e çobanijes,
Vishi, vishi teshat e dhandërrijes;
Dishi, dishi teshat e truqueme,
Vishi, vishi teshat e palueme...

Kur duel prej dhome, u shkepi dy grushta sheqer të larëm fëmijve dhe shkoi kah oda me u takue me shoqin, i cili do ta rruente dhe do ta mësonte se si me u sjellë natën e parë.

Kur erdh kerri, vendi vend nuk i zihej. Endej poshtë e naltë tue mendue: „A thue, çfarë malli kam marrë?"

Tue kalue nëpër oborr, pa motrën e vet te drût, ia bani me dorë për me ardhë.

— Shka ish, bre, ky farë malli?

— Kie m'e pá... s'e kish shoqen!

— Ahaaa — ia bani dhe shkoi.

Hoxha nuk merrte tash pjesë në gëzim, vetëm si të tjerët, por edhe me detyrë fetare. Si imam të katundit e thirrshin në çdo darsëm. Mendonte se tash duhet me çue dhandërrin te nusja dhe — iu kujtue se si kish pasë bâ vetë natën e parë. Mandej kaloi te këta: Si të mbesin vetëm ia hjek duvakun, e shkel me kambë, ajo e dathë — ky i lyp ujë... Hanë bashkë — tue shique njani tjetrin si maca e mini. Kqyrin çejsin. Ulen afër njeni tjetrit. — Shtroje shtratin! Qite jorganin! Deshu! Hiqe edhe këmishën! — ia çon llambës fitilin: trupi i bardhë si bora. I gjuhet ndërmjet dy mollave verore dhe — han, han...

Para syve i vetoi ngjarja që edhe tash i kish mbetë pikë në zemër:

Nana e Taf Sadikut ishte halla e tij. Prandej ky kishte t'hymë e të dalun të shpeshta me ta.

Dimnit të kaluem shkoi njiherë te Tafa — me bujtë. Mbërrini pak para mbramjes. Zoti i shtëpís me djalin kishin pasë shkue ndër miq. Grueja me vajzën— që sod po bashkohej me Hasanin — e

pritën mirë. Vajza shërbente e ai nuk ia dante syt.. Mendonte:

"Çikë bet koka bâ!... Paska hŷ në bylyk... Gjynah âsht me humbë ditë".

Megjithëse nuk hangër aq mirë, shum herë i lypte vajzës ujë. Kish qejf me e pa se si i dridheshin gjît kur gërmuqej me mbushë ujë, e mandej kur ia kthente me dorë në zemër derisa ky e pinte krejt me pushime. I dukej se edhe ajo e kqyrte diçka si ambël...

„E pse mos me më kqyrë? — mendonte. — Katërdhetë, mâ tepër nuk kam... I hijëshëm... I veshun, me setër e pantoll... I dijshëm, mejteplí... Ndoshta thotë, e shkreta, me konë... Eee, nuk e din se edhe mue ai dert më ka kapë... Po qysh?"

Dikur, fjalët u sosën, e grueja e Tafës tha:

— Po bina...

Të dyja dulën jashtë derisa u desh dhe ra në qoshe të shtratit, e ktheu fytyrën kah muri. Porsa hynë, grueja e Tafës e fiku llambën. Muerën me u deshë. Ngadalë çovi kryet mos po ia shef kund ndonji anë të trupit cullak, nëpër at terr të sobës. Nuk pau gjâ. Nana i tha së bís „Bjer ti këndej". Kështu ai muer vesh se ajo ra kah dera — në shtratin tjetër.

Priti shum e gjumi nuk e merrte. I hypi njifarë mendimi: „Tafa nip... Miqsi dhe jarani... Ndoshta marre?... Ndoshta gjynah?... Me qitapë jo kjo, po motra e Tafës më bjen... Kjo, iii sa mâ e largët! S'ka gjynah!" Zemra filloi me i rrahë. Qetësín e vdekun e prishte nganjiherë kolli i gjumit të grues së Tafës. „Po flen... Nuk ka me ndie". Ngadalë e largovi jorganin. Në kambë e në duer, ashtu si maca kur i përvidhet minit, iu drejtue vajzës. Pa kalue mirë shtratin, u ndal: „Nëqoftëse pisket?" — u mendue dhe u kthye te teshat e lanuna nën shtrat. Muer prej xhepit të xhybes nji llokum që i kishte qëllue dhe, tue shkue si pak mâ parë, erdh te shtrati i tyne, mu atëherë kur grueja e Tafës u rrotullue tue u përçapë. U shtrî për shtrati si lepuri derisa u bind se ajo ishte në gjum të thellë, atëherë iu afrue vajzës e zemra nisi me i rrahë mâ shpejt. „Çka të baj? Ku ta kapi? „Dy mollat e paprekuna,

të forta si guri, ia shtuen edhe mâ tepër lezetin. Filloi me e lëmue lehtaz teposhtë. Dora i dridhej tue u pengue në pullat e këmishës, ndërsa tjetra shtrëngonte llokumin. Vajza gjysëm e fjetun, mendonte se ajo ishte dora e s'amës që âsht tue pa ndoshta ndonji andërr... Ia kapi dorën dhe e largoi kah e ama. Si ishte mbështetë në brryla, s'mujti me u mbajtë dhe ta haj dreqi, u lëshue mbi tê... Kur...

„Kuku, nanë, shka më gjeti! — briti, ajo, e msheli gojën me llokumin e ndrydhun...

„Kush dreqin ka ardhë këtu? — u ndie tash e ama që u zgjue trembshëm.

„Erdha me i dhanë nji llokum... nji llokum vetëm... e ajo, e mjera u hutue kur e pa aty...

Çfarë llokumi, he zoti të marroftë! More mulla llokum!... — na lëshoi ajo dhe nisi me kukatë...

Tue iu kujtue kjo, u tërqeth.

„Tybeistikfar! Shyqyr që mbaroi me kaq!" — e mbasi e kqyri sahatin, tha me vedi: „Nuk kaloi dy orë. Vakti!

— Alio, vakti! — bani me zâ dhe u çue.

Kur duelën jashtë, iu afrue Hasani me disa tjerë që ishin aty pari. Hoxha i çoi duerët e mbas tij, edhe të tjerët. Lutjen e tha ngadalë, me vedi, dhe e mbaroi me „amin" të madhe. Atëherë ia zgjati dorën Hasanit dhe ky e rroki me afsh dhe e afroi në ball e në mjekër.

— Udha e mbarë, bír, e të koftë me fat!

Simbas adetit, disa djem ia mshuen dhandrrit nganjiherë në shpinë dhe ky vazhdoi rrugën mbas Aliut dajës që e përcillshin për në dhomë.

Te dera e priti e ama. U hallashtis me tâ tue e marrë ngrykë — pse prej sonte ai dilte prej kujdesit të saj. Ata para e ky mbrapa hynë në dhomë, ku e pritte nusja. Aliu dhe daja u ulën mâ nalt, e ky mbet afër derës, me krye ulët. Vetëm nji herë, vjedhtaz, e çoi kryet për me e pa përpara se ta shifte ajo. Tha me vedi: „Adetin e parë e kreva: e pashë i pari... ia mora zemrën!"

Aliu dhe daja e ndezën nga nji cigare. Çika e Aliut ua afroi nusen për me ua marrë dorën. Kur

erdh te Hasani, ky e zgjati dorën para vedit tue e shique prap.

— Për hajr, o babë, për hajr! — i tha çika.

Mbas nji pushimi të shkurtë Aliu i tha mikut:

— A çohemi?

— Natën e mirë! — banë të dy dhe duelën. Mbas tyne duel edhe e motra.

Hasani u ngrit dhe ngujoi derën. Çarçafin e varun në gozhdë të derës, e lëshoi poshtë — që, rastësisht, mos të shiqonte kush nëpër plasa. U kthye kah nusja, por mbeti në vend. Filloi me shique poshtë e naltë, në të djathtë e në të majtë, sikur ai që kërkon ndonji gjâ të humbun. U drejtue kah ajo. Kur iu qas, ia snkeli kambën e djathtë. Nuk e randoi aq fort, por asaj i dhimbështin gishtat prej këpucëve, prandej u lakue prej dhimbjes. Megjithatë qëndroi pa folë që të mos marrohej. Djersët filluen me ia mbulue trupin. Hasani ia rroki duerët, ia ngrehi dorëzat e bardha dhe i qiti larg në trapazan. Ia hoq duvakun e telin prej fytyre dhe i la në dollap. Mandej u ul afër oxhakut.

— Qitma nji tas ujë!

Nusja e muer tasin, qiti në tê ujë prej kënate dhe ia pruni me dorë në zemër. Ai e muer tasin dhe e derdhi ujin për toke.

— Ama edhe nja — tha me të rreptë.

Nusja ia pruni, e ky e derdhi përsëri.

— Ama edhe nja! — tha si me idhnim dhe kësaj here e muer me dorën që i dridhej dhe e piu. — Hiqmi kundrat!

Nusja iu afrue dhe filloi me ia zbërthye. Edhe asaj i dridheshin duert. Kur i çoi këpucët mbas dere, ia la mbrapshtë.

— Apo na bje dishka me hangër?

Ajo shkoi te dollapi, muer nji sahan me petlla dhe ia pruni.

— Ungju edhe ti këtu, ngat meje, të hamë bashkë!

Nusja u suell pak dhe u ul, por — pak larg.

Hasani e kafshoi gjysmën e petllës dhe gjysmën ia dha. Ajo e muer dhe e shtini në gojë. Ky muer tash nji kokërr sheqer të bardhë dhe e theu për

gjysëm. Gjysmën e shtini në gojë të vet e gjysmën ia dha nuses.

— Afrou pak mâ ngat!

Nusja ishte kah përtypte kafshatën dhe u mendue me e përbî, por — iu kishte tha fyti e kafshorja gadi i nibeti në fyt. Filloi me e ngucë lemza. Në fytyrë u skuq edhe mâ tepër. Hasanit iu duk se nuk âsht në gjendje të mirë, u çue në kambë, ngau, e mu:r kënatën dhe i tha me zâ:

— Pi ujë se po des!

Vajzat, që rrijshin te dera me ndigjue derisa t'i ndërrojshin dy-tri fjalë „për mos me le fëmija shurdhan", qeshën dhe u larguen prej derës.

Megjithëse e pritshin me padurim këtë natë që ta shifshin njani tjetrin — a janë si njerëzit tjerë, mos i mungon ndonjanit ndonji pjesë e trupit, mos kanë mungesa shpirtnore e tjera, — prapseprap, shiqoheshin rrallë. Nuses iu ndal lemza, e Hasani e la kënatën në vend dhe iu afrue. Hapat ia preu nji — sorrë, e cila hyni nëpër oxhak dhe ia theu shishen e llambës copë-copë...

—Edhe kjo belá na gjet! — tha i trembun.

Në çardak plasi gazi i vajzave, të cilat e kishin përgaditë këtê. Njana cokati në derë dhe pruni nji llambë tjetër. Tue u mendue që të ndalte të qeshunit e trembi sorrën.

Sa duel vajza, filluen me qeshë. E kuptuen se vajzat talleshin. Tash shiqoheshin mâ shpesh. Vetëm — kur shiqonte njani, tjetri ulte kryet.

— Shka ke prû si çejz? — tha me buzëqëshje Hasani.

— Me shka me prû?... Zahere më keni çue pare?... Menzi ty dy bohçe — tha me zâ të rrafshtë nusja. — Nanës e babës ka njâ dhe tjerëve disa cikrrime.

— A bon m'i pa?

Nusja u çue dhe shkoi te arka në trapazan. Ndërsa ajo çilte arkën me çilsin që e kishte lidhë n'ushkur të dimive, edhe Hasani u afrue. Ajo kapte sendet me dorën e djathtë dhe i vente në të majtën, tue u mundue që Hasani t'i shifte sa mâ mirë. Ky filloi me i kapë teshat prej dorës së saj. Edhe tash, të dyve u dridheshin duerët.

— Qysh â konë puna, boll paske prû — i tha dhe, tue ia lëshue çejzin, ia shtrengoi duerët. Tash filluen me iu dridhë edhe kambët.

— Boll mâ, hajde t'ungjemi!

Ai para, nusja mbrapa, u ulën në shtrat, tash krejt afër njani tjetrit. Rastsisht kishin qëllue të dy të nji moshe, të dy marroheshin. Dridhja e kambëve u paksue. Zemra filloi me u rrahë mâ tepër, kur Hasani i tha:

— Shtroe shtratin... Qite jorganin... Dishu... Hajde bina.

SHUM të rij dhe të reja hynë në sallën e shkollës dhe zunë vend nëpër banka. Pak para se me e shpallë drejtori programin e çfaqjes, në sallë hynë dy tre grupe antarësh të Lidhjes socialiste. Disa u ulën nëpër vende të zbrazta, e disave të rijt ua liruen vendet e tyne dhe vetë ndejtën në kambë pranë murit.

Kadriu, me njanin prej mësuesve, ishte në kambë afër skenës. Të dy shiqojshin në drejtim të sallës.

— Në çfaqje kurr nuk kanë marrë pjesë kaq njerëz sa sonte.

Kadriu qeshi, sepse e pa se mësuesi nuk e kishte marrë vesh se ku qëndronte çashtja.

— Këta të vjetrit, zor që kishin ardhë, por i mashtruem . . .

— I mashtruet?

— Nuk të ka diftue drejtori, a?

— Jo.

— Rinija po i ndjekin mirë çfaqjet, kurse antarët e Lidhjes socialiste, jo fort. Disa, që janë mâ në kohë, dhe kryetarët e familjeve po vijnë në mbledhjet e Lidhjes socialiste, por gadi asnji nuk mund ta shofish në çfaqje.

— Ani?

— Jemi marrë vesh me drejtorin për me përgaditë këtë çashtje, e, n'anë tjetër, edhe me këshillin e Lidhjes socialiste me organizue nji konferencë. Kështu-me pëlqimin e tyne-mâ parë do të marrin pjesë në çfaqje e mandej edhe në konferencë.

— Aaa, për këtë punë drejtori nuk na paska lejue me e zgjanue programin! Për çka do të mbahet konferenca?

— Për çashtjet kulturo-arsimore, për të cilat duhet me u interesue si të vjetrit, ashtu edhe të rijt.

— Mirë e paski bâ. Të gjithë e shofin edhe çfaqjen edhe, ndoshta, i zgjidhim disa probleme shkollore. Jemi ngushtë...

Prej derës së skenës, drejtori e thirri mësuesin dhe ai u largue. Kadriu u ul në bankë, ku ishin vendosë kryetari dhe sekretari i Lidhjes socialiste. Drejtori duel në skenë, jasht perdes. Mbretnoi heshtja.

— Shokë e shoqe! Na, mësuesat, sëbashku me nxansat e shkollës dhe të rijt e katundit, ju kemi përgaditë nji çfaqje të shkurtë, njiaktëshe — „Prej territ në dritë". Nëqoftëse pajtohi, na kishim me dhanë mâ parë këtë çfaqje të shkurtë e, mandej, me fillue edhe konferenca e Lidhjes socialiste.

U ndigjuen disa duertrokitje.

Dy batanije, të varuna në vend të perdes, u ndanë.

Në skenë: Jovani e Petra tue bisedue për punën e vajzës së tyne të sëmundë. Pak mâ vonë duel edhe halla Stojnë. Plakë-me gungë të madhe në shpinë, hecte gërmuq tue u mbajt me nji shtagë.

Publiku filloi me qeshë. Syla, që po rrinte në bankën e parë bri murit, e zgjati qafën kah skena. Tue shique qeshi me zâ. I pëlqente çfaqja. „Këta mâ mirë se na — tha me vedi — që bâjmë netëve të

dimnit nëpër oda, ose edhe nëpër darsma. Këtu paska hem mashkuj, hem femna. A thue kush janë këto femna? Mund të ketë edhe prej tanëve. Edhe këtë n'e paçin bâ, përzo — mos vetë!... Me dalë para dyqind vetëve?... Edhe emnin m'e ndrrue?" dhe u mrrol shpejt. Iu kthye Dautit që ishte ulë në bankën e tij dhe e pyeti:

— Cila âsht ajo që konka bâ hallë plakë?

— Nuk e dij — përgjegji Dauti tue i rrudhë krahët.

U ndie nji „pëst", e Syla shiqoi djaloshin përbrij, që mbante gishtin në hundë tue dhanë shêj që të heshtin. E pyeti ngadalë:

— Kush janë këto gra që po luejnë?

— Këtë të zojën e shtëpís âsht kah e luen e bija e Dushanit-Milica. E hallën-falltore, çika e Beratit-Rabija.

— Çika e Beratit të Hakís?! — bani me hutim Syla dhe u ndreq në karrikë. Nën vetullat e mrrolta shiqonte prap kah skena.

Kur duel halla Stojnë për me i qitë fall vajzës së vogël e të sëmundë, Kadriu iu drejtue Beratit me të vogël:

— Qe, bre Berat, shka ta gjet çikën? Jau kenxjerrë shpirtin mësuesave derisa të binden që të merrte pjesë edhe ajo.

— Po, vallah. Po...

Berati nuk donte me lejue kurrsesi që Rabija të merrte pjesë në përgaditjen e çfaqjes. „Pse — arsyetohej ai — me mbetë në shkollë deri vonë, natën? Çika tash mâ â në bylyk... Nuk âsht puna si në klasë ku gjinden grumbull me shokë e shoqe. Këtu janë vetëm katër a pesë e, ndoshta, edhe ata — ku ta dijë unë — shpërndahen dhe kjo mbet vetëm me njanin... Ky ia luen synin, kishe pa deshtë, e prek, e piskon, e përqaf. E shmang në ndonji skej e, kjo, shukat... Dhe qe — hop — barku deri te buza! Ç'po të vyen atëherë të gjallët? Mbyte krejt... Qe, ta zamë se edhe nuk p'i bâjkanë gjâ. Por hec e mshilja hallkit gojën kur të del para syve të tyne tue livritë bishtin. Boll e ka që prej të gjitha çikave të katundit e vetmja ajo që po shkon

në klasët e nalta, ani, unë edhe i drejtë: dhetë vjet i ka!..." Prandej u thonte arsimtarëve:

„Jo, nuk muj!"

E ata:

„E ka nji rrol të lehtë. S'ban pa të! Kuriri ka m'e përcjellë deri në shtëpí. Mos u frigo!"

U përzien edhe ata t'aktivit të rinís. I foli edhe Kadriu. Atëherë s'pat kah me ia mbajtë?

„Për krejt dunjan s'e kishna bâ kabull. Po — për hatër të juej..."

Qe, edhe tash, tue iu përgjegjë, bani me idhnim:

— ... Leni ato fjalë, xhanëm, pse po më ngucë? Katundit njiqindenjizet shtëpi, prej tyne mâ tepër se gjysma shqiptarë, e vetëm nji çikë, e jemja, pa kurrnji shoqe, po shkon në klasët e nalta. Tash edhe â dalë këtu para synit të dyqind vetëve. Nejse... u bâ shka u bâ...

Mbasi u qetësue pak, pyeti me zâ të butë:

— Mirë bre, po unë hala nuk jam tue dijtë — cili âsht ai dreqi jem?

Kadriu qeshi.

— Më duket kjo halla që po hyn tash përsëri me qeremide në dorë.

Berati luejti kryet dyshueshëm:

— Kqyre, qafirin! Nuk paskna pasë m'e njoftë. Edhe zanin e paska ndërrue, se le mâ...

N'at çast halla Stojnë i tha zojës së shtëpís, tue shkue mbas saj:

„Zoti të ndihmoftë, bijo! Nuk jam tue lypë gjâ për vedi — unë këto punë i bâj për shpirt. Shka t'japish krejt duhet me jau dhanë shtrigave".

Berati s'mujti me u përmbajtë:

— Për tjetër s'më kërset, por shka me i bâ hallkit?! Kanë me thonë: „A e patë çikën e Berat Hakís — duel para dyqind vetëve, si Shkinë!"

— Fjalët e hallkit e birat e gardhit nuk mshelen kurr — thot populli. Shka bani kjo keq për me keshë dikush? — i tha Kadriu me shpejtësí, tue shique në skenë Savën, kuririn, kur tha:

„Tash po vjen doktori!"

Berati shiqoi rreth e rrotull e, mandej, u qetësue. Sikur ta kish hjekë edhe gjysmën tjetër të barrës. Pohoi me zâ t'ultë:

— Ki të drejtë!

Disa të rij deshtën me u çue, drejtori i shkollës duel në skenë:

— Çfaqja mbaroi. Tash do të mbahet mbledhja e Lidhjes socialiste. Ju lutem që të keni durim edhe pak.

Berati tash, si kryetar i Lidhjes socialiste të katundit, së bashku me sekretarin, Trajkun, hypën në sqenë. Trajku u ul e Berati mbet në kambë. Nxuer prej xhepit nji copë letër të shkrueme me disa rreshta të shtrembët, e vuni në tavolinë, shiqoi në tê, tue e mbajtë me të dy duerët, çoi kryet:

— Pa kadalë, bre shokë e vllazën, se dona me ia nisë konferencës!

Në sallë ende ndigjohej zhurma, që tash vintetue u pashitë:

— Në rendin e ditës... — dhe përsëri shiqoi copën e letrës — e kem qet kulturë e arsimin. Do të flasim për nevojat e shkollës dhe të kursit të shëndetsís — dhe e ngrehi kapuçin përpjetë e flokët e shkurtuem i duelën jashtë. Fytyra iu skuq, e syt i zgurdulloi.

— Ju edhe vetë po e shifni: në shkollë nuk janë tue na shkue shum fëmij, e çikat gadi se hiq. Nëkoftëse unë jam budallë që nuk p'e ndali çikën teme prej shkollës, atëherë thoni ashiqare, e jo mbas shpine! Më keni zgjedhë për kryetar të Lidhjes socialiste pse kam punue si duhet në kohën e komunistit. Duhet edhe me më ndihmue, me më ngue, unë vetëm s'mund t'bâj kurrgjâ! — dhe shiqoi në letër. — Secilën çikë që ka mbërrí për shkollë po lypet m'e çue atje. Qe, edhe kursi për çikat e mëdhaja e nuset e reja hala nuk po punon. Duhet m'e qitë këtu shka âsht sebepi. Nëkoftëse shkon puna si kur ka shkue deri tash, unë nuk muj me ndêjtë mâ kryetar. Zgjedhne nji tjetër! Pse — a shkolla s'âsht për të mirën tonë, a? Për të mirën tonë âsht edhe kursi i shëndetit. Shkolla në midis

të katundit... mësuesët po ashtu na i paguen hyqymeti. S'e dij se shka dojmë na mâ mirë! — tha, megjithëse as vetë nuk ishte aq i bindun në fjalët që flitte.

U ul, bani dy fjalë me Trajkun dhe përsëri u ngrit.

— Shokë, e ka fjalën shoku Trajk.

Trajku, tue shique para vedit nji copë letër në tavolinë, i shtyni mbrapa me dorë flokët e truquem e me tjetrën përthekoi setrën e zhgujt:

— Para se me u mbledhë këtu, kjo çashtje u diskutue në këshillin e Lidhjes socialiste të katundit, mandej në këshillin Komunal dhe në mbledhjen e aktivit të rinís. Unë deshta me u njoftue me përfundimet e këtyne mbledhjeve dhe me kërkue që të marrim vendime konkrete në lidhje me shkollën e kurset.

Çoi kryet, shiqoi kah rreshtat e fundit dhe vazhdoi:

— Në bazë të shenimeve që kemi, shifet se pesëmbëdhetë përqind të fëmive nuk janë tue ndjekë shkollën. Prej këtyne — shtatëdhetë përqind Shqiptarë e tridhetë përqind Sërb. Ka edhe shum nxanësa që nuk e vazhdojnë rregullisht shkollën. Kur e kemi bâ llogari, po del se — për çdo ditë po mungojnë afër njizet përqind. E dyta, së paku katërdhetë e pesë përqind vijnë në shkollë pa libra, fletore, lapsa e tjera. Harrova me thanë se prej këtyne që nuk e ndjekin shkollën rregullisht, tri pjesë janë femna e, ndër këto, tri të katërta femna shqiptare. Deri tash janë dënue vetëm dhetë përqind të prindëve që nuk i kanë çue fëmijt në shkollë. Në mbarim të vjetit shkolluer katërdhetë e tre përqind kanë ngelë në klasë. Edhe këta që kanë kalue, nuk kanë mbërri ndonji sukses të dukshëm. E faji, në rend të parë, âsht te na! Edhe këshilli komunal ka gabue që nuk ka marrë masa me i dënue prindët e nxanësave që nuk vijnë në shkollë... Mandej — shkolla ka nevojë për banka e tash që po vjen dimni edhe për drû, e tjera. Të gjitha këto ndikojnë në mësim. Edhe mësuesat nuk po e kqyrin shkollën si duhet. Qe, oborri i shkollës

ka mbetë shkret, në vend se me mbjellë, pemë, perime, lule e tjera. Kur shef se sa herë kanë mungue pa arsye në punë — del për secilin mezatarisht pesëmbëdhetë ditë. Na kemi të drejtë me kërkue mâ tepër prej tyne. E jo si deri tash! Dy i kanë banesat në shkollë, e dyve le t'ua gjêjë këshilli komunal. Le të sjellin familjen e le ta rregullojnë jetën. E jo me jetue si udhtari në kalim.

Mësuesat shiquen njani tjetrin dhe ulën kryet.

— Diçka edhe për kurset e shëndetsís... Vjet, te na, kursi nuk ka punue. Disa mendojnë se kanë me e shty edhe këtë vjet. Na kemi vendosë që kursi të fillojë punën këtë të diele. Kemi marrë vesh se njerëzit po i fejojnë dhe po i japin çikat para kohës vetëm mos me i çue në kurs. Ka edhe asish që po flasin kundër kursit e thonë: „Poduen me na qitë feje, edhe grât po i bâjnë gadi për asker." Lidhja socialiste duhet me luftue kundër këtyne anmiqve.

Në sallë prap filloi zhurma. Njerëzit pëshpëritshin ndërmjet vedit tue qeshë, e disa të prekun idhnoheshin.

— Hajde shok, — tha kryetari mbasi u çue në kambë. — Secili ka të drejtë me marrë fjalën. Folni lirisht.

Të gjithë heshtshin. Shumica me krye ulë. Vetëm disa shiqojshin në drejtim të kryesís, tue pritë e tue shique se kush po ia fillon i pari.

Dragutini që rrinte në nji bankë në të dytin rend, çoi dorën.

— Unë due me folë pak në lidhje me këtë problem — tha dhe heshti nji grimë, sepse zhurma kishte nisë me marrë hov prap.

— Fol de! — ndërhyni kryetari.

— Qysh me folë, kur po bâjnë gjithë këtë zhurmë. Thotë njeriu se jemi në mulli! — tha njani me zemrim.

Grupet e vogla që bisedojshin ndërmjet vedi, heshtën.

— Shum mirë ka bâ Lidhja socialiste që e ka vû këtë çashtje në rend të ditës. Besoj se Lidhja socialiste e ka vû këtë çashtje në rend të ditës për dy arsyena: E para — me i thirrë antarët e vet që

t'i çojnë fëmijt në shkollë, e çikat e grát e reja në kursin e shëndetsís. Me nji fjalë — me i thirrë antarët e vet në luftë kundër mbrapambetunís, për ngritjen e brezit të rí, për zhvillimin e kulturës dhe arsimit në katundin tonë. Pra, secili antarë që e don socializmin, duhet me iu përgjegjë kësaj thirrje!...

Dragutini fliste bukur. Fjalët i vijshin dhe i shkojshin si me i lexue diku në mur.

— E dyta — organizata socialiste kërkon prej këshillit komunal që të zbatojë ligjin në lidhje me ndjekjen e shkollës dhe të kursit të shëndetsís. Për këto çashtje ka ligje, por këshilli komunal nuk i ka zbatue pikërisht. Nëqoftëse këshilli ende nuk i zbaton këto ligje, ka me u përgjegjë edhe prej së poshtmi edhe prej së nalti. Ju, ndoshta, nuk e dini se kryetarin na e kanë qortue randë në këshillin e rrethit... Pse — këto fjalë që i folën shokët për moskujdesin e këshillit komunal, nuk janë të vogla. Këtu ka antarë të këshillit komunal, ku jam sekretar edhe vetë. Unë iu premtoj se kam me i krye detyrat që më takojnë mue në lidhje me shkollën... Duhet të mbushemi mend njiherë e mos ta bâjmë punën asgjâ! — përfundoi Dragutini.

Sa u ul ky, nji hallë, me krye të lidhun me shami të bardhë, iu drejtue Dragutinit me idhnim:

— Nuk po çuditna për ty, pse — qeni ku han qaty edhe leh! Po s'e di shka i ka gjetë këta tjerët?! Qe, unë as nuk kam kënue shkollë, as kurs dhe shyqyr zoti jam si â mâ mirë. I bana shtatëdhetë vjet e jam, shyqyr, shënosh si molla! — dhe u ul.

Syla dhe Stanku qeshën mâ tepër se tjerët. Dragutini u skuq dhe brofi:

— Mos me qenë plakë, ndryshe kishna bisedue! Po... thot njeriu se veç pse jam tue marrë nji rrogë po flas kështu. Për at rrogë, moj hallë, gjithë ditën po më duhet me ndejtë me krye gërmuc. Me mundim p'e fitoi, e jo badihava, jo...

Marku e çoi dorën dhe muer fjalën.

— Hajde ta zamë se Dragutini e paska për pare, po unë? Po shokët atje në kryesi? E sa e sa tjerë këtu? E dij se kush të ka shtij me folë kë-

shtu! Ti, për nji asht të thatë ia shet shpirtin gazda Stankut.

— Unë sjam konë kurr kundër shkollës! — u ndie Stanku, tue i ra bankës me grusht.

— Nuk âsht se je kundër shkollës. Por, âsht e vërtetë se gjithmonë ke qenë kundër nesh, kundër aktivistave të katundit tonë, kundër atyne që kanë luftue dhe që luftojnë për socializëm! Për këtë s'ka nevojë me u arsyetue. Vetë kjo shtriga plakë, pak mâ parë, tue hŷ në sallë më tha: „Ju dishka e keni marrë në sy gazdën Stank... Mâ së shumti, ai magjup' i zi — Dragutini. Po don me e çue prej shpije e katundi... Stanku âsht njeri erzeli dhe gjymert. Qe, — m'i ka dhanë kambët dhe veshët e thiut që ka pre dje." Për kambët dhe veshët e thiut ajo tash po flet kundër Dragutinit.

Disa qeshën me zâ.

— Hajde — kush don mâ me diskutue?

Njeni, me plis të shkyem e të përllomtë, u çue në kambë tue rrudhë fytyrën e njomë që ia kishte mbulue leshi i butë.

— Shka të doni m'bani: Unë po ju them në këtë vend se gruen teme nuk kam m'e çue në kurs të shëndetit! Jam bâ qyl deri e kam marrë, e sod m'e çue në kurs, vallaha, kurr jo! Jo në burg, po në deshi edhe në konop qitemni, pesë pare s' i jap!

Kryetari i Lidhjes socialiste ia priti me idhnim:

— Na s'kemi punë me azgana! Nëkoftëse nuk na ngon neve, atëherë — ligjin e ngon! Edhe mue nuk më ka pasë hy njiherë në krye m'e çue çikën në klasë të nalta, por...

— Hiqu këtij budalle, allahile, se ky nuk po din gjâ! — tha nji plak pranë atij që foli. — Si t'i çojnë krejt, edhe unë kam m'e çue rén teme, qe besa.

Nji që ishte tue ndejtë në pod bërtiti:

— Unë kishna me e çue me qejf rén teme, por âsht me yzer.

— Grueja jeme më ka thanë: „Mbytëm, se në kurs nuk shkoj!" — tha tjetri.

Edhe prej mesit të sallës u ngrit njani:

— More, shka m'i bâ që ma ka falë zoti çikën gjytyrym? Me nji sy nuk po shef hiç, e ka zanë

dishka edhe tjetri m'i livritë. Si budalla shkon nëpër shpi. Trembet prej hijes së vet... E — nuk kishna m'e ndalë, mazallah! Si krejt dunjaja...

Syla e preku Dautin me brryl. Mirëpo, ai suell kryet tue i dhanë shêj se nuk don me folë. Prandej u çue vetë.

— Unë kishna m'e çue gruen teme, po âsht tepër e re. Atëherë kur e mora u desht me ia rritë vjetët e tash me kqyrë me ia zdrypë diqysh. Kjo mbesa mâ skruen edhe në tefter se âsht e ré.

Kryetarit s' i zente vendi vend. U ngrit në kambë.

— Asht njifarë fjale: „Të dektë nana e harrofsh njerkën." Ashtu edhe kjo puna jonë. Sikur të kishim folë vetëm për kursin e jo edhe për shkollë. Edhe për këto që u folën për kursin, secili e gjet ka nji sebep, vêç mos me punue kursi. Njani: „nuk e çoj se për at grue jam bâ qyl", tjetri: „âsht me yzër", i treti: „më ka thanë mbytëm se nuk shkoj në kurs", „âsht gjytyrym", „nuk i ka vjetët..." Atëherë — ta lamë këtë muhabet! Domethanë grât e reja dhe çikat prej tetëmbëdhetë deri në njizet — jo, çikat e vogla në shkollë — jo, pra — nuk e di se për shka jemi mbledhë këtu? Nëkoftë kështu, të shpërndahemi — dhe u ul.

Mbrretnoj nji heshtje e vdekun. Kundërshtim të hapët, posë njanit, kurrkush nuk bante.

Syla u ngrit ngadalë, sepse duhet me dalë diqysh prej kësaj gjendje.

— A thue kish bâ m'i shkrepë edhe unë si plak nja dy tri fjalë?

— Pse jo? Fol sa të duesh! — i tha kryetari.

Në dorën e Sylës vizlluen tespihët e qehlibarit me tufë të kuqe. Tue i numrue kokrrat me nji dorë, tjetrën e çoi përpjetë.

— Po i foli disa fjalë, veç jau kam hatrin· mos t'i bleni për të keq!

Këto i foli i kthyem kah kryesija, kurse tash iu drejtue të pranishmëve:

— Hyqymetit, sidokoftë e i kujdokoftë — sikur ujit e zjarmit — nuk i rrihet karshi! Kush nuk i rri ndër itatë hyqymetit, ai edhe zotin e ban inqar. Kjo âsht edhe me qitapë — qysh më kanë kallxue

hoxhallarët. Mbasi hyqymeti kërkon që të çelet kursi — duhet m'e çelë! Po kishna me folë edhe nji gjâ, që këtu nuk u ndie: në këto kurse po deshka me ardhë ka njiherë doktori dhe mamija me u dhanë ders çikave. Dersi tyne po deshka me u pague me pare të hyqymetit, sikur i mësuesave. Unë jam tue u tutë që edhe do të harxhitet hyqymeti, edhe çikat nuk do të mësojnë gjâ. Mandej — edhe hyqymeti, ndoshta, do të prishet deri diku me milet. Po qysh? Ju e dini se ky â katund i vogël e çika ka krejt pak. Edhe ato që janë, janë kah bâhen gadi me shkue. Në tjetrën anë, nuse kemi marrë krejt pak në katundin tonë... Ato që janë ardhë para — si folën edhe shokët — jo me yzër, jo të sëmuta, jo po marrohen. Shka del prej kësaj? Na, ndoshta, do ta hapim kursin, e krejt pak do të vijnë. Edhe ato nuk do të mësojnë. Grat e çikat tona mâ zi se lopët. Mâ shpejt merr vesh lopa se ato. Pra — kurrfarë fitimi, pare me harxhitë hyqymeti po, edhe miletin m'e ngushtue.

— Ashtu, beli valla! — u ndigjuen disa zane.

Syla mendoi: „Ia qëllova" — dhe vazhdoi edhe mâ me të nxehtë:

— Ashtu po qysh jo! Unë po flas për të mirën e hyqymetit. Hyqymeti i sotshëm kurr nuk â konë. Shum hyqymet i mirë. Hyqymet i miletit. Mileti jonë, i ka do adete. Në to nuk ban me prekë, se miletit i vjen ranë. Do punë, që tjerët i çojnë neve nuk na shkojnë. M'e konë m'i pasë mësue grát, hahet, ndashta. Por nusen e re e çikën në bylyk me i çue te mësuesi, kjo kurrqysh nuk hahet! Mos të më marrin vesh dallash mësuesët. Unë nuk po thom se ata janë të këqij, koftë larg! Po, a din... vendi jonë s'mundet me i bajtë do punë...

U çlodh pak, tue shique para vedit. Ishte edhe nën përshtypjen e çfaqjes. Përsëri e çoi kryet dhe i shiqoi të gjithë me rradhë, prej së naltit.

— Hajde, ke qysh ke, çikat — p'i çojmë diqysh në shkollë. Po edhe ky besharetimi si sonte nuk ka kurrfarë dere! Me dalë para dyqind vetëve, me luejtë, m'u besharetue — kurr nuk â konë ndër né! Leni krejt, po Rabija e Beratit edhe emnin e kish ndërrue, ish bâ — „halla Stojnë"!?... Unë

kaq, e, ju thash edhe përpara, që mos të ma merrni vesh dallash. Unë kurr nuk muj me konë kundër emrit të hyqymetit. Këto që i fola, i fola për të mirën e hyqymetit dhe të mirën e miletit — dhe e preu fjalën e u ul hijerandë si vaktile.

Disa duertrokitje e përcuellën mbarimin e fjalëve të tij.

Kadriu luejti vendit me zemrim. Ishte mllefë — me plasë.

Rabija, pa e kërkue fjalën, u çue në kambë. Ashtu e vogël me trup, memzi shifej prej tjerëve. Zani i saj tinglloi hollë:

— Kësaj i thonë: „ha bukën tande e baj gajlen e huej!"

— Rri mori ti! — i bërtiti i ati që kryesonte konferencën, e n'vedi shtoi: „E kam dijtë që do të bâhet kështu!"

— Bash nuk po rrij, pse me folë për mue? Pse nuk po flet për horlluqet e veta? Ku e gjeti at drejtësi — burri plak m'e marrë çikën trembëdhetë vjeç? E ka nxjerrë prej shkolle. Ja ka nxî jetën! Ky âsht adet i mirë, a? E unë, pse e luejta nji hallë, me më marrë nëpër gojë? — dhe, e skuqun në fytyrë, mêjti.

Syla uli kryet dhe vrani vetullat e kryetari, si i hutuem shiqonte para vedit.

Rama, i nxêmë prej fjalëve të Rabijes, nuk u përmbajt:

— Hyqymeti jonë nuk thotë si âsht tue shkue puna te na — gadi të gjitha vajzat m'i nxjerrë prej shkolle! Dikush ia ndërron vjetët dhe thot se âsht vjetrue për shkollë — e ajo hala fëmi. Dikush ani, pajtohet m'i hangër dy-tre muej burg, vetëm mos me lejue çikën me ardhë në shkollë. Po i martoni çikat, pa i çelë syt, pa e pa botën, pa e dijtë se shka âsht mirë e shka âsht keq! Po i ndjekni sikur me i pasë anmiq e jo evladë... Kjo âsht drejtësi, a? — dhe i ra bankës me dorë. — More, unë nuk kisha me jua mbushë mendjen aq fort. Të gjithë ata që punojnë kështu i kisha shti m'at'anë drynit! Ky plaku këtu s'u marrue aspak m'e e barazue me lopë. Duhet me ju hŷ mâ njiherë në trû — se lopa

âsht shtazë. As femna shqiptare nuk lejon mâ m'u barazue me lopë!

E Rabija, tue shty mbrapa flokët e rruncallta, ndërhyni edhe mâ me idhnim:

— Mâ besharet i keq se qysh po shkojnë grát tona a ka kund? Kishe e kanë hjekë çarçafin, e mbështellen me gjithëfarë teshash, e shemtojnë vehten! Pse nuk po flitni për këto, aga Sylë? Kush âsht besharet mâ i keq, ky apo ai imi sonte? — dhe u ul e syt thue se i qitshin shkëndija.

Të rijt e disa të reja, së bashku me do antarë të Lidhjes socialiste, duertrokitën. Kryetari mendonte: „Ndoshta nuk ka hije kështu?... Kjo âsht femën... Por ani, nxuer hak..." Në sallë u bâ zhurmë e madhe, e kur muer fjalën Kadriu, të gjithë heshtën.

— Këto kurse për femnat e reja katundare janë hapë në të gjithë katundet e Jugosllavís, me urdhën prej së nalti, prej shokut Tito. Edhe në rrethin tonë, shumica e katundeve i kanë hapë këto kurse. Nëqoftëse na nuk e kemi hapë në vjetin e kaluem, në këtë vjet nuk mundemi me e shty. Duhet me e dijtë se na nuk jemi tue mendue me e hapë kursin kushedi se për shka. Kursi duhet me luejtë nji rrol të madh në jetën e femnave. Në këtë kurs — çikat, nuset e motrat tona do të mësojnë me mbajtë pastërtín në shtëpí të vet, me i ndihmue njeriut kur vritet, pritet ose, përshembull, kur ta hajë gjarpni.

— Po këto po u bahkanë doktoresha, bre! — u ndigjue nji zâ me ironí dhe plasi gazi.

— Këto mësojnë me dijtë disa gjana të vogla të doktorit — tha Kadriu. — A s'âsht mirë kjo, a?

— Ashtu âsht! — u ndigjuen disa zane.

— Qe shka kisha për të thanë unë, se boll e kemi zgjatë: e para — nesër âsht e diele dhe — nesër ka me fillue punën kursi i shëndetësís! Në këtë kurs duhet me ardhë këto çika e gra... — tha tue lexue emnat e nja pesëmbëdhetë femnave të reja. — Kursi ka me u mbajtë në shkollë e mësim ka me dhanë drejtori i shkollës. Kursi do të punojë tri herë në javë nga katër orë.

E dyta — secili antar i Lidhjes socialiste, që ka fëmij në shkollë, ka me i dërgue rregullisht. M'u kujdesue me i pajisë fëmijt me libra e mjete tjera për shkollë...

E treta — mësuesat ta marrin mbi vedi me mbjellë oborrin e shkollës me pemë e, ndoshta, me bâ edhe nji kopsht në pranverë. Këta duhet me luftue edhe për meremetimin e ndërtesës së shkollës. Veçanrisht duhet me luftue kundër mosdisiplinës që po shifet te disa mësues. Unë s'e dij si mundet ky mësues i katundit tonë me e thirrë vehten arsimtar, e âsht martue para nji mueji si çdo katundar. I ati i ka zanë nuse, ka çue paret dhe ia pruni. Hera e parë që âsht pa me shoqen e vet, ka qenë nata kur ka hŷ dhandërr, bile me duan e hoxhës! Ky tjetri, ani, nuk po e bjen familjen prej rrethit të vet; zaher ka frigë se po ia shofim gruen.

E katërta — këtu jemi tre këshilltarë të këshillit komunal që na keni zgjedhë: unë, Trajku dhe Dauti. Më duket se, para nesh, Lidhja socialiste ka shtrue këto detyra: me marrë masa të rrepta kundër atyne që nuk i çojnë fëmijt në shkollë e me u kujdesë për pajisjen e shkollës me banka; me i paditë që të gjithë ata që marrin e apin vajza ndën tetëmbëdhetë vjet. Për këtë punë âsht dënue vetëm nji me dy muej burg. Duhet të kujdesohemi tash edhe për tjerët.

Qe — këto propozimet e mija në lidhje me këto që rrjedhin prej asaj që u fol. Po — edhe nji gjâ — e tue çue zanin edhe mâ nalt, vazhdoi:

— Këtu u fol mbarë e mbrapshtë. Folën njerëzit që nuk na e duen të mirën dhe ata që e duen të mirën e popullit. Qe, përshembull, Berati e Trajku e mâ shum, kjo vajza e vogël e Rama kanë folë të vërtetën. Disa folën edhe mbrapshtë. Ndoshta prej mosdijes. Sigurisht ata kanë me e ndreqë qëndrimin e vet. Vetëm Syla i ka folë fjalët me bishta, fjalë që nuk i pijnë ujë te na. Hyqymeti ynë âsht i popullit, pse e ndihmon popullin, e ngren në shkallë mâ të naltë. Këtu kemi pasë nji qëllim tjetër. Syla âsht njeri i mençëm, por i mbrapshtë. Po don me përfitue nga mosdija dhe mbrapambetunija e disave e me tregue vehten se mendon për milet

e hyqymet. E dijmë na se sa ja ka hatrin miletit e hyqymetit, e dijmë!

— Ani de, përkthemi fjalët e mija si të duesh! — ia priti Syla.

— Jo si të due, po si janë! — tha Kadriu dhe u ul.

Në heshtjen që mbretnoi për nji kohë u ndie zani i kryetarit:

— A po don me folë edhe kush? — dhe mbasi nuk u paraqit askush, tha:

— Kush âsht, pra, për detyrat që i shtruem dhe propozimet që i dha Kadriu le ta çojë dorën!

Dauti, që rrinte afër Sylës, u ngrit:

— Kjo âsht mbledhje e Lidhjes socialiste e jo e votuesave. Mendoj se nuk âsht nevoja me votue.

— Unë pveta popullin: në dashin m'i çue duerët, le t'i çojnë, mos dashin mos t'i çojnë — tha kryetari me zemrim.

Gjymsa i ngrehën duert, e ata që nuk i patën ngritë, tue shique rrotull, nisën edhe vetë me i çue. Tash i mbajshin të ngrituna shumica. Edhe Dauti iu bashkue shumicës.

Plisshkyemi dhe të dy të tjerë nuk i ngritën duerët. Syla as që lëvriti.

— Hajrli koftë!... Në koftë kismet, nesër ka me u mbushë kursi. Edhe reja eme ka me shkue! — tha Aliu që deri atëherë nuk e pat çelë gojën.

Kadriu, tue nxjerrë emnat prej librit të gjendjes civile, kqyri edhe për Fatimen. N'at kohë ishte rregjistrimi i popullsís. Fatimen e kishin shkrue pesëmbëdhetë vjeç, megjithëse i kishte tetëmbëdhetë: „Tash, ajo nuk do të marri pjesë në kurs, — mendoi ai. — Ndoshta e kisha pa ndonji herë rrugës. Kish mësue me shkrue. Të paktën i kishim shkrue letra njani tjetrit." Tue u çue vazhdoi me zâ:

— Unë kisha me thanë, shokë, edhe nji gjâ: na e dijmë se ende ka vajza që duhet me hŷ në këtë tefter. Por, nuk kemi mujtë me i shtie pse në librin e amzës prindët e tyne ua kanë ulë vjetët e, kështu, po del se janë të reja. Kisha me u thanë atyne që kanë bâ kështuqë t'i bijnë në kurs nëqoftëse përnjimend i kanë këto nga shtatëtetëmbëdhetë

vjet. Nëqoftëse nuk i shkruejnë në kurs, s'kanë me mujtë me i dhanë. Nëqoftëse i japin, kanë me u dënue.

Dauti iu kthye Sylës dhe i tha me të vogël:

— Mirë e ka!

— Çou, atëherë!

— Shtine në tefter edhe motrën time, Fatime Hajdinin, se i ka mbushë tetëmbëdhetë vjet. Shkoj unë ndonji ditë në këshillin komunal dhe ia ndreqi vjetët.

Kadriu, tue i rrahë zemra, e shkroi Fatimen në listën që kishte në dorë.

U ngrit edhe nji burr i pashëm:

— Shtine edhe temen se i ka mbushë tetëmbëdhetë.

— Jo, nuk po e shkruej.

— Pse, bre?

— Pse nuk i ka përmbi trekatërmbëdhetë.

— A mâ mirë e din ti apo unë? Kjo s'âsht e drejtë!

— Qe ku janë tjerët. Nëqoftëse âsht ashtu, le të flasin.

Megjithëse ia mbajtën krahun dy-tre vetë, nuk u pranue propozimi i tij.

Plisshkyemi, tue krue mjekrrën tha:

— Edhe unë p'e çoj, veç nëkoftëse kursi nuk mbahet në shkollë, po në nji odë tjetër, si bje fjala n'odën e agës Sylë. Nuk po ban, vlla! Dimën, lloç, borë, larg — tha tue mendue se ajo që mund ta gjente gruen në shkollë, n'odë nuk do ta gjente.

Syla foli me njanin që ishte mbrapa tij, dhe ai u ngrit!

— Jam i mendimit që në kurs ta çojmë edhe këtë hallën që foli pak mâ parë. Le të rrijë aty me to. I paguejmë dishka.

Dy propozimet e fundit, sikur me pasë qëllue në dëshirën e të gjithëve.

— Të gjithë jemi për këtê! — tha nji plak.

Mbasi u pranuen edhe këto dy propozime, mësuesi falënderoi popullin që kishte ardhë në çfaqje dhe mbledhja muer fund.

Salla u mbush me zhurmën e njerëzvet që muerën me dalë grupe grupe.

NËPËR dritaret e dhomës shifeshin shllunga të mëdha bore që bijshin në tokë njena mbas tjetrës. Nga ana e Karadakut të Shkupit ndihej zani i patave t'egra, që fluturojshin kah livadhet e Moravës — shêj ky që dëshmonte se dimni do t'ashpërsohej edhe mâ.

Kadriu hyni mbrenda, msheli derën dhe u drejtue kah Rama. Tue shkue, i tha së kunatës, e cila u ngrit në kambë:

— Shtini koftorit edhe ndonji drû, mos të nerth nana! — dhe e shikoi t'amën që dergjej në nji shtrat druni, e mbulueme me jorgan. Te kambët i rrinte vllau i Kadriut, e poshtë, në shkamb, grueja e tij, tue shique plakën me dhimbje.

— Gajret, nanë! Kemi me të pa edhe njiherë në kambë. Pa zbardhë drita e kam çue Ramën me

çejz në Vitinë me marrë doktorin. Tash kanë me mrrí...

Ajo ia lëshoi syt e mekun dhe gjëmoi:

— Mos u harxhit, more bír! — dhe me nji zâ të shuem, tue i ndërpre fjalët, vazhdoi: — Kërkush nuk ka faj... pleqnija e shkretë! Qe dy herë që më ka këqyrë doktori, po... s'po më gjen çare. Edhe unë po des me gjegat e babës tand. Me të pasë pa edhe ty të martuem, nuk kish me m'u dhimtë kjo dynja...

— Hajt, nanë bre, se sa të shëndoshesh veç kam me u martue! — i epte zemër Kadriu. — Por, shtrëngou pak, se jo veç ndër def, por edhe ndër tupan ke me luejtë! — i tha me buzëqeshje.

— Ishalla, bre bír... Zotit, shyqyr, tash, po del dinari... Kqyr mos i harxhit paret, biro... Ruej, bani turq dhe martou... E mbasi të martohesh — qysh ta jep zoti! Eeee, dynjaja e shkretë!... Sa u çuem në kambë tona, u rritën djemt, po punojnë, bamë ni idare orta — mos me cokatë mâ nëpër dyer të hueja, po duhet me thanë — elvida dynja! Shko e flêj pak! Je mbetë gjithë natën pa gjumë, tue më ruejtë mue, qyqen...

Kadriu, me sy të skuqun duel n'anën tjetër të dhomës dhe u mbështet në shtrat. Iu kujtue e kaluemja e vështirë, dëshira e flakët e babës dhe e nanës që ta martojshin...

*

Atëherë kishin vetëm nji lopë. Kur milshin atê, kishin me çka me e bylmue bukën, e kur shterrte, nana trazonte nji grusht krypë në kalanicë dhe e vente në sofër. Uleshin rreth šaj dhe i ngjyjshin kafshoret derisa sosej buka. Nganjiherë fëmijt qajshin, tue kërkue ende bukë. Baba e nana shiqojshin njeni tjetrin. „Dil nër kojshí e merr nji tepsí miell uha për darkë!" — thonte baba. „Nuk po japin, more njerí" — përgjigjej ajo. Mandej baba çohej prej sofrës tue lanë disa kafshore dhe dilte përjashtë. Nana i merrte ato, shtonte pak edhe prej të vetave dhe ua ndante...

Njiherë ishin te plehu me vllaun e Dautit, tue ndërtue nji kasollëz. Erdh e motra. „Nana ka shtî

pasul për darkë!" Ky briti prej gëzimit, kceu shtegun dhe përdrodhi kambën. I mbet merak jo vetëm pse vetë nuk hangër prej dhimbjes së kambës, por ua prishi darkën edhe tjerëve...

Kur vinte pranvera e vera baba, bashkë me nanën, i merrshin fëmijt me vedi që t'ushqeheshin edhe këta atje ku shkojshin prindët me punue. Me punën që bante i ati, mâ parë lante borxhin e atyneve që u kishte marrë gjatë dimnit — tri kile drithë për nji argat. Mandej — punonte Arën e Madhe t'agës Sylë, që e pat marrë dy herë në të katërt e njiherë në të tretë.

Në kohën e pushimit, tue ndejtë nën hije, ose atëherë kur gjindej në shtëpí, nana nuk rrinte kot — herë tirrte, herë thurte çarapë me hak.

Kur merrshin fund të fshimet, baba mirrte kosën dhe shkonte në kambë — këtu drejt nëpër Kopilaçë, në fushën e Shkupit. Kositte otavën e bejlerëve. Rrinte atje nji muej e punonte dy javë. I mbeteshin ka pesëgjashtë banka. Vinte me do kutë bez të bardhë e nji shamí. Si hynte n'oborr, lypte ujë. Menjirendi shtrîhej në postaqí, nën hijen e mollës. Fillonte me u dridhë. E, kur nana ia qitte plafin, thonte:

— Hiqma se u kalla!

Fëmijt, njani në nji anë e tjetri në tjetrën, rrijshin në kambë pranë tij, tue mbajtë bezin në dorë. Motra ia trembte mizat me shamín që ia kishte prû ai. Nana ia vente në krye marhamën e lagët e baba shtrygjej disa herë dhe flinte. Por, as atëherë nuk ishte rahat: flitte jerm pa ia ndá.

Nana e pritte bezin me brisk. Motra ia dridhte pejt dhe ia shtinte në gjylpanë. Të dy bâheshin me tëlina e këmisha të bardha, çliroheshin prej zheleve të përllomta plot harrna. Kjo ishte ngjarja me randësí në jetën e tyne, gëzim i madh.

Edhe këto përllomeshin dhe shkyheshin. Duhej me i harrnue dhe lá. Ndërsa nana bante këto punë, fëmijt hyjshin nën jorgan dhe kallxojshin prralla: „qysh e ka pshtue njani gjarpnin kur â djegë mali", „si e ka marrë ajo çika e begit rrogtarin", ose këndojshin kangën e Hasan agës dhe të çikës Potureshë.

Tash janë bâ shum ndryshime: djemt u rritën për punë. Mbas çlirimit, ndërtuen shtëpín. Posë nji lope që kishin, i banë edhe dhetë krén dhenë e nji pendë mëzet. Shteti u dha katërdhetegjashtën edhe nji gjysë hekteri tokë të konfiskueme e u banë — nji hektar e gjysëm. Në krahasim me ato që kishin pasë, kjo ishte pasuni e madhe. Por edhe kjo nuk mjaftonte për të dy vllaznit e babën. Tash u zgjidh edhe ky problem. Kadriu hyni n'ekonomí si puntuer i përhershëm. Rrahimi, vllau mâ i madh, u martue dhe ia lëshoi rendin Kadriut.

Tash e lodhte mendimi — si me u martue dhe kë me marrë. Shum herë iu kishte sjellë në mend Fatimja. „Më ka dashtë qysh në vogli e at natë, në dasmën e Hasanit, ma shtrëngoi edhe dorën... Do të ketë dishka këtu!... U bâ mirë që shkoi në kursin e shëndetsís" — dhe pëshpëriti:

— Ah të kisha m'e pá e t'i thom vetëm dy fjalë!

Iu përzien edhe shum gjana, shum mendime, kryet iu randue — u rrotullue dhe fjeti.

*

Qeni lehi e Kadriu kceu prej gjumit. Prej obrrit ndihej nji zhurmë e madhe. Mandej — trokitje në derë. Së bashku me Ramën e mjekun, hyni mbrenda edhe drejtori i shkollës me kursistet.

Kadriu u përshëndet me mjekun, pak i habitun.

— Tue kalue pranë shkollës — i tha mjeku ngadalë — ktheva në kursin e shëndetsís. I pruna kursistet m'e pa të sëmundën në praktikë. Besoj se nuk ke gjâ kundër?

— Vetëm urdhnoni, shok doktor.

Mjeku iu afrue të sëmundës, që tash ishte tue hjekë me shpirt, e kursistet u banë tubë ke kambët e saj. Fatimja iu afrue te kryet. Mjeku u kthye dhe i tha Kadriut me zâ të vogël:

— Po e vizitoj, vetëm... Qenka në minutat e fundit.

Ndërsa u jepte disa spjegime të shkurta kursisteve, nana ngrehi dy-tri herë dhe prâjti — përgjithmonë! Fatimja bërtiti:

— Kuku, vdiq nana!

Kadriu iu afrue të vdekunës. Fytyrës i rrëshqitën dy pika lot. Kur e ngriti kryet, dy shiqime u përpoqën. Fatimes, jo vetëm që iu kishin mbushë syt me lot, por i rridhshin pa da fytyrës. Kadriut, thue se iu paksue dhimbja. I fshini syt me dorë.

— E kreu kjo të vetën! — tha me zâ t'ultë.

— Mos u mërzitni! Qofshi shëndoshë ju tjerët, — tha mjeku dhe u nis kah dera.

Të mbramët duelën drejtori dhe Rama. Kadriu duel mbas tyne.

Edhe kur i vdiq i ati zihej ndër vedi. Thonte „Unë pa këputë po flas e po punoj kundër mbrapambetunís edhe bajtësave të saj — fés e hoxhallarëve, e tash — thue se bota nuk mundet me qenë pa to" — dhe bisedoj me Rrahmanin për me e përzanë hoxhën. Po vllau — si me pasë vû në zjarm, nuk deshti as me ndie për këtë punë. Atëherë nana ishte e sëmundë. Me i thanë asaj mund ta tronditte dhe, kështu, pat çue duert. „Po, a edhe tash m'e lanë ashtu, a?" — tha me vedi. „Sa âsht nanë e Rrahimit, aq âsht edhe e jemja! Babën për qejf të tij e nanën për qejf temin!" — përfundoj dhe e luti Ramën e drejtorin e shkollës që të ndërhyjnë me lajmrue farefisin, me çelë vorrin, me gëdhendë dërrasat. Mbasi i përcuell, u kthye në dhomë. Rrahimi qante edhe mâ tepër. Grues së tij gadi i ra të fiktë prej vajit.

— Boll mâ! Edhe me plasë nuk mundemi me e ngjallë.

— Po qysh mos me kajtë, — i tha vllau me zâ të marrun. — Na shkoj baba ungjë në shkamb e qe — edhe kjo tash. O, kuku për né! Na shkoi nana!

Tue qá, grueja muer nji marhamë, ia lidhi gojën e, me nji shervetë të madhe, e mbuloi të vdekunën.

— U bâ çka u bâ! Po të shofim tash a po e shtimë në dhé sod a nesër — tha vllau. — Duhet me i çue haber akrabás, me çue gjinën te vorret, me gëdhendë dërrasat.

— Mos u mërzit! Bâhen të gjitha. Ti veç rri. Rrnofshin shokët!

— Atëherë unë po shkoj me thirrë hoxhën dhe hoxhanicën. P'e marrë tabutin dhe, kah të kthehem, po e blej edhe qefinin — e ju kthye grues: Trazoje pak kanë e ngjitja nanës në dorë. Vënoje edhe nji kazan ujë m'e la...

Ndërsa ky bâhej gadi me dalë, Kadriu mendohej si me ia fillue.

— Lene, ebu! Shka po të vyen hoxha e hoxhanica!

— Qysh more: shka po të vyen!? Nëkoftëse nuk mujmë m'e shti në dhé me hatme, hoxha le t'ja kënon nja dy-tre jasina e talkinin. Hoxhanica duhet me ardhë sa mâ shpejt. Jo me kepë qefinin, jo me la xhenazen...

Kadriu u ul në shkamb dhe tue shique herë para vedit, herë vllaun, tha me vendosmëni:

— A di shka: do ta shtijmë nanën pa hoxhë e pa hoxhanicë.

Kunata e shiqoi në hutim. Vllau ia zbardhi syt:

— A je trenue apo të kanë lanë mendët?!

— Po kadalë de, mos u ngut!

— Atëherë ta thirrim popin dhe ta çojmë në vorret e Shkeve!

— Unë po të thom mos u ngut, e ti prap...

— E, pra, qysh po thue ti?

— Tash nuk kam kohë me ta mbushë mendjen. Por, po të lutem ma le mue vorrimin e nanës — i tha me zâ t'ultë.

— Ma mbushë ti mendjen si atëherë në prashë... Qe, edhe unë po të thom se hoxhallarët janë prishë... nuk janë gjin... Po shka të ka faj ty zoti, pejgamberi, islamieti?... Kujtou pak se s'je axhamí! A e din se as dheu nuk e mban mbrenda! T'i përcjellim pleqt si i ka përcjellë dynjaja, e jo... Për vedi i grahim si t'na e pret mendja.

— Tybe, Kadri aga, na keshin hallki! Ndashta edhe nuk vjen kush me e përcjellë — tha kunata tue u marrue që foli.

Kadriu fshani dhe e suell kryet me nji anë.

— Hajt, bre kunatë, shka flasin hallku unë nuk çaj krye. E sa me e përcjellë — del kush, e dij unë.

Vllau e shiqoi i habitun.

— Kush të vjen?

— Vijnë shokët e mij. Tjerët n'dashin le të vijnë, n'dashin mos të vijnë. Për reakcion s'kam gajle.

— Reakcioni le të jetë reakcion. Reakcioni nuk ka kurrfarë lidhje me xhenazen. Simbas mendimit tand — krejt katundi kokanë reakcionarë! Askush deri sot s'e ka shtî kend në dhé si po thue ti.

— S'po thom krejt katundi... Unë po due me punue si më flet ndërgjegja jeme.

— Jo, si po thue ti nuk âsht e mundun! Unë shkova — dhe iu drejtue derës.

— Kadalë, kadalë ku po shkon? — e ndali Kadriu tue u ndryshue në fytyrë edhe mâ tepër.

Vllau u ndal.

— Na po çajmë dërrasa badihava, e xhenazja do të na jetë pa e shtî në dhé!

Kadriu e shiqoi ngultaz:

— Kjo nanë a âsht vetëm e jotja, apo edhe e imja?

— Edhe e jotja! — iu përgjegj Rrahimi me zâ t'ultë.

— Po baba që na vdiq mâ parë?

— Sa â konë i jemi aq edhe i yti.

— Pse, pra, atëherë kur vdiq baba, unë të ndëgjova ty? A e din se të kam ndëgjue edhe pa hatër të nanës. E ti, tash, — nuk po don me ndie! Qe shka po të thom: Erdh hoxha ose hoxhanica këtu, unë kam m'e lëshue shtëpín... As xhenazen s'kam m'e përcjellë.

N'at çast hyni drejtori i shkollës dhe tha me zâ të naltë:

— Puna âsht organizue si âsht mâ mirë. Rama muer përsipër që, së bashku me nji grup tjetër, m'e çelë vorrin. Marku dhe dy mjeshtra në kooperativë me marrë dërrasat. Vehbiu lajmroi disa që të shkojnë mes lajmrue miqt dhe motrën. Katundi e shokët e kanë marrë vesh këtë fatkeqësí. Mos u mërzitni! Unë po shkoj me krye edhe disa punë.

— Të falemnderit, shok drejtor — tha zymtë Kadriu dhe e përcuell me sŷ.

Rrahimi dhe grueja e tij shiquen njani tjetrin. Kadriu iu afrue së vdekunës, ia çoi çevren dhe e shiqoi. Tue u kthye tha:

— Shka po thue, Rrahim?

— Ti e paske sosë punën. Shka po pvetë? Veç po të thom — na e ke marrë fytyrën, në dynja e n'ahiret! Mos me mujtë njeri me dalë ndër shokë. Gjithmonë me më hangër dishka në bark. Mos me konë rahat!...

— Lemi mue ti marret e gjynahet!

— Të kofshin, bre vlla! — dhe shtoi me idhnim: — Mâ mirë mos t'isha konë gjallë.

Rrahimi u suell edhe disa herë nëpër dhomë.

— Shkova me dhezë oxhakun n'odë... Mundet me na ardhë kush.

... Në dhomë hyni nji tubë gra, plaka e disa të reja. Kadriu duel. Grát ia filluen vajit me zâ. Grueja e Rrahimit e shploi të vdekunën, e ato vijshin e shiqojshin me lot ndër faqe. Sa pushuen këto, erdhën tjerat. Edhe ato qajshin me zâ.

Prej katundit ku ishte e dhanun, ia mbërrini motra e Kadriut. Si hyni n'oborr bërtiti:

— Kuku, nanë, për neve, pse na le vetë! — e kur hyni në dhomë iu drejtue s'amës, u gjuejt mbi të dhe ia plasi vajit sa u tmerruen të gjithë. Së bashku me të qajshin edhe grát tjera që deri tash heshtshin dhe bisedojshin. Mbasi ajo nuk ndalej, e rrokën për krahësh dhe e larguen prej të vdekunës. Tash edhe ajo e ndali vajin me zâ.

— Akshami po afrohet— tha njana.

— A i keni bâ zâ hoxhanicës? — pyeti nji grue tue iu drejtue së shoqes së Rrahimit. — Zoti na ruejtë, po jet xhenazja pa u lá!

Ajo rrudhi krahët:

— S'e di. Kadri aga e ka marrë në dorë këtë punë. Hala s'âsht kthye.

Kadriu hyni në derë dhe thirri të motrën me dalë jashtë. Megjithëse edhe ajo kundërshtoi, mâ në fund iu mbush mendja mos me tregue gjâ haptazi — me heshtë e më ia lânë Kadriut vorrimin e nanës.

Tash, në kohën e dimnit, nuk ishte vështirë me i mbledhë katundarët. Gadi të gjithë ndodheshin nëpër shtëpija. Memzi pritshin me u largue prej poterës së fëmijve e përlamjes së grave. Veshë curruem, pritshin të ndëgjojshin se ku vinte ndonji mysafir, kush kishte ndonji zijafet, ose kush i thirr-

te në ndeje. Në vdekje, simbas adetit, merrshin pjesë edhe pa u thirrë. Këtê e ndijshin për detyrë, pse: „të gjithë kemi me kalue për këtê derë." Prandej edhe n'odë të Rrahimit, së shpejti, u mblodhën shum burra të katundit. Ndër ta erdh edhe Syla.

Disa pleq muerën abdes dhe falen iqindín. Biseda nuk shkonte. Edhe kur kuvendojshin diçka, fjalët silleshin rreth vdekjes në përgjithësí ose rreth të vdekunës.

— Â konë në vend të burrit!

— Sa keq m'erdh kur ndieva se diq!

Ndërmjet fjalëve ndëgjoheshin edhe pështpëritje të shehadetit e selavateve.

— Qe shka âsht dynjaja — tha Syla. — Kurrgjâ! Njeri i shkretë: hâ-hâ-hâ e dynjas në skaj nuk i dilet! Nji ditë po e zen veshin. Rrëno diqysh — shka po hapesh! Mos ban keq — dije se ke me dekë. Kjo dynja — Kurrgjâ! Ahireti âsht shka âsht. Atje mbetesh përgjithmonë! Ura — si tehi i shpatës... poshtë — vlon peshkëvja... Atje largë — xhehneti... hyrí... A ka mâ mirë se me dekë Turk — elhamdulilah — hiq pa shybe?!... Musliman i paqët...

Dhe përsëri — shehadet e selavat.

Tue i dhanë ujë nji plaku, ky e pyeti Rrahimin:

— A thue nuk koka këtu pari imami, a?

— Po, more, parzit e pashë n'udhë. Nëkoftëse jeni të pangae, po shkoj e p'e thirri, — tha Aliu tue iu drejtue Rrahimit.

Rrahimi u kthye kah kënata me tas në dorë.

— S'ka nevojë. E rregullon Kadriu këtê punë.

EDHE në shtëpí të Taf Sadikut të Moravës, për djalin e të cilit u dha Hajrija, ndodhën shum gjana prej ditës së dasmës e këndej.

Mbasi duelën të gjithë prej dhomës, dhandrri u çue për me ngujue derën. Hajrija ia lëshoi syt mbrapa — nëpër duvak — m'e pa se çfarë njeriu kishte marrë. Shpejt e tërhoqi shiqimin dhe i msheli syt. Iu duk se dikush i ra thikë mbrapa. Trupi iu tërqeth, zemra filloi me iu ligshtue. „A thue edhe këtë fat e paskëna pasë?" — tha me vedi. Burri tash vinte në drejtim të saj tue çalue randë në kambën e djathtë. I kreu disa adete, të cilave Hajrija nuk ua vuni veshin fare. Kishte humbë — me trup këtu e me mend kurrkund. Filloi me mbledhë vehten, kur ndigjoi nji zâ të përziem:

— D... d... d... da... dathëm!

„Po ky koka edhe belban?! Hajt mori, hajt!" — mendoi, sikur të donte me i thanë fatit të vet: „Edhe nji grimë në kofshë, largou prej meje! M'len vetëm... ta shof deri ku..." — dhe filloi me shkue hutueshëm. Qeshi si me u zgërdhi. Të qeshunit e saj flitte: „Çka po tallesh me mue? Kush je ti? Qysh u takuem kështu pa pritë e pa kujtue?... Të ndahem me të mirë!" Në ballin e njomë lëshuen hije dy rrudha. „Ku jam unë kështu? — Në shtëpi të huej! Për neve po bâhet gjithë ky gëzim përjashta?" — tha tue ndëgjue zhurmën e njerëzve, bumbullimën e tupanit, gumimin e defit dhe tingllimën e zurlës e të kangëve, që mbërrijshin në dhomën e saj.

„Kështu vlon edhe në shtëpin tonë... Shka muj me bâ tash? — kurrgjâ!" — përfundoi tue i krye padashtë adetet që kërkonte burri.

E ai kërkonte e dëshironte shum. Sikur kërkon e dëshiron nji bari që, prej vogjlis e deri në moshën njizetepesëvjeçare, ka shkue mbas dheneve nëpër fushë e male, tue u ushqye me djath, mazë e tamblë dhe tue pi ujë të ftoftë të kronit.

Të çaluemit dhe belbzimi e shoqnojshin prej fëminis. Por këto nuk e pengojshin me mbërri qëllimin e vet. Në mbramje dilte në rrugë dhe përzihej me njerëz. Nganjiherë shkonte edhe në konferenca. Në kooperativë blente gaz, krypë, sheqer. Kur shitshin ndonji delme, shkonte edhe në pazar. Fusha dhe mali i Moravës sikur t'ishin të tijat — e njifte pllambë për pllambë, dinte se ku gjindet dhe se e kujt âsht çdo arë e livadh. Bante tirqi e xhurdí. Mbas fejesës e ndërroi xhurdín me nji setër stofi të thjeshtë. Shkurt — ishte njeri i Moravës që i kishte mbërritë të gjitha e që i mungonte vetëm kjo. „Dhe qe — thonte me vedi — ajo për të cilën kam mendue aq shum, për të cilën nganjiherë më digjej shpirti — âsht këtu... mshelë n'odë... vetëm me mue... dhe po dishet me ra..." Lutjen e Hajris për m'e lanë sonte të qetë, sikur të mos e kishte ndëgjue. Nuk u mundue as me ia zgjidhë ushkurin atje ku ajo e mbante me dorë. Ia këputi me nji të kapun. Hajrija i mbuloi syt me shuplakë, e gjijt i

shtrëngoi me brryla. I erdhi kaq randë, si me i pasë ra shtëpija mbi krye...

— Më mbyte! — mbërriti me thanë.

— J-j-j-jo! — ushtoi dhoma.

... Tash çlodhej. Hajrija e mblodhi trupin e raskapitun dhe ia ktheu shpinën. Papjekunís së saj iu shtuen edhe vragët e këqija që i bani burri dhe neveritja prej asaj që i ndodhi pak mâ parë. Ajo nuk e ndieu at kënaqsí për të cilën kishte ndëgjue dhe mendue nganjiherë... Përsëri ra në mendime: „A thue jam unë? Unë, Hajrija?... A mos âsht kjo ndonji prrallë që e kam ndëgjue moti e tash m'u shtie n'andërr? A thue shka po më ndodhë mue? Mos më ka zanë ankthi?" Këto mendime e sulmuen prap, kur burri e kapi përsëri:

— Ha... ha... ha... la!

*

... Ditët shtyjshin njana tjetrën. Hajrija nisi me iu shtrue fatit.

„Vetëm mos t'ish topall! — thonte nganjiherë me vehte. — Mos t'ish belban... mos ta kish gojën e shtrembët!" — dhe qante tue pyetë vehten: „Shka bana keq me më provue i Lumi kështu? A s'e ngova nanën?... A s'e ngova babën... A kesh shpirtkeqe?... Pse mos me më ra hise bile pa ndonji behane në trup?"

Fshinte lotët dhe përsëri mendonte:

„Ndoshta po hŷ në gjynah?! Zoti e ka falë kështu... Zoti ka bâ emër. Ia ka shkrue këtij në báll, ma ka shkrue mue në báll: ju kini m'u marrë?"

Dilte prej dhome dhe zbritte poshtë. Merrte prej verigut kusín me ujë të vokët dhe ia lante Tafës kambët në legen. Merrte vedrën dhe milte gjânë, tamblin e linte në fllanik, dhe, shpejt kthehej në shtëpí. Nxirte bukën prej çerepit, e kruente dhe shtronte sofrën. Dhe — si hajshin darkë, shkonte nalt. Shtronte shtratin e Tafës të vjehrrës dhe zbritte poshtë. Ulej në shkamb dhe shukatte derisa Tafa thonte:

— Shkoni, bini!

Çohej pa zbardhë drita. Ndizte zjarmin, vente kusín, fshinte shtëpín dhe oborrin, milte gjânë — dhe hynte në magje. Hajshin mëngjez, dhe përsëri vijshin dreka e darka. Kështu — çdo ditë.

Burri nuk sillej aq nëpër shtëpí. Në mëngjez lëshonte dhentë e në mbramje i kthente. Rrogtari i qitte gjâtë e trasha e Tafa mirrte qet e pllugun dhe dilte n'ara për me mbjellë grun. Hajrija mâ tepër e kalonte ditën me vjehrrën, e cila ishte tepër e kënaqun „që ia pruni zoti këtfarë hyrije në shpí."

— Sí vidër e kam rén! — u thonte grave të kojshive e të katundit.

Nji natë, katërmbëdhetë ditë mbas ardhjes së Hajrijes nuse, Tafa i tha:

— Banu gadi, se nesër po të çoj s'pari!

Të nesërmen, tue shkue, kjo në kali e Tafa përpara në kambë, e porositi:

— Unë po të çoj, e ata le të kthejnë. Këtë hov ky nuk vjen me të marrë!

— Ani, bre babë.

Tafa tha atê që dëshironte Hajrija.

„Sa mirë u bâ!" — thonte me vedi. „Kish kalue java dhe, simbas adetit, kish ardhë ai me më marrë. Grát e fëmijt kishin me u lëshue tuba tuba me pa dhandrrin, e — shka me pá! Kishin thanë atëherë: ‚E mjera, pa nafakë'. Këtë hov s'po vjen e, mbasandej, zoti e din se shka bâhet!"

Te shtëpija, vetëm nanës ia tregoi atê që ia brente zemrën. Për këtê i kishte kallxue edhe nusja, por fjalët e Hajrijes e prekën thellë dhe i plasi vaji. U ndal mbasi Hajrija i tha ftoftas, pa ndjenja:

— Zoti ma ka bâ kismet.

E shoqeve të veta dhe grave:

— Kish pak behane... po për burr kjo s'âsht gjâ.

Java kaloi. Hasani e ktheu Hajrijen dhe muer gruen e vet. Jeta vazhdoi si ditëve të para.

Vetëm nji gjâ ndryshoi, që kjo nuk e pritte: i shoqi, si njeri që i njifte shum mirë dhent, hyni në kooperativë me rrogë muejore. Tash, së bashku me tregtarin e kooperativës, mirrte pjesë në ble-

mjen e dhenëve prej katundarëve dhe kujdesohej për to deri sa i shitëshin. Por, nuk mbaroi vetëm me kaq. Tregtari e shtini shpejt në kurthë. Kur i blejshin dhent, në dokumenta shkruejshin mâ tepër se sa kishin dhanë për to. Njiherë, ani, i shitën mbas dore njizetepesë krenë, e këndej e qitën fjalën se u kishte ra metili dhe kishin cofë. Tregtari i merrte dy e ky nji pjesë të fitimit. Kjo dallohej edhe në shtëpi: binte gjithnji mâ shpeshë — sheqer, oriz, kafe, llokuma. Kalin e keq e ndërroi me nji të mirë. Bleu pushkën për gjah. Dhent e veta të dobta i ndërronte me ato të mirat që i blente dhe i shitte. Edhe shtëpija i dukej e vjetër...

„Prej kurrkushit don me dalë dishka!" — mendonte Hajrija.

Po — kështu nuk zgjati shum. Nji ditë organet përkatëse u ranë në gjurmë. Burri u mshel dhe u dënue tri vjet burg. Kjo nuk e hutoi Hajrijen. Ajo tha me vedi:

„Hem po më dhimbet, hem s'po më dhimbet... Me tê mirë, pa tê ban..."

Tash u ngarkue edhe mâ tepër me punë. Posë atyneve të shtëpís, që i takojshin si grue, ajo filloi me kapë edhe ato të burrave. Ditëve të dimnit merrte koshin, shkulte me krahë sanë në mullar, e hidhte në shpinë dhe jua binte dhenëve në torishtë. Nganjiherë shkonte ndërmjet dhenëve, lëmonte dashin dhe ia shtrëngonte brinat. Tue u largue, ia bante:

— Byyyy!

Dashi çonte kryet dhe mirrte turr në drejtim të saj. Ajo shmangej dhe qeshte me zâ.

Prej se ishte bâ nuse, e sidomos prej se ia kishin mshelë burrin, ishin bâ shum ndryshime në trupin e saj. Tash ishte rritë e forcue. Gjît i kishin gufue me dalë prej këmishe, e vithet i ishin rrumbullue. Faqet — skuqë e syt i qitshin xixa.

Kjo i ra në sŷ Tafës.

Hajrija veshi fustanin që ia kishin pre së bashku me tesha tjera, dhe duel në kopsht me mbarue dy lehë për qepë.

Aty afër mbi nji cung rrinte ulë Tafa. Rrezitej në diellin e ngroftë të prillit. Tymonte duhan dhe mendonte:

„Na marroi zoti... Le që në burg, po edhe hajn!" Çoi kryet prej sikletit dhe i ra në sy Hajrija: „Na bani zoti çirak me tê!" — tha me vehte. „Edhe këtê e provoi zoti. Në mâ të mirën istinë — vetëm dy muej me burr. Burr..." — dhe përsëri e shiqonte. Tash edhe mâ tepër i ranë në sy vithet e kofshët e saj, për të cilat iu kishte ngjitë fustani. I shkoi syni kah kambët dhe — diçka i luejti në zemër. Por i largoi syt shpejt. „Mos jam trenue?..." U ngrit dhe shkoi në kopsht. Ua theu kumbullave disa rrema të thatë dhe përsëri: „T'i thom: boll ke punue!" dhe i qiti duert mbrapa e iu drejtue. Nji bylbyl këndonte atje në mollë pa prâ.

— Boll, bre bijë, u këpute! — i tha.

— Nuk jam tue i dhanë zor fort, o babë — u përgjegj Hajrija pa e këputë punën.

Tue i mëshue tokës me shatë — cicat e vogla e të shlirta ia rrihshin fustanin, që herë largohej herë afrohej.

U krrus pak, e mos po ia shef kund, nëpër grykën e fustanit, nisjen e tyne. U tërqeth dhe u largue shpejt. „Tybe istikfar!... Nuk jam në mend... E kam në vend t'evladit..."

Mbas do ditëve erdh vllai i grues së Tafës dhe e muer të motrën në të pamë. Erdh edhe Aliu me marrë Hajrijen për Shëngjergj, po Tafa nuk ia lëshoi:

— S'ka kush me na gatue.

*

„Nesër Shëngjergj e nuk ka lezet me dalë Hajrija në fushë. Po shkoj vetë!" — tha Tafa.

Atje, në livadhe të Moravës, tue shkelë nëpër bar të njomë e kpurdha të vogla, nxuer dy kunguj t'egjër. I shiqonte:

„Këto të madhin Hajrís e të voglin mue. Le ta bân nji varg të madh... Le ta varë... prej qafës e lugut të gjyksit... deri në shokë" — dhe i ra ndërmend ajo që ia kishte tërqethë trupin. U largue shpejt prej atyhit, si me pasë frigë se po e ndë-

gjonte ose po e shifte kush. I la kungujt dhe filloi me mbledhë lule Shëngjergji. Te nji therrë këputi dy hîtha të mëdhêj. Hypi tash në shelg buzë Moravës dhe, me mundim, i theu disa rrema të njomë. Të gjithë i mblodhi truq dhe u ul që të shlodhej. Me sy në hîtha, ndezi cigaren dhe filloi me e krue dorën aty ku e kishin djegë. „Kështu kanë m'e djegë edhe Hajrin, kur të lahet... cullak..." dhe, si me e nxanë vehten në faj: „Ej, allah, mos më shtin në gjynah!" Dhe prap: „Pse gjynah? Evlad?... Kush e ka bâ? — Bllatjanka! Pra — nuk âsht gjaku jem". I ranë në mend tash edhe ato fjalët që ia pat thanë ky Aliut dhe Aliu këtij, kur i ndërruen çikat mbas Kodrës së Madhe: „Gjaku jem, robi yt. Ia pashë hajrin!" Iu kujtue edhe ai rasti i Hoxhës së Cërnicës: „Me konë gjynah s'e kish kapë ai të rén... Parsija s'e lanë fajtuer." Dhe — thuese iu hoq nji barrë e randë. Shpejtoi kah shtëpija... Hajrija, tue zbukurue në mbramje derën e shtëpís me rrema shelgu dhe lule Shëngjergji, i tha kur e pa:

— Babë, po të zê dielli në shtrat nesër!

— Vokma ujin e bjerma në sobë heret — ia priti ky tue kalue pragun e derës.

*

Kur këndoi gjeli i parë, Hajrija u çue. Ndezi zjarmin dhe vuni kazanin me ujë në verigë. Ndërsa uji vokej, kjo preu kungllin. I bani disa rrotëza — si pesë dinarëshe — dhe i vargoi në pê të kuq. Mandej i hodhi në kazan nja pesagjashtë. Me ta qiti edhe disa rrema shelgu, lule Shëngjergji e fletë hîthash. Gjymsën e ujit e derdhi në kusí. Duel jashtë me kusí në dorë — dhe shkoi te kaqa, pranë gardhit. Atje, në terr të mëngjezit, u lá nën kaqë. Kur u kthye te shtëpija, e vari në qafë vargun me rrotuj të kungujve. U letue. Iu duk se mblodhi tanë shëndetin e botës. Kur ia çoi Tafës ujin nalt në dhomë — ai u rrotullue, u shtryq tue u zgërdâ:

— Unë po hŷ në hamam. Ti hajde pak mâ vonë... Fërkoma qet vironë shpinë...

Tue dalë, Hajrija mendonte: „Me ia fërkue shpinën?!... burrit cullak! A thue ka lezet?" — dhe

iu përgjegj vetvehtes: „Pse jo?" — I bani zoti çirak me at nuse. Edhe pleqt po i lanë si fëmín!? — iu kujtuen fjalët që flitshin kur e lavdojshin ndonji nuse të ré.

U kthye mbasi Tafa hyni në hamamxhik. Shpinën ia kishte kthye derës. Qëndronte galuc. Kjo i përvoli duert dhe iu afrue.

— Fërkoma qafën!

I qiti ujë me pocerkë, ia vuni sapunin mbi qafë dhe nisi me e fërkue.

— Oh, oh, oh! Fërkoma edhe shpinën, fërkoma...

Duert e reja, të ndihmueme prej ujit të vokët dhe shkumës së sapunit, ia nxên dejt e trupit dhe tash, tue u dridhë, bani me zâ t'ultë:

— Edhe pak mâ poshtë!...

„Ku mâ poshtë?" — mendoi Hajrija kur ai u kthye, e desht me e kapë për mjedisi — ia ngjiti për duersh. Hajrija u tërhoq me hov. Plakut i rrëshqitën duert e lëmueta prej sapunit. Grueja iku me zemër që i rrihte si zogut.

„Edhe kjo më gjet?! Unë: babë, ai: bijë... e tash: ‚pak mâ poshtë'! Deshti me më kapë... rrezili..." — dhe qeshi me vetvehte. „Nëkoftëse ka ardhë puna deri aty, ka tjerë... me ia durue jargët e tij, a?!... Burri, gjashtëdhetë vjeç!" — pshtyni — „Zoti e marroftë!... Po tash? Çka të bâj, e mjera? Kujt me ja mbushë mendjen?... Kanë me thanë: Asht bâ hajlaze — pa burr... Këtê nuk e ban burri plak!' — dhe ja plasi vajit.

Tafa zbriti shkallëve, ra n'oborr e duel nëpër kapixhik sikur të mos kishte ndodhë gjâ.

*

Hajrija i kreu punët, shkoi naltë në dhomë dhe u ul afër dritares. Ishte ditë e nxehtë. Asnji rê në qiellin e hapët dhe sorrat, me sqepat e hapun, s'luejshin prej hijeve. Prej vape ajo flladitej herë mbas here me mbështjellak dhe shiqonte në drejtim të rrugës që zgjatej si shiriti. Në tê i ra në sy nji udhtar që po vinte prej katundit. Para se me u afrue, ajo u shmang prej dritares — se mos ta shifte ai, e këndej e shiqonte edhe mâ tepër. Udhtari e

suell kryet anësh, e mbasi nuk pa njeri, iu afrue nji therre dhe bani nevojën e vogël. Hajrijen e tërhiqte dishka e fuqishme me pa donji mashkull të huej, e ky iu duk se ishte për tê. „A t'i ap shêj?" — mendoi. „Ndoshta kalon edhe ndonjiherë këtu pari..." Udhtari, sa iu avit shtëpís, kjo iu afrue dritares. Kur e pa mirë se ishte djalë i ri, u kollit dy herë. Ai ngriti kryet e ajo buzëqeshi. Edhe ai bani buzën në gaz dhe i rralloi hapat.

Pa pritë, nga ana tjetër e shtëpís duel Tafa me shat në krah. Shiqoi udhtarin e, mandej, të rén. Hajrija u largue shpejt prej dritares e udhtari vazhdoi rrugën.

Kur hyni në shtëpí, Tafa i dha vetëm dy shpulla.

Në mbramje, mbasi muel gjânë dhe e çoi tamblin në fllanik, tue u kthye, Tafa ia ngjiti për dore:

— Kur mundesh tjerëve... mundesh edhe mue!

Hajrija bërtiti e ai, i zemruem, ia msheli derën e fllanikut dhe briti tue shkue kah shtëpija:

— Plas, meçkë!

Vjehrra deshti me i ardhë në ndihmë, por ky nuk e la:

— Rri në vend! Po do me bâ herifja jaraní me hallk...

Hajrija bërtitte. Kur pushoi u ndie nji e krisme në fllanik. Kur erdhi Tafa — kishte çka me pa: Hajrija kishte derdhë tamblin, përmbysë qeberren e djathit dhe thye vegshin me tëlyen. E rroku të rén përkrahu dhe e pruni në shtëpí. Tue hypë naltë, nëpër shkallë, muer litarin e teshave dhe nisi me i ra. Kjo bërtitte tash prej dhimbjes me zâ edhe mâ të dhimbshëm.

— Shka âsht, bre Tafë! — bërtiti njani prej shtëpís së vet.

— M'u ka shpejda nji dhampir, oj!...

•

Stihija e ujit të Moravës së Binçës, si para bujqve të Bllatës, ashtu edhe para kolektivit punues t'ekonomís së kooperativës, shtronte detyra të randa.

Drithnat, orizi, tërfoja dhe duhani e kopshtet, që kishin përfshi pesëdhetë hektar t'ekonomís, po thuejse pa nda, ujë ose duhej me i mbrojtë prej vërshimeve.

Kadriu, i lodhun nga puna e natës, me shatë në krah, ecte ngadalë megjes dhe shiqonte orizin. U takuen me agronomin, i cili po vinte përbáll tij.

— Orizi âsht mirë, por kopshti ligshtë — tha agronomi seriozisht. — Ndoshta nuk ka nevojë m'i lëshue shum ujë orizit.

Kadriu bloi me vedi: „Me nji rendi po shet mend" — dhe i tha ftoftas:

— Më ka thanë nji bujk Maqedon se uji duhet me ndêjë në oriz dhe mbi bari. Në këtë mënyrë bari do të kalbet e orizi do të jetë i pastër. E... sa i përket kopshtit, qe ku je ti: udhëhiqna e na po ndërhyjmë për me e përmirësue gjendjen.

— Me të thanë të drejtën, edhe nuk e njof si duhet proçesin e prodhimit t'orizit. Në shkollë kemi mësue mâ tepër për drithnat... Sa për kopshtin gjendja nuk mundet me u përmirësue derisa kjo çashtje të mos shtrohet para kolektivit t'ekonomís, — dhe shiqoi Kadriun. — Shko në shtëpí, e shlodhu. Ke punue gjithë natën. Për sod ti e ke krye punën.

Agronomi shkoi kah duhani, n'anën e poshtëme, e Kadriut, ngadalë, erdhi n'anë t'epërme e u ul nën hijen e mollës. Deshi setrën dhe e la afër tue e bâ truq. U mbështet në tê dhe mendonte:

„Për ata që nuk kanë shkollë, zor me mujtë me bâ pak sefá! Kur ishte nevoja mâ e madhe me çue puntorë nëpër vendet e ndryshme, me bâ gjithfarë grumbullimesh, nuk kërkohej fort shkolla. Kur u bâ decentralizimi: „Ti, shok Kadri, je i vetdijshëm. Po duhet m'e paksue aparatin, m'e plotësue me specialista. Duhet m'u kthye në katund. Nëqoftëse atje nuk ke se çka me punue, atëherë shko në sipërmarrje! Na i dhamë zor, e bamë ekonomín në katund, dhe shokët më zgjodhën vetë për drejtor. Tash, përsëri, puna n'ekonomi duhet m'u zhvillue nën udhëheqjen e ekspertit të bujqësís! Kjo nuk më pëlqen, por kam vendosë me qenë i disciplinuem."

Biseda që po bâhej ndërmjet nji grupi të puntorëve t'ekonomís ia këputi mendimin. E ktheu kryet kah ana e poshtëme. Ndërmjet tjerëve pa edhe Markun.

— Mark! — thirri me zâ të naltë. — Hajdeni të rrijmë pak!

Erdhën Marku, Vehbiu dhe puntorë tjerë me shetën e drapna. U përshëndetën dhe u ulën.

— Çka pate që shkove në spital? U habita kur ndëgjova.

Marku e shtrëngoi shajkaçen mbi krye të mbështjellun me pëlhurë të bardhë:

— Pat ra shum shí, e unë, me dy puntorë e Vehbiun, hypëm në grazhd të jazit për me e shpërthye. Kishim frigë se po vjen ujë i madh e po'e merr orizin, kopshtin e duhanin. Kur e çoj kryet, kisha çka me pa — barijt kishin lëshue afër njiqindepesëdhetë krénë gjâ, të trasha e tima, në tërfojën e livadhet e ekonomís. Menjiherë thirra puntorët: „Mule, shokë, se na e faruen fushën!" Ata u larguen me vrap. Uji filloi me i hŷ vadës s'orizit. Tue u ngutë me hapë edhe nji pjesë të grazhdit, më rrëshqiti kamba, rash dhe — u meka. Kur më qiti Vehbiu në trap, e pa gjakun fytyrës.

— Taksirat! Qysh qëlloi me nji anë të krés hunit të madh, e me tjetrën gurit? — tha Vehbiu.

— Mirë që ke qëllue afër. Ka mujtë edhe m'u mbytë n'ujë.

— I sëmutë kam qenë mjaft — vazhdoi Marku — mirëpo — doktorët e fortë! Kur dola e pëveta se sa kam me pague. M'u përgjegjën: — „Asgjâ! Ti je i siguruem. E kemi marrë listën tande prej kooperativës." Njani që kish qenë sëmundë si unë — për shtatë ditë që ndejti në spital, pagoi gjashtëmijë dinarë! Ky sigurimi social ishte gjâ e mirë për fatkeqësit! Kur shoqnija kujdesohet për né aq shum, edhe na duhet me punue pa hile.

Nji puntuer që po ndëgjonte me kujdes, e që po i dukej se tash bâjshin hile që ishin mbledhë, tha, mbasi mbaroi Marku:

— Hajde, shokë, të çohemi se puna po pret!

U çuen. Ende pa shkue, Marku e pyeti Kadriun:

— A shtín kend në burg për damin që na banë n'ekonomí?

— Jo.

— Qysh, more jo?

— Milicija s'mujti me zbulue se kush ka hŷ i pari. Këta po thonë: Hynë do gjâ e u lëshuen edhe tjerat. Thamë — meraja e katundit."

— Mandej?

— Kanë marrë vendim me dënue secilin që të na paguejnë damin.

— A thue, kah shkoi agronomi, oj? — pyeti nji puntuer.

Marku iu kthye Kadriut:

— Kur ka ardhë? Kush na e çoi?

— Qe tri ditë, më duket. Shokët e këshillit të rrethit na e kanë çue si drejtor t'ekonomís.

Puntorët që bisedojshin ndërmjet vedit, i këputën fjalët dhe filluen me përcjellë bisedën.

— Edhe ju e pranuet?!... Mirë që nuk kam qenë këtu — tha, tue e sjellë kryet. — Nuk ka me na drejtue punën mâ mirë se ti, veçëse edhe nji mâ tepër mbi kurrizim tonë! Apo shitte mend?

— Edhe na e thamë këtê — bani njani prej puntorëve. — Mirëpo...

Kadriu shukati.

„Shokët po më mbajnë për t'aftë, — mendoi — të gjithë janë për mue. E ata në rreth nuk duen me dijtë për këtë! Ndryshe flasin e ndryshe punojnë. Pse nuk po e ndëgjojnë dëshirën e puntorëve? Sod âsht demokraci, — vetqeverisje!... T'u thomë: ‚Epërzunë puntorët. Po më duen mue!' E mandej, nji komision tjetër: 'Jeni primitiva... edhe prej këtij nuk duel gjâ!' — Nuk bâhet mirë. Nëqoftëse unë si udhëheqës i organizatës nuk i përmbahem vijës së partís — çka bajnë tjerët?" — dhe tha seriozisht:

— Ata naltë dijnë mâ tepër se na! A nuk na e spjegoi shoku i rrethit sepse na e kanë çue agronomin? Besoj se ai ka me na ndihmue që ta rrisim edhe mâ tepër prodhimin. Në këtë mënyrë kemi me shtue edhe t'ardhunat tona, — dhe e qiti buzën përjashta, si ai që dyshon n'atê që flet.

— Ti s'po ua prishë kurr atyne naltë! Po ia tepron nga njiherë me qat disiplinë! — tha Marku.

— Nuk po ua prishi se, as neve as popullit nuk po na del keq, kur po shkojmë mbas fjalëve të tyne.

— Mirë, mirë. Ta shofim, — tha Vehbiu dhe shkoi me shokë.

— Edhe sa ditë ke pushim prej mjekut?

— Edhe tri.

Të dy shiquen shokët që po largoheshin. Njikohsisht shiqojshin edhe punën që kishin bâ. Orizi rritej si kallami n'ujë. Duhani i kishte rritë fletët rreth kërcejve të vet si kali i mirë që merr rrugë me veshë të curruem. Shiqojshin tërfojën, kopshtet e livadhin, të cilat së bashku me orizin e duhanin i jepshin këtij vendi nji pamje të mrekullueshme.

— Lulishtë e kemi bâ këtë vend! Deri vjet â kanë shkretînë. Plot hurdha e baltë, djep sëmundjesh — tha Marku tue u ngritë. — Unë u çova se nuk jam kah e ndiej vehten mirë. Prap më ka rrokë kryet. Më duket si me më pasë dêjë ajri.

Kadriu nxuer gazetën e iu ngjit mollës me nji thupër, e pastroi prej disa krymbave dhe, prej së nalti filloi me soditë: nji shumicë prrojesh, me shpinën e tyne të vizllueshme, derdheshin në Moravën e Binçës dhe e shtojshin ujin e saj. E ajo, si ndojni ushtrí ngadhnjimtare, vazhdontę rrugën e vet nëpër fushën e gjanë dhe gjarpnonte kah gryka e Bujanovcit. Nëpër rremat e pemëve dhe shelgjeve të Moravës, këndojshin zogjt pa ia ndá. Mbi nji lis të gjatë qindvjeçar ku e kishte çerdhen — lejleku, tue cokrratë sqepin, e çoi kryet, sikur të donte me i thanë Kadriut: „Ngreje kryet e kqyr edhe mâ larg! Shiqoje Karadakun e Shkupit, Stubllovacën e Presedelin që duken si valët e detit. Shiqoje Sharrin me majen e Lubetenit, mbulue me borë dhe mjegullë të zezë, që i ngjanë anijes me tymin e zi për mbi që n'oqean, çán tallazet midis shkumës së bardhë."

— Ah sa bukurí! — i shpëtoi Kadriut. Mbet për nji kohë naltë dhe, tue zbritë, pëshpëriti:

— Athue vjen përnjimend?

Muer setrën e gazetën dhe shkoi te Shelgjit e Shpeshta afër Moravës. E shtroi setrën nën shelgun mâ të madh, ra mbi të, dhe — vazhdoi me lexue. Kanga e zogjve dhe utrina e lehtë e lumit, cicritja e karcyjve dhe farfuritja e krahëve të fluturave e kapitën, syt iu mveshën, gërmat iu turbulluen dhe duerët iu randuen. Ajri i pastër e vuni në gjum të thellë...

*

Qysh se e kishin fejue, të gjithë njerëzit e shtëpís së Sylë Hajdinit, thuese e përcillshin çdo lëvizje të Fatimes. Megjithatê, ajo kërkonte çdo mënyrë që të takohej me Kadriun. Shtëpijat nuk i kishin larg, por adeti i vendit që femna nuk mundet të takohet me mashkullin, përveçëse me atê që e ka të gjakut ose mik të shtëpís, ia zhdavariste çdo mendim që thurte. Shpeshë, tue mendue për këtê, nuk mbyllte sy deri në mesnatë e, ndonjiherë, deri në mëngjez.

Sa herë e kishte ndëgjue axhën Sylë kah bisedonte me Dautin për punën që bâhej n'ekonomín e kooperativës, për at kopilin, Kadriun, që u bâ shkaktar me e shti copën mâ të mirë t'utrinës së katundit në kooperativë. Ajo kishte ndigjue bisedën se si ishin marrë vesht disa të katundit me ia lëshue bagtín tërfojës dhe lëvadhit të kooperativës. Merrte me mend se Kadriu âsht tue punue atje, në fushë buzë Moravës, nji gjysëm ore larg katundit.

Në mëngjez erdhi Rabija dhe e lajmoi Fatimen se ia kishte krye dje porosín: Sod e pret Kadriu te Shelgjet e Shpeshta. Si me u takue me tê e mos me u hetue prej kujt? — ishte pyetja kryesore që e mundonte pa ndá.

Planin e përpiloi krejt lehtë. Syla dhe Dauti shkuen për pazar në Vitinë. Vllau i vogël ishte në shkollë. Nana e sëmundë rrinte në dhomë, ndërsa grueja e re e Sylës ishte magjetore. Kur bariu i pruni gjât, Fatimja i lidhi në torishtë e Bardhushen me viç i la zgjidhë. Tue dalë prej torishtës, gjoja harroi me e mshelë trinën e, mandej, shkoi te dera e oborrit dhe e hapi sa të mujshin me dalë

lopa e viçi. Vetë u kthye, hypi naltë në dhomë, u ul afër s'amës dhe vazhdoi me thurë çarapë.

Njerka e qiti bukën në çerep dhe e mbuloi me prush. Muer vedrën dhe duel me i mjelë gjât. Menjiherë i ra në sy se Bardhushja me viçin nuk ishin aty. La vedrën, hyni në shtëpi dhe u ngjit naltë.

— Bardhusha me viçin s'ishin aty!

— Boll keshe e lidha!

— Qite mafesin në krye, mbulou pak e shko shpejt me i gjetë! P'e zen polaku e burrat na qesin faret — i tha e ama.

Fatimja duel në dhomën tjetër, muer mafesin e bardhë dhe e qiti në krye. Mandej shkoi te arka dhe nxuer nji palë çarapë të larëm e nji marhamë të stolisun, i shtini ndën sjetullë, i mbuloi me nji pjesë të mafesit dhe duel.

Pak mâ poshtë, në prrue, e gjet Bardhushen, e cila rrinte afër ujit nën nji hije. Viçi e thithte pa nda. Fatimja e ktheu kryet n'anën tjetër, si me dashtë me e bindë vehten se nuk e pa dhe vazhdoi rrugën kah fusha e Moravës.

Tue u mëshefë ndërmjet shelgjeve e çubave buzë Moravës, i afrohej ekonomís. Kështu, pa vu ré, mbërrini edhe të shelgja nën të cilën flinte Kadriu. Kur e pa të shtrimë iu tërqeth trupi. U tërhoq disa hapa, si me dashtë me u mshefë mbas shelgjeve të vogla e të shpeshta. Zemra filloi me i rrahë. Mbeti nji grimë ashtu e shtangueme dhe mandej, tue shkelë lehtë e me hapa të vegjël, iu afrue. U ndal te kryet. E shiqoi me dashuni e përmallim. Kadriu i luente buzët në gjumin e randë për diçka. Fatimja u krrus dhe ia afroi veshin, po s'mujti me dallue asnji fjalë. Tue shique herë anëve herë djaloshin, e preku, tue ia dridhë lehtë krahun. Kadriu lëvizi dhe çeli syt. Kur e pa Fatimen përmbi krye, iu përvodh buza në gaz. U ngrit në kambë dhe shiqoi për rreth.

— Erdha me të pa, e me të thanë ... — tha Fatimja e hutueme.

— Nuk po mundem me besue se ke ardhë! A të pa kush?

Ajo uli kryet dhe e shtyni mafesin përmbrapa. Fytyra e bardhë dhe vetullat e gjata e të zeza, iu

skalitën mâ tepër. Çeli gojën e vogël tue luejtë buzët e holla e tue zbulue dhambët e bardhë e shiqoi ambël me syt e saj të kaltërt!

— Mos po të vjen keq që kam ardhë?

— Pse po flet kështu? Prej se më tregoi Rabija se do të vijsh as gjumin s'e kam bâ gjum! — i tha me zâ të ngrohtë.

— Mos bërtit fort se po na dikton kush! Dreqi na ha...

— Ulu pra, se nuk i bijmë mâ kujt në sŷ!

U ulën aty, nën Shelgjen e madhe. Mbi shelgjen tjetër, pak mâ larg, këndonte gëzueshëm bylbyli. Atje mâ poshtë, ku kishte blerue misri, cicrojshin karcyllat. Larg, n'anën e sipërme, ndigjohej tingllima e kumbonave të dhenëve dhe fyelli i bariut. Te grazhdi, poshtë tij, buçitte uji. Përmes fushës së gjanë, atje ku rruga e Gilanit zgjatet mâ tepër, farfullonte ajri prej rrezeve të diellit.

Të dy heshtshin. Thue se nuk kishin çka me i thanë njani tjetrit edhe pse shum ditë e netë e kishin andrrue këtë çast të lumtun. Kadriu fshani thellë dhe u mrrol. Fatimja shiqonte para vedit.

— Fshane si nana jeme.

— Nuk po të marr vesh.

Kjo u drejtue.

— Nji mbramje, axha Sylë dhe Dauti nuk ishin aty, e vllau i vogël flente. Isha tue ndejtë me nanën. Ajo ishte hala e sëmundë. E mora „Shëndetin" dhe fillova me e lexue. Kur e çova kryet me shique nanën që ishte ulë në shtrat afër dritares — shka me pa? I shkojshin lotët sa grushti. E lëshova revistën, kceva dhe e përqafova.

„Shka ke, nanë? Ku po të dhemb?"

Si ti kisha thanë — qaj edhe mâ fort. Vaji iu kthye në dënesë...

„Lem çikë se nuk kam gjâ!"

„Mos me pasë nuk kishe qajtë kaq shum. Nuk ke qa kështu as kur ka vdekë baba Hajdin".

„Tjetër ai e tjetër ti..."

U ndala dhe e pyeta vehten në hutim: A thue shka më paska gjetë?!

„Shka më ka gjetë, nanë që po qanë?

„Axha ta ka da dje vaden. Nesër dy javë ke me shkue".

Thue se më lëshoi toka. E lash nanën dhe fillova me u mendue. Më kaloi njifarë ngulshimi. Veç sa s'ja kisha nisë vajit.

„Shka me bâ, oj bijë? Qe shoqet tueja krejt u dhanë. Janë bâ me fëmi. Po më dhimbesh ti... I lumi ai që ka me të shti mbrenda. E mjera unë që po jes pa ty".

Më kqyrte dhe ma lëmonte kryet.

„Mâ mirë, bijo, dil në shtëpí tande. Boll ke punue angarije në shtëpí të huej. Ishalla edhe vendi âsht ashtu, si po thonë, e të ban zoti rahat!"

„Po pse, bre nanë, bile ti nuk më kallxove deri tash?"

„Shka kishe, çikë, me bâ?"

U mendova pak dhe thashë — tybe m'e lanë pa i thanë:

„Lum nana, a më don fort?"

Asaj, të shkretës, përsëri iu mbushën syt me lot.

„Due me të thanë dishka, veç, pash kryet e Hakís, nuk i kallxon kujt!"

„Jo, çikë, pasha kryet tand!".

„... Unë due nji djalë tjetër".

Tash Fatimja u ndal. Shiqoi Kadriun, i cili për gjithë kohën që foli ajo, nuk ia ndante syt.

— Fol de, fol — i tha Kadriu.

Fatimja u përbî. Shiqoi përsëri anëve dhe vazhdoi me zâ t'ulët:

— Nana më tha:

„Shuej çikë, a je trenue, a të kanë lanë mendët? Ku guxon bishti yt me dashtë kend. Dynjaja me keshë me né. Me na qitë në belá!"

Me këto fjalë, ma msheli gojën. Nuk dijsha shka me i thanë. Ajo nuk mujti m'u durue, zahere kishte qejf me dijtë për kend jam tue mendue.

„Kush âsht ai dreq?"

Njiherë nuk deshta m'i kallxue, mirëpo, nana...

Fatimja u ndal përsëri dhe uli kryet. Mandej tha ngadalë:

„Kadrija i mixhës Hysen" — i thash.

Kadriu luejti vendit dhe u skuq.

— Shka të tha ajo?

— Më tha:

„Mos gabo me çelë gojën kund! Po të ndien kush — vend nuk ke me pasë! Kanë me të mbytë" — dhe fshani sa edhe tokës me i ardhë randë.

Kadriu gjeti nji krande të thatë dhe filloi me luejtë me tê.

— Fshamja jeme paska qenë me vend. Tash isha tue andërrue.

— Shka andërrojshe? — e pyeti me kurreshtje.

— Thue se shkova te vorri i nanës. Diqysh ky ish shkatërrue. E mora shatin dhe e ndreqa . . .

Tash iu kujtue ajo letra anonime e fjalët që ishin bâ në katund për vorrimin e s'amës. E ndjeu të nevojshme me i thanë edhe Fatimes për këtë letër:

— Qe, para tri ditëve, çfarë letre pa emën kam marrë prej Gilani.

E nxuer letrën e përlyeme prej xhepit dhe filloi me lexue:

— „Lene që shpirtit tand nuk i ke lanë vend në dynja e n'ahiret, po plakën e shkretë pse e more në qafë? Nuk e le m'e shtie në dhé si Turki — me hoxhë e hoxhanicë. Pirolla të koftë se shum mirë ke bâ! Krejt katundi i Moravës âsht shahit se nanjote t'u çue dhampir. Taf Sadikut i ka hŷ në fllanik dhe ia ka bâ torishtë. I ka vikat nji natë në çardak me asi zani të shtiravtë si me pasë dalë shtatë kat prej toke. Katundit i ka hŷ friga prej asaj shtrige të coftë. Ti ndoshta po pret me t'ardhë edhe në shpín tande? . . . Edhe si dhampir të ka leçitë. Hiç mos e prit!"

E largoi letrën dhe e shtini prap në xhep.

— A p'e shef çfarë pisash ka? Do ta ruej këtë letër. Herë do kur do ndoshta i bij në fije. Rrahimit nuk kam guxue me ia lexue. Hala âsht idhnueshëm. Edhe ti, të lutem, mos e qit kund këtë fjalë.

— Zoti i marroftë, të pafytyrë! Për qetâ ti e paske pa at andërr.

— Nuk ta kallxova andrrën krejt . . . Kur e ndreqa vorrin, u ula me u shlodhë, e ti erdhe me nji tubë lule, ia vune te kryet dhe fillove me qá.

Unë t'u afrova dhe të rroka për krahu. „Mos qaj!" — të thash.

Heshtën të dy. Kadriu e shiqoi.

— Gjithmonë të kam dashtë, Fatime. Edhe atëherë kur ishim fëmij e vijshe nganjiherë me mue me dhenë. Edhe atëherë, kur prashitshin ditëve të gjata të verës dhe e shiqojshim njani tjetrin... e Prej darsmës së Hasanit, gjithnji të kam ndërmend. Lotët tu, që i derdhe kur më vdiq nana, më lidhën edhe dhetë herë mâ tepër me ty. Qave pse ajo ka qenë nana ime. Ke qa me ndá dhimbjen me mue... Ti ma ke rrëmbye zemrën... Unë nuk e di se si kisha me jetue pa ty?!...

— Ah, Kadri!... — i lëshoi duerët në krahnuer. — Po më dhimbesh ti, se për mue s'kam gajle! Ndoshta nuk do të na lanë me bâ jetë të bukur... Axha Sylë âsht boll njeri i praptë. Dauti i shkretë i mbet ndër kambë. Unë me hesap, nuk i kam ngja gjakut të tyne...

— Po:.. ti je tjetër njeri... Ti je për mue! — dhe u përqafuen me afsh.

Jo larg tyne u ndigjue kushtrimi:

— Oo, kapne, mos e lëshoni, bre!

Kadriu brofi në kambë. Shiqoi për rreth dhe i tha Fatimes, që tash ishte shtangue nga friga.

— Hec gërmuq e hyn nën ato rakita!

Dy vetë po ndiqshin nji femën, që vinte në drejtim të tyne.

Fatimja hyni në rrembat e shpeshtë të shelgjeve që mvareshin mbi lum dhe u mshef.

Femna që ikte, e mbushun frymë, me flokë të çthurun e këmishë dhe dimi të shkyeme në shum vende, ia mbërrini. Pa shique kujt po i bjen në dorë, sa e pa Kadriun, iu përplas nër duer:

— Pështom, bre vlla, pasha kryet tand!...

Kadriu ia ngjiti për krahu, ia çoi flokët që ia kishin mbulue fytyrën dhe e shiqoi në hutim.

— Hajrije, ti je, a?!

Kur ia lëshoi syt e njofti menjiherë. Tue e shtrengue me duer, i tha:

— Unë, Kadri. Mâ mirë mos kofsha!

Tafa e nji tjetër, me nga nji shtagë krryle të trashë në dorë, ia mbërrinë. Edhe ata të mbushun frymë e të lodhun, u ndalën. Tue u afrue, Tafa i tha grues si me ngadhnjim:

— Ku kujtove se po shkon? Të kam thanë se fluturë me konë, s'kí pështim prej dorës sonë!

— Mos afrohi! Më ka ra në dorë! — u kërcnue Kadriu.

Burri i panjoftun qeshi tue luejtë kryet. Çoi shtagën dhe iu drejtue Kadriut:

— Gruen e kujt po mban në dorë ti, bre, nanën e nanës ta luejsha!

Dy puntorë t'ekonomís me shetën në krahë, ia mbërrin. Kur e panë se ku qëndronte puna, njani prej tyne çoi bishtin e shatit, iu afrue shpejt burrit që shkonte kah Kadriu dhe i mshoi në dorë. Shtaga i pështoi në tokë.

Hajrija i shtyni mbrapa flokët e gjatë, i çoi duerët dhe, tue u drejtue kah ata dy që e ndiqshin, bërtiti:

— Qe ku jam. Mbytmni! N'at shpí nuk kam m'u kthye mâ!... Boll kam durue plot nandë muej! Ho sod, ho nesër!... — dhe u drejtue tjerëve:

— Merrni me mend, more vllazën. Le ta ha dreqi që kismet ma qiti burrin beter, belban e të shtrembtë si krandja e xhehnemit. Po me këta më ka gjetë edhe tjetra e ligë, edhe mâ e zezë. A p'e shihni këtë vjehrrin plak — dhe tregoi me gisht kah Taf Sadiku — e kam dijtë se jam shkue për nji burr, e jo për dy... Më ka mshelë njiherë gjithë natën në fllanik dhe më ka rrehë me konop të lagët. Hallki ndien bërtimën e ky u thojke: „M'u ka shtirë nji dhampir!" dhe e pështyni prej së largu. — Zoti të marroftë! Burri plak...

Ndërsa flitte Hajrija, Taf Sadiku rrinte krye ulë, i mbështetun për shtagë:

— Po don me ma marrë fytyrën, a?

Ai tjetri filloi m'u largue me hapa të vegjël, sikur të donte me thanë: Unë s'e kam dijtë këtê... Të tjerët herë shiqojshin Hajrijen, herë Tafën.

— Edhe kjo paska ndodhë? — tha Kadriu me zâ t'ultë tue luejtë kryet dhe u kujtue:

— E hë! Ti qenke ai dhampiri për të cilin flitej? ... — e, tue ngrit zanin: — Shkoni në shtëpijat tueja. Nëqoftëse kjo u ka hak, qe ku âsht gjyqi!

Me hapa t'imtë, këta nisën me u largue.

— Ju dy, shokë, merrnje këtë grue e çonje te Aliu!

— Zoti të ndihmoftë! — tha ajo dhe u nis mbas tyne.

— E ty — a p'e shef sa mirë të ka ndihmue zoti?!

— Jo, për mue të shkretën nuk kish pasë zot, — tha Hajrija tue kthye kryet mbrapa.

Zhurma u ndal. Kadriu shiqoi për rreth dhe u nis kah Fatimja.

— Dil se shkuen! — i tha ngadalë.

Fatimja ndigjoi për fatkeqësín e Hajrijes prej gojës së saj. Nëpër rremat e shelgjes së shpeshtë, rreth ujit të kaltërt të Moravës, e shiqoi me syt e vet këtë sqenë tragjike. „Fatin tem kam m'e mbajtë në duert e mija!" — tha dhe duel tue qá.

Erdh në vendin ku ishin ulë mâ parë.

— A e pa? A e ndjeve shka tha?

— Mâ parë kam m'u mbytë në bunar se me shkue atje ku më kanë fejue!

— Pse m'u mbytë? Kur të mbushet mendja, hajde te unë. Jam tue fjetë në pleme. Le të bâhet shka të bâhet. Hû në gardh mos mbetët!

Ndëgjohej jehona e kangës së „Hasan Agës" që po e këndonte nji bari dhe e përciellte tjetri me fyell.

... Kokanë lidhun besë m'besë...

Ia zgjatën dorën njeni tjetrit dhe, tue i shtrengue fort u shiquen me dashuní:

— Besa?

— Besa!

Çika i nxuer prej shervetes, nën sjetullë, çarapët e marhamën dhe ia dhe shpejt.

— Shkova, se lopës nuk i ka mbetë asnji pikë tambël!

Ndërsa largohej, u kthye edhe dy herë. Nuk guxonte me bâ me dorë, kishte frigë mos po e shifte kush. Kur u kthye herën e fundit tha me zâ t'ultë sa Kadriu mezi e dalloi:

— U pjekshim për të mirë!

Ende pa humbë në largësí, Kadriu e shiqonte gjithnji i mbështetun për shelg.

NXEHTËSÍ e madhe. Bllatëjanët mbushnin misrin e vyshkun. Prroni kishte shterrë — kroni vetëm sa pikonte. Atje largë, në Moravë, gjâja pijshin ujë. Duhani ra për toke, filloi m'u thá. Deri në drekë edhe dita e sotme ishte si tjerat. Atëherë, bashka e bardhë e rêve mbi Lubeten filloi me u zgjanue. Me tê u bashkuen edhe disa rê tê zeza që duelën prej anës së Karadakut të Shkupit dhe Prezedellit. Qielli filloi me u mbulue. Rêt grumbulloheshin edhe mâ tepër. Njiherë naltë e dikur edhe poshtë, u errsue. Njerëzit çojshin kryet dhe shiqojshin.

„Don me na bâ zoti çirak. Ta shofim njiherë si po njomet toka, si po ushtojnë prrojet, si po gurgullon kroni si përpara — si po e shuejnë etjen arat e livadhet tona bukëdhanëse..."

Rêt ishin randue — thonte njeriu se do të shembet toka. Shkrepi vetima dhe, mbas saj, krisi.

— Mâ mirë m'u shmangë. Kushedi se shka don me u bâ?!

Ata që ishin në punë largë katundit, u strukën nën kunorat e pemëve. Këta afër, nepër rigën e parë, erdhën te shtëpija.

Po, së shpejti ia filloi nji erë. Rêt nisën m'u shkapërderdhë. Bllatëjanët nuk e pritën atê që shpresuen: shiun.

Qielli u kthjell në perendim. Në lidhje mbetën edhe disa rê të holla. Dy ylbera lakoheshin atje, nga ana e lindjes — njani afër tjetrit. Dallndyshet gadi pa ndá fluturojshin mbi tokë, mu rrugës kah ecte Kadriu me duer në xhepa. Mbasi u përshëndet me dy kalimtarë, u ndesh me Markun, i cili vinte nga ana e kundërt.

— Na ka kënaqë! — tha Marku me ironi.

— S'po don.

— A din çka kam ndigjue?

— Çka?

— Nji vajzë kish dalë me prashitë, e njifarë njeriu kalon pranë saj dhe i thotë: „Shko te shpija se me nji rendi ke me vdekë." Ajo shkon në shtëpí, dhe — sa mbërrín — vdes. Në shtëpí fillojnë me e vajtue. Mâ shum qante e ama. Kur e bâjnë gadi për vorrim, ajo çohet. Ata, që ishin bâ gadi me e përcjellë, hutohen e disa ikin. „Kadalë, ku po shkoni?" — u thot çika dhe i drejtohet nanës së vet: „Pse, bre nanë, kajte aq shum? Nuk më le me ndejtë deri në fund. Shkova në konferencën e diellit me hanën. Dielli i thojke hanës: „Krejt kam m'i djegë se po më shajnë pa ndá!" e hana e qortoi: „Mos u ban edhe ti me mend të tyne!" dhe pushuen. E pritshin zotin me ardhë e me i dhanë fund konferencës. Ju ia nisët vajit dhe unë u detyrova me u çue."

Kadriu qeshi me zâ.

— Sa bukur e paskan thurë!

Qeshi edhe Marku.

— Dje, kur nana u kthye prej kishe, ma kallxoi këtë prrallë. Kurrqysh nuk mujsha me e bindë se kjo âsht prralë që e ka qitë vetë popi... Po, nejse... Pse më ke thirrë, Kadri? Kallxo!

— Hajde të mbështetemi këtu e të bisedojmë pak.

U ulën galuc afër murit që çohej buzë rrugës, nga të dy anët.

— Diçka na u ka turbullue situata në katund. Asht përhapë njifarë parolle e keqe. Po thonë: „Krejt Shqiptarët do të shpërngulen për Turqí."

— Unë s'kam ndigjue gjâ!

— Unë i kam ndigjue disa fjalë. Por, me të thanë të drejtën, nuk ua kam vû veshin. Thash: i merr era! Si kanë ardhë ashtu edhe shkojnë.

N'ato fjalë, ia mbërrini Rama.

— Qe, pëvete edhe Ramën...

Rama u përshëndet e, tue qëndrue në kambë,

— Çfarë derti po qani?... Shka keni ra mazun? pyeti:

— Kem tue bisedue për at që ma the ti para dreke.

— Ku e din ti se edhe në katundin tonë po flitet për shpërnguljen e Shqiptarëve? — pyeti Marku.

— Unë në Shkup e po e njof gjendjen e katundit mâ mirë se ju! — tha Rama tue qeshë dhe vazhdoi:

— Kur e lamë punën dje dola në „Bit pazar", kisha me u takue me nji shok... — dhe i shkoi buza në gaz. — Dojshim me shkue në kinema.

— Pse s'po thue shoqe? — qeshi Kadriu.

Sa shpejt u bâ ky me shoqe, se — tha Marku.

— Qe motmot e mâ tepër që po sillet aty pari. Sa ta blejë edhe shtëpín e as dimnit nuk kemi me ia pa syt në Bllatë!

— A âsht e mirë, ej? — pyeti Marku.

— Lene këtë muhabet!... Ndigjoni shka po ju thom.

I shtini duert në xhepat e pantollonave të ri dhe u mrrol:

— Kur dola në „Bit pazar", qe Dauti e Alija. Sa më panë, Dauti iku e Alija erdh me u përshëndetë. Unë e pyetësha dishka, e ai — si me qenë i pîtë.

„Fol, baca Ali, i thash, — shka ke? Ti e din se kurr nuk ta kam deshtë të keqen" — e ai shiqoi rreth e përqark dhe m'u afrue te veshi:

„A e din ku e kanë vendin do afkat që po shkruejshin arzuhalle për me shkue në Turqí?"

Nji djalë i ri, që sillej aty pari, e ndigjoi Aliun dhe iu afrue:

„A mos po don, mixhok, m'u shkrue për Turkí? Për pak pare muj me ta mbarue arzuhallin . . ."

„Po kjo tash?" — thash me vedi. Alija, herë më kqyrte mue herë djalin.

„Eja me mue, baca Ali, se unë ta ndreqi punnën" — i thash.

Kur u ndamë prej atij djalit, e pyeta:

Çka âsht kjo? Pse nuk-po më kallxon? Pse po tutesh prej meje"?

„Shih, bre bacë! Ti je konë gjithmonë shum djalë i mirë. Prej teje nuk kam shka mshefi. Asht dalë, atje tu na, njifarë fjale. Po thonë: — Krejt Shqiptarët do të dalin në Turkí! Aftakët në Shkup, hiç pa ia da janë tue shkrue arzuhalle. Kush shkruhet mâ shpejt, merr vend mâ të mirë. Erdhëm me pa a âsht esah kjo, a jo . . ."

Ma shtini frigën. Thash: Shka u bâ kështu? edhe e pëveta:

„Edhe Dauti, ka ardhë për këtë punë, a?"

„Me hesap ai ka ardhë me ble dishka. Po . . ."

Hymë në nji kafe. Ia porosita nji çaj dhe i thash:

„Rri ti këtu e pritëm. E njof nji shok të komitetit të Shkupit dhe ai ka me më kallxue se si âsht puna".

Kur u ktheva, Aliu s'ishte në kafe. Prita nji kohë, e posa u çova me dalë — ai u kthye. Si duket kish qenë tutë mos po ia bâj ndonji ngatrresë.

Kadriu e Marku qeshën.

— Prap u kthyem në kafe — vazhdoi Rama. I tregova:

„Ai shoqi, që bisedova me tê âsht njeri i madh dhe i dijshëm. Më tha: ‚Këto fjalë nuk janë të vërteta. I ka qitë anmiku. Thuenju njerëzve që të mos mashtrohen. Kanë dalë nëpër Shkup do hama-

dreqën e p'i mashtrojnë gjindën. Po u marrin pare badihava . . . '

Aliu më ndigjonte me kujdes. I thash:

„Nëqoftëse më ndëgjon mue, ktheu e shko në shtëpí. Hiqu këtyne punëve!"

„Po dal e p'e lypi Dautin. Me të parin pampur, nëkoftë kismet, po i lëshohemi udhës së frengut kah shpija. Edhe mue po më duket se nuk âsht gjâ kjo punë. Mâ mirë se e dijnë gjindja e hyqymetit s'e din kush!"

— Kështu ngjau në Shkup, — tha Rama. — Si zuna besë Aliut e thash të vij vetë në katund. Mirëpo, edhe këtu ishin mbushë me këso fjalësh. Bile edhe nana më tha: „Krejt katundi don m'u shkrue". E baba: „Mbasi je në Shkup, kqyr kryje këtë punë." Merret vesh se ua mbusha mendjen . . .

Tasa, kuriri i këshillit komunal, qysh së largu, bante me dorë, e kur u afrue i tha Kadriut:

— Të lypa n'ekonomí . . . të lypa në shpí . . .

— Hë, shka ka të ré?

— Qe nji letër prej sekretarit të Komitetit të komunes.

Kadriu e hapi zarfin. Në letër shkruente:

„Kadri, nesër mbrama duhet me bâ mbledhjen e organizatës së Lidhjes së komunistave. Në rend të ditës me vu çfaqjet në lidhje me shpërnguljet e Shqiptarëve për Turqí. Përgatituni për këtë mbledhje sa mâ mirë dhe me gjana konkrete. Me mue ndoshta vjen edhe ndonji shok prej komitetit të rrethit. Kam marrë vesh se edhe komiteti i rrethit këto ditë ka me mbajtë nji mbledhje në lidhje me këtë çashtje."

31-V-1954 *Të fala*

Stojani

— Mirë plak, shko!

— Shkruma njiherë në zarfë se e more letrën. Nuk punon mixha në hava!

Të tre qeshën, e Kadriu shkroi nji gjysëm rreshti në zarfë. Kuriri shkoi.

— Po më shkruen Stojani se nesër mbrama duhet me bâ mbledhjen e organizatës së Lidhjes së komunistave, mu për këtë çashtje. Prandej ti, Mark,

lajmro Vehbiun dhe Dragutinin, e unë po u bâj zâ shokëve që i kemi pranue frik në partí si dhe Dautin. Mbledhjen po e mbajmë në sallën e bibliotekës, mbas darke. Thuej mësuesit le të shkruej edhe njî pllakatë për këtë mbledhje. Rendi i ditës: çashtja e shpërnguljes për Turqí...

Rama dhe Marku shkuen sokakut përpjetë e Kadriu u kthye rrugës kah kishte ardhë.

Qielli kishte nisë me u kthjellë. Atje kah lindja, ylberat gadi ngjitë njani me tjetrin, zhdukeshin. Rrezet e diellit që depërtojshin nëpër të çamet e rêve në perendim, flakruen me tanë fuqín. Prej dritares së shtëpís dykatëshe, midis dy plepave, nji tubë rrezesh i ra mu në sy dhe u zhduk. Mandej prap dhe prap... Kadriu shiqoi kah burimi i dritës dhe, atje në çardak, pa Fatimen. Ajo ia lëshonte dritën me pasqyrë tue i dhanë shêj. Kadriu ia bani me dorë. Fatimja nxuer letrën prej gjinit dhe i dha me kuptue se ishte për atê, por nuk mundej me ia dhanë.

N'at çast prej derës s'oborrit duel Syla dhe u ul aty afër, mbi nji gur të madh rranzës murit.

SHKO në sobë të njerkës e flêj. Ai më tha se vjen sonte m'i ndërrue teshat — i tha nana Fatimes mbasi hangrën darkë.

— E njerka ku âsht

— I erdhën të vetët, çikë, dhe e muerën. Ajo ka darsëm: edhe katër ditë po e marton vllán... E ti — po rrin si mos me pasë me ngjitë bojën nesër! U thash hallave me të lanë rahat. Shko e pusho edhe sonte.

— E axha Sylë e Dauti... Ku shkuen?

— Erdhën do gjindë n'odë.

Fatimja e shiqoi t'amën, si ai që don me ndërmarrë ndonji hap të guximshëm në jetë e vet e nuk âsht i sigurtë se a do të fitojë.

— Natën e mirë, nanë!

— Të mirë e bafsh, bijo!

Kur hyni në dhomë, e ndezi llambën, mbylli derën dhe e hodhi jorganin në shtrat. U ul afër dritares, tue u mbështetë në jastek. Shtini dorën në gjî dhe nxuer letrën që prej çardakut deshti me ia lëshue Kadriut. E shiqoi, u mat me e shkye dhe u ndal. E shtini përsëri në gjî. „Le ta shofi se sa e due!" — përshpëriti tue mendue n'atê që kishte shkrue." Edhe unë u mësova me shkrue, nuk jam e pagëdhendun!" U çue dhe filloi me u endë. Shkoi te dollapi. I ra në sy fletorja e lapsi. „T'jau la ndonji shêj." E shkeu nji fletë, muer lapsin dhe u ul. Me gërma të shtrembta filloi me shkrue:

„Të dashtunit e mij . .."

— Kush të dashtun? — pështëriti dhe i ra vizë. Mandej shkroi:

„E dashtuna nana jeme. Gjithmonë të kam ngue. Njimij e njiqind herë të koftë hallall. Shum të lus që edhe ti të ma bâjsh hallall. Falem që nuk të ngova ty dhe tjerët në shpí për me shkue atje ku më keni dhanë. Mos e bani kabahatlí Kadrín. Unë e kam dashtë gjithmonë, jam zie në vedi, e nuk kam guxue me i thanë kuj. Edhe atíj nuk kam mujtë me ia shplue zemrën. Por, na a kemi dhanë besën njanî tjetrit. Sonte po shkoj te ai. Mâ mirë me bâ kështu se me më gjet si Hajrijen e shkretë. Edhe Kadrija më don shum. Sa gjindë të mirë do t'ishi sikur të na lêjshi rahat. Mâ së mbrami, mâ mirë dy ditë si duhet se gjithmonë në terr.

Nanë, ty ta marr dorën, e banma hallall!

Fatimja

Tash kërkonte rasë me u largue. E mbështolli letrën dhe shiqoi nëpër dritare. Prej odës, ngjitë me katin e poshtëm të shtëpís, ndihej nji zhurmë jo aq e madhe sa e gjallë. Nëpër dritare dalloi disa njerëz të njoftun. E fiku llambën. „Le të mendojnë se po flêj" — tha dhe filloi me ndigjue me kujdes se çka po flitej.

... Biseda kryesore bâhej në lidhje me shpërnguljen e Shqiptarëve në Turqí. Përveç të zotit të shtëpís, aty merrshin pjesë edhe Stanku, si mik i vjetër i Sylës, hoxha, nëpunësi i komunës, që ishte

përjashtue për qëndrimin në lidhje me IB-en dhe Aliu, së bashku me pesëgjashtë kojshi të Sylës.

Dauti, mbështetë në gju, mbante në dorë tabakun e letrës dhe lapsin. Në heshtjen që mbretnoi, tirej hollë peni i mendimeve. Mendimeve të ndryshme — të përbashkta e të kundërta...

„Qe, këtu janë rritë: baba... babëgjyshi... katragjyshi... e përtej. Këtu jam rritë edhe unë — këtu po rriten edhe fëmija jonë. E tash? — erdhi dita me thanë: elvidá vatan!; elvidá: shpí... e oborr... e kodra... e ara!...; elvidá: pemë... e prrcje!; elvidá: bylbyla të hareshëm dhe ju kajusha fatbardha... dhe ju bretkoca e prronit të Bllatës..."

Zemra shtrengohej, syt njomëshin. Po... u dukej se po u shkulej dishka prej fundit të zemrës. Dhe përsëri e ndezshin cigaren tjetër. Heshtnin dhe vazhdojshin me mendue, tue kqyrë me fytyrë të vrantë para vedit.

„Shyqyr zotit që po çohemi të gjithë. Mos me t'u kallë bile zemra për dost e jaran... për mik e dashamirë... për motër e çikë..."

„Vatan? Çfarë vatani, kur Turku s'e ka në dorë! Din? Dini me dindushmana, a? Po... idarja...? Në mall tand po t'përzihet:.. E ka çue rrogtari kryet si dash. Hup, asgjâ mos të dhimbet!"

„Edhe unë duhet me shkue — çka me bâ vetëm? Eee, ishalla âsht rrenë! Mund të jenë fjalë t'erës. Kur jam konë mâ mirë se sod? Idare orta, po... lirí sa të duesh... shka tjetër? A thue vetë po duem — apo hyqymeti po na çon me zor?.. Me konë me zor, pse jemi mbledhë këtu tinza? Asnjâ prej udhëheqësave, asnjâ prej hyqymetit. Ishalla s'ka me u bâ gjâ — badihava jemi tue shkrî mend..."

Heshtjen e preu zani i ultë i Sylës:

— Shka muerët vesht në Shkup, Daut?

— S'e dij, valla... qe Alija le të flasi — tha Dauti tue rrudhë krahët.

Alija u gjunjzue i hutuem. Shiqoi Sylën e mandej i përfshiu të gjithë:

— Nuk âsht, bre vllazën, esah kjo që po flitet. Këto ishin fjalë të badihavxhive e t'atyne që nuk janë për këtë ditë — tha pa u mendue shum.

— Po mirë, qysh e more vesht ti këtê? — pyeti Syla me ironí.

— Qysh e mora vesh, a?... Zateta Ramën, po punonte në Skhup e ai shkoi te nji njeri i madh, i mençëm dhe iftibarlí. Ai i kish thanë kështu:

Stanku dhe Syla u shiquen.

„Shka po flet ky?" — mendojshin të dy e Syla tue përqeshë tha:

— Na i çuem kishe me na prû ndonji havadis të ri, e... këta paskanë shkue te ai lahperi! Përzo, s'kam diitë që jeni kaq budallë... — bani tue i zgërdhi dhambët.

— Unë i pash do tue u shkrue...: po — Aliu më tha: „Edhe këta po shkruhen badihava" dhe kështu u kthyem — çfajsohej Dauti.

„Nuk âsht gjithkush për kësi punësh" tha hoxha me vedi.

— E, kuku për ju! Edhe grát janë tue folë se shkuem për Turqi, e këta — hala shybelí!... Ngoni këhâ, burra, shka po ju thom: — i zgurdulloi Syla syt tue u çue në gjûj — kuj s'i dhimbet vatani? Mirëpo, apo e shihni se këtu nuk ka jetesë për neve. A na i muerën dhí? e na e lanë bukën that? — Po! ta ka vû kanarin edhe në mal tandin e le mâ në të vetin? — Po! E n'anën tjetër — a t'i ka vû ka katër poreza në mot?... Jo, jo — nuk janë budallë dynjaja qi po shkruhen! Atje po të jep me nji rendi ka gjashtë hekterë tokë, shpín me plan, me ujë dhe elektrik, nji pendë kije... shka po lyp mâ tepër? E kjo — e sakt! Dje, në Vití,folshin ashiqare në pazar. Ai kushrini i Mogillës më tha: „Hala po pritni, a?" Vallahi m'erdhi inati! Katundi jonë â konë gjithmonë i pari për çdo gjâ, e sod me mbetë i mbrami!...

— Â konë kur â konë — tha Stanku. — Â konë kur ka pasë të parë. E sod kend po ma zen të parë? Përzo edhe vetë e kam sosë m'u çue prej katundit! Tokën e kam bâ pazar, e nesër nji javë njani vjen me e pá edhe shpín...

„Këta nuk më keqkuptojnë ndoshta?" — mendoi e tha ngadalë:

— Juve që jeni këtu, me anën e Sylës, ju kam ndihmue... Pra — nuk kam kurrfarë frige prej jush. Ju beli nuk jeni si Shqiptarët tjerë. E muj me ju thanë pa shybe se këta të mëdhajt kishin vendosë në Berlin me nda Jugosllavín. Kush dreqi e din se kush vjen këtu: Shqipnija e Bullgari me Rusín, Krali me Inglizin e Amerikën, nuk dihet... po — pale, pale...

— Njeri i mençëm! Mendon fellë — bani ngadalë njeni.

— Mirë e ka gazda Stank — tha Syla. — Po flet për të mirën tonë. Ky vend nuk ka kapërcye kurr pa luftë. Asht si lisi në derë të farkës: kush çohet mâ heret ia mshon. Ai që vjen, kqyr a iu ka topitë e — shkllapë sakicë! Ai që del, gjene, kqyr a iu ka mprehë mirë, e — vapë! Kur t'i kqyrësh, ky bam ai bam: Bugari këndej, Gjermani andej — thiu e i biri — na mbaruem.

Njerëzit pohuen me krye. Syla përfundoi:

— Turqija âsht usta, bre vlla. Le të bâhet shka të bâhet, atje — rahatí.

Stanku i rrudhi syt e vegjël:

— Na, bre kojshí, jemi dy milete. I kemi dy fé. Nuk po thom se nuk mujmë me çue njifarë jaranije me ndokend. Mirëpo, qysh po thonë e qysh po donë këta: vllaznim, bashkim, m'i prishë të gjitha hudutet — nuk shkon. Unë nuk jam kundër Shqiptarëve. Qe, Sylën dost mâ të mirin. Po, nuk mund të bâhemi të gjithë nji — e tue i ra në mend se edhe vetë Serbët s'çajnë kryet për tê, dhe se nuk e pyet kush për kurrgjâ, tha me dëshprim:

— Tash i ka hangër dreqi edhe këta të mijt. Edhe ata janë prishë! Çfarë Sërbjani kur nuk e mban sllavën, nuk shkon në kishë, nuk pagzon fëmijt dhe nuk kërshmon. Lej këto, — po ata që janë konë nën kambë teme, tash po duen me më sundue... Nuk po muj me i bajtë dhe qe! Më lodhen, ej! Mâ mirë po shkoj atje ku nuk më njef kush, ku nuk njof kend dhe ku âsht krejt nji milet — dhe iu duk se u nda se shkoi... iku... — Por, shkuem ku shkuem, me ty aga Sylë, kam me

mbajtë lidhje gjithmonë. Më shkruej ,e kam me të shkrue.

„Njimend tjetër fé e tjetër milet, po burrë katërqind derhem!" — tha Syla me vehte e mandej me zâ:

— Aaa, besa të koftë se si të mbërrí n'Anadolli, të parën letër kam me ta çue ty!

Tue ndezë cigaret shiqojshin njani tjetrin si miq që kishin kalue shum vjet e tash bâheshin gadi m'u nda me të mirë. Ndamja u dukej krejt me vend: dy fé, dy milete...

Ndërsa flitte Stanku, hoxha luente në vend tue njehë tespihët. Mendonte:

„Xhehneti... për kend? — për mysliman. E kush â mysliman? Ai që ninon ramazanin, që falet, shkon në haxhillëk, ep zeqat, bje shehadet. Apo i ban kush këto? — Krejt pak. Këtyne here menxi e pritshim bajramin. Mâ e mira hae... mâ e mira teshë... mâ i madhi gëzim... Barazoje tash bajramin me nji majin. Njiqind të vjetër... njiqind e mâ tepër të ríj... e jo me ardhë në xhamí e me ngue dishka për ahiret, po ia krisin haes... pijes... kangës... lojës... Le pula e pite, po ku i muerën njizet kingja?!... Allah, allah!... E pse atëherë kur e pa punën kështu nuk i pështove myslimanët? — do të më thot i lumi — Pse?!

Kur Stanku mbaroi, hoxha ia nisi si me dashtë me u çfajsue para zotit:

— Njeri jeton për fé, për erz, për namuz. Kurrkuj nuk p'i thom: lëshoje fén tande! Mirëpo, edhe në fén tonë mos të na prekin. Nëkoftëse edhe ndonji ditë rríjmë këtu, feja jonë, adeti, erzi e namuzi e patën! A p'e shihni çka na gjetë? — Mejtepet na i mshelën. Këta hoxhallarë që kemi nuk do të rrënojnë gjithmonë. Xhematit kush ka me ia falë nesër xhumán? Kush do t'i shtje xhenazet në dhé? — i ra në mend vorrimi i nanës së Kadriut. — Ndoshta, ata do t'i shtijnë në dhé, nuk do t'i lanë përjashta, por do t'i shtijnë si ai qafiri — Kadrija!... Shkolla kanë çelë në çdo katund. Po thonë — për të mirën e popullit! Edhe kjo nëkoftë e mirë, atëherë nuk di shka âsht e keqja?! Qe shka po na bâjnë me femna:. Pak iu duk që p'i çojmë çikat në

shkollë, po edhe çarçafin e havalen na e hoqën! Tasn i napën, gjoja, edne kurset e shëndetsis. Çikat e nuset në mâ të mirën istinë, he zotin havale... Shka po të vyen mâ ajo femën? Qe, edhe të rijt: gadı ıe gjithe u prishen! Do p'e pijnë rakin, do p'e hanë mishin e thiut. Tan askerin p'e ushqejnë prej nji kazani... Jaaaa! Jugosllavija e vjetër boll e keqe â konë, po këto të zeza nuk i ka pasë...

— Po, po ajo â konë drzhavë, more hoxhë — tha Stanku.

— Beli drzhavë, hë!

Syla e ndëgjonte hoxhën me vemendje të madhe dhe ia vërtetonte fjalët tue luejtë kryet. Tash iu kthye kojshive:

— Hajde, shokë, shka po thoni? Kush po don hala me u shkrue? Edhe pesë ditë kemi myhlet. Mbasandaj — mshilet udha! Ai që mbet këtu ka mi' shtî thitë në farë, s'ka shka ban tjetër.

Heshtje. Nëpunësi çoi kryet, nxuer krahnin dhe krehi flokët.

— Secili dha mendimin e vet. Edhe unë deshta me folë dishka: Ato që thatë ju gadi ashtu janë. Mirëpo, unë po flas tash si Shqiptar. Nëqoftëse na, Shqiptarët, shpërngulemi të gjithë prej katundit, atëherë nuk bâhet mirë për këtë vend. Shqipnija nuk ka mâ të drejtë me lypë Kosovën.

— Po nëkoftëse mbesim këtu? — ia priti shpejt Syla.

— Nëqoftëse mbesim, mundet me e kërkue me u bashkue me tê.

— Me u bashkue me Llatinët, a? mâ mirë bâhem Shká se Llatin!

— Edhe me qitap âsht ashtu! — tha hoxha. — Po na po thom me shkue atje ku âsht dyreki i dinit.

Heshtën përsëri.

— Hajde shokë, mos të hupim kohë. Sa u banë, bre? — tha Syla tue iu drejtue Dautit.

Dauti shiqoi letrën.

— Shpija jonë — njâ, e bacit Abdyl — dy, Hoxha — tre... Tash të shofim shka po thonë baca Rexhep e baca Ali.

— Fol, Rexhep?

Ai çoi kryet dhe filloi me ndukë qimet e mustaqeve tue thanë me vedi: „Çka kam me bâ këtu vetëm?

— Mirë, de, shkruemëni. Me krejt dynjan, edhe unë.

— Shkrueje bre! — shpejtonte Syla, tue ia bâ me dorë Dautit.

— Po ti, Ali Ti je idhnue dishka me mue. Unë nuk të kam faj, bre vlla. Të ka ikë çika dhe adeti jonë të len në kabahat. Si njeri i paris, m'u desht medoemos me të lanë në gjak. Për ty bile, s'âsht me ndêjtë këtu as dy sahat. Sod je, nesër s'je! Nuk âsht lehtë me pasë hasëm. Qe, edhe me Rexhepin, ti e din vetë, për nji virane arë nuk kemi hy e nuk kemi dalë te njani tjetri qe dy vjet. Mirëpo, tash kur duhet me bâ nji punë të madhe, nuk ka idhnim. Jemi nji gjak. Edhe ti je i gjakut tonë. Të parët tonë në të katërtën shokë i kemi pasë vllazën. S'kemi ku të çojmë. Ku të shkojmë, po shkojmë truq.

Biseda e Sylës, Stankut, hoxhës e nëpunësit — jo vetëm që nuk e bindi Aliun, por filloi edhe me e zemrue diçka. Ndezi cigaren, ngrehi tymin, dhe, si ishte kambëkryq, e çoi kryet dhe i shiqoi njiherë të gjithë e mandej me rradhë — herë njanin herë tjetrin.

— Nuk thom se nuk jam në kabahat për çikën, por, edhe këtê ma bani hoxha. Qe, ky! Më pastë në qafë në dynja e në ahiret!

— Kismet ish konë, bre Ali! — tha hoxha.

— Mirë, mirë, veç qe shka po të thom: Ti në xhehnet, unë në xhehnem, ti në xhehnem, unë në xhehnet — me ty mâ, jo kurr! Shka ke folë në këtë vesh i kam shti e në këtë tjetrin i kam qitë... Ashiqare po rrêjshe, bre hoxhë! — i tha tue mendue për at që kishte bâ me Hajrijen.

— Nejse, le ti këtë muhabet! I ngove edhe fjalët tjera që i folëm këtu, — tha Syla tue pa se e zuni ngusht hoxhën.

— Për fjalët tjera, a din shka kisha me thanë?

— Hë?

— Fjalë mâ bajat nuk kam ndie qe dhetë vjet e këndej! Unë për vedi po flas. Idaren e jashama-

kun që e kam sod — nuk e kam pasë kurr. Dhetë krén dhi m'i hupën, por më dhanë pare dhe bleva nji lopë. Tash i kam bâ lopë e nji pendë kije. Unë nuk kam pasë kije kurr, kam punue me të huejt. Drû sa me djegë, huqymeti po jep bollë. Bukë kam. Shpín në ditët e kumunistit e qita në dy katë. Besa edhe veshëmbathje për të gjithë robët e shpís kam bâ mâ shum se përpara. Djali po më shkon në shkollë. Edhe nji vjet e do ta çoj në shkollë për mësues. Me kanë se hyqymeti ka me ia hjekë harxhin. Ky tjetri, ani, po qet metra hiç pa dá. Kur po punon, për çdo ditë p'i bjen ka njiqind banka në shpí. Shka lypi unë mâ mirë? Hyqymeti pa porez nuk â konë kurr...

E suell kryet, tue kujtue tjera që u banë aty.

— Ju, bre burra, ku keni hŷ mue s'ma qet. Në punët e hyqymetit nuk ban me u përzie. Edhe n'u përzifsh, mos fol — kërk në hamar: jo nuk mujmë me u bâ njâ, jo po na prishet feja, jo ka me ardhë këtu dikush tjetër, e ku di unë... Këto janë fjalë të randa. Po edhe nuk janë t'esahta. Sa herë ia kanë këndue këtij hyqymeti: ardhke dimni, thojshin — në verë; ardhke vera, thojshin — në dimën... vjetët po kapërcejnë: u banë dhetë e mâ tepër, e kurrfarë ndryshimi nuk u bâ, veç shka p'e qet edhe mâ mirë punën në dyzen — e tue shique herë hoxhën, herë Stankun, vazhdoi:

— Kush t'u ka përzie deri sod në fé? A të ka thanë kush — mos shko në xhami e kishë, prishe ninimin, pije rakín, haje mishin e thiut? Ato shka thatë ju — janë prralla! Kush don me shkue në medrese, kurrkush nuk p'e ndalë. Qe ku âsht Prishtina e, thonë, edhe Sarajeva. Po edhe ty, bre hoxhë, ky hyqymet po të jep ka njiqind banka në muej. Vllaznimit e bashkimit, ja katundi jonë ia ka pa hajrin, ia kurrkush! Sod jemi bâ nja. Mos me pasë konë të bashkuem, kush na e kish ndërtue shkollën? Kush na e kish prû ujin?... E tjera, e tjera. Pra, po ju thom se — derisa të çohet njeri i mbramë prej këtij katundi, unë nuk shkruhem! Nuk më kanë lanë mendët me lanë kronin e ftoftë e blinin si kodër para derës së shpís e me shkue në zâll

të Rrum Kajzerit, me më hangër mushkojat e gjarpijt!

Ndersa flitte Aliu, këta, të shqetsuem, mendojshin — a thue mund t'u bante gjâ? Sepse — organizatat politike une organet e pushtetit jo vetëm që nuk lejojshin propogandë të këtillë, por edhe e dënojshin rreptësisht. Prandej edhe kërkojshin mënyrën si me dalë prej kësaj ngushtice. Syla tha:

— Po ti, pasha axhën, vetë e nise këtë punë. Pse shkove në Shkup? Mos kujto se ki me kapërcye mâ lehtë se na. Shka na gjen neve edhe ty ka me të gjetë! Unë, bile nuk kam shkue kund. Dola nji pazari në Vití, po edhe atëherë me punë — m'i mbathë kijet.

— Kam shkue në Shkup, thash, të kqyri mos âsht emri i hyqymetit. Mbasi nuk ish ashtu, me qejf temin nuk jam budallë me shkue.

Stanku i përpoqi syt dhe u suell në vend:

— Unë fola këtu si te vllaznit e mij...

Hoxha ra në shehadet me zâ t'ultë:

— Ruena zot!...

— Jo more, na e njofim Alín, — tha nëpunësi. — Nuk âsht ai asi njeri...

— Nëkoftëse del ndonji fjalë për mue ose për shokët, prej konakit tem, le ta dij, kushdo koftë, se âsht në belá me mue! — tha Syla. — Në pëvetë kush, thueni: „Jemi konë për muhabet, idare hesapi... Për Turkí — nuk dijmë gjâ. Veç n'e pastë shkrue kush prej inati..."

— E kam tullusum muzevirllakin!' — i tha Aliu.

— Shlymni mue se u bana pishman! — u ndie Rexhepi.

— Shlyje e në vend të tij shtine at mikun e ri. Më ka thanë: „Shka të bâjsh ti, edhe unë. I kemi robët e ndërruem — s'mund t'i dajmë'. Ai e kish nji mik në Turkí. I kish çue letër dhe i kish thanë se ka me na i bâ vesikat gadi.

Aliu e Rexhepi u çuen dhe duelën. Përveç Dautit që i përcolli, kurrkush s'u tha as — udha e mbarë.

Kur u kthye Dauti, Syla e porositi:

— Këto dy ditë merri emnat me vedi, shko në Shkup e mbaroj arzuhallat te afkatët. Kur t'i shtijsh në postë, qiti n'emën t'atij mikut të rí. Mos ta marrin vesh që jam shkrue... — e tue u kthye tjerëve:

— Ju, që jeni shkrue, qitni ka pesëdhetë banka, për afkat e postë!

Ndërsa Dauti ishte tue mbledhë paret, qeni lehi n'oborr.

*

Gjatë tanë kohës që bisedohej poshtë n'odë për shpërngulje, Fatimja sillej rreth dritares ose endej nëpër dhomë. Disa fjalë i ndëgjonte e disa jo, por kësaj bisede nuk i epte randsi aq të madhe. Kishte kujdeset e veta. Kur Syla tha: „... Shtine at mikin e rí. I kemi robët e ndërruem", kjo, si ishte ulë e ndëgjonte, u çue me zemrim. „Po mashtrohesh". Muer gjylpanën para oxhakut, ia nguli letrës që shkroi pak mâ parë dhe u nis me dalë. Hapi derën me kujdes dhe nguli në tê gjylpanën megjithë letër. Në dimí e këmishë, dathë, me nji bohçe në dorë, duel ngadalë n'oborr. Balçiu afrue. Tue luejtë bishtin i sillej rreth kambëve.

Nata e shkurtë, të gjithë flêjshin. Rreth e qark mbretnonte heshtje vorri. Vetëm nalt, në qiell, xixllojshin yjet.

Fatimja erdh te kapixhiku. Balçi e hapi me kambë dhe duel para saj. Hyni n'oborr të fqijës së parë. E kaluen me kujdes edhe kapixhikun e dytë e, shpejt, u gjetën te gardhi i Kadriut. Fatimja e vuni kambën mbi thupra dhe, tue u kapë për huni, u gjet mbi gardh. Ktheu kryet mbrapa, shiqoi edhe njiherë Balçin, i cili me krye përpjetë kërkonte shteg me kcye edhe ai. Tue ia bâ me dorë, i tha: „Shkova, Balo!" — dhe kceu n'oborr. Qeni lehu disa andej gardhit dhe, tue lehë mâ shpesh, u kthye kah shtëpija.

Tash, qyqe vetëm, Fatimja iu afrue kasolles, u ndal dhe shiqonte dyrekët e pallzinës. Megjithëse ndërtesë e thjeshtë, për ushqim të bagtís, ia tërhoqi

vërejtjen. Merrte frymë thellë tue thithë orën e kandëshme të sanës së ré.

— Sa i mençëm, dreqi. Ka ikë prej pleshtave e stenicave! — tha me zâ të vogël.

Filloi me përgjue te dera, por nuk ndigjonte kurrfarë zani. U kthye mbrapa, shiqoi anëve dhe erdhi përsëri te dera. E shtyni — ajo u hap. Kur ndigjoi kërhatjen e vogël hyni mbrenda. Zemra donte me i dalë prej krahnorit. Prej shushuritjes së sanës dhe dihatjes së shpeshtë të vajzës, Kadriu u zgjue dhe kceu trembshëm.

— Unë jam... — u ndie nji zâ i hollë.

Kadriu u ndal.

— Kush ti? Çka po lyp këtu?!

— Unë, Fatimja.

Nuk e dallonte prej territ.

— A bâhet me qenë ti? — tha me mosbesim.

— Bash unë — u përgjegj Fatimja tue u dridh.

Kadriu Bani dy hapa përpara, e kapi për krahu dhe u përqafuen me afsh.

Hana pesëmbëdhetëshe, buzagazash ndriti shpinën e Stubllovaçës. Rrezet e saj, nepër deren e hapun ndritën fytyrat e tyne të ndezuna flakë.

— Sa herë jemi takue, më ke gjetë në gjum...

— Kjo e dyta herë.

— Tash do të jemi gjithmonë bashkë! — i tha dhe u mendue:

„Edhe kjo dëshirë m'u plotësue. Sa mirë u krye... U krye? Po sa ka fillue!... I Livadhësi ka me kapë Sylën e Syla neve. Zor që mund të kalohet pa derdhë gjak... Në tjetrën anë — kanë me thanë: ‚Pse e ka mbajtë msheftë prej organizatës?' ‚E këta të pushtetit: Pse e ka marrë vajzën e re!'..."

— ‚Shka po mendohesh? — e trandi Fatimja.

— Që... mendojsha... nuk e dij se si do të ndahemi me këtë punë. Në dy anët — llugë. Shkova para dy ditëve në këshillin komunal. Me mjeshtri, pa më hetue kush, e hapa librin e gjendjes civile. Dauti nuk t'i kish shkrue vjetët sa i ke. Në konferencën e Lidhjes socialiste, kur qe puna e kursit të shëndetsís, pat thanë se do ta rregullonte këtë çashtje. Pa i pasë në regjistër tetëmbëdhetë vjet,

jo vetëm që nuk na del niqahi, por ndoshta na shtijnë edhe në burg. Mund të na ndajnë...

— Jo tetëmbëdhetë, por edhe pesë muej i mbushi nandëmbëdhetë — ndërhyni ajo.

— Regjistri po kqyret. Atje shkruen se ke gjashtëmbëdhetë vjet e gjashtë muej.

— Shka të donë le të bâjnë. Ti në burg unë mbas teje.

— More, po më vjen keq me më mbyllë pushteti im, e...

Të dy heshtën. Diku larg u ndie gjeli i parë.

Kadriu vazhdoi:

— Asht edhe nji gjâ tjetër: Askujt prej organizatës sonë nuk i kam kallxue. E komunistat duhet me kërkue pëlqimin e organizatës ose t'udhëheqësís për këso punësh.

— Nëkoftëse ti nuk je mirë me axhën Sylë, çfarë faji kam unë? — dhe iu dridh zani.

— S'âsht puna se je ti prej asaj familje... Jo... por — duhet me marrë pëlqimin e organizatës...

Përsëri heshtën.

— Edhe me të tut nuk kemi m'u ndá mirë. Syla ka me ra në zjarm prej kaskanllekut. Me nji rendi ka me na qitë në belá: „Ma keni marrë çikën e dhanun. Ai jarani po lyp robin prej meje e unë prej jush."

Fatimja e shiqoi tue i vrâ vetullat:

— Pse nuk po thue se shka mendon? — e me vedi: „I paska ra pishman!" — Unë nuk kam ardhë me zor. Të kam dashtë dhe të due. Edhe ti më ke thanë ashtu!... Ia kemi dhanë besën njeni tjetrit. Tash mizën p'e ban buell.

I pështuen dy pika lot dhe u çue. Kadriu e kapi për dore.

— Pse po flet kështu? Të thash shka mundet me na gjetë. E ti duhet ta dijsh se dashunija ime ndaj teje as me tokë e qiell nuk matet. Le të ndodhë shka të ndodhë! — tha tue mendue gjakun që mundet me u derdhë dhe pushtetin. — Prej teje, nuk ka fuqi që më ndán. Ti je e jemja. Prej sonte e deri sa të marrë frymë.

— Edhe ti je i jemi, deri të hy nën dërrasa! — u betue ajo dhe u përqafuen...

— Ta lajmrojmë Rrahimin — tha më vonë Kadriu, tue shkundë sanën që iu kishte ngjitë në tesha.

Duel jashtë e kur u kthye:

— Po largohemi për ndoj ditë.

*

Syla mbante shtrëngueshëm ndërmjet kambëve nji shtagë të re krryle dhe gdhente me thikë të madhe disa skeja që sakica nuk kish mundë me ia lëmue. Kur iu duk se e kreu punën, e lëshoi thikën në trapazan, ku ishte ulë, dhe u ngrit. E çoi shtagën përpjetë, e vuni në sy — sikur shenjon me pushkë! Tue e lëshue teposhtë kqyri skajin, ku ia kishte vû nji burmë të madhe hekuri dhe tha me vehte: „Unë — shtagë me hekër, dang krés, e Dauti — bum, bum alltí... ai — coftë në tokë!... Dije, he zog kurve, me kênd je kapë! Hyqymeti — neve përqafe e në burg. Mirëpo, mileti: ‚Rahmet u pastë shpirti në dynja e n'ahiret, që qitën pushkë për erz e namuz!' E pse mos me qitë? A më la rahatllëk në shpí, a? Me at grue u mahitsha kajherë... Tash mbeta edhe pa tê — e ndali miku. Jam martue e qysh jam martue. Martesë për mue mâ nuk ka. Ah, me pasë me u gjetë njifarë pusulli... qe, tash edhe në belá me rá. A ka gjâ mâ keq? Gjindja mshelë në shpí... hajvanati mshelë në torishtë e n'oborr... fusha e pat!..."

— Ti je martinà jeme e ke me ma zbardhë fëtyrën! — i tha shtagës me zâ, tue e varë me nji gozhdë afër derës. U kthye te qoshja e oxhakut, u ul kambëkryq, nxuer kutín, mshtolli cigaren dhe e ndezi me brincë e eshkë — që të hiqte pak mërzín. E ngrehi tymin e parë dhe e qiti tue fshâ thellë.

Prej rrugës ndigjohej tingllima e kumbonave dhe fyjet e barijve, ndërsa bagtija e tij pallshin pa këputë n'oborr. Qeni i bagtís uluronte te dera. Prej kopshtit ndihej kukama e qyqes.

„Shêja që ndjellin zi" — mendoi Syla dhe u tërqeth. N'at ças hyni Dauti.

— A t'i bij nja dy gojë kaftjall, axhë?

— Bjerëm zeher!

Prej oborrit u ndie zani i mikut që, tue hŷ në dhomë, e shtyni legenin që ishte në rrugë dhe u ul në trapazan.

— Erdha me të thanë... miq jemi, por edhe unë i kam punët e mija. Goditni, vlla, ndonji rrogëtar se unë nuk muj me jau ruejtë lopët derisa jeni në belá.

— Mos fol, bre mik, ashtu! Edhe ty sod a nesër mundet me të gjetë ndonji e ligë.

— Edhe sod e nuk kam mâ kohë...

U nis me dalë.

— Merre bile at qen, mos të m'uluron para derës — iu lut Syla, e Dautit që ishte ulë në nji shkamb:

— Shka po pret? Pse nuk p'i shtin gjât në bahçe? Na shurdhuen! Trembe edhe qenin dhe hajde këtu!

Dauti e kreu detyrën. Tue hy mbrenda, trusi dishka në shokë dhe e mbuloi me setrën e hollë që të mos shifej.

— A e more at virone?

— Po.

— Sa?

— Gjashtëqind e gjashtëdhetë.

— A e ki këtu?

Ky pohoi me krye. Shtini dorën në shokë dhe nxuer „nagantën" e ia dha. Syla e shiqoi nga të gjitha anët, ia suell me gishtë mullinin dhe ia ktheu.

Mbaje ti këtê. Unë, për vedi, qe ku e kam bâ „martinën" — tha tue tregue shtagën. — Jemi ardhë n'aso derexhe që pa e mbytë dikâ ose pa na mbytë dikush — nuk kemi derë. Nuk duhet me u mërzitë. Belaja âsht për burra...

Dauti u pajtue, e Syla pyeti:

— Edhe të përjashtuen, a?

— Po — iu kujtue mbledhja e mbramshëme. E zgjanuen rendin e ditës. Përveç çashtjes së shpër-

nguljes, u muer në diskutim edhe çashtja e Kadriut. Ndodhi ajo që nuk e shpresonte. Në vend që të përjashtohej Kadriu, u përjashtue ai. Mbasi mbaroi mbledhja e organizatës, filloi konferenca e Lidhjes socialiste. Aty u spjegue çashtja e shpërnguljes në përgjithësí. U fol për bajtësat e saj dhe për propagandën anmiqsore... N'at konferencë u përjashtuen prej Lidhjes socialiste: Syla, Stanku, hoxha dhe shoku i tyne — nëpunësi.

— Shumicës së komunistave ua mbusha mendjen ashtu si u patëm marrë vesh se — Kadriu ka ardhë me dy shokë tjerë t'armatosun dhe se ma ka marrë motrën me zor. U thash: me konë i drejtë nuk kish dalë ballist. Qe — kurrkund s'i dihet fija!... Sa e përjashtuem prej partís erdhi ai thiu i komitetit të komunes — Stojani. Ra fjala se Fatimja nuk âsht e re. Unë e nxora prej xhepit çertifikatën e datëlindjes së saj që e pata marrë dje në këshillin komunal, dhe ia dhashë. Harrova krejt se ishte në të edhe letra e Fatimes — të cilën e pata lanë pa hiri në nji xhep. Ai e hapi dhe filloi m'e lexue. Unë kceva me ia kapë, por ai më shtyni: „Rri në vend, bre dallaverexhi!" — dhe e lexoi letrën para të gjithëve. U tha edhe për atê që unë i kam shkrue njerëzit për Turqí. Kadriun e kthyen e mue më përjashtuen. Në konferencën e Lidhjes socialiste, si e din edhe vetë, ju përjashtuen edhe juve.

— Alija ka kallxue për punën e Turkís! Ai na ka marrë në qafë. Ia kam çue dy vetë.

— S'e dij, mund të bâhet. Nuk mujta kurrqysh me jau mbushë mendjen. Më thanë: „Nëqoftëse ti nuk beson se motra jote e ka shkrue këtë letër, qe ku âsht gjygji dhe padite."

Syla u mrrol dhe e solli kryet me nji anë.

— Pa e ndîe me veshë të mi, nuk muj me besue kurr se kjo meçkë ka ikë për at bír qeni! Vetë e kanë shkrue letrën... Vetë e kanë varë në derë... Me zor e kanë marrë e s'ka tjetër! — tha.

U ndigjue nji trokitje në derë t'oborrit. Mandej thirrja:

— Oooo, Sylë!

Në dhomë hyn shtatë burra. Tre u ulën në nji anë të shtrojes dhe, katër, në tjetrën. Të gjithë burra të vjetër, pesdhetë vjeç e përpjetë, posë njanit që ishte nja tridhetë vjeç. Dyve, mâ pleqve, Dauti u ndihmoi me dathë, — njanit opangat me toja të leshta e tjetrit këpucët e llastikut. Tjerët u dathën vetë. Dy vetëm i shpërthakuen palltat e gjata, e dy i deshën. Tre, që ishin me setra të holla, rrijshin kambëkryq, pa lëvizë. Syla u qiti të gjithëve nga nji cigare. Disa nxuerën cigarallëkët e qehlibarët e disa të therrës . I ndezën cigaret. Ai mâ plaku mixha Rashiti, shiqoi me sy të lodhun dhe luejti fulqit e thata plot lesh të thîmë.

— A po mërzitesh, o Sylë, që të gjet kjo e ligë?

— M'u mërzitë e m'u trenue, baca Rashit.

— Oooo, mos u mërzit, se hajri e sherri vijnë prej zotit — tha njeni që ish ulë në tjetrën anë t'oxhakut, i fshini syt e dërlavt, u kollit, pshtyni n'oxhak dhe tue hapë gojën thirri: „Lajlahe ilallah!"

— Kur kam ndije, m'u duk se më lëshoi toka. Kuku — thash — për agën Sylë, po ç'beter e paska gjetë! — tha tjetri me krye ulun.

— Eee çka me bâ...

Mâ i riu, që e kishte plisin të mbështjellun me marhamë të bardhë, nxuer kutín prej xhepit të setrës.

— Kjo âsht kur të vijnë të këqijat — çiljau derën; ato vijnë turq. E të mirat — kadalë kadalë...

— Po, bre, belivallah!

— Mâ kabullë e kishna bâ me më provue zoti mue se ty... shpín tande... oxhakin tand... nuk je konë ti për këso prove. Ti je mundue gjithmonë me ndreqë e jo me prishë punë, — i tha njani.

— M'erdh pa pritë e pa kujtue, si râia!

Tymi i duhanit shllunga shllunga çohej kah tavani dhe palohej si mjegullë. Dikur u ndigjue përsëri mixha Rashiti:

— O Sylë! Na ka çue ai, i biri i Hysenit — Rrahimi. Ai po i shtrohet kabahatit. Shka po thue ti? Shka po lyp prej tyne?

— Për neve nuk âsht mbetë mâ me konë gjallë, baca Rashit, — tha Dauti ulun në trapazan.

— Kadalë, pasha axhën, — i tha plaku i dërlavt. — Ti je i rí, na p'e pëvesim Sylën.

Sylës iu mblodhën rrudhat në ballë. Heshti për nji kohë dhe, tue i ra fytyrës së nxime me dy gishta, foli:

— Për dy gishta fëtyrë njeriu jeton. E edhe ata si t'i mirren, shka po i mbet tjetër? Unë, bre shokë, mbeta pa ta. Me të hŷ në shpí tre katër vetë me pushkë e me ta marrë robin e dhanun, tue u bâ gadi me shkue — nuk â konë kurr! Shum na ka poshtnue. Kurr muj me ja bâ!... Po... mbasi ju ka çue, jeni konë borxhli me ardhë. Veç, edhe a ka pasë kush me ju çue — jo! Me ta pasë bâ tjetër kush — hajde de! Po i biri i Hysenit. Burri tridhetë vjeç me ta marrë çikën pesëmbëdhetë vjeçe! Me idare — i coftë. Gjithmonë â konë rrogtar, njeri i pafé. Se di... zoti na ruejtë! A besoni që prej fjalëve të hallkut edhe mshelë në shpí nuk po muj me ndejë rahat. Qe, pardje â bâ kjo punë e dje çobanët na kishin qitë në kâjkë.

— Po besa — ia priti plaku i dërlavt. — Edhe unë i njeva sod. Tue u zdjergë, nji bari këndonte:

... Ej, ky Kadrija djali i ri,
Këtë Fatimen e kish shtí në gjí.

O, qe ky Syla krye lakën —
Mbet pa t'rejën, o, me ç't plakën...

— O, pas kuku për né shka na gjet! — kapi kryet Dauti.

Parija u muerën vesh ndërmjet vedi e Syla shiqoi Dautin tue vrâ vetullat:

— Shka po vajton si grue? Thot njeri se kanë hy ditët në thes. Ka vakt kur e shfryjmë mullanin!

Në derë hyni edhe hoxha. Në selamin e tij, u ngritën në kambë Dauti, Syla dhe dy prej tyne. Tjerët ia muerën selamin tue luejtë prej vendit e me dorë në zemër.

— Mos i këputni fjalët — bani ai tue u ulë në krye të dhomës. — Unë u vonova pak. Kesh me shti në dhé nji sabí të Halitit.

Syla çoi dorën:

— Më kanë thanë grát se mbesa jeme dhe ai rezili ia kishin pasë thithë njani tjetrit nanat, kur njana prej tyne nuk â konë në shpí ose ka qëllue e sëmundë...

Hoxha shiqoi tjerët:

— Nji tambël me pí e njani shoqin me marrë? Qitapi nuk e jep këtê!

— More, hoxhë, të kish ikë për tâ nuk më kish mbetë hatri. E paskem pasë gjakun e flliqët, p'e ungjim kryet, s'pe kqyrim kend në sy. Po — me zor, bre amani ju koftë!

— Këndej, ani, e kanë qitë fjalën se ajo e ka marrë me qejf. Si âsht puna e asaj letrës? — pyeti hoxha.

— O, more hoxhë, mos të kapshin të këqijat përpara! Ato mbasandej p'u rendojshin — konë e pa konë. Ku di ajo me shkrue, allahile!? Këta dy-tre muej dimën ka shkue ka njiherë në qat viron kurs — jo mësue, po mos të na qesin ndonji xheza. Ata e kanë shkrue vetë letrën. Me ia shitë marren tjetër kujt. Veç ne ta dijnë, se nuk kanë me kapërcye mirë, qe besa!

E kroi mjekrën e thime me pak lesh.

— Tash ña gjet edhe e liga tjetër: Djalin e përjashtuen prej partís, mue prej socialistave. Po më vjen keq edhe për Stankun e ty që ju përjashtuen për fjalët që i bâtë në konak tem. Na i folëm pardje mbrama ato fjalë, e ata i muerën vesh menjiherë dhe na larguen. Â hî ndër né njifarë munafik-llëku...

— More, le që e përjashtuen këtê prej partís e neve prej socialistave, po jam tue u tutë mos po na del puna mâ fellë! Qe, at hoxhën e Gilanit, e kishin mshelë për këso punësh. Këta nuk po kqyrin a janë fjalët me vend a pa vend.

— A thue, kush i shploi këto fjalë? — pyeti Rashiti.

— Ia kam çue dy vetë Ali Abazit. Edhe pse s'po lidhet, nuk më del i shëndoshë. Ia çova prap dy vetë dhe u thashë: „Për fjalët që ke qitë deri sod — gjysë gjaku... E nëkoftëse na gjânë ndonji e ligë tjetër... mos thuej se nuk e kam dijtë! Nji

gjak borxh ma kije. Të gjithë shokët m'u kanë lá. Ti lajmu qysh të duesh, besë nuk të zâ".

— Mirë e ke: atij besë nuk i zêhet. Ish njeri me dy fytyra — herë andej herë këndej — tha hoxha.

Syla pohoi me krye.

— Mbasi kapërcyen këto tri ditë e nuk na mshelën, po kam ymyt se po pshtojmë. Këto ditë, ndoshta, po dalim mâ për Turkí.

— Pa e shfrŷ mullanin me shkue për Turki, a? — bani Dauti.

— Hiç mos kini gajle-tha Rashiti-Badihava po flasim për Turkí. Tita kish thonë: „Shqiptarët nuk i lëshoj!" Këta — shka po thojshin — nuk kish mâ lojë. Këtê kam mujtë me pa në këto dhetë vjetët e tyne.

Plaku i dërlavt tha gjoja me urtí:

— Pulitika âsht rrenë, Rashito. Ndoshta këtê nuk e ka thanë Tita... këta p'e hijeshojnë vetë. E kanë për vedi: Shka bâjnë pa milet...

Syla ngrehi tymin dhe, tue e shfry përjashta, shtoi:

— Jo rrenë, po nana e rrenëve! — dhe u mrrol tue u shtî si njeri me përvojë që e din se shka âsht politika, që âsht marrë me tê edhe përpara e qe merret edhe tash.

— Po na jemi konë gjithmonë Turq. Emni Shqiptar na duel tash — tha hoxha. — M'e kqyrë hollë, rrâjën e kemi has prej Arapëve! Pse â mbetë „Arap — Arnaut"?

— Je konë Turk... Arnaut... Arap... po tash je shkrue Shqiptar! Këta p'e çojshin punën me tefter, jo qysh po ju thue ti — tha Rashiti.

— Mirë, pra, na shkojmë dhe e ndërrojmë tefterin! Në vend të Shqiptarëve shkruhemi Turqi, ose si po thue ti — Arnautë t'Arapit... Nëkoftëse nuk ban për Turkí... po shkojmë te vllau i madh... te Arapi.

— Po sharrojmë edhe mâ fellë... po — t' i lamë këto fjalë! Të bisedojmë për atâ që kemi ardhë — tha Rashiti.

— Nuk â konë keq, Sylo, m'u marrë vesh me Alín e mos m'e lanë punën çelë, mos m'e qitë belá

të reja — tha plaku i dërlavt. — Edhe ai e ka boll nji belá me të Moravsin. Ky nuk ia kthei çikën e ai nuk i deshti paret. Alija i ka hi në hak.

— Po mirë, shka po thue ti, Sylë, për këtë punën që kemi ardhë këtu? — e pyeti njani që deri tash nuk bani zâ.

— Shka kam me ju thanë tjetër? U thash boll. Mirë e pat ai shoqi: „Të ligave çiljau derën!" Mue më gjetën të gjitha truq. Për nji ditë ma muerën çikën, më qitën prej socialistave, e djalin ma përzun prej partís. Kjo nuk âsht tue m'u dhimtë sa tjetra: s'kanë me na lanë m'u përzie në punët e tyne. Lej këto të gjitha, po edhe i Livadhësi më ka ngujue. Jo vetëm që nuk po ma lëshon gruen, po as besë nuk po m'jep. Ta kisha dijtë se po bâhet kështu, nuk e kisha lëshue me shkue. Kishe për darsëm, e tash më mbet atje. M'e kish çue dje dy vetë dhe u kish thanë: „Motrën nuk e lëshoj mâ. E kemi bâ deri diku takikë, po del se na kije hak. Qe s'di sa ke jetue me motrën tonë, e na as nuk ta pamë mbesën. Kur e ke dijtë se je i asi gjakut, pse miqasohesh me hallk? Nëkoftëse nuk e drejton punën — mbaju. Besë nuk kije!" Edhe gjanë s'po ka kush me na i qitë në fush, e jo mâ...

Parija shiquen njani tjetrin. Plaku i dërlavt pshtyni n'oxhak.

— Shka ka dashtë me thanë me këto fjalë? Qysh m'e drejtue punën?

— Qe qysh kish thonë: „Nëkoftëse parija ose hyqymeti e shpalon se i biri i Hysenit ta ka marrë mbesën me zor, e zoti na ruejtë, edhe e ka poshtnue, s'kemi shka me bâ... p'e marrim dhe po ta kthejmë tonën. Nëkoftë, ani, se çika e ka bâ me pikë të qejfit, si po ndihet ndër hallk, atëherë je burrë i poshtër, âsht gjynah me kon gjallë e me rrêjtë dynjân."

Rashiti e përcolli me vemendje Sylën dhe iu drejtue menjiherë:

— Mirë të paska thanë... por nuk e dij a do të na del ndër sŷ e me p'vetë. M' i ia ndie fjalët e saj. A kini me folë hala? — tha tue vû cigaren në gojën e rrethueme me lesh të përhimtë, që iu kishte kuqë prej tymit të duhanit.

— Fjalët e fundit janë këto: Ju p'e shihni edhe vetë shka na ka gjetë...

Parija luejtën kryet e Syla vazhdoi:

— ... Ma ka marrë erzin e namuzin nëpër kambë! Nuk muj m'e pá, e jo mâ me folë me tê... Për hatër të juve, që keni ardhë... le të ma kthen çikën deri nesër. T'ja çoi të Livadhësit e ta marrë robin tem. Për ndryshe ma ka nji gjak borxh. Do të mundohem me e ndjekë edhe me anën e hyqymetit, deri ku të muj! Me më hŷ në shtëpi... me ma marrë çikën me zor... dhe mâ së mbrami me dalë në mal... besoj se, pak drejtësi në pastë ky hyqymet i soçëm, s'ka m'e lanë rahat! Unë kam me ngá për hak temin, e hyqymeti le të ngasë për të vetin.

— Aaa, bafsh hajr, zoti të ruejtë! Tjetër prej teje nuk dona, — i tha udhëheqsi i parís, Rashiti, dhe u drejtue shokëve: — A pak âsht për tê, që për këto ditë, që e ka mbajtë, Syla nuk p'i lypë kurrgjâ? Këto ditë, shokë, janë shum të randa, — dhe çoi gishtin përpjetë, thuese donte me iu kërcnue Kadriut për së largu — me fjetë, me shënerue robin e huej?!

— Qysh nuk janë të randa!... Veç hatri juej... e le ta ha dreqi, se... Edhe vetë kam punue me ju këso punësh. E dij se si âsht, kur njeriu i sajdis me dishka këta burra.

Parija, tue ia luejtë kryet njani tjetrit, biseduen me zâ t'ultë. Dauti, prej zemrimit, therte majen e opangës, me nji thupër që e kishte në dorë. Tullugu i duhanit e errsoi odën. Ferashti, kutija e degerxhikut dhe sofra varë në mur te dera, veç sa dukeshin. Disa qitape, gazeta të hjedhuna e kutija të ndryshme shifeshin si nëpër mjegull në raftin përballë. Kamishi i gjatë, varë në mur, dhe tespihët afër tij si gjarpën i coftë. Plaku i dërlavt vuni dorën në báll dhe shiqoi Sylën:

— Nëkoftëse thotë nuk muj m'e kthye çikën, a kish bâ m'u marrë vesh diqysh me pare? — e pyeti n'emën të parís.

Syla përgjegji shpejt:

— Zoti na ruejtë! Nuk jam n'zor për pare.

— A din ku âsht puna? — tha ai afër plakut. — Me pare, ndoshta, ish mshelë kjo punë.

— Jo, bre shokë! Nuk âsht puna te paret. Rob kam marrë dhe duhet me dhanë.

— Pa kadalë, de — tha njani prej parís. — Na bash tu robi e kemi fjalën. Nëkoftëse atij nuk i mbushet mendja ndryshe, e t'jep pare — nuk âsht keq. Paret ia ep të Livadhësit... ai me to martohet... e ty ta kthen robin tand...

— Mirë janë tue thanë shokët — tha Rashiti. — Kujtohu pak, mos u ngut!

Syla uli kryet dhe fshani.

— Nuk muj!

— Mos, bre, ashtu, pash rizán e zotit! Për të mirën tande po flasim. M'u bâ mirë âsht zor. Për të keq — kur të duesh.

— Efendëm i miri i zotit, Syla duhet me ngue! — tha hoxha.

Syla mendonte:

„Ndoshta nuk âsht pusull i keq. Pshtoi prej të Livadhësit... gruen ma kthejnë... ta kapërcej edhe ndoj ditë si njeri... Këtë meçkë me at bír qeni... le ti hanë dreqi!... Qe, mbas grumbullit të të këqijave po fillojnë të mirat — kadalë dalë."

— A po ta blen mendja, baca Rashit, se ban kështu? — pyeti tue iu kthye Rashitit.

— Shka të jetë marre, lema në qafë teme!

— E gjynahin në temen! — shtoi hoxha. — Na po mundohemi për të mirë.

Syla shiqoi Dautin, i cili tash u mrrol edhe mâ tepër. Thuese i luejshin të gjithë dejt e fytyrës së kuqe prej zemrimit. Syla iu drejtue prap parís:

— Mbasi po thoni ju, bre shokë, le të m'i jep dhetëmijë banka... Veç ta dini se m'u marrë ngryk me tê nuk muj.

Ndërsa këta bisedojshin për paret, Dauti ishte zhytë në mendime:

„Qysh po thonë këta — parja, p'e lajka marren. Jo, unë due me i vra. Kanë bâ aso pune që nuk âsht ndî deri tash në katundin tonë. Na kanë marrë fëtyrën. Qe, edhe çobanët na kanë qitë në kangë. Pse me jetue?..." — dhe klithi i mbushun pezëm.

— Unë nuk pajtohem me këtë që tha axha Sylë!

— Trusu more, ti nuk din gjâ! — iu ngërmue Rashiti.

— Mos dijsha gjâ, atëherë grahni si të doni. Por mue më duket se edhe unë duhet me u pvetë. Ju nuk po na mësoni qysh m'e hjekë këtë marre, po qysh m'e shtue edhe njâ.

— Kjo s'po shtohet, biro, po po mshelet.

— Mshelet atëherë kur unë ta laj këtë marre me gjak e jo me pare.

— Rri ti! — iu kërcnue Syla!

— Mirë...

— Si burrat ke punue, bre Sylë — i tha njani.

— Për hatër të juve.

— Zoti të ruejtë!

Udhëheqësi i parís lëmonte mjekrrën tue bisedue me nji shok afër, e mandej iu drejtue prap Sylës.

— Për me mujtë me gjetë at djalin e çikën, ose me t'i bâ paret gadi, duhet me ia dhanë nji besë të vogël Rahimit.

— Asnji sahat! — tha Dauti. — Ku ta zateti kam m'e vrá!

Syla e shiqoi shtrembët dhe u kthye kah parija:

— Nuk mujmë, bre shokë, me i dhanë besë!

— Ti Sylë, burrë i shtatë gjaqeve, me folë kështu, a?! — tha udhëheqësi i parís. — Besa âsht shêj burrnije! Mos ia mshel herifit të gjitha dyert. Qysh mundet me ta kthye mbesën pa e lyp? E din edhe vetë se kanë hupë që dy-tri ditë. Paret, ani, nuk bâhen gadi, pa qitë dishka në pazar.

— Mirë de, qe po i jap tri ditë.

— Ooo, paç faqen e bardhë! — thanë parija me nji zâ.

Dautit iu nxî fytyra. Krye ulun mendonte:

„Me na kthye Fatimen ose me na dhanë pare. Pse? — qe aga Sylë të mundet m'e kthye përsëri gruen e ré!... Nëqoftëse ata nuk pranojnë — të dytë me i mbytë!... Pse me i mbytë? — Jo për tjetër, po, për gruen e axhës Sylë... Për gruen e tij m'e mbytë motrën?... Me humbë vehten?"

I vlonte diçka mbrenda dhe e shtrëngonte në fyt. Jo që nuk e ndigjoi trokitjen në derë, por as që ishte në gjendje me folë ose me lëvizë. Syla u ngrit, doli dhe u kthye shpejt me nji takam plot me filxhana të mbushun me kafe. Vetë ua ndau mysafirëve. Parija bisedojshin ndërmjet vedi dhe tymojshin duhan tue pi kafe.

— Punën e kryem si â mâ mirë — tha Rashiti. — Po i pijmë kafet e po çohem. Mâ së mbrami puna mbet kështu: Ai me ia kthye çikën! Nëkoftëse nuk mundet me bâ këtê, atëherë le t'ia apin Sylës dhetëmijë banka. Me soden i ka tri ditë besë. Mos raftë në kët pëlqim, s'kemi shka i bâjmë me zor. Edhe Syla tha parëza: „Si mos të ndreqet do t'i jep haber hyqymetit.." Edhe ai edhe ky kanë m'e ndjekë.

Tjerët ia vërtetojshin me krye fjalët. Syla e shiqonte tue luejtë kryet nganjiherë. Dauti rrinte ulë në trapazan tue shique mrrolshëm vetëm para vedit.

— Pa e bâ njanën prej këtyne dyjave, s'ka kah ia mban, si popi — tha plaku i dërlavt.

—Qitnajni kundrat e opongat — tha Rashiti.

Syla e shiqoi Dautin. Ky nuk luejti prej vendit. Ishte shtangë, po, mandej, u ngrit dhe ua afroi këpucët e opangat. Ata që kishin këpucë i mbathën shpejt. Këta që ishin me opanga, i shtinë në kambë, e mbathëset i mbështollën kambëve. Të gjithë duelën, posë Dautit. Tue dalë, hoxha iu afrue:

— Shka po të ha palla? Mos u ban budallë me u mërzitë!

Dauti e shiqoi dhe qeshi me ironi.

Syla përcolli parín, e kur u kthye n'odë iu drejtue me të butë Dautit, që ende ishte në mendime :

— Krejt dynjaja po punojnë kështu.

Dautit i plasi mâ në fund delli dhe ia shkarkoi në fëtyrë:

— Jo krejt, poti me shokët e tu! — i tha me zâ të rreptë. — Ti më ke shti gjithmonë me ra në kundërshtim me shokët... Për punën tande u përjashtova edhe prej partís. Tash p'e shof se feja, erzi e namuzi yt, qenka dinari e ... grueja e ré!

Pra — po të thom, se u bâ qysh u bâ, u fol shka u fol — alltija jeme nuk ka me qitë në trup të Kadriut e të Fatimes ! — tha dhe duel shpejt jashtë.

Syla mbet i habitun.

*

Rrahimi ndezi zjarmin n'odë dhe vuni gjygymin në të. Edhe e shoqja erdh me nji krah qylyma, jastekë e nji postaqí. Të dy së bashku shtruen qylymat e rí mbi ata të vjetrit dhe i renduen jastekët. Postaqín e vunë n'anën e djathtë t'oxhakut. Tue shique nëpër dritare grueja tha:

— Kah Lubeteni po shihen do rê të zeza.

— Ani?

— Po tutna mos po bjen ndonji shi i madh, e zoti na ruejtë edhe ndonji breshën, e pa na e çon poshtë edhe at trohë drith në fushë.

— Për atê, hallki i ruhen belás. Po duhet m'e lutë secilin. I kam çue fjalë vllaut tand me ardhë sod... në mujtë me na e korrë drithin. Nuk jam mësue me ndêjtë mshelë. Po më duket se jam në burg.

— Përzo, more njeri, shka të lypin, mos u kurse... Të jemi shëndoshë e mirë na, se... gjindja e bâjnë mallin.

— Kadrija nuk erdh hala. Pa tê nuk dij shka m'i thanë paris.

N'at çast hyni Kadriu dhe tue pa fëtyrën e zymtë të vllaut, qeshi:

— Mos u mërzit aq shum, bre vlla!

Këta mbetën me gojë hapët.

— Pse nuk erdhe natën, po ditën? Me të pasë zatetë hasmi, shka të kish bâ? — e qortoi Rrahimi mbasi erdh në vedi.

— Shyqyr që paske pshtue këtë hov shëndosh e mirë! — u gëzue e kunata.

— Mos e bani punën aq kijamet! — qeshi përsëri Kadriu dhe — iu drejtue Rrahimit: — Shka më ke thirrë, Rrahim?

Rrahimi thynte duerët.

— Tash vijnë parija... A e din, unë i kam çue te Syla... U desht me ia bâ qat nderë. Jemi kabahatlí. Pa ty nuk dijta shka me iu thanë...

Kunata, sikur të donte me e largue prej asaj që i tha i shoqi, ndërhyni;

— Deri at natë, ti, Kadri aga, nuk na thae gjâ se do ta marrish Fatimen?!

— Po, as unë s'e kam dijtë që do të bâhet bash kështu.

— Tybe, bash çikë të mirë ke marrë! Ishalla e gëzon.

— Mbas do ditëve, do të kthehet prej motrës dhe ti do të kesh shoqe...

— Tash ta shofim shka na thonë parija — vazhdoi bisedën e vet Rrahimi.

— Unë sa i thash këtij: shka të lypin jepni. Nëkoftëse bâhet me pare, i kemi: kijet, lopën, dhentë. Mâ së mbrami po shesim edhe nji copë tokë. Si të jeni ju dy shëndoshë e mirë, ara bâhet prap. Pa ju — dynjaja s'na vyen gjâ.

Kadriu solli kryet dhe filloi me u endë midis shtrojave. Grueja tue rregullue dimít, i pështritte diçka burrit.

— Pse m'i dhanë pare? Nuk e kam marrë me zor. Më ka dashtë dhe e kam dashtë!

Vllau e kunata e shiquen me habí.

— Mos fol ashtu, pash zotin! S'mund të rrij unë mshelë si Alija. Nuk shkohet jeta me copa të besës.

— Po ti mos rri mshelë!... Shka po të han palla?... — ndërhyni Kadriu.

— Edhe ti po flet ka njiherë si me pasë zdrypë prej qiellit. Na jemi nji gjak... vllazën... A zatetet në ty a në mue — ku m'e dijtë — jarani e shfryn mullanin!

„Kjo mund të ndodhë... plumbi s'po të pëvet kush je... Ndoshta më mbysin mue?... Fatimja e vejë — merr nji tjetër... Ndoshta e mbysin Rrahimin?... Sa të jem gjallë, kunata ka me më nemë... Çka me bâ?... Kanë të drejtë këta: gjindja e bâjnë mallin. Po ja apim nja dy-tri mijë banka... Punën e nji verës." — i sillej nëpër mend.

— A u muerëm vesh? — pyeti Rrahimi.

— Mirë.

U ndigjue trokitja në derë t'oborrit.

— Ata janë! tha Rrahimi dhe duel me nxitim. Duel edhe e shoqja.

Parija, e përcjellun prej Rrahimit, hyni në n'odë me: „Koftë mirë!"

Shtagat krryel mbetën në trapazan, e pleqt u varguen në krye t'odës.

Rrahimi jua qiti nga nji çaj dhe mbet në kambë.

— Amanetin tand e kryejtëm, bre djalë, dhe haber të mirë jemi tue ju prû — e filloi bisedën Rashiti, tue iu drejtue Rrahimit.

— Bâfshi hajr, e zoti sevap jau shkroftë! Pa të parë, ishalla, dynjaja nuk mbetet — tha me gëzim Rrahimi.

— Si burrat na ka pritë. Kanë thanë të parët: „Mâ mirë me dhetë hasëm azgana se me njâ të lig shtë. Azgani ta çel nji derë e i ligi t'i mshelë të gjitha." Kështu âsht edhe puna juej me Sylën.

— Jau ka lanë disa udhë çelë — tha plaku i dërlavt.

Rashiti u kollit dhe fshini gojën me shervetë të kuqe.

— Na duket se mâ e mirë âsht udha e parë. Edhe pse ia keni marrë me zor e, ndoshta, ia keni shnjerëzue, ai, si burrat, jau fali këto.

— Njimend burrë koka konë. S'e paskam njoftë si duhet, — tha Rrahimi në hutim, tue kujtue se puna âsht krye si â mâ mirë.

Parija shiquen njani tjetrin e hoxha i nxuer tespihtë.

— Po kadalë, bre djalë, se ti dallash e more vesh! Nuk âsht puna se jau ka falë të gjithë marren që ia keni bâ. Jo! Ai po lyp me ia kthye mbesën sod deri n'aksham. Neve na i fali ato ditë që ia keni mbajtë. Këto ditë, djalo, janë shum të randa! — dhe shiqoi Kadriun.

— Po mirë, e! Çfarë udhe tjetër na paska çelë? — pyeti me ngadalë Kadriu.

— Demek ky farë pusulli nuk po të pëlqen ty, a? — ia priti Rashiti.

— Jo. As unë as ajo nuk e kemi marrë shoqi shoqin me zor. Moti e duem njani tjetrin. Bollë ke-

mi vuejtë njani larg tjetrit. S'ka fuqí që mundet me na ndá.

— Eeee, sa çikat e katundit e të mahallës i kam dashtë unë, por nuk kam punue si ti. Nuk kam dashtë me prishë razín e miletit, m'i qitë gjinden e shpís dhe vehten në belá... Pse belá mâ të keqe se kjo nuk ka! — tha plaku i dërlavt.

— Nuk kam pëvetë kend! Me pikë të kastit e kam bâ.

— A kish bâ me na e qitë at hallajkën e t'ia ndiejmë fjalët edhe asaj? — tha Rashiti.

— Nuk âsht këtu, hala s' e kam kthye prej miqve. E — ajo s'âsht hallajkë, por njeri, shoqja jeme, — e çoi zanin Kadriu.

Hoxha qeshi.

— Mâ mirë thue: hala s' e kam shtrëngue me thanë atê që don ti...

Kadriu luejti vendit.

— Unë, burra, po ju flas të vërtetën. Edhe sikur t'ish këtu, ajo më ka thanë se nuk del para parís.

— E pse, kishe? Tash ferexha âsht hjekë... — tha njani.

— Nuk âsht puna te ferexha, po s'po ju beson. Asnji punë deri sod nuk e keni krye pa ia lanë ndonji bisht përmbrapa!

Parija u shiquen ndër vedi, e dy u muerën vesh për diçka. Njani prej tyne tha:

— Mbasi nuk do bâjka kështu, na e kemi edhe nji udhë tjetër mâ të lehtë.

— Fol, axhë, fol — tha Rrahimi.

— Për robin, që ia keni marrë, me ia dhanë Sylës dhetëmijë banka.

Rrahimi iu kthye vllaut dhe e shiqoi me buzëqeshje. Mandej parís:

— Ky pusull nuk âsht i keq!

Kadriu kceu:

— Dhetëmijë! Nuk muj. Dy, tre mijë — nejse, për hatër t'juej. Syla âsht mâ mirë me idare se unë. Shka më vyen grueja, kur as asaj as tjerëve në shpí nuk u mbetet shka me hangër!

N'ato fjalë Rashiti iu kthye mrrolshëm e me kërcnim:

— Ti po ban hajgare me né! Ashtu jo, kështu jo, ku âsht puna? Diqysh do të lidhesh. Kabahatlí je!... — dhe muer frymë. — Pak e kí që ta bamë punën me pare. Qe, Aliu i dha të Moravsit dhetëmijë banka, po ai nuk ia muer. Ky p'i merr për hatrin tonë.

— A e din, mixha Rashit, se pse jam fajtuer: Që nuk i kam kallxue kërkujt se jemi besatue e se do të mirremi. Këtë kabahat e ka edhe ajo, edhe unë. Syla dhe vllau jem do të bâjshin mirë, me na e falë këtë gabim. S'kemi mujtë m' e qitë fjalën para se me krye punën. Jam i sigurtë se kishin me u mundue me na bâ ndonji ngatrresë.

Njeni, afër Rashitit, bisedoi me tê e ai vetëm bani me krye.

— Na nuk kemi ardhë këtu me na kallxue se kush âsht kabahatlí e për shka. Ti, bre djalë i mirë, me kanun tonë i ke borxh nji rob e nji gjak. A pak po të duket që robin e gjakin ta kemi ndërrue me pare? Kadriut sikur t' i kish mshue dikush me çekiç krés. Iu kujtue ajo që Rama pat folë në mbledhjen e organizatës: „Nji zakon, jo dy! Nji gjykatës, jo dy!" dhe zihej me vedi: „Unë, komunist... unë, sekretar... me iu shtrue këtyne?... Këtyne që shum kujt ia kanë kallë zemrën me kanunin e mbrapambetunís!" Dhe vendosi: „Jo dy-tre mijë banka, po as dy tre dinarë s' m' i kanë pa! Do të më vret?... Le të bâhet edhe ajo! Nuk po vdes vetëm për nji grue, po për përparim të përgjithshëm! Edhe atyne u rrjedh gjaku."

— Me çfarë kanuni ia kam nji rob ose nji gjak borxh? — pyeti me ironi.

— Me Kanunin e Lekës! — u përgjegj Rashiti me krenarí.

— Kanuni duhet me pasë gjykatës.

Parija qeshën idhshëm. Plaku i dërlavt fshini syt.

— Po na, shka jemi na? Qe, se jam hý në bylyk, me këto punë jam tue u marrë.

— A ban me iu përvetë nji gjâ tjetër?

— Hêê!

— Ta zamë se dy vetë kanë ra në mosmarrëveshje. Bje fjala si unë e Syla. Në lidhje me këtê

ju merrni vendimin ose si i thonë pusullën. Mirëpo, a janë ata të detyruem me e zbatue vendimin tuej?

— Përpara, në kohë të vaktit, parija kanë marrë vendime dhe i kanë krye vetë. Nëkoftëse kabahatlija nuk iu ka shtrue, e çojshin njerin prej katundit dhe ia digjshin shpín; e tash, janë ndërrue devret, axho! Ne po ju thom qysh â mâ mirë me punue e qysh m'u ruejtë prej belave. Kush na ka ngue nuk i ka ra keq.

— Pra, edhe ti ngona se beli vallah s'ka me të ra keq! — tha hoxha.

— Eshedy bilah, ki me na lypë masandej! — e plotësoi tjetri.

— Unë ju ngova juve bollë. Tash edhe ju ngomni mue pak.

— Shka me të ngue ty? — tha Rashiti.

— Qe shka: Sod âsht Jugosllavija e Titos, Jugosllavija e popullit. Ajo ka ligjet e veta dhe gjykatësat e vet. Ligjet i bâjnë njerëzit tanë që i kemi zgjedhë — deputetët. Ata zgjedhin edhe gjygjtarët. Dy ligje e dy gjygjtarë nuk munden me qëndrue në nji vend! Ju jeni gjygjtarë që punoni me kanunet e pesqind vjetëve. Vendimet dhe propozimet e jueja, në shumicë të madhe, janë kundër të drejtave që gëzojnë sod edhe mashkulli edhe femna. Nëqoftëse vazhdoni me punue kështu, ta dini se pushteti ynë ka me ju ndjekë — e tue ulë zanin: — Shkoni në shpija tueja e mos u përzini në punën e tjerëve! Disa prej jush keni bâ njiqind të zeza deri tash e prap po mundoheni me kallxue vedin si njerëz të popullit, që punoni për të mirën e tij! Bollë âsht që njerëzit kësisoji kanë mbetë gjallë. — tha Kadriu tue e ngritë prap zanin.

— Po na —tha hoxha — s'kemi ardhë me zor. Vllau yt na ka lutë dy tri herë që të shkojmë te Syla.

— Mos, bre vlla, mos e përbuz të mirën që na kanë bâ! — e luti Rrahimi.

— Çka të kam thanë deri sod nuk na ka dalë keq. Edhe në këtë punë, të lutem, mos m'u përziej.

Pleqt mbetën me krye varë e Kadriu vazhdoi:

— Ju i thueni Sylës: Nuk ia kam bâ me inat. Vajza më ka dashtë dhe unë e kam dashtë. Jemi

marrë me qejf. Mâ mirë i kish rá me shukatë e me çue njifarë miqsije — po deshti. Nëqoftëse nuk i pranon këto fjalë, le të bâjë si t'ja marri mendja. Qe ku âsht pushteti. Ai le të më padisi, unë po mbrohem!

Rashiti i vari vetullat dhe nëpër muştaqe, murmuroi:

— A po bajka kështu, a?... Mirë, pra! Veç po të thom se kí me na lypë, se ti, pasha axhën, belás veç zaniń ia ke ndí! Ti i kije hala mendët përmbi kapuç.

Rrahimi e shiqoi Kadriun me idhnim dhe iu kthye parís:

— Banmani hallall, bre burra, që ju mundova.. Shkoni e thoni Sylës ashtu si po thot ky „azgoni" jem. Ta shohim se deri ku po shkon...

— Qitnani opongat! — urdhnoi Rashiti.

Tue dalë, ai që ishte mâ i riu, i tha me zâ t'ulët plakut të dërlavt:

— Po ia çojmë Sylës edhe këtë haber e p'i lamë mâ këto punë. Kurrkush nuk po na e ven mâ veshin si duhet.

— Mos u ftof, de! Kujna i bje mirë mos t'na ngon. Këtë qafir duhet m' e leçitë prej katundit!

STOJANI, sekretar i komitetit të komunes, erdh në Vitinë me qëllim që ta njoftojë komitetin e rrethit për ngjarjet e Bllatës. „Ta shof — thonte — a kam punue si duhet." Me vedi muer edhe Kadriun dhe Fatimen, tue i bindë rrugës se nuk kanë me u përgjegjë.

Trokiti në derën e zyrës së sekretarit dhe hyni.

— Edhe — tha tue u përshëndetë me sekretarin — t'ju njofë me disa punë... me disa gjana të reja... për masat që kemi marrë...

Sekretari e ndëgjonte me vemendje.

— Ishim së bashku me shokun Fazli — tha Stojani — kur e çuen agronomin n'ekonomín e Bllatës.

„Nuk banë kurrfarë kundërshtimi... e pritën mirë. — Fazliu. Bllata, si po duket, âsht kah shkon

shpejt përpara. Kadriu ka merita të mëdha... Po bâhet udhëheqës i mirë".

Stojani ia filloi përsëri, tash tërthorazi:

— Na, shok sekretar, e kemi sqarue, si me thanë, e kemi shpartallue këtë çfaqje në lidhje me Turqin. Posë asaj që kemi skjarue popullin, kemi marrë edhe masa tjera...

— Çfarë masash? — pyeti sekretari me kurreshtje.

— Njifarë Daut Hajdinin, nëqoftëse të kujtohet, e kemi përjashtue prej Lidhjes së komunistave.

Sekretari, herën e mbramë kishte qenë në Bllatë atëherë kur e thirri Kadriu me shkresë që të merrte pjesë me rastin e hapjes s'ekonomís. Tash iu kujtue biseda e Dautit: „Meraja âsht e krejt katundit, e jo veç e fukarave." Shpirt spekulanti! Iu kujtue edhe ajo që e pat njoftue Fazliu, prandej e kish porositë Kadriun: „Me pasë kujdes për të." Iu kishin përzie në krye shum njerëz e shum raste. Mandej kishte kalue edhe shum kohë. „A thue âsht ai?" — pyette vetvedin.

— Daut Hajdini? Nipi i Sylë Hajdinit?

— Po. Ai i ka shkrue me dorë të vet njerëzit për Turqí. Ka bâ edhe dallavere tjera.

— Po... më kujtohet!

— Prej Lidhjes socialiste kemi përjashtue Sylë Hajdinin, Stanko Markoviqin, hoxhën — mulla Rexhep Azemin dhe at nëpunësin e komunes që ka qenë informbyroist. Këta të gjithë kanë bâ propagandë antisocialiste dhe kanë mashtrue njerëzit me u shkrue për Turqí.

Sekretari buzëqeshi. Shtrini dorën dhe prej tavolinës muer tabakun e letrës që pak mâ parë ia pruni kuriri. Tue shique letrën, tha:

— Syla dhe Stanku kanë nënshkrue, si propozuesa, edhe listën për kandidimin e Xhaferit dhe të Vukojës për deputet.

— Jo more?! — bani Stojani.

— Qe, shife!

— Leni këta, po Alija?!... tha tue kqyrë tabakun e letrës. — Po Xhaferi e Vukoja a janë çmendë a, çka dreqi i ka gjetë?

— Sod do ta shqyrtojmë çashtjen e tyne në mbledhjen e komitetit — e mbasi heshti pak, pyeti: — Si u ratë në fije për çashtjen e Turqís?

Stojanit iu kujtuen ato që i tregoi Kadriu në lidhje me këtë çashtje. Iu kujtue edhe ajo natë, jo e largët, kur ata, të zanun piskë, e pranuen „gabimin".

— Fare lehtë. E mbesa e Sylës, motra e Dautit, i dëftoi Kadriut.

Sekretarin nuk e bindi kjo që tha Stojani. Mendoi: „Vajza shqiptare, me botëkuptime patriarkale, me folë kundra vllaut e mixhës?"

— S' e besoj.

— Asht puna me besue. Kjo vajza ka ikë për Kadriun...

— Për Kadriun? — tha tue ia pre fjalën në hutim.

— At natë, para se me shkue te Kadriu, e kish ndëgjue prej odës këtë bisedë dhe kish pa këta njerëz... Na nuk u diftuen kush na ka thanë. Mirëpo u përmendën emnat se kush ka marrë pjesë dhe shka kanë folë — kapituluen. E pranuen. Thojshin: „Kemi gabue."

— Mrekulli! — tha sekretari, i kënaqun mâ tepër për mënyrën e martesës së Kadriut se sa për izolimin e reakcionarëve. — Çka po flitet tash për Kadriun e shoqen e tij?

— Dauti deshti me mshtjellue dishka, por ia zumë letrën e Fatimes... Kadriu na ka njoftue se parija kanë dashtë me i ndreqë me pare, por ai e ka përzanë.

Sekretari i muer me mend anët pozitive të Kadriut: „Shko në katund! — Po. Bahu sekretar! — Po. Ai vetë: — Po duem me themelue ekonomín... Ti jo drejtor! — Ani. Asht martue si çdo njeri përparimtar... Parín e ka përzanë... Nanën e ka vorrue pa hoxhë..." — dhe përfundoi: „Në zgjedhjet e para — me kambë e krye në komitet të rrethit..."

— Asht njeri me perspektivë — i tha Stojanit.

— Syla e ka paditë në gjygj se, gjoja, ia ka marrë me zor të mbesën ende të pa rritun për martesë...

— Po më vjen keq që s'mujta njiherë me u takue me at Sylën!

— Çudi, si nuk paska ardhë me u ankue!

E ndezën nga nji cigare në heshtje.

— Unë nuk të thashë se Kadiru me at vajzën janë tue pritë këtu. Po dëshirojnë me folë me ty.

— Ani? Pse s'po hyjnë? — tha tue buzëqeshë sekretari.

Kur u çue Stojani me dalë, sekretari e pyeti:

— A patët përkrahje prej popullit për përjashtimin e tyne?

— Prej shumicës — po. Tjerët — disa heshtnin. do kundërshtojshin.

— Kqyrni, mos ju sjellin ndonji dam në bashkimin e popullit.

Tue hy te sekretari, Fatimja nuk mundej me i çue syt prej marres.

— Shum mirë keni bâ. Urime! E sa për gjygj — iu drejtue Kadriut — me marrë çertifikatën prej mjekut se shoqja âsht në moshë për martesë.

— Syla âsht mjeshtër i madh, shok sekretar — tha Kadriu.

— Puna âsht në duer tueja, në duert e kësaj shoqes. Vetëm nëse jeni marrë me qejf!

Kadriu mendonte: „A âsht e mundun me na ndihmue diqysh edhe prej këndej? Ky s'mundet me ia ndalë pushkën as sakicën mos me na mbytë. Thotë: ‚Ai të vret, pushteti e mbyll në burg' — tjetër shka ka me thanë?... Sidoqoftë po ia përmendi."

— Syla âsht kah na kërcnohet... Ti i din adetet e vendit.

Tash edhe sekretari mendoi: „Nji tip i tillë mundet fare lehtë me u sjellë ndonji fatkeqësi. Sa dam i madh do t'ishte për ne! Duhet me pasë kujdes!" — dhe tha me zâ:

— Do të ndërmarrim dishka... Do të kemi kujdes për ju... — dhe shenoi diçka në fletore.

Kadriu e Fatimja duelën shum të kënaqun...

*

Syla hyni tue përshëndetë me dorë në vetullë.

— O, t' u ngat jeta, shok sekretari! — bani Syla.

„Njeri i panjoftun, në sy — plak i pashëm. A thue kush do të jetë?..."

— T'u ngat jeta, urdhnoni!

Syla nxuer kutín e cigareve prej xhepit të setrës dhe ia zgjati:

— Kalle njâ!

— Kam cigare — tha sekretari dhe muer cigaret dhe shkrepsën prej tavolinës tjetër.

— Mos ma kthe nderën, he burrë!

I ndezën cigaret. Syla ia nisi tash me zâ të rrafshtë e ngadalë:

— Ti je si baba i këtij mileti. Na kështu të dijmë ty. Duhesh me ma sosë nji punë krejt të vogël. Ndoshta edhe s'âsht për ty, po, thash të shkoj mâ së pari te ai... Ai âsht mâ i madhi... — dhe heshti tue mendue se ia filloi mirë.

— Nëqoftëse âsht me vend, pse jo?

— Mos me konë me vend, nuk kisha ardhë... nuk të kisha mërzitë... Ti ki punë tjera mâ të mëdha. Por edhe kjo e jemja s'âsht e vogël. Po të flas ty që je Turk... — dhe e qortoi vedin shpejt — Shqiptar që na i din adetet e vendit...

Sekretari ia nguli sŷt.

— Nji dreq ma ka marrë mbesën me zor: tamam kur isha tue e bâ gadi m' e përcjellë... Tash ai, i Livadhësi, po lyp gjak prej meje... Më ka ngujue...

— Ti qenke Sylë Hajdini i Bllatës?

Prej pyetjes së sekretarit muer vesh se ky nuk kishte mendim të mirë për tê.

— Po... unë... a e di... unë i kam dhanë haber hyqymetit. Po... deri të del puna në muhaqeme — thuej milicëve, le ta dajnë prej atij kopili... Nëkoftëse ajo thotë në muhaqeme — edhe ti s'ke shka ban.

— Kam ndigjue për ty. Burrë i mençëm qenke — i tha me ironi. — Punë krejt të vogël po kërkojshe.

Syla nuk e kuptoi, ose ashtu u shtî. Qeshi dhe u mrrol shpejt.

— Unë nuk të ngushtoj ty. Edhe në marofsha unë — ti me humbë vehten për mue — zoti na ruejtë!

Sekretari ziente. Deshti me i folë me zemrim, por vetëm i vrani vetullat dhe u përpoq me e bindë:

— Bota kështu po marrtohet me qinda vjetë. Mbesa jote ka bâ nji punë përparimtare. Ti duhet me ua bâ për hajr.

„A, po ç'më ke mësue?!" — tha syla me vedi. „Ky duhet m' e dijtë se na për këso punësh vritemi. Derdhim gjak. Ndoshta njâ... ndoshta dy... ndoshta... T' i thom. T' ja shtî në mend... mund t' i ketë harrue adetet tona."

— Edhe ti, si njeri i popullit, nuk duhet me lejue që për nji gjâ krejt të vogël — me u derdhë gjak. Këtu mbarim s'ká.

Sekretari u zemrue: „Këtê mund ta bjerë në mend vetëm friga." Mendoi.

— Unë kam faj që mundohem me të bindë! — i tha. — Kê me prû në mend? Sylë Hajdinin, rrogtarin e okupatorit... penguesin e ngritjes socialiste... përfaqësuesin e reakcionit në Bllatë?

Syla i përcillte fjalët e idhta të sekretarit si mos t'a kishte me tê. Tash i bijshin në sy fotografít në mure me mjekrra të mdhá: „Popat e dynjas i paska varë përmbi krye!... — mendoi. — A lypet myhfat prej këtij?" U çue me dalë.

— Për mue, demek, s'paska drejtësí?

— Qe ku âsht gjygji!

— Mirë... Po jau kqyri edhe at drejtësí.

Ndërsa i afrohej derës, ashtu i zymtë, sekretari erdh në përfundim se ky mund të sillte ndonji fatkeqësi.

— Nëqoftëse ti mendon m'u hakmarrë, dije se të gjithëve na ke në shpinë! Jo vetëm ty, por edhe shtëpín me familje kemi me ta djegë! — i tha me zâ të rreptë.

BARI i shpeshtë e i rritun, të cilin e pahiste ngadalë era e mëngjezit të verës, pemët e shumta qufurrake të rendueme njana mbas tjetrës rrugëve të ngushta të parkut — hoqën gadi çdo brengë të Fatimes dhe Kadriut. Ulë në nji bankë, Fatimja. tue u mundue me kapë përnjiheri, me nji shiqim, çdo gjâ — pau për rreth nji pllumb të larëm që fluturoi e ra në nji ndërtesë të madhe, mbas tyne. Pllumbi ktheu kryet disa herë anëve, hapi krahët dhe fluturoi prap e u zhduk mb'at'anë pullázit.

Tash filloi me shique ndërtesën e re dykatëshe me shum dritare. Mandej iu kthye Kadriut:

— Kush rri n'at shpí mbas nesh?

— Gjygji i rrethit dhe prokurorija. Aty kemi m'u gjykue sod.

— Jo, more! — bani ajo. Shiqonte dhe mendonte: „A thue, në cilën sobë âsht ai njeri që kemi

me dalë para tij?... Kush vjen prej shpís?... Ndoshta vjen edhe nana... Sa më ka marrë malli për të! Ishalla s'vjen axha... Dauti e daja — ani... Po të Livadhësit?" — dhe e theri diçka në zemër. „Le vedit po edhe shum kujt i qita punë! Ndoshta vijnë edhe miq tjerë... Akrabaja... Plot njerëz... P' e ha dreqi e po më mshilet goja... Të mbulohem pak... mos të thonë: ‚Paska dalë prej tefterit!' Pse kam marrë njerin që e due — prej tefterit nuk kam dalë" — dhe, tue shique anëve, hoqi çevren e bardhë, që e kishte qitë krahëve, ngrehi shamín dhe e hodhi përsëri çevren mbi shamí, mbuloi flokët, nji pjesë të fytyrës dhe krahnorin. Mandej i ngrehi dimít dhe shiqoi këpucët.

— Pasha zotin, Kadrio, bash më ka hŷ njifarë frige. Kish mujtë ai sekretari yt me na e sosë punën, pa ardhë këtu, m' u bâ maskare... Po, zahere, edhe ai ka hile.

— Sekretari ka punët e veta, e gjygji kqyr të vetat. Ai sa dijti na mësoi. Pse m' u frigue? Thueja ato fjalë: dang, dang dhe — shuej.

— Po ato fjalë „dang dang" po tutëna mos p' i përziej!

Kadriu filloi me dyshue. „S' e ka keq... „Shiqoi anëve nuk kishte njeri afër. „Ta përgadis".

— Në desh mos m' i përzie — a di shka?

— Shka?

— Çou në kambë! — e urdhnoi.

Fatimja u çue, tue e shique me kurreshtje.

— Largou tre hapa!

— Pse m'u largue?

— Largou se po due me të mësue qysh mos me t'u marrë goja.

— He he, — u largue ajo.

— Tash, shka të pyes unë, ti përgjegju drejt.

Fatimja ia bani me krye se e kuptoi. Kadriu e pyeti mrrolët:

— A të ka marrë me zor Kadriu apo me marrëveshje?

— Me qejf e kam marrë. E kam dashtë qe disa vjet.

— Ungju në vend, pra, — i tha Kadriu.

Ajo erdh e ia ngjiti për dore tue qeshë.

— Në koftë për kaq, këto fjalë i kam bâ ujë.

— Asgjâ tjetër, gjykatësi ka m' i thanë atij që shkruen: „Shkrueje", e ty: „Ulu në vend!"

Rrugës, rreth tarabave të parkut, kaloi nji milic. Ai i shiqoi dhe shkoi kah ndërtesa e gjygjit. E kishin urdhnue me u gjetë aty pari derisa të kryhej gjykimi e të shpërndaheshin njerëzit.

Edhe Kadriu shiqoi kah ndërtesa dhe i ndali syt në nji letër të bardhë të ngjitun në nji drrasë të vogël e të zezë, gozhdue për muri.

— Po shkoj pak, tash po kthehem.

— Kqyr, rueju!

— S'âsht gjâ, mos u tut! — tha tue bâ me dorë dhe u largue. U ndal, lexoi letrën e u kthye me vrap.

— A din se edhe Hajrija e paska gjykimin sod!

— Pash zotin?

— Na ishim të parët, e ajo me të Moravsin menjiherë mbas nesh.

— Kush të tha?

— Qe, po shkruente n'at letër, — dhe tregoi me dorë.

Grupi i njerëzve, që vinte rrugës, tue kuvendë gjallnisht, ua tërhoqi vërejtjen.

— Shokët, — tha Kadriu dhe kceu i prekun. Edhe Fatimja u ngrit e hutueme. Së bashku me Rrahimin ishin — Dragutini, Vehbiu, Marku Rama, dy mësues, dy gra të reja dhe dy puntorë t'ekonomis. Me ta ishte edhe sekretari me dy shokë tjerë.

— Këta dy — afër sekretarit — tha Kadriu — janë antarët e komitetit të rrethit. At gruen tjetër nuk po e njof.

Grupi i shokëve iu afrue tarabave. Rama çoi kryet:

— Qe, ku qenkanë! — tha tue bâ me dorë në drejtim të Fatimes e Kadriut dhe hapi derën e tarabave të parkut.

Sekretari me nji grup shkoi kah gjygji, e tjerët u afruen dhe u përshëndetën.

— Iu falemnderit që keni ardhë — tha Kadriu.

— A po i njef Kadri, këto shoqe? — tha Marku tue i tregue shoqet që kishin ardhë me ta.

— Kjo âsht shoqja e mësuesit, e atê tjetrën nuk e njof.

— Kjo âsht shoqja jeme — tha Rama.

— Qysh e more?

— Krejt kollaj. U deshtëm dhe u muerëm. E kemi trashë vllaznimin. Kjo Sërbjane e unë Shqiptar. Të dy jemi puntorë. Kjo punon në monopol e unë në ndërtime. Kjo komuniste, unë komunist. Tash erdhëm në pushim. Muerëm vesh se keni gjykim. Thamë — hajt të shkojmë e t' i ndigjomë.

Fatimja iu afrue dhe e rroku shoqen e Ramës për dore.

— Tybe, shoqe të mirë paske marrë!

Rrugës pranë tarabave u ndigjue prap nji zhurmë. Kadriu çoi kryet:

— Aliu me Hajrijen e Hasani me gruen — tha dhe thirri:

— Hajde këhâ, o baca Ali!

Aliu me Hasanin para e Harija e nusja e Hasanit mbrapa me nga nji çevre të bardhë në krye, hynë në park. Kur erdhën, u shpërndanë në dy grupe: burrat me burra e grât me gra.

— Po ti, baca Ali? Qysh mujti i Moravsi me ia mbushë mendjen gjygjit?

Aliu fshani.

— S' e dij, veç burrë i lig dhe i flliqët ish konë, i bir' i qenit! I rashë në pusull paris me ia dhanë dhetëmijë banka. Mirëpo, ai nuk i muer. Thojke: „Ia kthema nusen, ia kthema çikën që ta kam dhanë për djalin!" Këto, ani, as njana, veç m' i mbytë. Leqë më paditi në gjygj, por as besë nuk po më jep!

— Po sod, a ke besë?

— Deri n'aksham, sa të kryhet muhaqemja.

— Unë i kam thanë Rrahimit: Mos gabo me lypë besë! Kujt t' i bje mirë, bujrum!

— Tash kam m' i kallxue para hyqymetit! — tha Hajrija që ndigjonte me nji vesh fjalët e burrave. — Ka me iu nxî fëtyra mâ tepër se e ka të zezë!

Rrugës vinte edhe nji tubë njerëzish. Në têbinte në sy Syla që mbështetej në shtagën krryle. Mbas tij tundej Dauti, tue i qitë hapat e rrallë me krye ulë. E mbramja ecte nana e Dautit, lidhë nën

fyt nji çarçaf të bardhë të dyfishuem. Syla u ndal te dera e tarabave dhe shiqoi kah parku.

— Të himë atje mbrenda e të pushojmë pak! — tregoi me shtagë kah bankat.

Ende pa u ulë, Dauti shiqoi kah ndërtesa e gjygjit.

— Paskanë mbërri! — tha.

— Kush? — e pyeti Syla mrrolshëm.

— Kush? Ti s' po thue kush nuk paska ardhë! Kqyre grumbullin e njerëzve. Të gjithë udhëheqësat e katundit me ta edhe këta të rrethit.

Syla shiqoi n'at drejtim dhe nisi me krue mjekrrën e parrueme. U ul në bankë dhe u mbështet në shtagë. Grueja u ul galuc e Dauti ende shiqonte kah njerëzit.

— Kqyr, mori ti, po ta merr zoti gojën!

— Ore njeri, e para herë që po dal unë qyqja para hyqymetit!

— Mos u tut, mos të ban zoti mâ qyqe se je. Ti ki me thanë: „Hinë katër vetë me pushkë. Tre hinë mbrenda e njani pritte në çardak. E ndjeva nji zâ si nëpër dhé. Dola jashtë, Rrahimi ma ngrehi pushkën: ‚Mos luej se të vrava!' Unë mbeta në vend. U paka. Kur ata tre duelën prej sobe tue e ngrehë çikën zhag. Ia kishin lidhë gojën me marhamë..." Kaq ke me thanë.

— Fatimja po kqyr nganjiherë këndej — tha Dauti.

— Banja me dorë le t'ikë — tha Syla.

Dauti e çoi dorën. Tue qeshë i dha shêj që të vijë. E lëshoi dorën ngadalë dhe u mrrol.

— Ma pa dorën po e ktheu kryet andej.

— Hê hê! Do me ikë po nuk guxon prej tute. Ani, ani! Sa të hŷjnë në hyqymet... E ti, mori? Ngo këhâ shka po të thom! Thuej: „Ky rrezil e ka thithë gjiun tem sa herë, pa hesap. A thotë allahi me m'u bâ dhandërr, a thotë hyqymeti?"...

Grueja edhe tash mendonte: „Na muer fëtyrën... Duelëm në telall." Këto mendime shtyjshin nga njiherë tjera: „Ndoshta ka bâ mirë?... Nuk kthehet mâ ajo shtrigë e vogël e jes pa ortake. Po t'ja thomë këto fjalë hyqymetit, kanë m' e nda Fa-

timen e shkretë. M' e da prej njerit që e don... M' e çue te i Livadhësi... Me ma kthye shtrigën e vogël..." Nga friga se po e kupton burri, foli me zâ t'ultë:

— Mirë, ore njeri, a na bâjnë gjâ nëkoftëse e shofin se po rrêjmë?

— Po rrêjmë?! Qysh po rrêjmë bre shtriga plakë? Na po iu thomë qysh â konë. Mos po shtojmë gjâ, a? Na po bâjmë dert qysh me e pshtue evladin tonë. Me pshtue njerin fol shka të duesh — s'âsht gjynah!

„Ndoshta mirë e ka. Për dy tri vjet, edhe sa muj me rrënue, mos ta koriti pjellën teme. Të flas shka të më bjen në mend" — mendoi.

— Jo me shtue, jo! Po... ndoshta, hala kemi me thanë ndoj send — tha me zâ.

— Shka kemi hala?

— A e di kur â konë ky dreqi rrogtar te na?

— Po.

— M' i ka pasë vjedhë njiherë tri voe. E Ragushën e milte gadi gjithmonë dhe ia pinte tamblin. Veç hajnit që e bâjnë këtê.

— A p' e shef sa mirë të ka ra në mend. Edhe këtê duhet me ia thanë hyqymetit!

— Lene, pashë zotin! Kjo âsht gjâ e vjetër. Kanë me keshë me né — tha Dauti.

Syla e shiqoi.

— Eja, ungju këtu!

Dauti u ul në skajin tjetër të bankës.

— Të kam thanë: nëkoftëse na del puna ndryshe, mâ mirë se me kërsitë nuk ka. Të dyve mshoju allti.

Grueja kceu në kambë, u zverdhë dhe filloi me u dridhë.

— O, pashë rizan e zotit, njeri, nuk m' i hup këta dy jetima!

— Shuej, bre meçkë! Shpija jonë â konë shpí oxhak e soj. Pjella jote krejt këto na i flliqi. Mujmë me e la vehten para miqve, dashamirëve e vorrit të babës, vetëm nëkoftëse këtë të ligë e lajmë me gjak! — iu ngërmue Syla e me vedi:

„Le të na jetë nji nám!... Le të na përmendin sa të jetë dynjaja, le të na kënojnë në kojkë: E

dhanë jetën për erz e namuz!... I dhamë mend dynjas se qysh nuk duhet me punue..." Mendimet iu përzien kur Dauti i kundërshtoi:

— Të kam thanë se alltija jeme nuk ka me u shprazë në trupin e tyne! — dhe mbasi heshti: — Të kish dhanë pare, pate me shuejtë. Unë nuk qes pushkë për pare.

Syla mblodhi vetullat, bërtiti:

— Edhe ti je i pjellës së saj. Pade këhâ alltín!

N' at ças prej tarabave u ndigjue hoxha:

— Këtu koke aga Sylë, a?

— Po bre — dhe e rrudhi dorën e zbrazët që e kishte zgjatë mę marrë alltín.

Me hoxhën erdhën Rashiti e tre tjerë të parís. Grueja u largue pak prej tyne. Dauti u çue në kambë. U ulën në bankën e Sylës.

— Duelëm sod në pazar. Ndimë se ki muhaqeme. Thamë: Hajde të shkojmë, ndoshta i vjen mirë Sylës, — tha Rashiti.

— Bafshi hajr, bre shokë. Kur ju pashë m'erdh shum mirë. Bash kesh tue u kujtue: Qe, unë po shkoj vetëm në hyqymet, e atij të birit të qenit, i kanë ardhë gjysa e katundit dhe shum gjin' të hyqymetit.

— Jo more! — bani hoxha.

— Qe, ktheu e shihi.

— Shih, shih! — tha hoxha tue shique. — Edhe sekretari koka me ta!

— Apo ma zê atê mâ të mirë se tjerët, a? Edhe ai — qasi malli. Bile të kish m' i kqyrë punët e veta... Po ka ardhë me iu çue krye... Eee, sa njeri po lyp plumb, nuk ka fyshekë! — tha Syla tue fshâ.

Rashiti e preku me brryl. Milici, tue shique kah ata, kaloi me hapa të rrallë. Hoxha ende shiqonte kah grumbulli i njerëzve që ishin para gjygjit.

— Po ai, magari? Shka ka lypë me ardhë prej Shkupit?

— A nuk keni ndie gjâ për tê, a? — tha Rashiti tue u kollitë.

— Jo! Hë?

Rashiti pshtyni përpara dhe e fshini pshtymën me opangë.

— E kish marrë nji Shkinë!

— Me vedi e kish. Ajo ngat grues së mësuesit — tha Syla tue bâ me dorë andej. — M'u ka pasë dukë se ka me dalë dishka prej këtij djali. Mirëpo, këta Shkijet ishin ustallarë. Si p' e shihshin se ndonjani prej nesh po del pak i shpërdhitë, mos mujshin kurrqysh ndryshe, po ia epshin nji grue e p' e kthejshin për vedi. Ky s'âsht mâ i yni. Kish pre thi në shpí të vet.

Në derë të gjygjit duel nji nëpunës dhe thirri:

— Sylë Hajdini, Fatime Hajdini, Kadri Hyseni — le të hyjnë mbrenda. Gjykimi po fillon.

— A kemi të drejtë me hŷ edhe na tjerët? — pyeti dikush.

— Gjykimi âsht i hapët. Kush të dojë le të vijë!

Rrugës kah gjygji shpejtojshin dy vetë me kapuça të zez. Tash u ndalën te tarabat. Ai mâ i riu, që ishte nja njizet vjeç, ishte burri i premtuem i Fatimes, e tjetri — i vllai. I pari e nxuer thikën prej shoke dhe e shtini në çarapë. Vllau mâ i madh i tha:

— Nëkoftëse del ashtu qysh kanë thanë, p' e marrim gruen e po ja bâjmë hallall. As ai as grueja nuk kanë faj. E ka marrë me zor. Po duel ndryshe — ka me pa Sylë Bllata se me kênd âsht rrokë. Mshoj thikë! — dhe, tue vrapue, hynë në ndërtesën e gjygjit.

Mbas tyne hyni edhe Taf Sadiku i Moravës.

*

Të gjitha bankat e sallës së gjygjit u mbushën me publik. Disa i hoqën kapuçat e bardhë ose të zez e, disa pleq, as që i prekën me dorë. Njerëzit që erdhen mâ vonë u ulën kambëkryq në pod, e disa rrijshin në kambë brî murit.

Grupi i Sylës i zû vendet n'anën e majtë. Ngat tyne u ulën hoxha e Rashiti me shokët e vet. Para e mbrapa tyne ishin disa dashamirë të Sylës, shumica nè moshë. Kishin ardhë prej katundeve të

ndryshme me pa e ndëgjue, a thue e ka marrë në qafë ajo, apo edhe ky ka faj në këtë punë. Rrallë kush prej tyne bisedonte. Rrijshin ulë dhe shiqojshin mrrolshëm.

Sekretari, së bashku me Fazliun, u ulën në bankën e parë, n'anën e djathtë. Në bankën e dytë zunë vend Fatimja, dhe Rama e, mbas tyne, aktivistat e katundit. Atje, mâ poshtë, u vendos Aliu me të vetët. Këta bisedojshin dhe qeshnin nga — njiherë. Disa prej tyne ende dyshojshin se, ndoshta, ngjarja nuk ishte zhvillue mu ashtu si flitej. Ndonjani dyshonte n'aftësín e vajzës se nuk do të mundej me u shprehë si duhej. Mund të marrohet. Edhe Aliu rrinte në kujtime të veta.

Gjykatësi hyni me dosjen nën sjetullë. Tue luejtë dorën e djathtë, ai erdh me hapa të shpejtë në vend të vet dhe u ul. Mbas tij hynë dy antarët e porotës. Njani mashkull e, tjetri — femën. Femna u ul në të djathtë e mashkulli në të majtë. Heshtje. Vajza, që u ul afër maqinës së shkrimit, e shiqonte kryetarin tue i mbajtë gishtat në germa. Në tjetrën anë, rreth tavolinës së vogël, u ul edhe prokurori.

— Gjykimi fillon! — tha kryetari i gjygjit. — Ju lutem mbani qetësín! Kadri Hyseni!

— Këtu!

— Ulu në këtë bankë, — dhe i tregoi me gisht bankën e zezë para tij. — Fatime Hajdini!

— Këtu jam! — dhe krye ulun shkoi para kuvendit.

Nana, sa u çue, ia priti me zâ të vogël por që e ndëgjuen të gjithë:

— Oh bijë, zoti të marroftë! Qysh na bane kahër!

Kryetari i tërhoqi vërejtjen për me heshtë.

Burri i premtuem i Fatimes, që rrinte në nji bankë afër derës së bashku me të vllan. mundohej me ia pa fytyrën. Dauti shiqonte publikun nën çerpikë, tue u mundue me ndigjue fjalët që ata bâjshin me njani tjetrin. Kadriu kqyrte në drejtim të kryetarit, kurse shumica e publikut kah Fatimja. Hajrija e vidhte me sy Tafën që ishte ulë në pod.

— Sylë Hajdini! — thiri kryetari.

Syla u ngrit dhe me duer të lëshueme iu drejtue kuvendit. Kryetari u tërhoqi të gjithëve vërejtjen që të heqin kapuçat në zyrë.

Syla e hoqi plisin e mbështjellun me shall bojë kafje, tue thanë me zâ të vogël „Tybe istikfar." I hoqën edhe tjerët.

— Urdhnoni, shok prokuror!

Prokurori u çue nxuer prej dosjes nji tabak letër të shkrueme me maqinë dhe filloi me lexue:

„Më pesë korrik të vjetit njimij e nandëqind e pesëdhetekatër, natën, tue përfitue rastin kur burrat nuk ishin në shtëpí — Kadri Hyseni i katundit Bllatë, i shoqnuem me vllaun e dy shokë të tjerë t'armatosun, kanë hy në shtëpí të Sylë Hajdinit — po t'atij katundi — e kanë nxjerrë prej shtëpís me zor dhe e kanë marrë me vedi Fatime Hajdinin, të lindun më pesë qershuer njimij e nandëqind e tridhetë e tetë në Bllatë. Në këtë mënyrë, Kadriu ka bâ faj penal që dënohet në bazë t'artit njiqind e nandëdhetekatër të ligjit penal. Kësaj padije t'i bashkanjitet edhe çertifikata e datëlindjes së vajzës, lëshue prej këshillit komunal të Gjelekarit, në bazë të librit të gjendjes civile."

Kur prokurori u ul, të Livadhësit shiquen njani tjetrin: „Nuk qenkan fajtor!" Ai i riu, megjithëse nuk e shifte në fytyrë, thuese iu kërcnue Kadriut. Syla u drejtue dhe u kthye me buzëqeshje kah publiku, si me dashtë me thanë:

„Qe, mos më zafshi besë!"

— Tash, — tha kryetari, — Syla dhe Fatimja le të dalin përjashta për nji kohë.

— Hajde këhâ me mixhën tand! — iu kthye Syla Fatimës.

Publiku buçiti. Prej grupit të Sylës u ndëgjue:

— E paskanë marrë në qafë, të ngratën!

E prej grupit të Kadriut:

— Ky tash ose ia mbushë mendjen ose ia ha kryet!

Kadriu u çue dhe shkoi kah Fatimja. Asaj iu drejtue edhe Syla. Fatimja mbeti në hutim. Kryetari ndërhyni:

— Ju dy dilni jashtë! E ti, — iu kthye Kadriut — ulu në vendin tand! — mandej iu drejtue kuririt:

— Leni në dhoma të veçanta!

Kryetari kqyri dishka në dosje para vedit, foli me zâ të vogël me antarët dhe iu drejtue prap Kadriut:

— Çou në kambë!

Kadriu u ngrit, shiqoi mbajtësen e proçesverbalit, të cilës kryetari i bani shêj me krye që të shkruente.

— Ju ftoj n'emën të ligjit që të flitni të vërtetën. Padín e ndëgjuet. Çka keni me thanë për mbrojtjen tuej?

— Nuk âsht e vërtetë se unë e kam marrë me zor mbesën e Sylës, Fatimen.

— Po?

Kadriu uli kryet, heshti për nji çast tue ngurue.

— Fol de!

— Prej vogjlís, qysh se isha rrogtar te Syla, Fatimja dhe unë jemi dasht. Para nji vjeti kemi fillue me mendue seriozisht njani për tjetrin. Qe nji muej që edhe jemi besatue. Me pesë korrik në mbramje ajo erdhi te unë dhe më tha se nuk e ka mendjen me u kthye mâ. E kam dijtë se në librin e amzës âsht rregjistrue e ré, por ajo ka vjet mâ shum.

E Shtini dorën në xhep dhe nxuer çertifikatën e mjekut.

— Qe edhe mjeku e vërteton se Fatimja âsht e aftë për kunorzim.

Kryetari muer çertifikatën, e shiqoi dhe ia dha shoqes antare.

— Ti po thue se nuk e ke marrë me zor, po ajo të ka ardhë vetë në shtëpí?

— Si urdhnoni!

— Në çfarë kohe ajo erdh te ti?

— Kah ora njimbëdhetë, natën.

— A erdh vetëm apo e përcolli kush?

— Vetëm.

— Qysh u muerët vesh? A të thirri, apo ti e pritshe?

— Kur u besatuem se do të mirremi, unë i pata thanë se jam tue fjetë në pleme. Aty erdh, e, bile më gjet tue fjetë.

Kryetari e muer çertifikatën që ia ktheu shoqja dhe ia dha antarit tjetër.

— A keni me pyetë gjâ? — iu drejtue antares.

— Në cilin vend jeni besatue se do ta merrni njani tjetrin? — pyeti ajo.

— Te ekonomija e kooperativës, nën Shelgjet e Shpeshta.

I Livadhësi, ai i riu, e ktheu kryet, e tjetri fshani. Dauti u skuq dhe uli kryet. Nana u nxî.

— A ju ka pa kush te Shelgjet e Shpeshta? — e pyeti antari tjetër i gjygjit.

— Nëkoftëse ka qenë at ditë që kam ikë prej këtyne të Moravës, unë i kam pa — tha Hajrija, tue u çue në kambë.

Kryetari i tërhoqi vërejtjen se nuk guxon me folë pa e pyetë. Aliu e ngrehi për mange që t'ulet. Hajrija shiqoi mrrolët kah i Moravësi dhe u ul.

— Më duket se nuk na ka pa kush, megjithëse kjo ndodhi at ditë kur kjo grue, që foli tash, më ra në dorë që ta mbrojë prej dy njerëzve të panjoftun.

Kryetari i ndërroi disa fjalë me antarët.

— Kjo nuk ka randësí për gjykim! — tha ngadalë. — Ulu! Le të hyjë tash i damtuemi, Sylë Hajdini.

Tue kalue afër Kadriut, Syla iu kthye:

— Rezil bre!

Kryetari e qortori:

— S'ke fjalë me tê, po me mue! Ndalu aty.

Mandej, mbasi i muer gjeneralitetet, iu drejtue prap:

— Si të ka hŷ Kadriu me shokë në shtëpí? Si ta ka marrë mbesën?

— Pooo, zotni gjykatës, e ka çelë derën me mjeshtri. Dy a tre kanë hŷ mbrenda, e njani ka pritë jashtë. Ia kanë lidhë gojën çikës me shervete dhe e kanë qitë jashtë tue e ngrehë zhag.

— Kush e ka pa? Kend e ke dëshmitar?

— Qe, nanën e çikës!

— Kend tjetër?

— Jo, jo, tjetër kush nuk i ka pa.

— Ti, ku ke qenë?

— Unë me nipin tim, Dautin, kemi qenë n'odë me do shokë. Patën ardhë me ndêjtë, e tue bisedue nuk ndiemë se shka u bâ nalt.

Këta të grupit të Kadriut filluen me qeshë, me qenëse shumica e dijshin punën e asaj nate n'odë. Kryetari iu tërhoqi vërejtjen që të heshtnin.

— Kur e muerët vesh se ju kanë marrë mbesën.

— Mbas darke, kur erdh e ama e na kallxoi: Kadrija i Hysenit me vllaun e dy tjerë me armë në dorë na e grabitën çikën!

— Pse nuk e njoftuet at natë pushtetin?

— Ku me guxue me dalë! Na me duer thatë e ata me pushkë. Këta vetë hyqymet zotni gjykatës. Nëkoftëse edhe ju nuk na e drejtoni këtë punë, atëherë drejtësi për ne nuk ka. Po çohemi prej katundit e këta le të zgjanohen.

— Ti, plak, po thue se të kanë hy në shtëpí dhe ta kanë marrë çikën me zor. Dëshmitar tjetër, përveç mbesës sate, Fatimes, nuk na duhet.

— Po qe ku âsht edhe nana e saj!

Nanës filloi me i rrahë zemra.

— Nanën nuk po e pyesim pa e pyetë vetë të zojën.

„Shyqyr!" — bani nana me vedi.

— Thirre dëshmitaren, Fatime Hajdinin! — i tha kuririt që ishte te dera. — A ke me thanë dicka tjetër?

Tash të gjithë shiqojshin kah dera. Secili e ndiente vehten të paqetë dhe të padurueshëm.

— Nuk kam shka me thanë tjetër. Gjyqi duhet m'e pëvetë edhe gruen teme për këtë punë. Duhet me kqyrë se ndoshta ma kanë tutë çikën dhe e kanë shtî me thanë shka s'ta pret mendja...

Tue hy Fatimja, e përcjellun prej qinda sysh, u drejtue kah trupi gjykues. Mbretnoi heshtje e vorrit. Ajo iu afrue mbajtëses së proçesverbalit thuese mendonte se afërsija e saj do t'i bante përshtypje që të shkruente diçka mâ mirë në maqinë. Ndoshta do ta përkrahte luftën e saj edhe si grue përparimtare. Mbajtësja e proçesverbalit i hoqi duerët prej maqinës dhe e shiqoi me simpatí. Fatimja

vuni dorën në tavolinën e saj. Fytyra e kuqe i dukej vetëm në profil.

Hajrija, e mbështetun në brryla, e shiqonte Fatimen. Nana e kqyrte herë me urrejtje herë me përmallim. Ajo nuk ishte mësue me mbetë pa tê asnji orë, e jo mâ me ditë e javë. Tue shique, i rrëshqitën dy pika lot. I fshini dhe shiqoi anësh, e kur pa se sa njeriu shiqonte në drejtim të çikës së saj — e rroki kryet me dorë...

N'at ças u ndigjue zani i kryetarit:

— Çka keni me thanë ju?... Flitni drejt... mos kini frigë prej askujt... jeni dëshmitare.

— S'po dij shka po doni — tha me zâ t'ultë Fatimja.

— Sa vjet i keni?

— Tetëmbëdhetë vjet e gjashtë muej.

— Me tefter keni mâ pak vjet! — i tha antarja e gjyqit.

— Mirë âsht m'e lanë me folë njiherë kjo vetë — u përzie kryetari.

— Vjetët m'i ka zvoglue axha Sylë.

Ajo pjesë e publikut që e përkrahte Kadriun filloi me buzëqeshë e sekretari, i kënaqun, shiqoi shokët e komitetit. Syla i fshini syt me shervetë: A thue âsht e mundun kjo folë kështu? Të Livadhësit e tërhoqën shiqimin. Ai, i riu, e preku vllaun me brryl. Ky e luejti kryet tue dhanë shêj se e kuptoi. Nana e Dauti rrijshin me krye ulë. Hajrija tue u çue nganjiherë gjysëm në kambë mundohej me e pa mâ mirë Fatimen. Aliu herë e shiqonte Sylën që zihej ndër vedi, herë Tafën që rrinte i rrudhun. Kadriu heshte.

— A keni qenë ndonji herë e dënueme?

— Qysh e dënueme?

— A je konë ndonjiherë tjetër para gjyqit, a je konë haps, në burg? — pyeti nji antar gjygji.

Fatimja fshani.

— Sa e mbaj mend — në burg jam konë!

— Mej, bre rrospijë! — briti Syla dhe u nxî në fëtyrë.

— Nëqoftëse i përzihesh në fjalë edhe njiherë të qes përjashta! — i tha kryetari me zâ të naltë.

Fatimes i qitte fytyra gacë.

— Mirë, shoqe, a të ka marrë Kadriu me zor apo jeni marrë me qejf?

— Kadriun e due qe katër vjet. Kam shkue në shpí të tij dhe i kam thanë: erdh sahati, nuk kthehem mâ mbrapa! Këtu po ju thom se pa më pre copë-copë nuk ndahem prej Kadriut.

— Ashtu, bre motër! — bani tue pëshpëritë Hajrija dhe u çue edhe mâ tepër prej vendit. Aliu e ngrehi prap për mange dhe e uli në vend. Tafa e shiqoi me sy shtrembët dhe e ktheu kryet shpejt. Hoxha luente buzët, tue ra shehadet e selavat për hatán e madhe që po i ndodhte dinietit. Ata dy djemt e rij te dera e prekën njani tjetrin me brryl dhe vazhduen me shique me buzë në gaz Fatimen. Prej publikut u ndigjuen fjalë me zâ të vogël: „Trimneshë koka, nuk duhet me ia hangër hakun." „Bravo i qoftë!" „U prish dynjaja, do të na lëshon toka." „Kuku për Turqit e zi, shka na gjet." „Hajmedet për shpín e Sylës!"

Kryetari u tërhoq vërejtjen me e mbajtë qetësín dhe iu kthye prap Fatimes:

— A ke me thanë edhe diçka tjetër?

— Ndoshta Kadriun e mue nuk do të na lanë rahat... po, ani... mâ mirë dy ditë si duhet se gjithmonë në terr!

Syla solli kryet, e dhambët i kërcitën prej zemrimit.

— Shka thueni ju, shok prokuror, në fund? — pyeti kryetari.

— Unë po e tërheqi padín.

— Tash nji pushim i shkurtë. Mbas pak kohe ju komunikojmë vendimin e gjygjit. Dilni jashtë.

Fatimja me Kadriun u bashkuen me shokët që, tue qeshë, bisedojshin ndërmjet vedi, dhe duelën. Kur sekretari erdh te dera, u takue me Dautin.

— Në vend që të jesh kryenaltë që paske pasë këso motre që i kallxoi sot rrugën brezit të rí shqiptar si duhet me vendosë njeriu për fatin e vet, ti je nxî si korb! Mos hyn në nji thes me mixhën tand.

— Demek ty po të duket mirë kjo punë, shok sekretar, a? — tha Syla tue u afrue mâ ngat.

— S'dij se si mund të bâhet mâ mirë.

— Eee, lum na kend e kemi të parë!...

— N'dash lum, n'dash mjer, ky jam. Mos t'u duksha, urdhno e banu ti!

— Besa, i kish pasë hije! — u përzie Rama tue e vû në tallje.

Për rreth qeshën me zâ.

Kuvendi i gjygjtarëve e kreu punën shpejt. Kryetari i ra ziles.

— N'emën të popullit — filloi me lexue nji letër të shkrueme me maqinë dhe të gjithë u çuen në kambë — gjygji i rrethit të Vitinës muer këtë vendim:

Të hidhet poshtë padija e Sylë Hajdinit si e pavend, e t'u bâhet e mundshëme Fatime Hajdinit dhe Kadri Hysenit që të martohen njani me tjetrën... Arsyetim...

— A don me u ankue?

— Kujt me iu ankue?! Ju po ia kepshi njerit këmishën pa ia matë! Po, ani, se zoti s'thotë shka thotë insani... — tha Syla.

— Ky gjykim me kaq mbaroi — përfundoi krye tari.

Grupi i njerëzve që e përkrahshin Sylën, duelën të shpartalluem nji nga nji pa bâ vër me gojë. Ndër të parët Rashiti e hoxha. Të Livadhësit shpejtuen me dalë jashtë. Duelën edhe Syla, Dauti dhe e ama.

Nji puntuer i kooperativës, grueja e mësuesit dhe Dragutini, të cilët nuk muerën pjesë në komunikimin e vendimit të gjygjit, i pritën Fatimen e Kadriun te dera e sallës me dy bohçe të vogla. Njanën bohçe puntori ia afroi Kadriut.

— Ju nuk keni pasë kohë as mundësi m'u bâ gadi për darsëm. Këto dhuratë e keni prej shokëve të katundit.

Edhe grueja e mësuesit ia dorëzoi dhuratën Fatimes.

Këta dy, të habitun, i muerën bohçet tue shique njani tjetrin. U kthyen kah ata dhe ua shtrenguen dorët. N'at çast duel edhe mbajtësja e proçesverbalit.

— Hajdeni në zyrën time e vishuni me nji rendi.

*

Kur Syla zbriti te dera e ndërtesës së gjygjit, u ndal dhe i tha Dautit me zâ të vogël:

— Mos luej prej këtuhit! Në këtë vend do t'jau humbim fijen!

Dauti u ndal dhe luejti kryet, tue i dhanë me kuptue se nuk pajtohej me të. Mandej shiqoi për rreth:

— Të Lidvadhësit dishka nuk po rrijnë urt, po hec të shkojmë.

Të Livadhësit, tue u shty ndër njerëz, iu afruen Sylës. Fytyrës ishin nxî aq fort sa nuk mund t'i ndajshe prej kapuçave të zez. I madhi ia lëshoi syt e kuq, e i vogli i rrinte mbrapa.

— Po tash, mik, shka po thue?

— E patë vetë, bre mik, se faji nuk âsht te unë.

Nana e rroki Dautin për dore dhe e tërhoqi. Dauti u largue dy hapa dhe ia bani nanës me dorë që të pritte.

I Livadhësi u mrrol:

— Ndoshta faji âsht te unë. Te unë që ta kam dhanë motrën fëmi tue të zanë besë se ke me ma dhanë mbesën për vlla. Kur e din se ke asi gjaku, pse miqasohesh me hallk? Ma ke përjargë motrën nji motmot e mbesa jote po merr tjetër kend!

— Më le rahat — i tha Syla me zâ t'ultë. — Qe tash ki me pa se shka kam me bâ. Ke me besue se nuk kam hile në këtë punë.

— Ke pasë kohë deri tash, po s'ishe konë kërkushi!

Syla shiqoi rrotull. Disa njerëz përcillshin fjalët e tyne, e ky iu kthye të Livadhësit përsëri me zâ të vogël:

— Mos u poshtno, bre mik, po më le rahat se jam tue u bâ gadi me njxerrë hak e me e zbardhë fytyrën teme dhe tanden — dhe shiqoi kah rrugina e djathtë e ndërtesës a po vijshin Kadriu dhe Fatimja. I Livadhësi iu afrue dhe mâ ngat.

— Po i poshtër e me faqe të zezë ishe konë, breee!

Syla i zbardhoi syt e u zverdh në fëtyrë. Filluen me iu dridhë duerët, me të cilat e shtrengoi shtagën krryle.

— S'po të vjen marre me folë kështu, bre qen!

— Pos ti qen dhe i bir' i qenit, bre surroshi plak!

Syla e çoi shpejt shtagën dhe u mat me i ra, por i riu që rrinte mbrapa e nxuer thikën. Dauti u kap për pishtole. Milici, me pishtole në dorë, iu bërtiti:

— Mos lueni!

Ia muer të Livadhësit thikën, Dautit pishtolen dhe Sylës shtagën. Shtagën e hodhi dikund larg, e pishtolen dhe thikën i shtini në xhep. Mandej nxuer fletoren e lapsin dhe i muer në shënim.

— Hajt shkoni tash i paraqiti në milici. Përpara!

Syla, i zemruem që nuk mujti me u hakmarrë e mblodhi trupin e shkurtë dhe muer rrugën. Sa i qiti pesë gjashtë hapa të shpejtë, iu afrue Rashiti e hoxha me dy shokë tjerë.

— S'po ban me zor, bre vlla. Edhe hyqymeti po ua jep krahin! — tha Rashiti.

— Në mujshin m'e i ruejtë gjithmonë le t'i ruejnë, e unë në këtë vend po jau api nji besë se veç në hifshin kah kanë dalë se Sylë Hajdini pa e hjek këtë marre nuk ka me e lanë!

Nana e kapi Dautin për krahu dhe e shtyni para vedit.

— Hec se ke tue marrë vehten në qafë e tue ma përvlue zemrën përgjithmonë.

Para se me kthye mbas nji ndërtese, nana, tue ecë ngadalë, kqyri mbrapa. Atje i ranë në sy Fatimja e Kadriu, të veshun me rrobe gjysëm qytetare, tue dalë prej ndërtesës së gjyqit.

*

Tafa, kur e pat paditë Hajrín, ishte i bindun se ajo do të kthehej te ai në Moravë pa dalë para gjygjit.

„Ka me u frigue! — mendonte ai. — Do të marrohet me folë para hyqymetit".

Por tash, kur e ndigjoi gjykimin e Fatimes, ndryshoi kryekëputë. Duel shpejt prej ndërtesës së gjygjit dhe filloi me u endë me zemrim aty pari.

„Ka me ma drrasue në sy — shtoi me vehte. — S'len gjâ pa më thanë... flet mâ zi se ajo...

ndoshta flet edhe për atê?!..." — dhe iu kujtuen fllaniku e çardaku. „Mâ faqe e bardhë me hjekë dorë se me ma marrë fëtyrën... Le ta hajë dreqi mallin e robin!... Por a thue muj se?"... — e n'at ças pa Aliun mu te dera e gjygjit.

— A po afrohesh pak, Ali!

Aliu u afrue, tue u rrudhë.

Tafa ia zgjati dorën dhe e muer ngryk.

— Banma hallall që të kam mundue deri sod. Çikës sime ia pashë hajrin! Unë tanden nuk due me e mbajtë me zor. Je i lirë. Shko ku të duesh dhe kur të duesh.

Tafa shkoi në gjygj me tërheqë padín, e Aliu iu bashkue grupit të Kadriut.

FJALORI
I TURQIZMAVE QË KA PËRDORË VETË AUTORI

adet — zakon, doke
alejkymy selam — përgjegje e përshëndetjes fetare arabisht
allah emrile pejgamber kaullille — me urdhën të zotit e pëlqim të profetit
asllan — luan
asker — ushtar
ashiqare — çiltas
bedat — trillimi, çpikje
beli — cok, me të vërtetë
besharet — përçudnim
bërllog — pleh, bazhgare
bogosi — lloj peni për bamjen e pëlhurave të ndryshme
burushuk — i rrudhun (dorza ase jaka e këmishës me ojme)
dallash — gabim
demek — don me thanë
ders — mësim
devër — kohë
dynja — botë, gjithsi

ejvalla — lamtumir, falemderës
elfatiha — fundi i lutjes fetare arabisht
elvida — ndamja me dhimbje të ndijshme
eudhubil, bi lahi minesh-shejtani rraxhim, bismilahi rrahmani rrahim — hymje në lutje fetare.

gafur — i tmerrshëm, rreptë,
gjégat — djega, marak
gjymbysh — gazmend, dëfrim
gjynah — mkat

hajvan — kafshë
hallajkë — lahpere
hak-u — e drejtë
hajlaz — i mbrapshtë
hatá — e zezë e madhe

hala — endè
hallk — turmë
haritë — hartë
herife — thirrje e pavehtsueme
hesap — llogari
hedije — dhuratë
hudut — kufi
hygjym — sulm
idare — pasuni sa për jetesë
iftibarli — njeri që gëzon nderë, respekt
ikram — nderim, respekt
ilahi — kangë fetare
inqar — mohim
insaf — mëshirë
itát — nderim
jasin — lutje fetare — pjesë e randsishme prej kuranit
jemek — gjellë
kabahat — faj
kabull — pranì
kalenicë — sqyre, çanak,
kapixhik — derickë
kaskanllëk — zilí, smirë
kojshí — fqij
kollaj — lehtë
lajk — i ngarkuem me të këqija
lezet — shije
marifet — zotsí, aftsí
mejtep — shkollë fillestare fetare
maskare — zvetnim, çnjerzim
manxhe — gjellë, haje
mexhbur — detyrim
meselà — për shembull
mësit — shkues
milet — popull
muhabet — kuvend
munasip — pajtesë, arsye
munafikllëk — shtimje, spiunim
mutllak — pikrisht, sigurisht
myhmat — furnizim
myhlet — afat
myzevirllek — dyftyrsí, hipokirizí
myzhde — dhuratë që i jipet lajmtarit që bjen nji lajm të gëzueshëm .

orta — i ndërmjemi
përokolla — për rreth, përqark
pishman — pendim
qefin — pëlhurë me të cilën mbështjellet i vdekuni
qitap — libër
razi — pajtim, pranim
rrahim — i mëshirshëm
sajdi — nderim
sandek — arkë
sebep — *shkak*
sebepxhi — shkaktar
sefte — për të parën herë
selamun alejkum — përshëndetje fetare arabisht
selavat — lutje fetare jo e detyrshme
serbez — lirisht
Sham — Damasku
shervete — shami
shehadet — lutje fetare e detyrueshme per musliman
sheriati — ligj fetar
shudetxhi — i pa mëshirshem, i tmerrshëm
shybeli — i dyshimtë, dymendjesh
shybe — dyshim
tabut — arkivol
talkin — lutje fetare që i këndohet t'vdekunit mbassi t'varroset
takam — servis, komplet për kafe etj.
trapazan — vend i çuem me dërrasa në të hymë të dhomës
tullusum — ves, pikë
tybeistikfar — përbetim, mohim
uligje — plak i katundit, njeri në kohë
vakt — kohë
vaktile — me kohë
vatan — atdhé
vaz — predikim, ligjëratë fetare
xhehnet — parajs
xhemat — turmë, popull që kryejnë detyrat fetare
xhenaze — kufomë, i vdekuni
xhezá — dënim
xhuma — e premte
ymyt — shpresë
zina — thyes kunore, kunorë thyemje, shkelje kunore

SINAN HASANI
RRUSHI KA NISË ME U PJEKË

Redaktori teknik:
NIKOLLA VUÇINIQ

Korektor:
RAMADAN HASHANI

Madhsija 16 tabakë shtypi — Tirazhi 2000 copë

U shtyp në muejin mars të vjetit 1957 në shtypshkrojën e Shtëpis botuese — „Milladin Popoviq" — Prishtinë.